




REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT



# **RAPORT VJETOR**

## **Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit**

**1 Janar – 31 Dhjetor  
Viti 2015**



Tiranë, Shkurt 2016



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

## **RAPORT VJETOR**

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit**

**1 Janar – 31 Dhjetor**

**Viti 2015**

**Tiranë, Shkurt 2016**

## **Fjala përshëndetëse e Avokatit të Popullit**

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë,

Të nderuar deputetë dhe deputete,

Në mbështetje të nenit 63, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26, të Ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, kam nderin që, në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t’ju paraqes raportin për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2015. Ky Raport është një analizë e detajuar, si dhe një përmbledhje integrale e përpjekjeve të institucionit që drejtoj në përmbushje të Misionit për mbrojtjen e lirive dhe të drejtave të njeriut. Ky raport është një mundësi për të vlerësuar progresin, por edhe për të krijuar një këndvështrim kritik mbi qasjen ndaj respektimit dhe garantimit të të drejtave të njeriut në vend. Gjithashtu, raporti reflekton përpjekjet dhe punën që institucioni ynë ka realizuar për të mbrojtur dhe promovuar më tej këto të drejta.

Mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut, është një rrugë e vështirë. Ajo kërkon një njohje të mirë të rreziqeve dhe sfidave me të cilat përballësh në një vend të politizuar. Në shumë raste kritikata tona nuk pranohen, keqkuptohen e madje konsiderohen si sulme personale. Ndaj të gjithë duhet të ndiejmë detyrimin dhe përgjegjësinë për ta ndryshuar këtë realitet dhe të jemi të hapur ndaj opionencave me fakte dhe argumente, si pjesë e kulturës demokratike, që lidhet direkt me të drejtën, por edhe respektin për institucionet e pavarura.

Është domosdoshmëri që ne të angazhohemi të gjithë bashkë, për rritjen e ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit të të drejtave të njeriut nga ana e publikut, institucionet e administratës publike dhe aktorët e tjerë në shoqëri, duke krijuar një ambient mikpritës dhe demokratik për çdo qytetar.

Me respekt,

**AVOKATI I POPULLIT**

Igli TOTOZANI

## PERMBAJTJA

	Faqe
Fjala pershendetëse e Avokatit të Popullit	3
<b>KREU 1</b>	4
Përmbledhje ekzekutive - Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2015	
<b>KREU 2</b>	20
2.1. Roli parandalues në shkeljen e të drejtave të personave të privuar nga liria	
2.1.1. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet	
2.1.2. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet	
2.1.3. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionet Penitenciare	
2.1.4. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar, arrestuar në njësitë policore	
2.1.5. Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura	
2.1.6. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike	
2.1.7. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve	
2.2. Roli Parandalues i Institucionit të Avokatit të Popullit në shkeljen e të drejtave të njeriut në fusha të tjera të veprimtarisë së tij	30
2.2.1. Inspektime për respektimin e të drejtave të fëmijëve në institucione	
2.2.2. Inspektime në qendrat e përkujdesit social të personave me aftësi të kufizuara	
2.2.3. Inspektime në Institucionet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit	
2.2.4. Inspektime në Spitalet rajonale	
<b>KREU 3</b>	
Roli mbrojtës i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut dhe objektivat sociale	33
3.1. Respektimi i të drejtës së pronës dhe procedurat e legalizimeve	33
3.2. Respektimi i të drejtave të shtetasve nga organet e qeverisjes vendore	39
3.3. Respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar në njësitë policore dhe çështje të tjera që lidhen me këto institucione	44
3.4. Respektimi i të drejtave të personave e arrestuar, dënuar në institucionet penitenciare	46
3.5 .Rastet e tortures, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare	
3.6. Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor	
3.7. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative	
3.8. Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës	
3.9. E drejta për informim	
3.10. E drejta e sigurimeve shoqërore	
3.11. E drejta për kujdes shëndetësor	
3.12. E drejta për arsimim	
3.13. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim	
3.14. Ndihma ekonomike	
3.15. Synimi për një mjedis të shëndetshëm	
3.16. Mbrojtja e konsumatorit	

#### **KREU 4**

Roli i Avokatit të Popullit tek grupet në nevojë	81
4.1. Fenomeni i gjakmarrjes në Shqipëri	81
4.2. Gjendja e të drejtave të minoriteteve në vend	
4.3. Të drejtat e grave në Shqipëri	
4.4. Të drejtat e fëmijëve	
4.5. Të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara	
4.6. Të moshuarit	
4.7. Ish të përndjekurit politikë dhe dëmshpërblimi financiar	
4.8. Të drejtat e Komunitetit LGBTI (Interseks)	

#### **KREU 5**

Roli promovues/proaktiv I Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut	94
5.1. Shërbimet ndaj qytetarëve nëpërmjet rritjes së rolit proaktiv të institucionit dhe funksionimit të zyrave rajonale	94
5.2. Nxitja e të drejtave të njeriut në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Raporteve të Veçanta	
5.3. Investimi i Gjykatës Kushtetuese nga Avokati i Popullit për rivendosjen në vënd të të drejtave të shkelura	
5.4. Roli i institucionit të Avokatit të Popullit në dhënien e mendimeve dhe Komenteve për draft-ligjet për vitin 2015 në mënyrë proaktive, ose me kërkesë të institucioneve përkatëse	
5.5. Forcimi dhe bashkëpunimi me median dhe median sociale; Revista e institucionit	106
5.6. Roli proaktiv dhe bashkëpunues i Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse	
5.7. Aktivitete promovuese në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut	

#### **KREU 6**

Disa nga çështjet kryesore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015 në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut	112
6.1. Monitorimi i zgjedhjeve dhe rekomandimet përkatëse për kuoten gjinore	112
6.2. Çështja e Legjislacionit të pronave	
6.3. Çështja e Marinzës	
6.4. Çështja për shpërnguljen me forcë të komunitetit rom	
6.5. Çështja e strehimit të minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian	
6.6. Politika Penale	
6.7. Çështjet të cënimit të të drejtave të personave të ndaluar, të paraburgosur dhe të dënuar	
6.8. Çështjet e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT)	
6.9. Largimet nga Administrata publike, në pushtetin vendor dhe qendror, testimi, etj	
6.10. Çështje të lidhura me kalimet e paligjshme të kufirit, procedurat e kërkimit të azilit dhe të përfitimit të statusit të refugjatit	
6.11. Energjia elektrike	
6.12. Çështjet kryesore në vizitën në fshatin Lazarat, Gjirokastrë	
6.13. Përmblytjet dhe procedura e dëmshpërblimeve	

## **KREU 7**

Sfidat dhe arritjet në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të popullit për vitin 2015	132
7.1. Vështirësitë e hasura në marrëdhënien me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit	133
7.2. Vështirësitë dhe arritjet në marrëdhëniet me qytetarin	
7.3. Sfidat në bashkëpunimin me median dhe shoqërinë civile	
7.4. 15-vjetori i Avokatit të Popullit	138
7.5. Konferenca Kombëtare e Avokatit të Popullit	
7.6. Vlerësimi me statusin A të institucionit të Avokatit të Popullit	

## **KREU 8**

Avokati i Popullit dhe veprimtaria ndërkombëtare	143
8.1. Institucioni i Avokatit të Popullit në mbajtjen e Presidencës së AOM	144
8.2. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare	
8.3. Përfaqësimi i institucionit të Avokatit të Popullit në aktivete ndërkombëtare	
8.4. Lista e anëtarësimeve	
8.5. Ndërveprimi me institucionet dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut	
8.6. Bashkëpunim i Avokatit të Popullit në rrafshin dypalësh	
8.7. Ngritja e kapaciteve të stafit dhe vizita studimore	
8.8. Mbështetja e Mbretërisë së Danimarkës për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit	

## **KREU 9**

Institucioni i Avokatit të Popullit në shifra për vitin 2015	157
9.1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative	157
9.2. Realizimi i buxhetit të Institucionit për vitin 2015	
9.3. Donacionet	
9.4. Statistika përmbledhëse të ankesave dhe trajtimit të tyre për vitin 2015	164

## KREU 1

### Përmbledhje ekzekutive - Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri për vitin 2015

Avokati i Popullit si një institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është një garanci kushtetuese për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit, shtetas shqiptarë, të huaj, rezident të rregullt, ose jo në Shqipëri, refugjatë, si dhe të personave pa shtetësi, që ndodhen në territorin e Republikës së Shqipërisë, nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj.

Institucioni Avokatit të Popullit është krijuar më 1998, me miratimin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 dhe në vitin 1999, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, “Kodi i Procedurave Administrative” (nr. 8485, datë 12.5.1999), ligji “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” (nr. 9888, datë 10.3.2008), ligji “Për mbrojtjen e konsumatorit” (nr. 9135, datë 11.9.2003), “Për shëndetin mendor” (nr. 44/2012, datë 19.4.2012), si dhe ligji nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara”, përbëjnë bazën ligjore, ku përcaktohen thujtë të gjitha të drejtat dhe detyrat funksionale të Avokatit të Popullit.

Në veprimtarinë e tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, konfidencialitetit, profesionalizmit dhe pavarësisë, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit. Pavarësia e institucionit është një tipar i garantuar, në radhë të parë tek parashikimi si institucion i pavarur, i parashikuar shprehimisht në Kushtetutë. Avokati i Popullit, ofron oponentë për mirëqeverisje dhe tipar themelor i Avokatit të Popullit është pavarësia nga Qeveria dhe nga çdo ndikim politik.

Nëpërmjet kësaj përmbledhje ekzekutive, kemi si qëllim që të japim një paraqitje përmbledhëse dhe transparente të konstatimeve dhe gjetjeve të nxjerra gjatë vitit 2015, si dhe dhënien e opinioneve dhe rekomandimeve të përgatitura gjatë këtij viti për gjendjen dhe përmirësimin e situatës së të drejtave të njeriut në vend.

Gjatë vitit 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur një sërë arritjesh përsa i përket një bashkëpunimi të mirë me median; bashkëpunim të frytshëm me shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtarë; në rritjen e besimit të qytetarit tek Institucioni i Avokatit të Popullit duke e parë si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të tyre; krijimi i një profili Institucional proaktiv në identifikimin dhe ndjekjen e çështjeve; qasja ndaj problematikave dhe diskutimi konkret nga ana e të gjithë aktorëve për çështjet e mbarëvajtjes së qeverisjes vendore.

Arritje jo vetëm e Institucionit të Avokatit të Popullit por e gjithë vëndit, ishte akordimi për herë të tretë i “Statusit A”, si niveli më i lartë vlerësues i institucioneve kombëtare të mbrojtjes të të drejtave të njeriut.

Por sfidë mbetet ende zgjidhja e problematikave të shtetasve që adresohen tek Institucioni i Avokatit të Popullit, ku shpesh *mospërgjigja dhe mosbashkëpunimi nga Institucionet shtetërore* e rëndon më tepër. Shqetësues mbetet fakti i ekzistencës së një numri të lartë rekomandimesh për të cilat nuk është kthyer fare përgjigje, pavarësisht insistimit tonë të vazhdueshëm. Gjatë vitit 2015, rezulton se nga 349 rekomandime të adresuara në total, 68 janë pa përgjigje; 54 Rekomandime të Refuzuar, 160 Rekomandime të Pranuar; pjesa tjetër në proces shqyrtimi.

Problematike mbetet dhe moskthimi i përgjigjeve të shkresave për shpjegime nga institucionet shtetërore duke penguar kështu hetimin administrativ që kryhet nga ana jonë. Në shumë raste

***institucioni i Avokatit të Popullit është penguar nga institucionet shtetërore për të kryer hetime administrative të filluara***, duke penguar konkretisht aksesin fizik dhe ushtrimin e detyrës të ekspertëve të MKPT-së, për kryerjen e konstatimeve dhe verifikimeve në vend gjatë dy hetimeve të kryera, në IEVP Lezhë dhe IEVP “Mine Peza”, Tiranë, si dhe në një rast pengesa gjatë një hetimi në DPV Tiranë, me vonesa në dhënien e aksesit, për të marrë kontakt dhe shqyrtuar dokumentacionin përkatës; apo edhe me krijimin e vonesave në dhënien e aksesit për të marrë kontakt dhe shqyrtuar dokumentacionet përkatëse, si p.sh në rastin e prishjes së ndërtimeve pa leje nga IKMT (ish INUK), mosdhënies së informacionit nga Drejtoria Arsimore Rajonale Durrës.

Për vitin 2015, nga numri total i shkresave 2857, 211 mbeten pa përgjigje, duke mbajtur parasysht që në disa raste shkresat janë dërguar më shumë se një herë institucioneve shtetërore. Evidentojmë me shqetësim se, jo në të gjitha rastet jemi vënë në dijeni ose njoftuar, për të dhënë mendimet tona për projekt ligje dhe akte nënligjore. Por, vlen të përmendim dhe raste pozitive të cilat kanë bërë efektive veprimtarinë e Institucionit tonë siç është miratimi i dy Rezolutave të Kuvendit të RSH-së për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes, dhe të drejtat e LGBT-së, falë diskutimit të raportit të veçantë të Avokatit të Popullit për këtë çështje në komisionin parlamentar. Gjithashtu Kuvendi ka përfshirë sugjerimet e bëra nga ana jonë për ndryshimet në kodin e punës dhe specifiku për ngacmimet morale në punë.

Gjatë këtij viti, nga Institucioni i Avokatit të Popullit janë trajtuar në total 4203 ankesa, kërkesa dhe njoftime (*duke përfshirë dhe ato të pritjes së qytetarëve*). Ankesa, kërkesa, njoftime gjatë vitit 2015 që kanë qenë pjesë e objektit të institucionit të Avokatit të Popullit janë 2735 gjithsej. Nga zyra e pritjes së qytetarëve, 1112 ankesa i janë dhënë përgjigje menjëherë, ndërsa 356 ankesa i janë dhënë përgjigje në formën e këshillimeve shkresore.

Nga të dhënat, rezulton se 70 ankesa jashtë juridiksionit, 94 ankesa jashtë kompetence, 473 ankesa të pabazuar, 51 Ankesa me heqje Dorë, 510 Ankesa të Pranuara pa Rekomandim (*të zgjidhura në favor të qytetarëve*).

Ndërkohë, ankesat e shqyrtuara sipas seksioneve janë:

Seksioni i Administratës	1125 ankesa
Seksioni i Veçantë	672 ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	807 ankesa
Njësia e parandalimit të Torturës	131 ankesa


Institucioni i Avokati i Popullit edhe këtë vit është përpjekur të jetë një hap përpara me ndjekjen e problematikave të shumta që shqetësojnë qytetarët. Në këtë kuadër jemi përpjekur të shfrytëzojmë sa më mirë kompetencat e dhëna nga ligji organik për fillimin e ndjekjes së çështjeve me inisiativë.

Larmia e çështjeve të ndjekuar me inisiativë dhe vëzhgimi analitik i fenomeneve të ndryshme, kanë paraprirë ndërhyrjet që ndikojnë, qoftë në përmirësimin e sistemeve që gjenerojnë realizim të të drejtave, qoftë në adresimin dhe zgjidhjen e çështjeve individuale.

Roli proaktiv është konsideruar si pjesë thelbësore e reagimit që institucioni kryen në punën e tij. Parë në këtë këndvështrim edhe numri i rasteve me inisiativë është rritur.

Më konkretisht në vitin 2011 ka patur 153 raste, në vitin 2012 - 195 raste, në vitin 2013 – 173 raste, në vitin 2014 – 192 raste , në vitin 2015 – 235 raste me inisiativë. Në mënyrë grafike, këto të dhëna paraqiten në tabelën e mëposhtme).





Gjatë këtij viti, Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë proaktive dhe me kërkesë të disa institucioneve vendimmarrëse ka dhënë mendimet dhe sygjerimet e tij lidhur me një sërë projekt ligjesh dhe aktesh të tjera në proces miratimi.

### ***E drejta e pronës***

Respektimi i së drejtës së pronës private, nuk është në nivelin e parashikuar në aktet ligjore dhe nënligjore, për shkak të mosrespektimit nga ana e organeve të administratës publike të parimit të ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të drejtave të personave privatë, eficientës dhe deburokratizimit. Problematike gjatë vitit 2015 për të drejtën e pronës konstatohet: proces i tejzgatur për kthimin dhe kompensimin e pronës, tek ish pronarët; Mosregjistrim veçanërisht i titujve të pronësisë të parashikuar në nenin 196 të Kodit Civil; Rregjistrimi fillestar i pronave në mënyrë të pasaktë nga ana e ZVRPP-ve; Moskryerja e procedurës së kalimit në pronësi të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.8.1991, e të truallit funksional të tyre, në rastet kur nuk posedohen akte të fitimit të pronësisë. Problematike paraqitet situata edhe në veprimtarinë e zyrave vendore të rregjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe në dhënien e shërbimit ndaj qytetarit.

Problematikat që ka mbartur ndër vite procesi i kthimit dhe kompensimit të pronës, lidhen sa me përmbajtjen e akteve rregullatore, aq edhe me procedurat e ndjekura nga ana e organeve përgjegjëse për mbarëvajtjen e procesit. Për të gjithë problematikën e konstatuar në lidhje me ecurinë e procesit të kthimit dhe kompensimit të pronës, Avokati i Popullit ka paraqitur në muajin Nëntor 2015, një Raport të Veçantë, “Mbi problematikat që lidhen me të drejtën e pronës”, ku edhe jepen rekomandimet për përmirësimin e situatës.

Ndërkohë në opinionin e Institucionit të Avokatit të Popullit, projektligji i paraqitur nga Këshilli i Ministrave dhe tashmë i miratuar nga ana e Kuvendit, me Ligjin nr.133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, nuk i jep zgjidhje të drejtës së pronësisë, në respektim të parimeve bazë kushtetuese.

Në gjykimin e Avokatit të Popullit ky ligj kufizon të drejtën e kërkimit të pronësisë me një afat prekluziv, pavarësisht faktit se kjo e drejtë njihet si e paparashkrueshme; nuk parashikon

mundësinë e njohjes dhe kompensimit të pasurisë së luajtëshme të konfiskuar ndaj subjekteve pronarë; nuk parashikon kthim të plotë fizik të pronës; përkeqëson metodikën vlerësuese të pronës që do të kompensohet, si dhe mënyrën e trajtimit të kërkesave të paraqitura prej vitesh tashmë në AKKP, pa përjashtuar ekzekutimin e vendimeve që janë prej këtij organi deri më sot; si dhe ndryshon disa procedura që lidhen me kompetenca të AKKP-së, apo të afateve të regjistrimit të vendimeve të këtij organeve pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive. Ky ligj nuk respekton në thelb konceptin e së drejtës së pronësisë. Për më tepër, diskutimi i projektligjit të miratuar me Ligjin nr.133/2015, nga ana e Kuvendit, është bërë pa diskutuar më parë Raportin e Veçantë, të Avokatit të Popullit, “Mbi problematikat që lidhen me të drejtën e pronës” dhe për rrjedhojë pa marrë në analizë, gjetjet, konstatimet dhe rekomandimet e bëra nga ana e Avokatit të Popullit, në këtë raport të veçantë.

Për të gjitha arsyet e cituara më sipër, nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit po përgatitet dhe do të dërgohet në Gjykatën Kushtetuese, një kërkesë për shfuqizimin e Ligjit nr.133/2015, “Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

### ***Administrata publike dhe mbrojtja e të drejtës së punës***

Reforma në Administratën Publike mbetet një nga prioritetet bazë për integrimin e vendit në strukturat evropiane. Kjo nënkupton një shërbim civil me nëpunës civil profesionistë, të cilët garantojnë pavarësinë, integritetin, transparencën dhe cilësinë u garantohet qëndrueshmëria dhe ecuria në karrierë. Në ndjekje të problematikave që kanë shoqëruar reformën në Administratën Publike, Avokati i Popullit ka depozituar në Kuvend dy raporte të veçanta për “Administratën Publike dhe Rregullimin e marrëdhënieve të punës”, dhe është në proces konsultimi për raportin e III-të të veçantë, si dhe në proces draftimi të raportit të IV, me fokus vetëm për punonjësit e pushtetit vendor. Nga të dhënat e pasqyruara në raportet e veçanta, evidentohet se për periudhën shtator 2013 - maj 2015, ka një numër total prej 4093 punonjësish të larguar nga Administrata Publike. Nga të larguarit, 1021 gëzojnë statusin e nëpunësit civil dhe 3072 janë punonjës që trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Nga të dhënat e marra nga Gjykatat administrative dhe ato të Apelit administrativ, për periudhën Shtator 2014 - Maj 2015 rezulton se janë 762 vendime për dëmshpërblime financiare për largime të padrejta nga puna dhe 23 vendime, për rikthim në punë të nëpunësve të larguar.

Vazhdojnë të konstatohen parregullsi në procedurat e largimeve nga puna veçanërisht në kuadër të proceseve të ristrukturimit të institucioneve. Vendimet gjyqësore të formës së prerë për rikthim në vendin e mëparshëm të punës, mbeten ende të paekzekutuara.

Parregullsi janë konstatuar në rastet e zgjidhjes së marrëdhënies së punës për shkak të ristrukturimit të institucioneve në nivel vendor, e lidhur kjo më së shumti edhe me reformën administrative – territoriale. Ne kemi gjykuar se, zbatimi i kësaj reforme nuk përbën shkak për përfundimin e marrëdhënieve të punës sepse, deri në datë 31.12.2017, në çdo njësi administrative funksionon administrata e njësisë vendore dhe kjo strukturë do të vazhdojë të jetë pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë. Në shumicën e njësive të pushtetit vendor nuk janë krijuar ende komisionet e ristrukturimeve për nëpunësit civil.

Avokati i Popullit ka ndjekur në kuadër të ecurisë së marrëdhënieve të punës, procedurën e testimin të mjekëve dhe infermierëve në të gjithë sistemin shëndetësor në vend duke gjykuar se, ky testim është në kundërshtim me ligjin dhe ndër të tjera, shkel parimin e “sigurisë juridike”.

Sa i takon reformës për testimin e mësuesve, Avokati i Popullit gjykon se Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të gjejë rrugë më të efektshme për zhvillimin profesional të mësuesve, në bashkëpunim dhe partneritet social me sindikatat e tyre dhe se, çdo formë tjetër rekrutimi, apo zhvillimi profesional e aplikuar nga kjo ministri jo në përputhje me ligjin “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, është antiligjore.

Në këtë vit janë paraqitur ankesa për largime nga puna për shkak të mospagesës së detyrimeve për energjinë elektrike, nga punonjës në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, si dhe në OSHEE. Duke qënë se, mospagesa e energjisë elektrike nuk është parashikuar si shkak ligjor për largim nga puna në legjislacionin që rregullon marrëdhëniet e punës dhe në kushtet kur furnizimi me energji elektrike është një shërbim publik, e kemi konstatuar këtë shkak për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si shkelje të legjislacionit në fuqi, duke rekomanduar revokimin, apo konstatimin si të pavlefshëm të urdhërave të largimit nga puna.

Ndryshimi i shpeshtë i stafëve në administratën publike mbetet çështje serioze që mbart pasoja në qëndrueshmërinë, eficientë, profesionalizimin e vet administratës, por edhe për vet të punësuarit.

Gjatë diskutimit të përmbajtjes së projekt-ligjit për ndryshimet në Kodin e Punës, në mendimet e dhëna Avokatit të Popullit, për herë të parë ka sugjeruar përfshirjen në këtë Kod të "**Ngacmimit Moral**" nga ana e punëdhënësit, në nenin 32 të tij. Ky sugjerim i miratuar nga Kuvendi ka të bëjë me:

- Garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit mendor dhe fizik të punëmarrësve;
- Përfshirjen e bilbilfryrësve (sinjalizuesve) në rastin e identifikimit të ngacmimeve morale të punonjësve;
- Barrën e provës si pjesë detyruese nga ana e punëdhënësit, për të provuar se veprimet e tij nuk kishin për qëllim ngacmimin moral;
- Garantitë e dhëna ndaj punonjësve që denoncojnë raste të tilla për të mos patur penalitete, ose largime nga puna, ose veprime diskriminuese.

Përfshirja e ngacmimit moral dhe garancive që ofrohen në Kodin e Punës, pas ndryshimeve si një hap pozitiv, do të vazhdojë të jetë prioritet në punën e Avokatit të Popullit, për garantimin tashmë të kësaj mbrojtjeje që i është njohur punëmarrësve.

### ***Çështjet e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT)***

Nga veprimtaria e analizuar e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, sa i takon prishjes së ndërtimeve të paligjshme, ndërtimeve informale për të cilat është bërë vetëdeklarimi për legalizim dhe të atyre, për të cilat pronarët janë shpronësuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, ka rezultuar se; nga ana e IKMT në raste të përsëritura nuk janë ndjekur procedurat e nevojshme ligjore që garantojnë kryerjen e procesit të rregullt ligjor, gjë që çon në cënimin e së drejtës së pronësisë. IKMT-ja nuk ka zbatuar procedurat e veta kompetenciale për shkak të inaktivitetit të këtij organi në hetimin administrativ që i paraqiten për ndërhyrje; nuk ka harmonizim të veprimtarisë me organe të tjera si ALUIZNI dhe ka mungesë transparence në veprimtarinë e tij; në disa raste veprimet, ose mosveprimet e punonjësve të këtij organi flasin për konsumim të veprave penale të caktuara, pasi kanë cënuar dhe dëmtuar interesat e ligjshme të shtetasve.

Bazuar në konstatimet tona të bëra gjatë shqyrtimit të këtyre çështjeve, nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur një Raport i Veçantë "Mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator 2014 - Maj 2015". Ky raport analizon veprimtarinë e IKMT-së, konkretisht për disa zona si ajo e Selitës, Tiranë (ku po zbatohet projekti i ndërtimit të unazës së re të qytetit); zona e Udenishtit, Pogradec, (ku po zbatohet projekti i rehabilitimit të segmentit rrugor Lin-Pogradec), si dhe zona e segmentit rrugor Rrogozhinë – Lushnjë. Njëkohësisht nga ana e Avokatit të Popullit në ndjekje të kësaj problematike i është propozuar organit të prokurorisë, me anë të rekomandimit përkatës, fillimi i ndjekjes penale ndaj një inspektori të IKMT-së.

### ***Strehimi***

Strehimi mbetet një nga çështjet më të mprehta sociale. Legjislacioni në fuqi për strehimin nuk garanton barazi thelbësore në kërkesat për strehim që mund të paraqiten nga familje në kushtet e mbijetesës. Pjesa më e madhe e familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehit ende nuk mund të

përfitojnë nga programet sociale për shkak të pamundësive të tyre në përmbushjen e kritereve të parshikuara në ligj.

Një pjesë e mirë e Bashkive nuk janë të përgatitura as për sigurimin e vend-strehimeve alternative për grupe në nevojë emergjente si personat endacakë ose të pastrehë të tjerë. Familjet qiramarrëse në banesat e ish pronarëve pas zbatimit të parashikimit të aktit normativ, prej vitesh kanë ngelur pa një zgjidhje konkrete dhe afatgjatë për strehimin e tyre. Avokati i Popullit gjykon se nevojitet një bashkëpunim më i mirë midis organeve të qeverisjes vendore dhe atyre qëndrore me qëllim të plotësimit të kërkesave për strehim nëpërmjet sigurimit të fondeve të mjaftueshme dhe zhvillimit të politikave të reja sociale.

### ***Furnizimi me energji elektrike***

Grupet e cënueshme po përballen me vështirësi në aksesin e furnizimit me energji elektrike për shkak të rritjes së çmimit të energjisë elektrike, pamundësisë në pagesën e saj për shkak të kushteve ekonomike. Këto shkaqe kanë bërë që grupet e cënueshme të vuajnë e pasojën e mungësës së vazhdueshme të energjisë elektrike, ashtu si edhe në kushtet ekstreme atmosferike të dimrit.

Megjithë masat e marra nga qeveria, pas ndryshimit të çmimit të energjisë elektrike, për mbrojtjen e shtresave në nevojë, përsëri shumë konsumatorë përballen me pamjaftueshmërinë e të ardhurave të nevojshme për pagimin e energjisë elektrike. Duke mbajtur parasysh direktivat e BE-së mbi këtë çështje, si dhe ekzistencën e skemave lehtësuese për pagesën e detyrimeve të prapambetura, Avokati i Popullit gjykon se mbrojtja sociale dhe ekonomike e grupeve të cënueshme nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konsiderohet prioritet. Kjo pasi, për shumë familje sot diskutohet sigurimi i mbijetesës e jo më përballja me pagesat për shërbimet publike. Për këtë arsye kemi depozituar në Kuvend, disa propozime konkrete mbi ofrimin e zgjidhjeve për grupet e cënueshme që, ato të mos privohen nga e drejta për akses në furnizimin me energji elektrike, duke iu siguruar një minimumin i domosdoshëm furnizimi me energji elektrike. Qasja institucionale në këtë çështje mbetet ajo e përcaktuar në axhendën e miratuar të samitit të Kombeve të Bashkuara, në muajin shtator 2015, “Për zhvillimin e qëndrueshëm 2030”, objektiva numër 7, që lidhet me sigurimin, aksesin dhe furnizimin me energji elektrike, të përballueshëm dhe të qëndrueshëm.

### ***E drejta për arsim***

Rekrutimi i mësuesve në arsimin parauniversitar si dhe largimet nga puna të shumë prej tyre mbeten jo transparente. Testimi i mësuesve që po zhvillohet aktualisht është kundërshtuar që herët nga institucioni ynë si një mënyrë jo e duhur e matjes së njohurive, pasi ka sjellë pasiguri në vendet e punës së qindra arsimtarëve. Infrastruktura në shumë shkolla të vendit ka nevojë për ndërhyrje dhe buxhet nga ana e strukturave vendore. Mungesa e mësuesve ndihmës për fëmijët me aftësi të kufizuara mbetet problematike edhe këtë vit shkollor.

### ***E drejta për kujdes shëndetësor***

Lidhur me problematikat për sigurimin e një shërbimi shëndetësor cilësor, konstatohet se ka mungesë të mjekëve specialistë në shumicën e spitaleve të vendit; mungesa të pjesësme të medikamenteve dhe shërbimeve mjekësore në spitale shtetërore; mungesë të buxhetit të nevojshëm për ofrimin e shërbimit në spitalin Onkologjik Tiranë (QSUT); mungesë pajisjesh mjekësore në Shërbimin e Traumës në ish Spitalin Ushtarak. Mungesa e infrastrukturës, pajisjeve të nevojshme dhe personelit mjekësor të specializuar është vënë re në disa spitale ose qendra spitalore. Në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit është se testimi nuk është mënyra e vetme për fotografimin dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave që ka sot sistemi shëndetësor.

Largimi dhe shkurtimi i vendeve të punës të personelit të mesëm shëndetësor është një nga problematikat e fundit që po ndjekim.

### ***Të drejtat e fëmijëve***

Një numër i konsiderueshëm të miturish në vendin tonë detyrohen të bëjnë punë të vështira dhe të lypin në rrugë. Shumë të tjerë kanë braktisur shkollat si pasojë e varfërisë, por edhe e distancave të largëta të shkollave nga banesat e tyre. Jemi tepër të shqetësuar për shtimin e rasteve të dhunës fizike dhe abuzimit seksual me të miturit, akte të shëmtuara që kërkojnë marrjen e masave urgjente parandaluese. Është domosdoshmëri shtimi i investimeve për fëmijët në nevojë; forcimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë territorin; hartimi i politikave që sigurojnë shërbime cilësore shëndetësore; investimeve në rritjen e cilësisë së arsimit; parandalimin e braktisjes dhe parandalimin e dhunës në shkolla, krijimi i sistemit të integruar të mbrojtjes të të drejtave të fëmijëve, etj.

Hartimi i politikave dhe buxhetimit i përshtatshëm për ofrimin e përkujdesjes dhe mbrojtjes sociale për të gjithë fëmijët nën kujdes rezidencial, përfshirë fëmijët e braktisur dhe fëmijët pa përkujdes prindëror, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët në varfëri, fëmijët e keqtrajtuar, fëmijët viktime të shfrytëzimit dhe trafikimit, fëmijët e përfshirë në punë të rënda etj.

### ***Të drejtat e grave***

Fuqizimi ekonomik, dhuna në familje, aksesit në shërbimet sociale e drejtësi, konsiderohen si çështje problematike, me të cilat përballen gratë në Shqipëri. Pavarësisht përmirësimeve në legjisllacion, konsiderojmë se ka ende nevojë të përmirësohet edhe praktikata në ofrimin e shërbimeve sociale, në përputhje me nevojat reale të tyre. Dhuna në familje mbetet ende një problem shqetësues. Burimet në nivel qendror dhe vendor nuk janë të mjaftueshme për të ndihmuar gratë, viktime të dhunës në familje të rindërtojnë jetën e tyre duke përfshirë mundësitë për punë dhe strehim. Një analizë gjinore e strategjive sektoriale do të mundësonte adresimin e duhur të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe të burrave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë.

### ***Problematikat që shqetësojnë Minoritetin Rom***

Romët sot janë një grup vulnerabel dhe në risk. Sistemi ynë social (*strehimi, regjistrimi në gjendjen civile, përfitimi i ndihmës ekonomike, arsimimi, punësimi, formimi profesional, kujdesi shëndetësor dhe çdo përfitim që ky sistem, ua siguron qytetarëve të vet*), i pranon formalisht këta individë, por faktikisht i përjashton. Barazia formale ekziston për pjesëtarët e këtij minoriteti, por ajo nuk është kthyer në një barazi reale thelbësore për ta. Fëmijët Romë, vuajnë problemin e braktisjes së shkollës, mosfrekuentimit të rregullt të saj, si dhe të krijimit të një ambienti jo paragjykses dhe pranues për ta në shkollë. Shfrytëzimi i tyre për punë vazhdon të mbetet problem serioz. Nuk mungojnë rastet unike të segregimit në shkolla, me shumicë dërrmuese të nxënësve nga komuniteti egjiptian dhe romë.

Një çështje shumë sensitive sidomos sa i takon problematikave që sot shqetësojnë komunitete të ndryshme Rome në vend, është ajo e zhvendosjes me forcë nga vendqëndrimet e tyre komunitare, ku kanë ndërtuar kryesisht baraka dhe të pozicionuara në periferitë e qyteteve kryesore. këto janë situata të përsëritura që kanë ndodhur ndër vite, ku më tipiket i përkasin komuniteteve në territorin e Bashkisë Tiranë, sikundër zhvendosja me forcë e komunitetit Rom të vendosur pranë ish stacionit të trenit, para rreth 4 viteve; zhvendosja me forcë e komunitetit Rom, të vendosur tek ish godinat e “Dekorit”, në rrugën e Kavajës, para më shumë setre vitesh, apo së fundmi zhvendosja me forcë e komunitetit Rom, të vendosur në zonën e Liqenit Artificial, Tiranë. Nga hetimet tona administrative ka rezultuar se në të gjitha rastet, subjektet që kanë vepruar për zhvendosjen e këtyre komuniteteve, qofshin ato private apo edhe shtetërore, nuk kanë respektuar parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme, të parashikuara në akte të

rëndësishme të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut.

Në çdo rast, gjendja e këtyre komuniteteve nuk është përmirësuar pas zhvendosjes, por është përkeqësuar, duke mos i zgjidhur problematikat e hershme të strehimit të familjeve të këtyre komuniteteve, por duke i rënduar ato. Avokati i Popullit gjykon se, përpos mungesës së një legjislacioni specifik vendas për trajtimin e rasteve të zhvendosjeve me forcë, nevojitet në mënyrë immediate, implementimi i parimeve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, të detyrueshme për shtetin shqiptar. Ndjehet nevoja për përmirësime dhe ndryshime në ligjin nr.9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, sa i takon garantimit ndaj komuniteteve Rome/Egjiptiane të barazisë thelbësore në trajtimin e çështjes së strehimit. Strehimi i këtyre komuniteteve kërkon një zgjidhje reale, të qëndrueshme dhe afatgjatë.

### ***Të drejtat e personave me aftësi të kufizuar***

Gjatë këtij viti janë evidentuar një sërë problematikash për personat me aftësi të kufizuar dhe më konkretisht;

-Mosindeksim i masës së pagesës së aftësisë së kufizuar për periudhën 2005-2010 për personat që gëzojnë Statusin e të Verbërve. Nuk kanë përfituar indeksimin e masës së pagesës së aftësisë së kufizuar, sa herë që është rritur paga minimale në shkallë vendi.

-Probleme në saktësinë e terminologjisë së përkthyer të Konventës së OKB-së, “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”, konkretisht të nenit 29 dhe 32, lidhur me organizatat e personave me aftësi të kufizuar.

-Për përfaqësimin më të lartë në vendimarrje të shoqatave, që në përbërjen e tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuar.

-Heqja nga skema e përfitimit të pagesës së aftësisë së kufizuar për personat që qëndrojnë në institucionet e përkujdesit social, të viktimave të dhunës në marrëdhëniet familjare si dhe të personave që me vendim të formës së prerë të gjykatës vuajnë dënimin me heqje lirie, (të pasqyruara edhe në Raportin Vjetor 2014). Për këtë çështje, në muajin Prill 2014, Avokati i Popullit i ka dërguar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë, opinionet dhe vërejtjet, lidhur me projektligjin në proces diskutimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9355 datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar. Këto vërejtje dhe sugjerime nuk janë marrë në konsideratë.

-Mungesë e përshtatshmërisë së ambienteve publike dhe private për këta persona.

-Mungesë e aksesit në transportin urban publik.

-Moszbatimi i parashikimeve ligjore për rimbursimin e biletës në transportin urban dhe interurban.

-Moszbatimi i dispozitave ligjore për punësimin e personave me aftësi të kufizuar.

-Mungesë e aksesit të personave me aftësi të kufizuar në drejtësi.

-Mungesë e aksesit në arsimin publik, të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

-Nuk ka ndjekje sistematike, të evidentimit të numrit të personave me sëmundje të rënda mendore.

-Nuk ka qendra rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore, për marrjen e shërbimeve të specializuara.

### ***Të drejtat e komunitetit LGBTI***

Komuniteti LGBTI has vështirësi në jetën e përditshme dhe kufizime të të drejtave themelore, të cilat parimisht duhet të gëzohen nga të gjithë qeniet njerëzore pa dallim. Si një vlerësim parësor mbetet ndryshimi dhe përmirësimi i legjislacionit në lidhje me çështjen LGBTI. Në Shqipëri personat LGBTI nuk gëzojnë të drejtën e martesës, të bashkëjetesës së njohur ligjërisht, unioneve civile etj. Në rekomandimin e Avokatit të Popullit të datës 22.09.2015, dërguar Ministrit të Drejtësisë, janë kërkuar disa ndryshime në Ligjin nr.9062, Datë 05.08.2003 “Kodi i Familjes i

Republikës së Shqipërisë”, dhe më konkretisht ndryshimin e neneve 163 dhe 164 në lidhje me “Bashkëjetesën midis dy personave të të njejtit seks, si dhe kushtet dhe procedurat e regjistrimit, pasojat e regjistrimit, dhe mënyrat e përfundimit të bashkëjetesës dhe marrëdhëniet personale e pasurore ndërmjet bashkëjetuesve, të cilat rregullohen me ligj të veçantë”. Në përgjigjen e Ministrisë së Drejtësisë, me shkresën e datës 21.10.2015, drejtuar Avokatit të Popullit evidentohet se është pranuar rekomandimi ynë, për rishikimin e Kodit të Familjes mbi institutin e bashkëjetesës, duke mbajtur në konsideratë parimet kushtetuese dhe zhvillimet në legjislacionin në fuqi”. Ende nuk ka zhvillime konkrete për ushtrimin e nismës legjislative nga ana e Ministrisë së Drejtësisë, për propozimin e ndryshimeve të kërkuara nga ana jonë. Po kështu ndër problematikat e tjera që lidhen me komunitetin LGBTI konstatohet se, Policia e Shtetit nuk ka një plan specifik për të adresuar krimet e urrejtjes me bazë homofobinë dhe transfobinë si dhe nuk ka procedurë për njohjen e gjinisë së ndryshuar.

### ***Të drejtat e minoriteteve***

Në Ligjin “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duhet të shtohen në shkaqet për të cilat ndalohet diskriminimi edhe kombësia; qëllimi i shpallur për të diskriminuar; nxitja për diskriminim dhe ndihmesa dhe inkurajimi i diskriminimit. Nevojitet miratimi i një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”.

### ***Të persekutuarit politik***

Sa i takon kësaj kategorie, sfida mbetet përcaktimi i një afati ligjor, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit të ish të dënuarve të regjimit komunist. Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ende skemën e pensionit, nga e cila do të përfitojë dëmshpërblimin financiar kategoria e personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist. Ende nuk janë nxjerrë aktet nënligjore për trajtimin e të internuarve nga regjimi komunist. Ligji “Për hapjen e dosjeve të ish sigurimit të shtetit duhet të fillojë të implementohet me krijimin e autoritetit që do të drejtojë këtë proces dhe fillimin e veprimtarisë konkrete. Nevojitet miratimi i një baze ligjore në nivel horizontal, e cila do të mundësojë procesin e lustracionit.

### ***Mosha e tretë***

Nuk është miratuar ende projektligji: “Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë”. Masa e pensioneve të pleqërisë është shumë e ulët dhe nuk garanton mirëqenien e tyre. Duhet ndryshuar kushtet e përfitimit të pensionit social, të pensionit të invaliditetit dhe atij familjar. Nuk kemi të shpallur ende nivelin minimal të standartit të jetesës në Shqipëri, ose minimumin jetik.

### ***Migrantët dhe azilkërkuessit shqiptarë***

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se këtë vit një numër i madh qytetarësh janë larguar nga Shqipëria drejt vendeve perëndimore, duke kërkuar azil dhe një jetë më të mirë. Asnjëherë gjatë kësaj kohe ky fenomen shqetësues dhe i dhimbshëm për mbarë qytetarët shqiptarë, nuk ju nënshtrua një debati publik e të ndërgjegjshëm mbi arsyet e ikjes, por përkundrazi çështja ka vazhduar të politizohet. Kemi paralajmëruar klasën politike shqiptare, por edhe shoqërinë vite më parë, që në kohën kur ky fenomen ishte thjesht një shqetësim, pa marrë këto përmasa. Në raportin e veçantë dërguar Kuvendit në Qershor 2014, janë konstatuar nga ana jonë disa problematika ende aktuale që kanë të bëjnë me:

- Nevojën për përmirësimin e bazës ligjore në fushën e emigracionit dhe të punësimit të formimit profesional, për ofrimin e shërbimeve të riintegrit të të nkthyerve, pasi Ligji

nr.9668, datë 18.12.2006, “Për Emigrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”, përcakton vetëm përgjegjësi të përgjithshme të strukturave shtetërore në procesin e emigrimit, përfshirë këtu kthimin dhe riintegrimin. Problemi kryesor që lidhet me zbatueshmërinë e këtij ligji është unifikimi i trajtimit të dy grupeve me karakteristika të ndryshme migratore, emigrantët dhe shtetasit shqiptarë të kthyer, në të njëjtin grup shërbimesh që i referohet një statusi, “statusit të emigrantit”, pa bërë përcaktimet e nevojshme për kriteret e përfitimit të shërbimeve për migrantët e kthyer, si dhe lidhjen ndërmjet statusit dhe shërbimeve ndaj emigrantëve (neni 13 i Ligjit 9668/2006).

- Mbrojtja e të drejtave të emigrantëve në fushën e sigurimeve shoqërore, që si një detyrim ligjor kërkon intensifikimin e përpjekjeve nga ana e vendit tonë për nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe, në fushën e sigurimeve shoqërore. Vonesat në këtë proces vështirësojnë deri në pamundësi përfitimin e pensioneve nga emigrantët shqiptarë, duke ju sjellë atyre një dëm të pallogaritshëm, për përballimin e jetesës në moshën e pensionit.
- Ruajtjen e identitetit kombëtar dhe të gjuhës shqipe, si një element themelor të tij. Emigracioni masiv, krahas problemeve të tjera, ka nxjerrë në pah edhe domosdoshmërinë e mësimin me programe specifike për gjuhën shqipe, sidomos për nxënësit që regjistrohen në arsimin bazë. Një hap shumë i rëndësishëm është hartimi i programit mësimor për fëmijët shqiptarë në diasporë si, shtypja dhe shpërndarja falas e librave për këtë kategori nxënësish, përmes përfaqësive tona diplomatike.
- Diskutimin dhe realizimin, për aq sa është e mundur, të përfshirjes së emigrantëve dhe personave të tjerë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, në procesin e votimit e vendimmartjes në vend. Pra përfshirjes në dispozitat e Kodit Zgjedhor, lidhur me “votimin nga jashtë”, për shtetasit shqiptarë që ndodhen jashtë vendit.

Ende sot, qytetarë të shumtë, të cilëve Shqipëria nuk ju garanton një perspektivë të qartë jete dhe mirëqenie, persona me aftësi të kufizuar, romë, egjiptianë, persona LGBT, gra të dhunuara, të papunë, kanë gjetur si rrugë të vetme ikjen nga Shqipëria. Ftojme qytetarët të mos e braktisin vendin dhe nga ana tjetër i bëjmë thirrje institucioneve shtetërore të marrin masa për mikpritjen dhe riintegrimin e tyre në vend.

### ***Kalimet e paligjshme të kufirit, procedurat e kërkimit të azilit dhe përfitimit të statusit të refugjatit***

Çështja e krizës së refugjatëve dhe migrantëve sot në Europë është çështje e të drejtave të njeriut dhe duhet të përshkojë në mënyrë tërësore politikat shtetërore të vendeve pritëse, apo të tranzitit dhe të atyre vendeve që kanë gjasa të preken nga kjo krizë. Shqipëria sot mbetet në një gjendje ende të papërgatitur në mënyrën e duhur për flukset ekzistuese, apo të pritshme migratore, apo të refugjatëve dhe nuk po ndjek ritmin e kërkuar të kushtëzuar nga zhvillimet. Kështu personave që kapen duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin për të ardhur apo larguar nga Shqipëria, qartësisht pjesë e flukseve migratore, iu mohohet tërësisht apo iu shtyhet pa fund hyrja në procedurat e azilit. Nga monitorimet dhe inspektimet e kryera në Qendrën e Trajtimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e kalimit kufitar, si dhe pikat potenciale për ngritjen e kampeve të pritjes apo të ndihmesës për kalimin tranzit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare, ka rezultuar se kapacitetet e tyre janë të pamjaftueshme në hapësirë, burime njerëzore dhe ato financiare.

### ***Të drejtat e personave të paraburgosur dhe të dënuar në IEVP-të dhe Institucionet e paraburgimit***

Gjatë inspektimeve të kryera gjatë vitit 2015 konstatojmë se vazhdon problemi i mbipopullimit, i trajtimit të paligjshëm të personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm” në IEVP si rrjedhojë e mos ngritjes së Institucionit të Posaçëm Mjekësor. Vijojnë ankesat nga të dënuar e të paraburgosur për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike. Nga



pikëpamja infrastrukurore, pjesa dërrmuese e I EVP-ve paraqesin probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të ambienteve përfshirë ato të ajrimit, dhomave të izolimit, apo edhe të mungesës së ambienteve të edukimit apo ushtrimit të riteve fetare e veprimtarisë sportive, duke sjellë pengesa në procesin e rehabilitimit psiko-social të burgosurve/paraburgosurve.

Në disa institucione paraburgimi dhe në seksionet e paraburgimit të disa I EVP-ve, mbahen persona të dënuar nga gjykata me vendim të formës së prerë, në shkelje të ligjit "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim". Në po këto ambiente mbahen persona të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-20 ditë, pasi nuk pranohen nga I EVP-të, pa urdhër të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Është konstatuar ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga disa punonjës të I EVP Burrel, I EVP Lezhë, I EVP Vlorë, I EVP Drenovë dhe I EVP "Mine Peza", dhe në rastet e vërtetuara të ushtrimit të dhunës, janë dërguar rekomandime ndaj I EVP-ve përkatëse dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës. Gjithashtu ka patur pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimin fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë, sidomos ndaj atyre që dyshohen si autorë të veprave penale në Komisaritet e Policisë nr. 2 dhe 5 Tiranë, në DPV Tiranë, në Komisariatin e Policisë Pogradec, si dhe në Komisariatin e Policisë Shkodër. Ankesat e gjetura të bazuara janë pasuar nga rekomandime konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.

#### ***Të drejtat e personave të ndaluar dhe të shoqëruar në organet e policisë***

Janë trajtuar një numër i konsiderueshëm rastesh të dhunës fizike nga punonjësit e policisë ndaj shtetasve, për të cilat janë dhënë rekomandime për fillimin e hetimeve dhe marrjen e masave ndaj personave përgjegjës. Ka moskryerje të detyrimeve ligjore nga personeli policor dhe ai shëndetësor që shërben në ambientet e sigurisë për raportimin e rasteve të ushtrimit të dhunës ndaj të arrestuarve ose të ndaluarve. Në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit, mbahen dhe trajtohen të paraburgosur për shkak të mbipopullimit në burgje, ndaj të cilëve gjykatat respektive kanë dhënë vendime për caktimin e masës së sigurisë "arrest me burg". Në shumë komisariate e organe policie nuk janë ndërtuar apo përshtatur ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë të cilat ende në pjesën më të madhe të tyre nuk plotësojnë standardet për trajtim dinjitoz të personave.

#### ***E drejta e votës dhe respektimi i kuotës gjinore në zgjedhje***

Megjithëse një institucion që nuk është pjesë e institucioneve të mbarëvajtjes dhe menaxhimit të zgjedhjeve, Avokati i Popullit ka luajtur një rol proaktiv sa i takon zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015, në kuadër të aksesit dhe lehtësimit të ushtrimit të së drejtës së votës, për kategoritë vulnerabël të personave, sikurse ato të moshës së tretë, PAK, apo edhe personave të cilëve ju është kufizuar liria fizike, në I EVP. Një element i proaktivitetit në këtë fushë ka qënë edhe respektimi i dispozitave të Kodit Zgjedhor mbi barazinë gjinore në proceset zgjedhore. Rekomandimet e dërguara dhe qëndrimet publike të mbajtura për këtë qëllim, kanë të bëjnë me;

- Përçimin e një mesazhi publik për ushtrimin e lirshëm dhe të pakushtëzuar të së drejtës së votës, nga ana e zgjedhësve;

- Publikimin e një letre të hapur, që ka sjellë në vëmendje të të gjithë kandidatëve konkures të zgjedhjeve vendore, problematikat mbi transparencën, luftën kundër korrupsionit, mirëqeverisjen, ndihmën ekonomike, programet sociale, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, problemet me bazë gjinore, strehimin, punësimin, kujdesin shëndetësor, kushtet për arsimim, moshën e tretë, dhunën në familje, minoritetin rom dhe komunitetin LGBTI, etj, që duheshin

patur parasysh për përmirësimin e punës në organet qeverisëse që, kandidatët fitues do të drejtonin, apo merrnin pjesë si përfaqësues.

- Rekomandimin dërguar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (për dijeni Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve), për marrjen e masave në mënyrë që, të gjitha Drejtoritë Arsimore në vend të mos lejonin pjesëmarrjen e nxënësve të arsimit 9 vjeçar, atij të mesëm, si dhe të personelit pedagogjik të tyre, në mitingjet, apo aktivitetet elektorale të forcave të ndryshme politike, gjatë orarit zyrtar.

- Rekomandimin (datë 12.06.2015) drejtuar Kryetarëve të të gjitha Bashkive në vend, për zbatimin me rigorozitet nga ana e tyre të ligjit, për sa i takon afishimit të materialeve propagandistike. (Këtij rekomandimi i janë përgjigjur vetëm dy bashki).

- Risjelljen në vëmendje të KQZ-së, të dispozitave të Kodit Zgjedhor, që garantojnë barazinë gjinore, si dhe nenin 108, që përcakton procedurat e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë, duke filluar që nga regjistrimi në listat e zgjedhësve, infrastruktura e përshtatshme për personat paraplegjikë e tetraplegjikë, si dhe për personat që nuk shikojnë.

- Dërgimin e një kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me qëllim garantimin e të drejtës për të votuar, të personave të cilëve iu është kufizuar liria fizike.

Nga monitorimi i drejtëpërdrejtë në një numër qendrash votimi në shumë rrethe të vendit, ka rezultuar se, ka patur infrastrukturë të papërshtatshme për PAK, mungonte infrastruktura specifike për lehtësimin e votimit për personat e verbër, si dhe mjetet e posaçme për këtë qëllim. Në rolin e MKPT, përmes monitorimeve të procesit të votimit në disa IEVP, ka rezultuar se ka patur mangësi në njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor për zgjedhjet, mosgarantim të së drejtës së votës për të paraburgosurit dhe të dënuarit për shkak të mungesës së ID-ve, mangësi infrastrukturore për votimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve PAK, si dhe parregullsi në procesin e votimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve, që nuk mund të votonin vet, apo që ishin deklaruar analfabetë. Rekomandimet tona për garantimin e barazisë gjinore në përbërjen e legjislaturës së Kuvendit, si dhe të garantimit të kësaj barazie në këshillat bashkiakë, janë pranuar pjesërisht në ndryshimet më të fundit të Kodit Zgjedhor.

### ***E drejta për një mjedis të shëndetshëm***

Kjo është një nga të drejtat që lidhet natyrshëm me një sërë të drejtash të tjera sikurse e drejta për jetën, atë të mbrojtjes së shëndetit publik, apo edhe të pasurisë në rrethana të caktuara. Një rast tipik mbi këtë ndërthurje të drejtash ka paraqitur ngjarja e fontanimit të pusit të naftës, në vendburimin e naftës Patoz-Marinëz, nga ana e shoqërisë “Banker’s Petroleum” s.p.a. Pas hetimit administrativ mbi këtë ngjarje dhe dërgimit të rekomandimit një sërë institucioneve përgjegjëse, theksi nga ana jonë është vënë në eliminimin e një sërë pasojave përmes marrjes së masave për mosrrezikimin e shëndetit dhe jetës së banorëve në zonë, deri në evakuimin e mundshëm të tyre. Masat e rekomanduara lidhen me kontrollat e vazhdueshme që duhet të kryhen për cilësinë e ajrit, ujit të pijshëm, tokave, produkteve blegtorale të zonës dhe kulturave bujqësore, si dhe të kryerjes së kontrollit sistematik të specializuar për shëndetin e banorëve të zonës. Pa dyshim, është kërkuar edhe marrja e masave për dëmshpërblimin në dëmet e shkaktuar në pronësinë e banorëve të zonës, si pasojë e shpërthimeve të ndodhura. Reagimet e pritshme kanë qënë të pamjaftueshme nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse, sikurse na rezulton të jetë e tillë edhe marrja e masave përkatëse të nevojshme. Kështu, megjithëse nga ana e Ministrit të Shëndetësisë është konfirmuar zyrtarisht se do të merren masat e nevojshme dhe se për këtë zhvillim në do të informoheshim brenda datës 1.09.2015, ende sot e kësaj dite nuk kemi asnjë informacion. Nga ana e Ministrisë së Mjedisit, përveç konfirmimit për masat monitoruese na është konfirmuar fakti se, në të ardhmen do të hartohet një plan për rehabilitimin e zonës së ndotur dhe për të cilin ne do të viheshim në dijeni, në momentin e përfundimit të tij. Edhe për këtë çështje ende nuk kemi një konfirmim nga ana e Ministrisë së Mjedisit.

Problematika të tjera janë prezantuar në çështje që kanë të bëjnë me vendosjen dhe rrezatimin që emetojnë antenat celulare në zona të banuara. Megjithëse është krijuar një strukturë për matjen e rrezatimit jo jonizues pranë Ministrisë së Shëndetësisë, efikasiteti i saj nuk mund të vlerësohet ndërkohë që konstatohet mungesë e infrastrukturës së nevojshme (aparateve matëse), për kryerjen e veprimtarisë normale.

### ***Trajtimi i problematikave të komunitetit të banorëve të Lazaratit.***

Gjatë muajit korrik 2015, Avokati i popullit ka qënë prezent në takime direkte me banorët e Lazaratit, për t'u njohur me ankesat dhe problematikat që shqetësojnë këtë komunitet, të lidhura ngushtë me respektimin e të drejtave të njeriut. Shqetësimet e prezantuara kanë të bëjnë me keqtrajtim në dëm të disa shtetasve nga ana e punonjësve të policisë të strukturave speciale operacionale, faturimet aforfe nga ana e OSHEE, problemet e furnizimit me ujë të pijshëm dhe faturimin aforfe të tij, problemet e funksionimit të sistemeve të kullimit dhe vaditjes së tokave në sektorin e bujqësisë, arsimimi i fëmijëve të fshatit Lazarat, si dhe kushtet e ofrimit të shërbimit shëndetësor. Ndërhyrja jonë institucionale është kryer me anë të rekomandimeve, apo edhe të ndërmjetësimit direkt me organet përkatëse të administratës publike, për marrjen e masave për zgjidhjen e problematikave të parashtruara.

### ***Përmbytjet dhe procedura e dëmshpërblimeve.***

Fokusi në këto çështje është vënë në problemet e mospërfitimit, apo zvarritjeve në përfitimin e dëmshpërblimit në rastet e ndodhjes së fatkeqësive natyrore. Kjo praktikë është një ndjekje sistematike ndër vite e problematikave të mbartura dhe atyre të reja sa i takon dëmeve të shkaktuara nga përmbytjet. Në çështjet e trajtuara, apo ende në trajtim, janë evidentuar mosmarrje masash nga ana e organeve të qeverisjes vendore për konstatim të dëmeve, mospërfshirje të subjekteve të dëmtuara në listat e të dëmshpërblyerve, si dhe zvarritje në akordimin e fondeve të emergjencës, apo të pagesave të caktuara për dëmshpërblim. Problem serioz i evidentuar mbetet mostrajtimi i rasteve të shkaktimit të dëmit prej përmbytjeve, si pasojë e mungesës së kapaciteteve financiare, fakt për të cilin Avokati i Popullit, i është drejtuar Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat, pranë Kuvendit të Shqipërisë, duke rekomanduar nevojën e parashikimit të fondeve shtesë për përballimin e këtyre rasteve. Efektivisht sot vërehet se, nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore nuk po merren masa konkrete për parandalimin e fenomenit të përmbytjes, që po bëhet gjithnjë e më shumë prezent dhe i përsëritshëm vit pas viti.

### ***Politika Penale***

Gjatë muajve të parë të vitit 2015, organi i Policisë së Shtetit ka kryer “arrestime në flagrancë”, për autorë të dyshuar të veprave penale të vjedhjes së energjisë elektrike, impulseve telefonike, apo edhe të kryerjes së ndërtimit të paligjshëm në një numër të konsiderueshëm personash. Policia gjyqësore ka aplikuar arrestin në flagrancë, ndërkohë që Gjykata ka caktuar për një pjesë të mirë të tyre masën e sigurisë “arrest me burg”. Ambientet e sigurisë të inspektuara në organet e Policisë së shtetit dhe ato të IEVP-ve, kanë rezultuar të tejmbushura në dyfish të kapacitetit të tyre dhe në to nuk siguroheshin standardet minimale të ndërkombëtare për jetesë, gjë që çon në shkeljen e të drejtave të personave që mbahen në to. Në fakt çështja e mbipopullimit nuk është dhe nuk duhet lidhur vetëm me pasojat individuale të personave që vuajnë privimin e lirisë në këto kushte, por edhe si një dëm që i shkaktohet drejtëpërdrejtë familjes dhe jetës familjare të këtyre të fundit.

Duke patur parasysh rrezikshmërinë e ulët shoqërore të veprave penale të sipërcituara dhe autorëve të tyre, si dhe mungesën e qëndrimit konsistent të shtetit ndaj këtyre shkeljeve ekzistuese ndër vite, Avokati i Popullit vlerëson se, masa e arrestit me burg e aplikuar nga gjykata në këto raste, nuk është një masë e drejtë dhe proporcionale.

Për këtë arsye i është rekomanduar Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë, aplikimi i ndjekjes penale në gjendje të lirë dhe aplikimi i masave më të buta të sigurimit personal. Megjithë pranimin në parim të rekomandimit nuk vërehen masa konkrete për zbatimin e tij.

Avokati i Popullit gjykon se duhen aplikuar masa dënimi alternativ, që në thelb justifikojnë një politikë penale proporcionale dhe objektive.

### ***Reforma në Drejtësi***

Një nga çështjet që shqetësojnë sot shtetasit, të cilët trokasin në dyert e Avokatit të Popullit është Sistemi aktual i Drejtësisë në Shqipëri që nuk garanton ruajtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Shtetasit kërkojnë Drejtësi, një drejtësi të pavarur, eficiente, të pakorruptuar. Avokati i Popullit mbështet Reformën në Drejtësi si një reformë jetike për të gjithë shqiptarët. Avokati i Popullit nxit dhe inkurajon forcat politike të shfaqin vullnet në përmbushjen dhe çuarjen deri në fund të kësaj reforme. Pa një sistem drejtësie të pavarur, eficient dhe të drejtë, Shqipëria nuk do të ndërtojë dot një ekonomi konkurrense, një politikë të pastër, një jetë të sigurtë për qytetarët e saj, për investimet e brendshme dhe të huaja, në fund të fundit një shtet të së drejtës. Ky sistem duhet reformuar rrënjësisht.

### ***Minimumi jetik***

Minimumi jetik nuk është përcaktuar ende sot e kësaj dite në Shqipëri. Kjo çështje është prezantuar edhe në raportet e mëparshme vjetore të Avokatit të Popullit.

Minimumi jetik përfaqëson madhësinë e të ardhura në para që duhet të ketë çdo person për të siguruar kushte minimale për jetesë. Personat që sigurojnë më pak të ardhura se minimumi jetik konsiderohen të varfër. Në këtë kuadër, evidentimi dhe përcaktimi i nivelit të varfërisë në vend do të quhej i mangët, pa përcaktuar më parë minimumin jetik. Ky koncept lidhet ngushtësisht me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, si dhe me përcaktimin dhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes sociale, sigurimeve shoqërore, sistemit të pagave etj. Nisur nga rëndësia specifike e përcaktimit të minimumit jetik, i kemi rekomanduar që në vitin 2014, Kryeministrit të Republikë së shqipërisë, ngritjen e një grupi pune për studimin dhe përcaktimin e nivelit minimal të standartit të jetesës në Shqipëri.

Megjithëse pranimin në parim të këtij rekomandimi dhe kërkesave tona në vijimësi për hapat e ndërmarrë për ngritjen e grupit të punës, përsëri kjo çështje nuk ka gjetur ende zgjidhje.<sup>1</sup>

Së fundmi, më datë 25.09.2015, i jemi drejtuar Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, lidhur me vijimësinë e ndjekjes së këtij procesi dhe hapat e ndërmarrë për realizimin e tij. Aktualisht jemi ende në pritje të përgjigjes nga ana e këtij organi të administratës publike.

### ***Braktisja e vendit***

---

<sup>1</sup> Përgjigje e ardhur nga Kryeministria, e cila me shkresën nr. 2386 datë 16.06.2014, i drejtohet Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për ‘*Organizimin e punës për ngritjen e një grupi pune, me drejtues dhe ekspertë, të cilët pasi të kenë studiuar gjendjen në vend, të japin rekomandime konkrete për mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen për të përcaktuar nivelin minimal të standartit të jetesës në Shqipëri. Rekomandimet e grupit të punës do t’i përcillen Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, i cili në ushtrim të funksioneve të tij, të ndërmarrë hapat konkretë për iniciimin e akteve përkatëse për përcaktimin e minimumit jetik në Shqipëri*’

<sup>1</sup>Përgjigja e ardhur nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me shkresën nr. 474/2 datë 09.03.2015 “*MMRS dhe strukturat e saj, duke qenë në kontakt të vazhdueshëm me partnerët socialë, është informuar në vazhdimësi me kërkesën e tyre për të studiuar dhe përcaktuar nivelin e minimumit jetik në Shqipëri, si një tregues përcaktues të nivelit ekonomik e shoqëror të popullsisë shqiptare. Aktualisht janë marrë në shqyrtim dhe po vlerësohen kërkesat dhe propozimet e sindikatave dhe grupeve të ndryshme të interesit, duke i ballafaquar me përvojat dhe studimet bashkëkohore që ndiqen në përgjithësi për këto procese studimore. MMSR shpreh interesin dhe gatishmërinë për fillimin e procesit të studimit dhe shpalljes së nivelit minimal të standartit të jetesës në Shqipëri.*”

Avokati i Popullit shpreh shqetësimin se gjatë vitit 2015, një numër i madh qytetarësh janë larguar nga Shqipëria drejt vendeve perëndimore, duke kërkuar azil dhe një jetë më të mirë. Asnjëherë gjatë kësaj kohe ky fenomen shqetësues dhe i dhimbshëm për mbarë qytetarët shqiptarë, nuk iu nënshtrua një debati publik e të ndërgjegjshëm mbi arsyet e ikjes, por përkundrazi çështja ka vazhduar të politizohet. Kemi paralajmëruar klasën politike shqiptare, por edhe shoqërinë vite më parë, për seriozitetin dhe rëndësinë e çështjes që në kohën kur ky fenomen ishte thjesht një shqetësim, pa marrë këto përmasa. Kjo problematikë është paraqitur në Kuvend, në muajin Qershor 2014, përmes Raportit të Veçantë, “Për ndjekjen, analizimin dhe evidentimin e shkaqeve që kanë ndikuar në rritjen e kërkesave për azil të shtetasve shqiptarë në shtetet anëtare të zonës Shengen”.

Raporti trajton problematikat e hasura nga shtetet e zonës Shengen me azilkërkuarit nga Shqipëria, duke konstatuar dhe analizuar të dhënat si dhe shkaqet e paraqitura për azil nga shtetasit shqiptarë, si dhe përmban një sërë rekomandimesh të ndara sipas kategorive përkatëse, të cilat trajtojnë dhe adresojnë të gjitha problematikat e konstatuara përgjatë hartimit të këtij dokumenti.

Qytetarë të shumtë, të cilëve Shqipëria nuk ju garanton një perspektivë të qartë jete dhe mirëqënie, persona me aftësi të kufizuar, romë, egjiptianë, persona LGBT, gra të dhunuara, të papunë, kanë gjetur si rrugë të vetme ikjen nga Shqipëria. Avokati i Popullit në qëndrimet e tij institucionale dhe publike ka ftuar qytetarët të mos e braktisin vendin dhe nga ana tjetër ka sjellë në vëmendje të institucioneve shtetërore urgjencën dhe rëndësinë e hartimit dhe aplikimit të një plani masash për mikpritjen dhe riintegrimin e tyre në jetën sociale në vend. Në ndjekje të kësaj problematike është ngritur në fund të vitit 2015 një grup pune, i cili do të analizojë në vazhdim ecurinë e këtij fenomeni dhe të masave të marra nga ana e institucioneve përgjegjëse shtetërore për trajtimin e gjendjes së krijuar, si në kuadër të shkaqeve të largimit, ashtu edhe në optikën e masave për riintegrim të atyre që janë rikthyer, apo po rikthehen në vend.

### **Varfëria**

Në të gjithë aktivitetin e zhvilluar nga Avokati i Popullit gjatë vitit 2015, thelbi i punës dhe prioriteti përcaktues ka ta pasur të bëjë me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të shtresave të cënueshme dhe komuniteteve në risk. Rezultantja e problematikave të konstatuara, derivojnë në një shkak të vetëm dhe bazik të ekzistencës së shoqërisë sonë që, lidhet me aftësinë e individit për të përmbushur nevojat jetësore bazë, si dhe nivelin e të ardhurave për frymë, si tregues i asaj që konsiderohet “Varfëri”. Varfëria ekstreme (kuptuar familjet apo individët të ardhurat e të cilëve janë më pak se 1 dollar në ditë/person) dhe varfëria absolute në Shqipëri, janë koncepte që shpesh njehsohen dhe që nga të dhënat statistikore evidentojnë se:

- Përqindja e popullsisë që jeton në varfëri absolute është rreth 14.3%, (e përcaktuar në si numri i personave me konsum mujor real nën 4891 lekë),
- Përqindja e popullsisë që jeton në varfëri ekstreme është rreth 2.2%, (e përcaktuar si numri i personave që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore).<sup>2</sup>

Këto kategori familjesh, apo individësh janë dhe duhet të jenë pjesë e skemave sociale, të cilat financohen nga buxheti i shtetit.

Megjithatë edhe pse flitet shumë për një shtet social që mbron dhe respekton më të varfërin dhe më të pambrojturin, sistemi ynë social realisht i dëmton ata dhe kjo ndodh sepse:

1. Ende nuk dihet zyrtarisht minimumi jetik në Shqipëri, si koncept që lidhet ngushtësisht me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, si dhe me përcaktimin dhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes sociale, sigurimeve shoqërore, sistemit të pagave, etj.

---

<sup>2</sup>Të dhëna zyrtare të publikuara nga INSTAT, tregues të varfërisë sipas prefekturave

2. Sot aktualisht në skemën e ndihmës ekonomike trajtohen rreth 81.621 (tetëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e njëzetë e një) familje<sup>3</sup> dhe individë në nevojë nga rreth 1.1 milion familje që janë në shkallë vendi, dmth 7.3% e familjeve shqiptare trajtohen me ndihmë ekonomike. Por, në realitet nuk është ky numri i familjeve që kanë nevojë për mbështetje nga skema, pasi numri i kërkesave është shumë më i madh. Kriteret e përcaktuara për përfitimin e ndihmës ekonomike janë të tilla që përjashtojnë padrejtësisht individë, apo familje që, në fakt janë në kushtet e varfërisë. Edhe familjet dhe individët që përfitojnë pagesën e ndihmës ekonomike, nuk arrijnë të përmbushin nevojat bazë jetike me këtë pagesë.
  3. Papunësia është në nivele të larta dhe mundësia e punësimit nuk ofrohet sipas një skeme prioritare për individët e familjeve të varfra.
  4. Një familje ekstremisht apo absolutisht e varfër, nuk ka mundësi pagese të energjisë elektrike që mund të konsumojë, dhe në rastin më të keq i hiqet akses i rrjetin e furnizimit me energji elektrike, për shkak të mospagimit.
  5. Një familje ekstremisht apo absolutisht e varfër nuk ka mundësi pagese të ujit të pijshëm që konsumon, dhe në rastin më të keq i hiqet akses i rrjetin e furnizimit me ujë të pijshëm, për shkak të mospagimit.
  6. Sistemi ynë i sigurimeve shoqërore në kushtet e mospagesës së kontributeve për shkak të varfërisë së individit, siguron vetëm përfitimin e një pensioni social në një masë krejtësisht të pamjaftueshme për përmbushjen e nevojave bazë të jetesës, pas arritjes së moshës së pensionit.
  7. Mungesa e një kuadri të përshtatshëm ligjor për të drejtën për strehim, sot ka sjellë pasoja serioze dhe konflikte të reja sociale, gjatë trajtimit të rasteve të dëbimeve me forcë, si mungesën e sigurimit të një strehimi të përshtatshëm, për familjet me të ardhura të ulta (në varfëri ekstreme, apo absolute), familjet përfituese nga skemat e ndihmës ekonomike, gratë e pastreha viktime të dhunës në familje, apo edhe për kategorinë e ish qeramarrësve të strehuar në banesat shtetërore. Kriteret aktuale të përcaktuara në ligj nuk sigurojnë akses në sistemin e trajtimit me strehim social për individët dhe familjet varfëra. Edhe kur arrihet ky akses nuk garantohet qëndrueshmëria e zgjidhjes së strehimit me banesë sociale, për shkak të mungesës së të ardhurave, apo të ardhurave të ulëta.
  8. Kushtet e varfërisë dhe mungesa e politikave sociale efektive kanë krijuar situata të konfliktit me ligjin.
- Sot është koha që shoqëria në përgjithësi dhe shteti në veçanti, të kthejnë kokën nga të varfërit.

---

<sup>3</sup>Të dhëna zyrtare të publikuara nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë

## **KREU 2**

### **Roli parandalues i Avokatit të Popullit në mbrojtje të shkeljes së të drejtave të njeriut**

#### **2.1. Roli parandalues në shkeljen e të drejtave të personave të privuar nga liria**

Institucioni i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është parashikuar në ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003 “Për ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Dënimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT)”, ndërkohë që njohja ligjore e saj, si strukturë e veçantë pranë Avokatit të Popullit në Shqipëri, u bë efektive me hyrjen në fuqi të ligjit Nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të Drejtat dhe Trajtimin e të Dënuarve me Burgim dhe të Paraburgosurve”. Gjatë vitit 2015, shtesat dhe ndryshimet ligjore të bëra me anë të Ligjit Nr. 155/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, ‘Për Avokatin e Popullit’”, e kanë kaluar strukturën e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT), në nivel Seksioni.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në ushtrimin e detyrave të tij të njohura nga legjislacioni vendas, udhëhiqet edhe nga parime e instrumente të sanksionuara në legjislacionin ndërkombëtar si: Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, si edhe protokollet e saj shtesë<sup>4</sup>; Konventa kundër Torturës dhe Vuajtjeve të tjera ose Trajtimin Mizor, Çnjerëzor e Degradues,<sup>5</sup>; Protokollin Opsional i Konventës kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT),<sup>6</sup>; Konventa Evropiane për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve Çnjerëzore dhe Poshtëruese,<sup>7</sup>. Lista e instrumentave që udhëheqin punën e Mekanizmit nuk është shteruese, pasi ka një sërë rekomandimesh, veçanërisht të Këshillit të Evropës, të cilët janë të rëndësishëm në garantimin e të drejtave të personave të privuar nga liria. MKPT funksionon dhe vepron në përputhje me legjislacionin vendas, si Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë; Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë; Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë; Ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”; Ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; Ligjin Nr. 8331, datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, i ndryshuar; Ligjin Nr. 10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 437, datë 20.5.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”; Ligjin Nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”; Ligjin Nr. 121/2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”; Ligjin Nr. 108/2013 “Për të huajt”; VKM-në nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”. Sërish, kjo nuk është një listë shteruese, pasi ka një sërë Vendimesh të Këshillit të Ministrave, si edhe manuale dhe dokumente të tjera pune, zbatimi i të cilave është një garanci për gëzimin e të drejtave.

##### ***2.1.1. Struktura organizative e MKPT-së, përfaqësimi institucional dhe bashkëpunimet.***

Gjatë vitit 2015, MKPT ka vazhduar funksionimin si një seksion me strukturë multidisiplinare të përbërë nga pesë ndihmës komisionerë, pjesë e shërbimit civil të Republikës së Shqipërisë, prej të cilëve tre ekspertë ligjorë, një mjeke psikiatre dhe një psikologe klinike në rolin e drejtueses së mekanizmit.

<sup>4</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8137, datë 31.7.1996

<sup>5</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 7727, datë 30.06.1993

<sup>6</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 9094, datë 03.07.2003

<sup>7</sup> ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin Nr. 8135, datë 31.07.1996

Prej fillimit të tetorit të vitit 2014 deri në tetor 2015, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, kryesoi me sukses Rrjetin e MKPT-ve të Evropës Juglindore, rrjet ky i jetësuar në vitin 2013 bazuar në Deklaratën e Bashkëpunimit të nënshkruar nga Institucionet e Ombudsmanëve/Avokatëve të Popullit të Shqipërisë, Austrisë, Bullgarisë, Kroacisë, Maqedonisë, Malit të Zi, Sllovenisë, Serbisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Hungarisë, Greqisë dhe Rumanisë. Në përmbushje të qëllimit të këtij rrjeti të specifikuar edhe në OPCAT për rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një realizim sa më të qenësishëm të mandatit të MKPT-ve në rajon, MKPT-ja shqiptare realizoi në Tiranë dy seminare dhe një konferencë. Seminari i parë, me titull “Shërbimet Shëndetësore të ofruara ndaj personave të privuar nga liria në rajonin e Evropës Jug-Lindore: Problematikat dhe arritjet e evidentuara gjatë ushtrimit të mandatit të mekanizmave, si dhe sfidat për parandalimin e keqtrajtimit gjatë përdorimit të kufizimit fizik dhe izolimit”, i zhvilluar më datë 29-30 qershor 2015, mblodhi së bashku grupin mjekësor të rrjetit. Seminari i dytë me titull “Sfida, shqetësime, dhe nevoja për standarde të përbashkëta monitorimi të Mekanizmave të Evropës Jug-Lindore në kontekstin e Migracionit” i zhvilluar më datë 29 Tetor 2015, mblodhi së bashku grupin juridik të rrjetit. Konferenca “Drejt standardeve të përbashkëta të monitorimit të trajtimit të Azilkërkuesve, Refugjatëve dhe Emigrantëve të paligjshëm në Evropën Jug-Lindore”, zhvilluar më datë 30 tetor 2015 adresoi çështjen emergjente të migracionit të paligjshëm. Në të tre këto aktivitete ndërkombëtare morën pjesë jo vetëm përfaqësuesit e Rrjetit, por edhe përfaqësues të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, Trajtimit Çnjerëzor ose Poshtëruës, apo Ndëshkimit (CPT), Nën-Komitetit për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (SPT), Shoqatës për Parandalimin e Torturës (APT), Agjencisë Evropiane për Menaxhimin e Bashkëpunimit Operacional të Kufijve të Jashtëm të Vendeve Anëtare të Bashkimit Evropian (Frontex), Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (UNHCR), Prezencës në Shqipëri të Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, etj.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës gjatë vitit 2015, ka bashkëpunuar ngushtësisht me Komitetin për Parandalimin e Torturës (CPT), Nënkomitetin e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Torturës (SPT), Shoqatën për Parandalimin e Torturës (APT) për të siguruar një sistem cilësor mbikëqyrje e raportimi. Bashkëpunimet me këto struktura janë kryer në kuadër të takimeve të përbashkëta e kontakteve të drejtpërdrejta, dhe kanë pasur për qëllim shkëmbimin e eksperiencave dhe vlerësimin e nevojave e mjeteve të nevojshme në luftën për mbrojtjen e të drejtave të personave të privuar nga liria në përmbushje të OPCAT-it. Vlen për t’u përmendur këtu pjesëmarrja e MKPT-së në Konferencën e organizuar Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe të Trajtimit ose Dënimit Çnjerëzor dhe Poshtëruës (CPT), me rastin e 25 përvjetorit të saj, që u zhvillua më 2 Mars 2015, në Strasburg, Francë, ku u diskutuan çështje me rëndësi të veçantë të tilla si lufta kundër mosndëshkimit në polici dhe në burgje, kujdesi shëndetësor në burgje, të miturit në paraburgim, dhe izolimi dhe standardet e CPT-së në psikiatri. Bashkëpunim tjetër me rëndësi gjatë vitit 2015 ka qenë ai i vendosur me Ombudsmanin Danez dhe MKPT-në brenda tij, Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut, si dhe Institutin Shëndetësor Danez kundër Torturës, veçanërisht gjatë vizitës studimore të kryer me mbështetjen e Projektit DANIDA, në datat 29 Mars – 2 Prill, vizitë gjatë të cilës u inspektua paraburgimi dhe komisarati më i madh në Danimarkë.

Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit në rolin e MKPT-së, në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë Kufitare dhe të Migracionit dhe FRONTEx, ka monitoruar në mënyrë konstante operacionet e riatdhesimit vullnetar e të detyruar të shtetasve shqiptarë nga vendet e BE-së dhe shteteve të zonës Shengen, me qëllimi transferimin sipas rregullave të shtetasve shqiptarë me vendim



riatdheshimi nga territoret e vendeve anëtare të BE-së. MKPT, ishte pjesë e grupit monitorues gjatë operacioneve të riatdheshimit, duke u bashkërenduar dhe me Mekanizmat e vendeve të tjera, duke ushtuar në këtë mënyrë rolin e vet ligjor si garant, e njëkohësisht duke përmbushur Direktivën 2008/115/EC të Parlamentit Evropian për standardet e përbashkëta midis vendeve të BE-së dhe vendeve të treta, në monitorim e pavarur nga ana e MKPT-ve të operacioneve të kthimit të shtetasve nga BE në vendet e origjinës.

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në realizim të funksioneve të tij ligjore, edhe gjatë vitit 2015 ka bashkëpunuar ngushtësisht me Organizatat e Shoqërisë Civile aktive dhe të specializuara të fushës në vend, si me Shoqatën Përthyerje dhe Komitetin Shqiptar të Helsinkit. Falë këtij bashkëpunimi, është arritur që të realizohen inspektime të përbashkëta, me karakter multidisiplinar dhe të thelluar si dhe janë zhvilluar auditoriume, konferenca e seminare me qëllim nxjerrjen në pah të problematikave të konstatuara në burgje e komisariate si dhe diskutimin e gjetjen e zgjidhjeve për to. Po ashtu, si rrjedhojë e bashkëpunimit efektiv janë prodhuar një sërë materialesh promovuese (fletëpalosje, postera, manuale) si dhe janë mundësuar një sërë trajnimesh me fokus të drejtat e njeriut me punonjës të policisë së shtetit dhe me stafin e sigurisë, atë shëndetësor e psiko-social të administratës së burgjeve. Trajnimet e materialet promovuese kanë pasur si qëllim rritjen e njohurive mbi të Drejtat e Njeriut në njësitë policore, në burgje dhe paraburgime me qëllim garantimin e respektimit të të drejtave të tyre, përmirësimin e njohurive mbi Institucionin e Avokatit të Popullit dhe rolin e tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe informimin mbi mekanizmat e tjerë mbikëqyrës. Trajnimet për stafet e burgjeve po ashtu janë fokusuar mbi Konventat e ratifikuara për sigurimin e respektimit të të Drejtave të Njeriut në Shqipëri dhe më gjerë, duke u ndalur kryesisht në aspekte të tilla si pranimi, regjistrimi, lëvizja dhe transferimi, klasifikimi dhe vendosja, mjedisi fizik dhe kushtet e jetesës, kujdesi shëndetësor, edukimi dhe punësimi, aktivitetet fetare, njoftimi për problemet shëndetësore, njoftimi për humbjen e një të afërmi dhe lejet e veçanta, kufizimi fizik dhe përdorimi i forcës, masat disiplinore, inspektimet dhe ankesat përkundrejt personelit, takimet me familjet dhe komunikimi, gratë në paraburgim, dhe grupet e vulnerabël.

Në funksion të promovimit të të drejtave të njeriut në vend, si dhe parandalimit të shkeljeve, ekspertët e MKPT-së gjatë vitit 2015 kanë qenë aktivë në median e shkruar dhe atë elektronike shqiptare, përmes konferencave për shtyp, takimeve të përbashkëta me gazetarët, intervistave, si dhe pjesëmarrjes në emisione televizive, me qëllim ndërgjegjësimin mbi problematikat dhe arritjet në fushën e të drejtave të njeriut për personat e privuar nga liria.

### ***2.1.2. Vizitat monitoruese, gjetjet dhe rekomandimet***

Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit, ka kryer 130 vizita, nga të cilat 83 vizita monitoruese të kryera në bazë të planit të miratuar të inspektimeve për vitin 2015, dhe 47 ri-inspektime, kontrolle me tematikë të veçantë dhe hetime administrative, në të gjitha institucionet ku privohet apo mund të privohet liria e individit, përfshirë këtu institucionet penitenciare, njësitë policore, spitalet psikiatrike, bazat ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendrat ku trajtohen shtetasit e huaj, azilkërkuesit dhe viktimat e trafikut, si dhe pika të kalimit kufitar dhe mjediset ku parashikoheshin të ndërtoheshin kampet e trajtimit të përkohshëm të migrantëve. I gjithë aktiviteti i mësipërm, është shoqëruar me përcjelljen brenda vitit kalendarik 2015 të 67 rekomandimeve ndaj institucioneve përgjegjëse mbi problematikat dhe fenomenet e konstatuara. Nga përgjigjet e deritanishme të marra mbi rekomandimet, ato rezultojnë të jenë pranuar e të kenë vënë në lëvizje institucionet për të përmbushur detyrimet e tyre. Mbetet për t'u ndjekur në vazhdim plotësimi i masave të tjera për përmirësimin e kushteve të trajtimit të individëve që mbahen në këto institucione.

### **2.1.3. Niveli i respektimit të drejtave të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institucionet Penitenciare<sup>8</sup>**

Inspektimet në Institucionet Penitenciare kishin si qëllim vlerësimin e nivelit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të parashikuara në ligjin Nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore përkatëse. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përfundimtarisht kanë bërë pengesa në ushtrimin e detyrës së ekspertëve të MKPT-së gjatë dy hetimeve të kryera në IEVP Lezhë dhe IEVP “Mine Peza”, me krijimin e vonësive në dhënien e aksesit për të marrë kontakt dhe shqyrtuar dokumentacionet përkatëse.

Në inspektimet e bëra gjatë vitit 2015 u vunë re një sërë problematikash, të cilat paraqesin nevojë të ngutshme për shqyrtim e përmirësim. Përmbledhtazi gjetjet pasqyrohen në vijim:

- Kushte fizike tejet degraduese e pa mundësi rikonstruktimi të mjediseve në regjimet e brendshme të IEVP Zahari Krujë, IEVP Sarandë, IEVP Tepelenë, IEVP Kukës dhe IEVP Burrel, të cilat e bëjnë të pamundur garantimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve të sanksionuara në aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin kombëtar në fuqi. Meqenëse këto gjetje janë konstatuar në mënyrë të përsëritur, madje me kushte edhe më të degraduara si rrjedhojë e mbipopullimit të vazhdueshëm dhe mungesës së investimeve, Avokati i Popullit rekomandoi mbylljen e menjëhershme të këtyre institucioneve dhe transferimin e personave në institucione të tjera penitenciare.
- Mbipopullim me një mesatare vjetore prej 25% mbi kapacitetet. Ndikim në uljen e ndjeshme të mbipopullimit krahasuar me një vit më parë, ka pasur hapja e IEVP Fier dhe IEVP Berat, si dhe rikonstruksioni i IEVP “Jordan Misja”. Megjithatë problematike paraqitej situata në IEVP-të Lezhë, Krujë, Lushnje, Rrogozhinë, Tepelenë, “Jordan Misja”, Burrel, Elbasan, Drenovë, Durrës, Kukës, Vlorë e Sarandë, të cilat funksiononin në pjesën më të madhe të kohës dukshëm mbi kapacitetin zyrtar. Si rrjedhojë e mbipopullimit, nga një pjesë e IEVP-ve ishin marrë masa për shtimin e numrit të shtretërve, gjë që kishte pakësuar numrin e personave që flinin me shtroje përtokë, por që kishte sjellë si pasojë cenimin e standardeve të hapësirës jetike për person. Në disa prej IEVP-ve situata paraqitej edhe më problematike, pasi si rrjedhojë e mbipopullimit ambientet e aktiviteteve të përbashkëta, observimi e izolimi ishin kthyer në ambiente banimi. Ndërkohë, veçanërisht shqetësuese paraqitej situata në seksionin e observimit të IEVP, Drenovë, ku pjesa dërrmuese e personave qëndronin me shtroje përtokë e për ta ishte e pa mundur realizimi i ajrosjes.
- Moszbatim i marrëveshjes ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për ngritjen e një Institucioni të Posaçëm Mjekësor, të parashikuar në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”, me qëllim strehimin dhe trajtimin e personave që kanë marrë nga gjykata masën “mjekim i detyruar” dhe “shtrim i përkohshëm”. Trajtimi i kësaj kategorie në IEVP, në kushtet kur në organikat e tyre mungon mjeku psikiatër dhe kur aksesit për konsulta psikiatrike pranë spitaleve psikiatrike rajonale paraqet vështirësi, ose në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve për rastet me episode akute, vijon të mbetet i paligjshëm, duke u reflektuar edhe në problematikën e përgjithshme të mbipopullimit.
- Pretendime për ushtrim dhune fizike dhe psikologjike nga disa punonjës të IEVP Burrel, IEVP Lezhë, IEVP Vlorë, IEVP Drenovë dhe IEVP “Mine Peza”. Ankesat e gjetura të bazuara u pasuan nga rekomandime ndaj IEVP-ve përkatëse dhe DPB-së për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.

<sup>8</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Institucionet Penitenciare janë hartuar 20 rekomandime

- Mbajtje e personave të cilët ishin dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat respektive, në disa prej IEVP-ve të parashikuara si institucione paraburgimi, si dhe në seksionet e paraburgimit të disa IEVP-ve të tjera. Në disa raste, këta të dënuar ishin vendosur në të njëjtat dhoma me të paraburgosurit, e për rrjedhojë të gjitha aktivitetet i kryenin bashkë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.
- Procedura disiplinore që nuk zbatoheshin në mënyrë korrekte për të miturit në IEVP ,Vlorë, ku vijonin të përdroreshin penalizimet kolektive dhe përjashtimi i të miturve me masa disiplinore nga aktivitetet mësimore, duke mos marrë në konsideratë udhëzuesin administrativ të DPB-së.
- Probleme me ofrimin e mundësisë për arsim. Në IEVP Lezhë, Lushnje, Tepelenë, Sarandë dhe Burrel, nuk ofrohej arsimi i detyrueshëm në përputhje me Marrëveshjen ekzistuese ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për arsimin 9-vjeçar. Në asnjë prej institucioneve penitenciare, përfshirë këtu Institucionin e Veçantë të të Miturve Kavajë, nuk ofrohej arsimi i mesëm.
- Shpërblimet për punën e kryer në të gjitha institucionet, përjashtuar IEVP Burrel, bëheshin me ditë ulje nga dënimi, gjë që nënkupton paragjykim të fajësisë për kategorinë e të paraburgosurve. Po në këtë kuadër, për punën që kryenin të paraburgosurit në këto institucione, nuk paguhej vlera përkatëse e sigurimeve shoqërore, gjë që sjell mos vlerësimin e kohës së punës në institucion si kohë vjetërsie në punë, si dhe mohimin e një të drejte, atë të përfitimit të pensionit të pleqërisë. Të dënuarit nuk ishin të pajisur me librezë pune dhe as me atë të kontributeve shoqërore. Sa i përket IEVP Burrel, e drejta e uljes së dënimit për punën e kryer nuk njihej pasi ekzistonte një vendim gjyqësor i formës së prerë nga gjykata e rrethit Mat i pasuar nga një praktike shpresore midis Prokurorisë së Përgjithshme dhe asaj Mat.
- Infrastruktura në pjesën më të madhe të IEVP-ve paraqiste probleme të amortizimit, lagështirës, furnizimit me ndërprerje me energji elektrike e ujë, sigurimit të ndriçimit natyral dhe të ajrosjes së plotë të qelive, pranisë së insekteve, kushteve jashtë standardeve të tualeteve, kuzhinave, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, etj. IEVP-të me problematika emergjente infrastrukturore paraqiteshin IEVP Zahari-Krujë, Lushnje, Rogozhinë, Burrel, Sarandë, Lezhë, Tepelenë, “Mine Peza”, e në Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve. Gjithashtu, ambientet e takimit me familjarët/të miturit ishin të papërshtatshme. Përjashtim bënin IEVP-të e reja dhe ato të ri konstruktura.
- Ambientet e përbashkëta për zhvillimin e aktiviteteve rehabilituese mungonin në një pjesë të IEVP-ve si rezultat i kthimit të ambienteve të edukimit, apo ushtrimit të rriteve fetare e veprimtarive sportive në dhoma banimi, apo mungesës së fondeve për pajisjen e tyre me materiale didaktike. Po ashtu sipërfaqet e vogla për ajrim të jashtëm kushtëzonin llojin e aktiviteteve sportive që mund të zhvilloheshin në to. Për rrjedhojë, në thuajse të gjitha IEVP-të, u konstatua plotësim në mënyrë formale i dosjeve psiko-sociale, sa i përket aktiviteteve në grup apo individuale, të cilat ndonëse shënoheshin si të realizuara, realisht nuk rezultonin të ishin kryer.
- Ambientet e kujdesit shëndetësor në burgje, përjashtuar IEVP Vlorë, Berat, Fier, Durrës, dhe Elbasan, ishin përgjithësisht të papërshtatshme për vizita apo manipulime mjekësore, e të pajisura me materiale ndihmëse.
- Vonesa në pajisjen e të dënuarve/paraburgosurve me librezë shëndetësore në shumicën e IEVP-ve, që sillnin si pasojë moszbatimin e skemës së rimbursimit të ilaçeve dhe probleme në furnizimin me medikamente.
- Vështirësi në realizimin e konsultave, ekzaminimeve dhe analizave laboratorike specifike si dhe ndërhyrjeve kirurgjikale, vëreheshin ende në disa prej IEVP-ve, për arsye të lidhura me mungesën e mjekëve me kohë të plotë në organikë apo mungesën e autoambulancave, me

rezistencën e spitaleve rajonale për të trajtuar personat për shkak të mungesës së kushteve të sigurisë në to, etj.

- Probleme të ofrimit të shërbimit stomatologjik në IEVP që vinin si rrjedhojë e mungesave në aparatura dhe materiale ndihmëse. Shërbimet dentare, përveç ekstraksioneve, kryheshin me vështirësi në poliambulancat publike apo në klinikat private me shpenzimet e vetë të dënuarve.
- Sistemet qendrore të ngrohjes, pothuajse në të gjitha IEVP-të, ku ishin të instaluar nuk funksiononin si rezultat i defekteve teknike ose të mungesës së karburantit. Në shumicën e rasteve të dënuarit/paraburgosurit përdornin batanijet dhe teshat e fjetjes si të vetmet mjete ngrohjeje.
- Mungesat në furnizimin me produktet bazë të higjienës personale (pastë dhëmbësh, furçë dhëmbësh, shampo, etj.) dhe të detergjenteve të nevojshme për të pastruar qelitë, si dhe mungesat në uniforma dhe doreza gjatë shpërndarjes së ushqimit u konstatuan në shumicën e IEVP-ve.
- Mungesat në dollapë e raftë të rrobave bënin që ato të mbaheshin nga të dënuarit/paraburgosurit në qese plastike ose në thasë, kryesisht poshtë shtretërve. Kjo problematikë ndeshje kryesisht në IEVP Lezhë, Tepelenë, Korçë, Durrës, “Jordan Misja”, “Mine Peza”, Sarandë, Kukës e Tropojë.
- Problem i hasur në të gjitha institucionet e inspektuara, ishte konstatimi i çmimeve të larta të produkteve të dyqaneve të IEVP-ve.
- Mbetej shqetësuese thuajse në të gjitha IEVP-të, cilësia dhe larmia e ushqimit.

#### ***2.1.4. Niveli i respektimit të drejtave të personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar në njësitë policore.<sup>9</sup>***

Inspektimet e kryera në njësitë policore kishin si qëllim, vëzhgimin e objekteve si dhe mbledhjen dhe vlerësimin e të dhënave mbi veprimet dhe praktikat e ndjekura nga policia në përmbushje të standardeve të përcaktuara në ligjin Nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, Manualin “Për Rregullat e Trajtimin e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, të miratuar me Urdhrin nr. 763, datë 27.09.2011 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhënë gjatë vitit 2014. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi. Përgjithësisht, vizitat e ekspertëve të Avokatit të Popullit në këto institucione për vitin 2015 janë kryer në përputhje me procedurën e monitorimit të MKPT-së, e në një frymë të mirë bashkëpunimi.

Nga inspektimet e kryera në organet e policisë, u konstatua sa më poshtë vijon:

- Mbipopullim i konsiderueshëm në DPV Tiranë dhe në disa prej Komisariateve në varësi të saj, në Komisariatin e Policisë Korçë, Komisariatin e Policisë Fier, ku punohej në pjesën më të madhe të kohës mbi kapacitetin zyrtar. Mbipopullimi ishte krijuar kryesisht si pasojë e arrestimeve e ndalimeve të shumta të bëra gjatë vitit nga policia, për vepra penale të përfshira rishtazi në Kodin Penal por edhe për shkak se, personat e ndaluar/arrestuar vononin të pranoheshin nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për arsye të mbipopullimit në institucionet e paraburgimit.
- Pretendime për raste të ushtrimit të torturës dhe keqtrajtimin fizik e psikologjik të shtetasve nga punonjësit e policisë, sidomos ndaj atyre që dyshohen si autorë të veprave penale në Komisaritet e Policisë nr. 2 dhe 5, Tiranë, në DPV Tiranë, në Komisariatin e Policisë

<sup>9</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Njësitë Policore janë hartuar 37 rekomandime.

Pogradec, si dhe në Komisariatin e Policisë Shkodër. Ankesat e gjetura të bazuara u pasuan nga rekomandime konkrete për marrjen e masave lidhur me personat përgjegjës.

- Mbjajtje dhe trajtim i personave të paraburgosur, ndaj të cilëve gjykatat respektive kishin dhënë vendime për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të Policisë së Shtetit. Po ashtu, në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të Policisë së Shtetit, mbaheshin dhe trajtoheshin persona të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-20 ditore.
- Moskryerje të detyrimeve ligjore nga personeli policor dhe ai shëndetësor që shërben në ambientet e sigurisë, për raportimin e rasteve ushtrimit të dhunës ndaj të arrestuarve ose të ndaluarve, në DPV Tiranë.
- Mos përmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të shoqërimit sipas standardit të kërkuar (3 dhoma shoqërimi, 1 për të rritur, 1 për femra dhe 1 për të mitur). Dhomat e shoqërimit në pjesën më të madhe të komisariateve nuk i plotësonin standardet për trajtim dinjitoz të personave, pasi rezultonin të papastra, të palyera, të pajisura me orënditë e nevojshme (karrige, stola, tavolinë) ose edhe atje ku kishte të tilla, ato ishin të dëmtuara.
- Mos përmbushje e detyrimeve ligjore për ndërtimin apo përshtatjen e ambienteve të sigurisë, sipas standardeve të kërkuara e të miratuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe Manuali “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimit e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”. Përgjatim bënin ambientet e sigurisë në DPV Tiranë, Gjirokastrë, Kukës, Korçë dhe Fier. Komisaritet e varësisë të DPV Tiranë me dhoma sigurie, po ashtu ishin në shkelje të dukshme të standardeve. Në komisaritet që duhej të rezultonin me dhoma të sigurisë të nxjerra jashtë funksionit, u konstatua se nuk ishin të mbyllura sipas procedurave përkatëse me dyllosje e procesverbal. Përgjithësisht, këto dhoma u gjetën të mbajtura me çelës ose dry.
- Plotësim jo korrekt i zërave të regjistrave për personat e shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar është hasur në pjesën më të madhe të komisariateve, kryesisht kjo mbi arsyet e shoqërimit, njoftimin e familjarëve apo të afërmeve të të shoqëruarve, si dhe shënimit mbi ankesat ndaj punonjësve të policisë.
- Mungesa në postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar dhe atyre të ndaluar/arrestuar, ose afishime në ambiente të pa aksesueshme prej tyre, në rreth 30% të komisariateve të policisë.
- Probleme në ofrimin e shërbimit shëndetësor të ofruar nga DPV-të, sa i përket plotësimin korrekt të regjistrave e kartelave mjekësore, si dhe ambienteve të papërshtatshme për ofrimin e shërbimit shëndetësor. Në një pjesë të konsiderueshme të këtyre institucioneve, vizitat mjekësore kryheshin përtej afatit 12 orësh, të përcaktuar në Manualin e Policisë së Shtetit.

### ***2.1.5 Niveli i respektimit të drejtave të personave me masë “ndalim disiplinor” në Forcat e Armatosura.<sup>10</sup>***

Inspektimet e përgjithshme në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë, në Komandën e Forcave Tokësore Vau i Dejës, Shkodër, kishin si qëllim verifikimin e respektimit të standardeve të përcaktuara në ligjin nr. 13/2015 “Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, zbatimin e rregullave të parashikuara në Instruksionin e Kryerjes së Shërbimit të Ruajtjes nga Përgjegjësi i Dhomave të Ndalimit Disiplinor në Policinë Ushtarake, lidhur me kushtet e dhomave të ndalimit disiplinor, procedurat e dhënies së këtyre masave, respektimin e të drejtave të ushtarakëve të dënuar, si dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit

---

<sup>10</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Forcat e Armatosura është hartuar 1 rekomandim.

të Popullit dhënë gjatë viteve të mëparshme. Gjatë inspektimeve u vunë re disa problematika të cilat paraqesin nevojë për përmirësim. Përmbledhtazi këto gjetje pasqyrohen si më poshtë:

- Urdhrrat për masën “ndalim disiplinor” të dhëna në Komandën e Forcave Tokësore, Reparti Ushtarak Nr.1010 Vau Dejës, Shkodër zbatoheshin në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë, si dhe për zbatimin e këtyre urdhrave dhe ndjekjen e të gjithë procedurave në zbatim të tyre ngarkohej një person përgjegjës i këtij institucioni.
- Kushtet në dhomat e sigurisë në Policinë Ushtarake Sauk, Tiranë, ishin të papërshtatshme për t’u ofruar ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor”, një akomodim dinjitoz dhe konform standardeve.
- Kushtet e ambienteve të takimit me familjarët ishin të papërshtatshme, krahasuar me standardet.
- Mungonte sistemi i monitorimit me kamera vëzhgimi në korridoret e dhomave të sigurisë së Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë.
- Mungonin zilet elektrike në dhomat e sigurisë.
- Nuk ishin afishuar posterat me të drejtat dhe detyrimet e ushtarakëve me masën “ndalim disiplinor”, në ambientet ku të jenë aksesueshme nga ata.
- Mungonte ngrohja në dhomat e sigurisë së Policisë Ushtarake Sauk, Tiranë.

#### ***2.1.6.Niveli i respektimit të drejtave të personave në Spitalet Psikiatrike.<sup>11</sup>***

Vizitat monitoruese në Shërbimin e Psikiatrisë, QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër, Spitalin Psikiatrik Vlorë, dhe në Spitalin Psikiatrik Elbasan, (që kanë në funksionin e tyre trajtimin më të specializuar dhe rehabilitimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët kanë shteruar të gjitha mundësitë ekzistuese për të marrë një shërbim të tillë në komunitet, nuk ka mundësi të trajtimit të tyre në kushte ambulatorie, apo nevojitet konsultë psikiatrike nga kërkesat që vijnë nga urgjencat e spitaleve të përgjithshme), përveç objektit të përgjithshëm të vizitave kishin si qëllim specifik: vlerësimin e respektimit të të drejtave dhe të standardeve që u ofrohen personave me çrregullime të shëndetit mendor në mjediset e shërbimit të shëndetit mendor të specializuar me shtretër, të përcaktuara në ligjin Nr. 44/2012, datë 08.05.2012 “Për Shëndetin Mendor”; vlerësimin e procedurave të kryerjes së shtrimeve të pavullnetshëm; masat shtrënguese e kufizimin fizik; kushtet në të cilat mbahen këta persona, trajtimin e tyre mjekësor dhe rehabilitues dhe verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të prezantuara për këto ambiente gjatë viteve të mëparshme. Nga vizitat monitoruese të kryera për vitin 2015, në spitalet psikiatrike të lartpërmendura u konstatua:

- Mosrespektimi i hapësirës jetike, kushte të papërshtatshme në dhomat e personave të shtruar, dhe mbajtja e tyre për një kohë të gjatë/kthimi në rezidentë të Spitalit Psikiatrik Elbasan dhe për pavijonet me pacientë kronikë në Spitalin Psikiatrik Vlorë.
- Mbajtja e personave me aftësi të kufizuara intelektuale në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Vlorë.
- Mungesa e dhomës të veçimit në Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shërbimin e Shëndetit Mendor me Shtretër në Shkodër si dhe problematika, për sa i përket kushteve dhe përmbushjes së standardeve së kësaj dhome në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë.
- Mungesa e një sistemi monitorimi me kamera në ambientet e këtyre spitaleve, si dhe mungesa e regjistrave të unifikuar nga Ministria e Shëndetësisë, në të katër institucionet e lart

<sup>11</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Spitalet Psikiatrike janë hartuar 4 rekomandime.

përmendura, veçanërisht për sa i përket dokumentimit të shtrimeve të pavullnetshme dhe aplikimit të kufizimit fizik.

- Mungesa e posterave të afishuar me të drejtat e pacientit në ambientet e këtyre institucioneve.
- Mangësi në plotësimin e organikës me mjekë psikiatër në Spitalin Psikiatrik Shkodër, dhe shtimin në organikë të infermierëve dhe kujdestarëve në atë të Elbasanit.
- Mungesa e mjeteve të kufizimit fizik në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë, Spitalin Psikiatrik Elbasan dhe Shkodër.
- Vonesa në revokimin e masës “mjekim i detyruar”, për personat të cilët trajtoheshin me këtë masë në Spitalin Psikiatrik Shkodër.
- Mungesa e një kabineti stomatologjik konform standardeve, e aparaturës së EKG-së, në Spitalin Psikiatrik, Elbasan.
- Kushtet higjieno-sanitare, thuajse në të gjitha ambientet e këtyre institucioneve ishin jashtë standardit e me lagështirë, kryesisht e gjetur kjo në spitalin Psikiatrik Elbasan dhe në pavijonet e “kronikëve” në Spitalin Psikiatrik Vlorë, pasi ky i fundit ishte ndërtuar së fundmi dhe pavijonet e urgjencës, ai akut dhe sub-akut përmbushnin standardet.
- Mungesa e një sistemi qendror të ngrohjes në Shërbimin e Psikiatrisë QSU “Nënë Tereza”, Tiranë dhe Spitalin Psikiatrik Elbasan.

#### ***2.1.7. Niveli i respektimit të drejtave të personave në Qendra.<sup>12</sup>***

##### ***Qendra Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve.***

MKPT, bazuar në ligjin nr. 121/2014, datë 18.09.2014 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, inspektoi Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve, me objekt vlerësimin e trajtimit të shtetasve të huaj që marrin shërbime në këtë qendër, në përputhje me të drejtat e tyre për trajtim dinjitoz dhe rehabilitues. Gjatë vizitës monitoruese në këtë qendër, u konstatuan zbatime të një pjese të rekomandimeve të bëra më parë nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Problematikat që vazhdonin të ishin të pranishme, paraqiten si më poshtë:

- Mungesa e një juristi, i cili duhet të merret kryesisht me pjesën e dokumentacionit që secilit individ të strehuar në qendër i nevojitet, duke marrë në konsideratë faktin se kjo qendër strehon shtetas të huaj.
- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf, për edukatorë, kujdestarë dhe staf mjekësor.
- Nuk ishte hartuar një marrëveshjeje me Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, lidhur me ofrimin e mundësive për formim profesional në Qendrat e Formimit Profesional në varësi të kësaj Ministrie, si edhe mundësi për punësim pranë Zyrave Rajonale të Punësimit, gjithashtu në varësi të kësaj Ministrie, për të gjithë personat e strehuar në QKPA, që janë të interesuar.
- Personat e strehuar në QKPA nuk trajtoheshin me ndihmë ekonomike, siç parashikohet në ligjin nr. 121/2014, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”.
- Mungonte afishimi i të drejtave dhe detyrimeve të përfituesve të kësaj qendre.

##### ***Qendra e Mbyllur për të Huajt, Kareç***

Inspektimi i Qendrës së Mbyllur për të Huajt, Kareç, të ngritur me VKM nr.1083, datë 28.10.2009, në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 83, të ligjit Nr.

<sup>12</sup> Mbi inspektimet e MKPT-së në Qendra janë hartuar 4 rekomandime.

9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, për strehimin e të huajve e parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë, ndaj të cilëve është marrë një masë ndalimi në përputhje me legjislacionin në fuqi, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Qendra e Mbyllur është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Migracionit dhe Ripranimeve, në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në Ministrinë e Brendshme. Gjatë vizitave të shpeshta monitoruese dhe hetuese në këtë Qendër, si rrjedhojë e ankesave të shumta mbi trajtimin e shtetasve të huaj në të, u konstatua se vijonin po të njëjtat problematika të konstatuara në vitin 2014:

- Organika e parashikuar nuk i plotësonte nevojat me staf për, komunikime në gjuhën dominante të të huajve, shërbime psiko-sociale, juridike dhe mjekësore.
- Mungonin pajisjet në ambientet rekreative dhe sportive.
- Mungonin aparatet kartofonike, televizorët e antenat për të mundësuar informimin e të huajve mbi ato çfarë ndodhin jashtë qendrës e në vendet e tyre të.
- Mungonin aktivitetet kulturore, argëtuese e sportive. I vetmi aktivitet sportiv ishte ai i lojës me top, në një fushë të papërshtatshme për lojëra me këmbë.
- Mungonin aktivitetet për të miturit, fëmijët e rritur dhe gratë.
- Kamerat në perimetrin e jashtëm të godinës nuk ishin funksionale.
- Sistemi i ngrohjes ishte jofunksional.
- Kishte mangësi në furnizimin me produkte higjieno-sanitare dhe pajisje vetjake, sipas grup-moshave.

Për këtë qendër, u dërguar një rekomandim i veçantë më datë 26.03.2015, lidhur me ofrimin e shërbimit shëndetësor 24 orësh, për 19 shtetasit e huaj të parregullt në grevë urie.

### ***Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikut, Linzë***

Inspektimi i Qendrës Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut, e cila strehon personat e identifikuar në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave/Viktimave të Mundshme të Trafikimit, u krye me qëllim vlerësimin e kushteve të trajtimit të personave të trajtuar në të. Kjo qendër e mbyllur, e sigurisë së lartë është ngritur me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 589, datë 28.08.2003 “Për ngritjen dhe vënien në funksionim të Qendrës Pritëse të Viktimave të Trafikut”, i cili, ndër të tjera, përveçse nuk parashikon detyrat funksionale të këtij institucioni apo shërbimet që ofrohen në të, parashikon në pikën 3 të tij se në këtë qendër trajtohen edhe emigrantë klandestinë, që kalojnë përmes Shqipërisë. Gjatë vizitës monitoruese në këtë Qendër, u konstatuan:

- Nevoja për ndryshime të bazës ligjore të funksionimit të QKPVT-ja, duke marrë në konsideratë vërejtjet sa më lartë.
- Nevoja për të kryer rikonstruktimin e brendshëm dhe të jashtëm të dy godinave ekzistuese.
- Probleme të mosfunksionimit të sistemit ngrohës.
- Probleme të mosfunksionimit të pajisjeve kompjuterike për përfituesit.
- Mangësi në organikë sa i përket pranisë së një juristi dhe një psikologu, me kohë të plotë pune në qendër.
- Problematika përsa i përket pajisjes me libra shëndetësore dhe vënies në funksion të skemës së rimbursimit të ilaçeve, për të gjitha përfitueset e kësaj qendre.



## **2.2. Roli Parandalues i Institucionit të Avokatit të Popullit në shkeljen e të drejtave të njeriut, në fusha të tjera të veprimtarisë së tij.**

Duke synuar mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer përgjatë gjithë vitit 2015 inspektime për të drejtat e fëmijëve, të personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve në disa institucione publike të përkujdesit rezidencial, si dhe qendra ditore<sup>13</sup>. Krijimi i kushteve të përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore të këtyre grupeve të popullsisë, duhet të jetë i një rëndësie të veçantë.

### ***2.2.1 Inspektime për respektimin e të drejtave të fëmijëve në institucione***

Për të **drejtat e fëmijëve** janë kryer gjithsej 9 inspektime, përkatësisht në: Shtëpinë e Fëmijës në Sarandë; Shtëpinë e Foshnjës “Lulet e Vogla” 0-6 Vjeç, Korçë; Shtëpinë e Fëmijës 3-6 vjeç Shkodër; Shtëpinë e Fëmijës 0-3 vjeç dhe Qendrën ditore 3-6 vjeç Shkodër; Shtëpinë e Fëmijëve Shkollorë 6-18 vjeç Shkodër; Shtëpinë e Foshnjës Durrës dhe 3 qendra ditore për trajtimin e fëmijëve me aftësi ndryshe.

Problematikat e ndeshura e që kanë nevojë për më tepër vëmendje nga pushteti vendor si dhe ai qendror i janë përcjellë në vëmendje institucioneve përkatëse, nëpërmjet rekomandimeve të përgatitura për gjithsecilin nga inspektimet e kryera.

Rekomandimet kanë konsistuar në marrjen e një sërë masave, konkretisht për përmirësimin e kushteve të jetesës, shtimin e fondeve, dhe përsa i përket organikës, shtimit të personelit me kujdestarë, psikologë, shofer, punonjës socialë, etj. Po ashtu i është kushtuar vëmendje e veçantë problemit të parandalimit të dhunës ndaj fëmijëve, duke u nisur edhe nga rasti i dhunës të pasqyruar gjerësisht në media, ku një punonjëse e Shtëpisë së Fëmijës në Shkodër ushtroi ndaj një fëmije të këtij institucioni. Nga ana e SHSSH dhe e Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë u morën masat e menjëhershme ndaj punonjëseve përgjegjëse të këtij akti.

Gjatë vitit 2016, do të vijojnë inspektimet kryesisht me institucionet e tjera të përkujdesit rezidencial për fëmijët, si dhe për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme të Institucionit të Avokatit të Popullit, në institucionet e inspektuara gjatë vitit 2015.

Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me një rekomandim, Kryetares së Bashkisë Shkodër dhe SHSSH “Për marrjen e masave për përmirësimin e mëtejshëm të kushteve për mirërritjen e fëmijëve në Shtëpinë e Fëmijës Shkollorë (6-18 vjeç), Shkodër<sup>14</sup>. Për plotësimin e vendeve vakante të institucionit (*punonjësit social, një kujdestar dhe një sanitar*); Studimin e rritjes së kuotës ditore për çdo fëmijë; Parashikimin e ndërtimit të një shkalle për daljet e emergjencave; Studimin e mundësisit të ndarjes së fëmijëve sipas grupmoshave më të afërta, pra 6-14 vjeç dhe 14-18 vjeç (brenda sistemit të institucioneve publike rezidenciale të SHSSH në të gjithë vendin)”.

---

<sup>13</sup> Bazuar në përcaktimin ligjor “Avokati i Popullit ose persona të autorizuar prej tij kanë të drejtë të hyjnë në çdo kohë, pa kufizim apo autorizim paraprak, por duke vënë në dijeni titullarin e institucionit, në të gjitha institucionet e administratës publike, në azile dhe veçanërisht në shtëpi fëmije, si dhe në çdo vend tjetër ku ka të dhëna dhe çmon se ekziston mundësia e shkeljes së të drejtave dhe lirive të njeriut. Hyrja në të gjitha mjediset e mësipërme mund të bëhet si për të hetuar një ankesë, një kërkesë ose njoftim të caktuar, ashtu edhe me nismën e Avokatit të Popullit për qëllime inspektimi apo studimi. Avokati i Popullit në këto raste mund të marrë takim, të bisedojë në mënyrë konfidenciale e pa praninë e personave zyrtarë me cilindo person që ndodhet apo mbahet në këto mjedise”.

<sup>14</sup> Rekomandim datë 20.11.2015, nr.201502097 drejtuar Kryetares së Bashkisë Shkodër

Nga inspektimi i kryer në Qendrën ditore për integrim dhe zhvillim, Librazhd, i është drejtuar një rekomandim Kryetarit të Bashkisë Librazhd, “Për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve për përfituesit në këtë qendër ditore.<sup>15</sup> E njëjta situatë është evidentuar edhe në Qendrën komunitare të fëmijëve autikë, Gjirokastër, për të cilën Avokatit të Popullit i drejtoi një rekomandimin Kryetarit të Këshillit të Qarkut, Gjirokastër, për marrjen e masave për përmirësimin e kushteve në këtë qendër.<sup>16</sup>

Nga gjetjet e bëra nga inspektimi i kryer në Shtëpinë e fëmijës Sarandë, Avokatit i Popullit i drejtoi një rekomandim Kryetares së Bashkisë Sarandë dhe SHSSH, për marrjen e masave për rregullimin e të gjithë problematikës shqetësuese të godinës së Shtëpisë së Fëmijës, Sarandë. Rekomandimi konsistonte në shtimin e kuotës ditore ushqimore; rritjen e kuotës së shpenzimeve të vogla ditore për fëmijët; mundësimin e shfrytëzimit për stinën e verës së Shtëpisë së Pushimit në Borsh, në varësinë e MMRS; lirimin e ambjentëve të kopshtit ditor nga Bashkia Sarandë; trajnimin e stafit nga SHSSH, duke e orientuar sipas kërkesave të kohës; kryerjen e rikonstruksionit të godinës, etj.

### ***2.2.2 Inspektime në qendrat e përkujdesit social të personave me aftësi të kufizuara.***

Për zbatimin e standarteve të përkujdesit social për **personat me aftësi të kufizuara** janë inspektuar 8 institucione publike ku trajtohen këta persona, përkatësisht: Qendra e Zhvillimit Korçë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Qendra e Zhvillimit, Edukimit dhe Integritit “Lira”, Berat, Qendra e Zhvillimit “Unë jam si Ju” Berat, Qendra Ditore të Zhvillimit në Lezhë, Qendra e Shërbimeve Komunitare Sociale Kukës. Gjatë inspektimeve janë konstatuar, si edhe në vitet e mëparshëm probleme me, kushtet e jetesës, mosfunksionimin e sistemit të ngrohjes, mungesën e burimeve njerëzore, sidomos me fizioterapistë e psikologë. Një problem shqetësues është edhe bashkëjetesa ndërmjet grupmohave të ndryshme. Për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe dhënien e shërbimeve cilësore për personat me aftësi të kufizuara, me diagnoza të ndryshme, që strehohen dhe trajtohen nëpër këto qendra, janë dërguar rekomandimet përkatëse. Konkretisht, Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Bashkisë Korçë dhe Shërbimit Social Shtetëror,<sup>17</sup> marrjen e masave për rikonstruksionin e dyerve të godinës; rikonstruksionin e kaldajës; vendosjen e një tharëse profesionale; shtimin në organikë të punonjësve psikolog, punonjës social, fizioterapistë dhe kujdestarë; ndarjen e personave me aftësi të kufizuara, me grup moshë, nëpër qendrat rezidenciale të zhvillimit; ngritjen e një salle fizioterapie, ndoshta edhe në oborrin e kësaj qendre (që mund të shërbejë edhe si dhënie shërbimi për komunitetin dhe të ardhurat të kalojnë në favor të qendrës).

### ***2.2.3 Inspektime në Institucionet e përkujdesit shoqëror për të moshuarit.***

Në Institucionet e Përkujdesit Shoqëror **për të moshuarit** janë kryer gjithsej 4 Inspektime, përkatësisht në Shtëpinë e të Moshuarve në Fier, Kavajë, Shkodër dhe Gjirokastër. Pas inspektimeve të kryera, kemi konstatuar problematika lidhur me, kushtet e jetesës, mosfunksionimin e sistemit të ngrohjes, lagështirën në katet e para të godinave, mungesën e psikologut në organikën e Shtëpive të të Moshuarve etj. Mbetet një nga problemet më shqetësuese mungesa e një automjeti, ku siç e kemi shprehur edhe në raportin vjetor 2014, është i domosdoshëm jo vetëm për aktivitete të ndryshme, por si një nevojë imediate, për emergjenca

<sup>15</sup> Rekomandim datë 20.11.2015 nr.201501259 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Librazhd

<sup>16</sup> Rekomandim datë 28.12.2015 nr.201502396 drejtuar Kryetarit të Këshillit të Qarkut Gjirokastër dhe për dijener MMRS

<sup>17</sup> Rekomandim, datë 6.01.2016, me nr. 201502348 drejtuar Kryetarit të Bashkisë Korçë dhe SHSSH

sëmundjesh. Gjithashtu, nëpër këto qendra rezultojnë se ka të moshuar me probleme psikike, që shpesh krijojnë situatë problematike në marrëdhënie me të moshuarit e tjerë. Si rezultat i këtyre inspektimeve ju janë dërguar rekomandime Kryetarëve të Bashkive respektive dhe Shërbimit Social Shtetëror, për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre dhe për zbatimin sa më cilësor të standardeve të kujdesit social, për këtë kategori. Konkretisht, për shtëpinë e të moshuarve Shkodër, është rekomanduar: rikonstruksioni i godinës, shtimi në organikë me punonjës si kujdestarë, psikolog, kuzhinier, shofer dhe gjetja e mundësive për vendosjen e nje automjeti në dispozicion; emërimi sa më parë i një punonjësi social; shtimi në organikë i një punonjësi roje, ose mbulimin e këtij shërbimi me roje private, për 24 orë; ngritja e një grupi pune për të grumbulluar të gjithë personat me probleme të shëndetit mendor në një qendër zhvillimi; rishikimi i mundësisë së tenderimit të ilaçeve jo vetëm në fillim vitit, etj.

#### ***2.2.4 Inspektime në Spitalet rajonale***

Gjatë vitit 2015 nga ana e ekspertëve të institucionit të Avokatit të Popullit janë inspektuar 15 **Spitale Rajonale** në të gjithë vendin, konkretisht në Tiranë, Lezhë, Kukës, Peshkopi, Burrel, Fier, Lushnjë, Berat, Gjirokastrë, Sarandë, Krujë, Kurbin, Leskovik, Koçë, Ersekë etj. Objekti kryesor i këtyre inspektimeve ishte monitorimi dhe respektimi i të drejtave të pacientëve në institucionet shëndetësore. Po ashtu, objektivi i këtyre inspektimeve ishte kontrolli fizik i ambjenteve ku srehohen pacientët si, dhomat e shtrimit, dhomat e operacioneve, dhomat e mjekëve dhe infermierëve, higjiena, lagështira, ngrohja etj; Intervista me pacientë të shtruar lidhur me trajtimin e tyre gjatë kohës së qëndrimit në spital, si trajtimi mjekësor-kushtet-ushqimi etj; Furnizimi me medikamente mjekësore i secilit spital, gjendja aktuale dhe problematikat që e ndjekin këtë proces; Furnizimi i spitaleve me paisje hotelerie si dhe aksesoret e tjerë të nevojshëm dhe domosdoshëm si detergjentë pastrimi dhe higjene; Shërbimi mjekësor i ofruar jo vetëm nga mjekët, por edhe nga infermierët e spitaleve në përgjithësi; Problematikat që vetë mjekët apo infermierët kanë në respekt të ligjit, apo sigurisë së tyre në shërbim të jetëve njerëzore; Furnizimi me ujë dhe drita 24 orë si dhe çdo problematikë tjetër, përfshirë këtu edhe marrjen e ankesave individuale nga pacientë, apo familjarë të tyre.

Lidhur me këto inspektime të kryera gjatë këtij viti i janë dërguar 7 rekomandime, Ministrisë së Shëndetësisë, për të cilat dotë ketë detaje në pjesën “E drejta për kujdes shëndetësor”, të këtij raporti.

## KREU 3

### Roli mbrojtës i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut dhe objektivat sociale

#### 3.1 Respektimi i të drejtës së pronës dhe procedurat e legalizimeve.

- *E Drejta e pronës*

Institucioni i Avokatit të Popullit në ushtrimin e detyrimeve të tij kushtetuese, brenda tagrave të tij ligjore, i ka kushtuar trajtimit të problemit të pronave kujdesin dhe hapësirën e duhur, për më tepër, që kohët e fundit, çështja e zbatimit të të drejtës së pronës ka marrë vëmendje maksimale prej organeve të shtetit për zgjidhjen e saj në mënyrë përfundimtare e të drejtë.

Institucioni i Avokati i Popullit, ka përdorur të gjithë mekanizmat dhe instrumentet ligjorë për evidentimin e situatës reale në të cilën ndodhet e drejta e pronësisë, si dhe problemet që hasin individët apo subjektet e ndryshme, kur janë drejtuar organeve të ngarkuara me ligj, në zhvillimin e një procesi të rregullt administrativë apo dhe gjyqësor.

Informimi për gjendjen në të cilën ndodhet respektimi i së drejtës të pronësisë, apo respektimi i së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor për çështje që lidhen më të drejtën e pronës, ka marrë vëmendje të veçantë dhe është pasqyruar në raportet vjetore dhe raporte të veçanta të institucionit të Avokatit të Popullit, duke qëllimuar kështu mbrojtjen, ushtrimin efektiv dhe promovimin e së drejtës të pronës.

Për të mundësuar evidentimin e problematikave që lidhen me respektimin e së drejtës të pronësisë, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar gjatë vitit 2015 respektivisht, prej AKKP, Tiranë,<sup>18</sup> Drejtorisë së Buxhetit në Ministrinë e Financave,<sup>19</sup> Kryeregjistruesit të ZQRPP, Tiranë,<sup>20</sup> si dhe prej Avokatit të Shtetit,<sup>21</sup> dhënie informacioni rreth të dhënave mbi të drejtën e pronësisë, informacion ky që nuk i është vënë në dispozicion.

Gjatë vitit 2015, pranë institucionit të Avokatit të Popullit janë trajtuar 200 ankesa për çështjet e pronave, të cilat kanë evindetuar një problematikë të larmishme, të prezantuar si më poshtë;

- a) Institucionet përgjegjëse, si Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendëshme, ALUIZNI, zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Kryeregjistruesi i ZQRPP, AKKP, nuk kanë mundësuar zhvillimin e procedurave për zbatimin e VKM nr.608, datë 05.09.2012, *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”*, të ndryshuar. Deri më sot edhe pse kanë kaluar më shumë se dy vjet nga hyrja në fuqi e VKM nr. 608, datë 05.09.2012, në dijeninë e institucionit të Avokatit të Popullit, nuk është kryer vendimmarrje nga njësitë e qeverisjes vendore, në rastin e kërkimit nga ana subjektit të interesuar, si regjistruesit të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të kryerjes së procedurës për kalimin e pronësisë së pasurisë të paluajtshme, të ndërtuar deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, në rastet kur nuk posedohen akte fitimi pronësie.

Pavarësisht reduktimit të afatit kohor (shtatë ditë) të zhvillimit të procedurave për këtë qëllim, nëpërmjet VKM nr.133, datë 11.02.2015, në rastet e realizimit të projekteve, investimeve dhe

<sup>18</sup> Shkresë nr.94/3 Prot, datë 30.03.2015.

<sup>19</sup> Shkresë nr.94 Prot, datë 30.03.2015.

<sup>20</sup> Shkresë nr.94/2Pprot, datë 30.03.2015.

<sup>21</sup> Shkresë nr.94/1 Prot, datë 30.03.2015

shpronësimeve për ndërtimin e infrastrukturës publike kombëtare ose vendore, konstatohet se, ky afat nuk ka ndikuar në përshpejtimin e procedurave prej njësive të qeverisjes vendore. Në këtë aspekt, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar një sërë rastesh të subjekteve, banesat e të cilëve cënoheshin për shkak të zbatimit të projektit të “Unazës së Re”, Selitë, Tiranë, apo të projektit të “By pass” të Qytetit, Fier.

Në rastet e evidentuara, Institucioni i Avokatit të Popullit për të mundësuar zhvillimin e procedurave të kalimit të pronësisë së pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më datë 10.08.1991, e të truallit funksional të tyre, i ka rekomanduar Kryeregjistruesit të ZQRPP, si dhe të gjithë regjistruesve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme<sup>22</sup>, ushtrimin e së drejtës të kërkimit pranë bashkive të kryerjes së procedurave përkatëse, konform VKM nr.608, datë 05.09.2012, të ndryshuar. Reagimi i 6 regjistruesve të zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ndaj këtij rekomandimi, ka qenë pozitiv si dhe tregues i respektimit të parimit të ligjshmërisë, sigurisë juridike, transparencës, barazisë para ligjit. Ndërsa i pajustifikuar është qëndrimi i shprehur prej Kryeregjistruesit të ZQRPP, i cili deklaroi se; “... nuk është objekt i veprimtarisë së ZQRPP”, qëndrim ky i cili, nuk vjen në përputhje me pikën 3, të VKM nr.608 datë 05.09.2012. Gjithashtu, moskthimi i përgjigjes prej shumicës së zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për rekomandimin në fjalë, përveç se shkel parashikimin e kryer në nenin 22, të Ligjit nr.8454, datë 04.03.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ndikon negativisht në zbatimin e vendimit të sipërcituar.

Çështje e pazgjidhur, e cila mundëson zhvillimin e procedurave sikundër përcaktohet në VKM nr.608, datë 05.09.2012, është mosnxjerrja e aktit nënligjor për përcaktimin e tarifës së shërbimit, në procesin e pajisjes me titull pronësie, të poseduesve të ndërtimeve të kryera para datës 10.08.1991. Pavarësisht përgjigjes së Ministrit të Financave,<sup>23</sup> në të cilën bëhet me dije se është ndërmarrë inisiativa për ndryshimin e kësaj VKM, lidhur me përcaktimin e masës së tarifës së shërbimit, e cila do të kryhet prej njësisë së qeverisjes vendore, deri më sot nuk ka asnjë zhvillim në këtë drejtim.

Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2015, ka pranuar për shqyrtim 8 ankesa nga rrethet Korçë, Lushnjë, Fier, ku edhe është kërkuar ndërhyrja e Avokatit të Popullit për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Për këto raste i janë dërguar rekomandimet përkatëse, (sikundër rekomandimi dërguar Kryetarit të Bashkisë, Fier), për përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e aktit të pronësisë, në favor të subjektit posedues të ndërtimit.

- b) Një numër i konsiderueshëm ankesash janë trajtuar lidhur me shkeljen e afatit ligjor të përcaktuar nga AKKP, për marrjen në shqyrtim të kërkesave të subjekteve. AKKP prej më shumë se dy vitesh, pa shkak të ligjshëm, nuk ka vijuar procesin e shqyrtimit të kërkesave të 11000 subjekteve, me objekt njohjen me të drejtë kthimi apo kompesimi të pasurive të paluajtshme, brenda afatit ligjor të përcaktuar në Ligjin nr.9235 datë 29.7.2004 “Për kthimin dhe kompesimin e pronës”, të ndryshuar. Ky qëndrim i AKKP-së, përveç se nuk vjen në përputhje me parimin e ligjshmërisë, mbrojtjes së interesit publik dhe të të drejtave të personave privatë, si dhe të përgjegjshmërisë, të parashikuar këto në nenin 9, 10 dhe 14 të Kodit të Procedurave Administrative, cënon edhe respektimin e së drejtës së pronës, si dhe të drejtën e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, të garantuara këto në nenin 41, 42/2 të Kushtetutës, si dhe në nenin 1, Protokollin nr.1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe në nenin 6/1, të kësaj konvente.

<sup>22</sup> Njëpërmjet shkresës datë 29.10.2015

<sup>23</sup> Shkresë dt 08.10.2015, drejtuar Avokatit të Popullit

Nga të dhënat e administruara, rezulton se, AKKP me hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”*, i ndryshuar, dhe deri në vitin 2013, ka shqyrtuar dhe marrë vendime për 54.927 çështje, pra me një mesatare vjetore prej afro 6100 çështje të shqyrtuara në vit. Krahasimisht, referuar numrit të sotëm prej 11.000 kërkesash të administruara prej AKKP, në afate kohore që fillojnë nga një vit e gjysëm e deri në shumë vite më parë, do të duheshin jo më shumë se dy vite kohë për trajtimin e tyre me vendimmarje.

- c) Institucioni i Avokatit të Popullit ka administruar 5 ankesa për moskompensimin e pronave të njohura në pronësi subjekteve të ndryshëm, në afatin ligjor të parashikuar në nenin 11, të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompensimin e pronës”*, të ndryshuar, me një nga format e parashikuara në këtë dispozitë ligjore. Regjimi i të drejtës së pronësisë në vitet e tejzgjatura të tranzicionit ka qenë shpesh i paqëndrueshëm. Procesi i kompensimit të pronave ka mbetur në kuadrin deklarativ. Kjo situatë ekziston dhe për 26000 vendime të dhëna në vite, në favor të individëve të tjerë. Ky problem është po aq i mprehtë, sa edhe ai i moshqyrtimit të kërkesave për njohjen, kthimin apo kompensimin e pronës në afatin ligjor të parashikuar. Konstatohet se, zgjidhja e çështjes së kompesimit të pronave të njohura në pronësi prej më shumë se 20 vjetësh, nuk ka gjetur rrugën e zgjidhjes. Edhe në ato raste kur është vendosur për kompesimin në të holla të subjektit, të cilit i është njohur pronësia mbi pasuri të paluajtshme, konstatohet se, zgjidhja e kësaj çështjeje është bërë në mënyrë të pjesëshme (për kompesimin e trojeve) për një numër subjektësh, duke mos e zgjidhur ende sot e kësaj dite në mënyrë përfundimtare çështjen e kompensimit. Kjo situatë ka bërë që numri i subjekteve që i janë drejtuar dhe drejtohen Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut, të rritet në vijimësi nga njëri vit në tjetrin, për shkeljen e të drejtës së pronësisë apo cënimit të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Vendimet e kësaj Gjykate, për moskompensimin financiar të subjekteve të shpronësuar në vite e kanë penalizuar deri tani shtetin shqiptar në disa milion euro. Ndërkohë ka një numër të konsiderueshëm kërkesash të tjera që presin rradhën e shqyrtimit, të cilat së bashku me barrën financiare të sipërcituar, përbëjnë një problem mjaft serioz për shtetin shqiptar dhe angazhimin e tij në zgjidhjen përfundimtare të çështjes së pronave.

AKKP-ja edhe pse ka disponuar që prej vitit 2008, fond fizik toke për kompesimin e pasurive të paluajtshme, në bazë të VKM nr. 868 datë 18.06.2008 *“Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi i tokës bujqësore”*, të ndryshuar, VKM nr.1077 datë 18.06.2008 *“Për krijimin e fondit të kompensimit fizik nga fondi pyjor dhe kullosor”*, si dhe VKM nr.1232 datë 18.06.2008 *“Për krijimin e fondit të kompesimit fizikë nga objektet shtetërore”*, nuk ka mundur të nxjerrë deri më sot asnjë vendim për kompesimin e tokës bujqësore, të njohur në pronësi subjektit me të drejtë kompensimi. Në këtë situatë, përparësi duhet të marrë evidentimi sa më i shpejtë i pronave të paluajtshme publike, të lira, që do të mund të përdoren për kompensimin fizik të të shpronësuarve, si zgjidhje me kosto shumë më të ulët, se sa ajo financiare.

- d) Mosregjistrimi i vendimeve administrative apo gjyqësore, titujve të pronësisë në përgjithësi, që lidhen me pronat, është një tjetër çështje e konstatuar në veprimtarinë e organeve administrative, apo gjyqësore, nga trajtimi i problematikave gjatë vitit 2015, në institucionin e Avokatit të Popullit. Referuar parashikimit të nenit 196, të Kodit Civil, AKKP-ja, gjykatat, si dhe çdo organ tjetër i administratës publike që ka prodhuar tituj pronësie, sipas të cilave është vendosur për njohjen, fitimin e së drejtës së pronësisë së paluajtshme, apo një të drejte reale mbi atë, ka pasur dhe ka detyrimin e dërgimit të tyre pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për regjistrim. Ky detyrim ligjor nuk është përmbushur në mënyrë

të rregullt dhe vijuese prej AKKP, apo edhe organeve paraardhëse të saj, si: KKKP Ish-pronarëve, pranë bashkive, KSHKKP, ZRKKP në Qark. Kjo situatë rezultoi e shfaqur dhe në qëndrimin e mbajtur prej administratës gjyqësore, e cila sikundër AKKP nuk ka përmbushur në mënyrë të rregullt detyrimin e dërgimit pranë zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, të të gjithë vendimeve gjyqësore civile, në kuptim dhe zbatim të parashikimit të kryer në nenin 196, të Kodit Civil. Për të mundësuar zgjidhjen e kësaj situatë të parregullt, Avokatit i Popullit i ka rekomanduar<sup>24</sup> që në vitin 2013, Ministrit të Drejtësisë, nxjerrjen e urdhërit për unifikimin e qëndrimit nga ana e administratës gjyqësore, e lidhur me dërgimin e vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë që përmbajnë, fitimin, njohjen, ndryshimin, pushimin e një të drejte reale mbi atë, ose që deklarojnë të pavlefshme veprimet juridike për kalimin e pronësisë të regjistruar më parë, e cila ende ka mbetur pa zgjidhje.

- e) Për pronat e paluajtshme të zëna me objekte shtetërore, ka ndodhur që subjekteve të shpronësuara nuk u është dhënë mundësia e ushtrimit të së drejtës së parablerjes mbi këto objekte, kur ato janë privatizuar.<sup>25</sup>
- f) Gjatë trajtimit të ankesave për vitin 2015, kanë rezultuar edhe një sërë problematikash; në 18 raste moslëshim të dokumenteve të pronësisë prej zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme në afatin ligjor të përcaktuar, (*për ZVRPP, Tiranë, Fier, Berat, Sarandë, Elbasan, Durrës, Korçë, Lushnje, Librazhd*), moskthim i përgjigjes subjektit kërkues rreth shkaqeve që justifikojnë mospërmbushjen e kërkitimit (aplikimit); në 4 raste mosdhënie informacioni si dhe mbajtje e qëndrimit të parregullt prej regjistruarit të zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, në procesin e shqyrtimit të kërkesave, (*për ZVRPP, Tiranë, Sarandë, Krujë*); në 3 raste moskryerje e veprimeve për korrigjimin e akteve, HRT, të cilat çënojnë të drejtën e pronësisë së subjektit pronar, mosushtrim prej Kryeregjistruarit të ZQRPP, i funksioneve në mbarëvajtjen e detyrave prej organeve në varësi, (*ZVRPP Tiranë, Durrës*), nxjerrje aktesh prej organit të pushtetit vendor të cilat kanë çenuar të drejtën e pronësisë së individit.
- g) Mospërputhje në regjistrimin e sipërfaqeve të pasurive të paluajtshme me atë të përcaktuar në titullin e pronësisë. Ka mjaft parregullsi dhe deformime me statusin e vërtetë të pronës, saqë del e nevojshme kryerja e një regjistrimi fillestar për të të gjitha pasuritë e paluajtshme në rang vendi (konstatim i kryer jo vetëm në 3 raste të shqyrtuara, apo në shqyrtim pranë Avokatit të Popullit, por edhe nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t, i cili në deklaratimet mediatike ka kërkuar ribërjen e regjistrimit fillestar të pasurive në rang vendi).
- h) Mostrajtimi me normën për frymë të familjes bujqësore, në rastin e zbatimit të Ligjit nr.7501, datë 19.07.1999 “Për tokën”; mosregjistrimi deri më sot i akteve të marrjes së tokës në pronësi prej zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme edhe pse një numër subjektsh kanë kërkuar (aplikuar) për marrjen e dokumenteve të pronësisë; moslëshimi i aktit “dublikat” në rastin e humbjes së tij; moskalimi në pronësi i tokave, i sipërfaqeve të tokës bujqësore të dhënë në përdorim sipas Ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për token”, janë situata të konstatuara në 5 raste të shqyrtuara, apo në shqyrtim në institucionin e Avokatit të Popullit.
- i) Mosdhënie e vlerës së shpronësimit subjektit për pasuri të prekura nga realizimi i investimeve publike, si dhe mospërfshirje e pasurive të paluajtshme, pronë private, në proces shpronësimi, në rastin e realizimit të investimeve publike. (*Konstatuar qëndrimi i parregullt në 4 raste të*

<sup>24</sup> Shkresa nr.K3/I5-60, datë 17.12.2013

<sup>25</sup> Ky rast evidentohet në çështjen e ngritur prej subjektit I.K. me banim në Qytetin e Gramshit

*shqyrtuara, apo në shqyrtim, që i përkasin Bashkisë Tiranë, Ministrisë së Industrisë dhe Energjetikës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar).*

- ***Procesi i legalizimeve të ndërtimeve informale***

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka pranuar për shqyrtim 41 ankesa në të cilat, individë të ndryshëm kanë prezantuar shqetësimet e tyre, ndaj veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme të ALUIZNI-t, si dhe ndaj Zyrave Rajonale të ALUIZNI-t në rrethe si, Tiranë, Vlorë, Mat, Shkodër, Sarandë, Lushnjë, Fier, etj.

Në pjesën më të madhe të ankesave, ankuesit kanë prezantuar shqetësimin e mospërfundimit të procesit për shqyrtimin e kërkesës (vetëdeklarimit) për legalizimin e ndërtimeve informale, si dhe të mosrespektimit të parimit të bashkëpunimit, marrjes së vendimeve, sikundër parashikohet në nenin 13 dhe 15, të Kodit të Proceudrave Administrative.

Edhe pas administrimit prej vitesh të kërkesave (aplikimeve) për legalizimin e ndërtimeve informale, zyrat respektive të ALUIZNI-t, nuk kanë bërë të mundur përfundimin e procedimeve administrative respektive edhe pse subjektet e interesuara kërkuese kanë përmbushur plotësisht detyrimet e tyre ligjore dhe financiare. Mospërfundimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve informale ka qenë dhe mbetet një problematikë serioze, e cila është prezantuar prej Avokatit të Popullit në raportet e viteve të shkuara.

Çështja e përcaktimit të një afati unik për fillimin dhe përfundimin e procesit administrativ, që lidhet me vendimmarrjen për legalizimin e ndërtimeve informale, apo shtesave informale në objektet me leje ndërtimi, është trajtuar në vijimësi prej institucionit të Avokatit të Popullit, duke i rekomanduar Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, në datë 19.11.2014, realizimin e iniciativës legjislative për përmirësimin e dispozitave të Ligjit nr.9482 datë 3.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*, i ndryshuar.

Për këtë rekomandim nuk është kthyer përgjigje ende, edhe pse ka kaluar më shumë se 1 vit nga data e dërgimit të tij.

Trajtimi i ndërtimeve informale, për të cilat është kryer vetëdeklarim prej subjektit ndërtues, në disa raste të realizimit të investimeve publike, nuk është kryer në përputhje me parashikimin e dhënë në nenin 23/1, të Kodit të Procedurave Administrative. Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Teritorrit (IKMT), ka vepruar për prishjen e ndërtimit informal në këto kuhste, pa pritur përfundimin e procesit administrativ për legalizimin, ose jo të ndërtimit informal, të filluar paraprakisht prej ALUIZNI-t. (Ankese e shtetases R.D. doculive 201401962).

Tjetër çështje e konstatuar në ankesat e shqyrtuara, apo në shqyrtim, në institucionim e Avokatit të Popullit, është mosshprehja, si dhe moskalimi për kompetencë i kërkesave për legalizimin e ndërtimeve të kryera para datës 10.08.1991, pranë njësive të qeverisjes vendore, në përputhje me VKM nr.608 datë 05.09.2012 *“Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuar deri më 10.08.1991, e të trualli funksional të tyre, kur nuk disponohen akte fitimi pronësie, si dhe për regjistrimin e tyre”*, i ndryshuar.

Gjatë Vitit 2015, referuar deklarimeve të bëra prej Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t, rezultojnë të jenë dhënë 40.000 leje legalizimi, nga të cilat, vetëm 25.000 janë rregjistruar pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Mosregjistrimi i titujve të pronësisë për 15.000 ndërtime është tregues i ekzistencës së problematikave të ndryshme, të cilat kërkojnë sidomos rirregjistrimin e pasurive të paluajtshme, sikurse dhe shprehur publikisht edhe Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t.



- ***Të drejtat e shtetasve në rastet e prishjes së ndërtimeve pa leje***

Veprimtaria e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes Territorit (IKMT) dhe Inspektoriateve të Mbrojtjes së Territorit (IMT), gjatë vitit 2015, gjatë prishjes së ndërtimeve informale, apo të ndërtuara me leje prej organeve përkatëse, në jo pak raste është bërë objekt kundërshtimi prej subjekteve, të cilëve ju janë cënuar interesat pasurore. Në ankesat e pranuar për shqyrtim prej institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015, konkretisht në 37 ankesa, subjektet ankues kanë ngritur pretendime për ushtrimin e veprimtarisë nga ana e këtyre organeve, në mënyrë të parregullt. Në procesin e shqyrtimit të ankesave të administruara, institucioni i Avokatit të Popullit, ka konstatuar se, veprimtaria e IMT-ve, apo IKMT-së, ka mbartur problematika që kanë të bëjnë me:

1. Zhvillimin e procesit të prishjes së ndërtimeve, pa kryer më parë procedurën e njoftimit të subjektit të interesuar për fillimin e procesit administrativ, apo vënies në dispozicion të tij të kopjes së vendimit “Për prishjen e ndërtimit”, dhe lënien me këtë rast, të afatit të parashikuar në ligj për prishjen e ndërtimit në mënyrë vullnetare prej subjektit që e posedon atë;
2. Zhvillimin nga ana e IMT-ve, apo IKMT-së, të procedurave për prishjen e ndërtimit, ndërkohë që subjektet posedues të ndërtimeve informale kanë aplikuar me vetëdeklarim për legalizimin e tyre dhe ndërkohë që ALUIZNI nuk është shprehur ende me vendim përfundimtar;
3. Prishjen e ndërtimeve të shpronësuara për interes publik, prej IMT-ve, apo ish INUK-ut, sot IKMT, ndërkohë që subjektit pronar nuk i është dorëzuar më parë vlera në të holla e shpronësimit;
4. Moszhvillimin e procedurave të domosdoshme ligjore, për prishjen e ndërtimit nga ana e IMT-ve, apo IKMT-së, edhe pse është marrë një vendim “Për prishjen e ndërtimit”;
5. Mungesën e transparencës në veprimtarinë e organeve, të referuar shpesh si problem nga ankuesit, por edhe të konstatuar gjatë veprimtarisë sonë institucionale.

Problematikat e lartpërmendura janë vërejtuar veçanërisht, gjatë veprimtarisë së IKMT-së për prishjen e ndërtimeve në zonën e Selitës, Tiranë (*ku po zbatohet projekti i ndërtimit të Unazës së Re të Qytetit Tiranë*); në zonën e Udenishtit, Pogradec, (*ku është zbatuar projekti i rehabilitimit të segmentit rrugor Lin-Pogradec*), si dhe në zonën e segmentit rrugor Rrogozhinë – Lushnjë. Për të mundësuar rivendosjen në vend të së drejtës, apo interesit të ligjshëm të subjekteve ankues, institucioni i Avokatit të Popullit, ka ndërhyrë rast pas rasti duke i rekomanduar IKMT-së marrjen e masave për analizimin e situatës dhe procedurave të ndjekura, si dhe shfuqizimin e çdo akti që është nxjerrë në shkelje të rëndë të procedurave të përcaktuara nga ligji. Po kështu është kërkuar respektimi i kompetencave ligjore në procedurat që do të ndiqen në vazhdim nga ana e IKMT, duke respektuar të gjitha të drejtat që individët gëzojnë në kuadër të procesit të rregullt ligjor. Për procedurat e ndjekura në prishjen e ndërtimeve në segmentin rrugor Rrogozhinë – Lushnjë, i është rekomanduar organit të Prokurorisë, Lushnjë<sup>26</sup>, fillimi i hetimit në ngarkim të shtetasit K.K. etj, me detyrë inspektor pranë IKMT, Tiranë, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, të kryer në bashkëpunim. Veprimtaria e IKMT-së ka qenë objekt i analizës në Raportin e Veçantë “*Mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator 2014 - Maj 2015*”, që Avokatit i Popullit, i ka dërguar Kuvendit në fund të vitit 2015.

Referuar qëndrimit të mbajtur prej IMT-ve, apo IKMT-së, në procesin e prishjes së ndërtimeve gjatë vitit 2015, del e nevojshme përmirësimi i veprimtarisë së tyre në drejtim të:

- Respektimit në mënyrë rigorozë të procedurave të parashikuara në Ligjin Nr.9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*”, të ndryshuar, Ligjin nr. 9304, datë

<sup>26</sup> Me Shkresën nr.K3/R12-11 Prot, datë 23.12.2015

28.10.2004 “Për legalizimin dhe urbanizimin e zonave informale”, Kodin e Procedurës Civile, neni 23, kur për ndërtimin është kryer aplikim me anë të vetdeklarimit pranë ALUIZNI-t prej subjektit, ose kryer ndërtimi para datë 10.08.1991, për të cilin VKM nr. 608, datë 05.09.2012, parashikon pajisjen e subjektit posedues me akte të fitimit të pronësisë.

- Respektimit të detyrimit ligjor për zhvillimin e procedurave sipas kompetencave që parashikohen në aktet ligjore. Çdo procedurë administrative që fillohet nga ana e IKMT-së nuk duhet dhe nuk mund të trajtohet thjesht si zbatim i një vendimmarrje paraprake nga një organ tjetër, që vepron në një juridiksion të ngjashëm me atë të IKMT-së. Procedimet konkrete administrative që duhet të zhvillohen rast pas rasti nga IKMT-ja, nevojitet të kenë si një element të domosdoshëm hetimin aktiv nga ana e vet këtij organi, të rrethanave, provave, veçantisë së problematikës së paraqitur, me qëllim që të parandalohen shkelje të ligjit.

Në rastet e shqyrtuara prej institucionit të Avokatit të Popullit, vlerësohet se, IKMT-ja ka dështuar në shumicën e procedimeve administrative të zhvilluara, përsa i përket respektimit të parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt dhe të ligjshëm administrativ, si dhe bashkëpunimit dhe harmonizimit të veprimtarisë me organe të tjera, që veprojnë në fushën e urbanistikës, siç edhe ALUIZNI.

Dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, edhe në prishjen e objekteve të ndërtuara me leje që, paraprakisht janë përfshirë në procesin e shpronësimit për interes publik, si dhe të atyre të përfshirë në procesin e legalizimit dhe për të cilët nuk ka patur ende vendimmarrje nga ana e ALUIZNI-t, përbën kosto shtesë që në mënyrë të kundërligjshme i shtohet detyrimeve që shteti duhet t’u paguaj në këto raste subjekteve të dëmtuara.

### **3.2 Respektimi i të drejtave të shtetasve nga organet e qeverisjes vendore**

Avokati i Popullit në kuadër të detyrimeve tij kushtetuese dhe ligjore në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të individit, si dhe në veprimtarinë e tij të përditshme, konsideron se, bashkëpunimi institucional me organet e qeverisjes vendore luan një rol të pazëvendësueshëm në mbrojtjen sa më efektive të këtyre drejtave.

Në Rezolutën për shqyrtimin e Raportit Vjetor për vlerësimin e veprimtarisë të Institucionit për vitin 2014, Kuvendi i Shqipërisë është shprehur se Avokati i Popullit për vitin 2015: *“Duhet të vazhdojë angazhimin e tij publik në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptar nga organet e qeverisjes vendore duke synuar monitorimin e zbatimit të legjislacionit të qeverisjes vendore, për respektimin e parimit të decentralizimit, për ofrimin e shërbimeve për shtetasit në nivel vendor, kjo dhe në funksion të ndarjes së re administrative”*.

Vizioni i Avokatit të Popullit, për mirëqeverisjen e organeve të qeverisjes vendore, si dhe monitorimin e zbatimit të legjislacionit nga ana e tyre, përputhet me parimet dhe standardet e parashikuara në Kartën Europiane të Vetëqeverisjes Vendore dhe Kartën Europiane të Autonomisë Vendore. Në këtë kuadër, Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson reformat e ndërmarra nga qeveria shqiptare që kanë të bëjnë me fuqizimin e pushtetit vendor dhe thellimin e procesit të decentralizimit në funksion të rritjes të efikasitetit të vetëqeverisjes vendore, rritjen e cilësisë dhe të aksesit të qytetarëve në shërbimet publike, si dhe në rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrjen nga organet e kësaj qeverisjeje. Por krahas tyre konstatohet se, mjetet që kanë në dispozicion këto organe dhe mbështetja

financiare në përmbushjen e këtij misioni, lënë për të dëshiruar, gjë e cila nënkupton se reformat do të mbeten minimalisht të pazbatueshme në gjerësinë dhe thellësinë e tyre.

Proçesi reformues i organeve të qeverisjes vendore nisi me reformën e re administrative-territoriale dhe miratimin e Ligjit të ri “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të cilat i hapën rrugën një proçesi të ri të decentralizimit, rritjes së rolit, autoritetit dhe përgjegjësisë të njësive të reja të qeverisjes vendore në funksion të zgjerimit të kompetencave me funksione të reja, si dhe ofrimin të shërbimeve cilësore në dobi të qytetarëve. Njëkohësisht, organet e qeverisjes vendore brenda territorit të tyre, sigurojnë qeverisjen e drejtëpërdrejtë më afër shtetasve, kjo nëpërmjet përdorimit efikas dhe eficient të burimeve publike, sipas parimit kushtetues të autonomisë vendore.

Fusha e veprimtarisë të organeve të qeverisjes vendore është e parashikuar në Kushtetutën e Republikës të Shqipërisë, në Ligjin Nr.8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i shfuqizuar, me Ligjin Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe në një sërë aktesh të rëndësishme ndërkombëtare të ratifikuara nga Kuvendi i Shqipërisë, siç janë Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore dhe Karta Evropiane e Autonomisë Vendore. Organet e qeverisjes vendore krahas zbatimit të kuadrit ligjor organik, në ushtrimin e kompetencave të tyre funksionale dhe funksioneve të deleguara nga qeverisja qëndrore, janë përgjegjës edhe për zbatimin e një sërë ligjeve sektoriale dhe akteve nënligjore, që kanë të bëjnë me shërbimet publike, mënyrën e ushtrimit të kompetencës për planifikimin e territorit nga njësitë e qeverisjes vendore, menaxhimin dhe disiplinimin e mbetjeve urbane brenda territorit të tyre, mbrojtjen e grupeve në nevojë, trajtimin dhe plotësimin e kërkesave për strehim të shtetasve, respektimin e të drejtës të pronës, mbrojtjen e mjedisit dhe menaxhimin e ujrave, etj.

Masat e parashikuara nga institucioni i Avokatit të Popullit për monitorimin e legjislacionit të qeverisjes vendore, në aspektin e respektimit të të drejtave dhe interesave të ligjshme të shtetasve, kanë qënë të mbështetura në zbatimin e procedurave që përcaktohen në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe në standardet më të mira ndërkombëtare.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndërmarë një sërë aktiviteteve inspektuese dhe ditë të hapura<sup>27</sup> me komunitetin dhe qeverisjen vendore për të trajtuar problematikat, sipas çdo njësie të qeverisjes vendore, jo vetëm për ankesat individuale, por edhe çështjet që shqetësojnë komunitetin në tërësi.

Numri më i madh i ankesave ndaj qeverisjes vendore, për të cilat është kryer një hetim i plotë administrativ, janë ankesa të adresuara në drejtim të Avokatit të Popullit, pa përfshirë këtu rastet e filluara me inisiativë nga ana e vet institucionit të Avokatit të Popullit.

Nga ankesat e paraqitura dhe të regjistruara pranë institucionit të Avokatit të Popullit, rezultojnë se **492 ankesa** kanë qënë ndaj ish njësive të qeverisjes vendore (nga të cilat 32 ndaj Komunave), **8 ankesa** ndaj Këshillave të Qarqeve, si dhe **8 ankesa** kanë qënë ndaj Prefekturave dhe më konkretisht, ndaj Komisionit të Verifikimit të Titujve të Pronësisë.<sup>28</sup> Gjatë këtij viti është vënë re një numër i lartë i ankesave ndaj organeve të qeverisjes vendore. Nga një vlerësim i përgjithshëm konstatohet në tërësi, një mungesë e transparencës në vendimarrjet e këtyre organeve, mungesë informimi të shtetasve mbi mënyrën e procedimit sipas ligjit ndaj kërkesave për plotësimin e interesave dhe nevojave të tyre, si dhe zbatim jo korrekt nga këto organe i

<sup>27</sup> Më shumë informacion për ditët e hapura shihni kreun Nr. 7

<sup>28</sup> Në shifrën e ankesave ndaj pushtetit vendor, janë ankesa që si numër statistikor mund të jenë trajtuar dhe tek pikat në vijim të raportit pasi lidhen me të drejta specifike pavarësisht pretendimeve kundrejt njësive të pushtetit vendor. Për efekt të identifikimit dhe studimit të problematikave dhe statistikave që përfshijn njësitë e pushtetit vendor i është dhënë një vend i posaçëm në këtë raport, duke e trajtuar më vehte.

dispozitive ligjore që rregullojnë veprimtarinë e tyre.

Gjatë vitit 2015, shqetësimet kryesore të qytetarëve ndaj organeve të qeverisjes vendore janë adresuar për çështje të tilla si: zgjidhjen e problemit të strehimit, ndërprerje të ndihmës ekonomike dhe kundërshtim të formulës së llogaritjes së saj, probleme që lidhen me mënyrën e trajtimit të çështjes të pronës, trajtimi i grupeve vulnerabël (si romët dhe egjiptianët), zbatim jo korrekt i procedurave ligjore në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës, cilësinë e shërbimeve publike dhe infrastrukturore që ofrojnë njësitë e qeverisjes vendore, zhvillimin e aktivitetit tregëtar nga subjekte private përmes masave lehtësuese për tregtarët ambulantë, etj.

Konkretisht, nisur nga statistikat numrin më të madh të ankesave, sipas të drejtave që lidhen direkt me veprimet dhe mosveprimet e organeve të pushtetit vendor, e zënë ato ankesa që lidhen me shërbimet, si e drejta për strehim (98 ankesa) dhe e drejta për të përfituar nga skema e ndihmës ekonomike (85 ankesa). Një grup ankesash nga komuniteti rom janë paraqitur për lejimin dhe ushtrimin e tregtimit ambulant spitalit nr 5, Tiranë. Ankesa të shumta janë paraqitur për të drejtën e pronës dhe shpronësimet (51 ankesa), marrëdhëniet e punës (27 ankesa), për çështje që kanë të bëjnë me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara si punësim, lehtësira për transportin publik, ndërprerje pagesash, etj (22 ankesa), për zyrat e gjendjes civile (17 ankesa), mosdhënien e informacionit të duhur qytetarëve (10 ankesa), për mungesën e shërbimeve publike (10), mjedisi dhe pyjet (9 ankesa).

Shqetësime të ndryshme janë paraqitur edhe nga komuniteti Rom kryesisht për përmirësimin e kushteve të jetës së këtij komuniteti nga ana e njësive të pushtetit vendor, si rasti i komunitetit Rom në zonën e Shkozës, në Bashkinë e Tiranës (33 ankesa). Mbrojtja e konsumatorit, veprimet arbitrare të kryera nga ana e IMT, pranë njësive të qeverisjes vendore, kanë qënë gjithashtu objekt i ankesave për vitin 2015.

Mos marrja e masave për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, si dhe mungesa e investimeve dhe ngrohjes në shkolla, është objekti i 27 ankesave që janë adresuar dhe trajtuar nga Avokati i Popullit, gjatë vitit 2015.<sup>29</sup>

Avokatit i Popullit ka ngritur dhe trajtuar problematikat e konstatuara gjatë shqyrtimit të rasteve të ankesave që lidhen drejtëpërdrejtë me rolin, përgjegjësitë dhe kompetencat e drejtuesve të organeve të qeverisjes vendore, por dhe me cilësinë e punës të administratave të tyre. Shpesh herë janë konstatuar probleme në formulimin e akteve administrative, të cilat janë bërë shkak për shkeljen e të drejtave të individëve. Jo në pak raste, ndeshemi me mungesën e referencave ligjore në përmbajtjen e këtyre akteve të miratuara prej tyre, mospërcaktimin e qartë të rregullave mbi mënyrën e procedimit administrativ. Në veprimtarinë e tyre konstatojmë dhe moszbatime të vendimeve të gjykatave të formës të prerë, deri dhe konflikte të interesave në vendimmarrje, duke sjellë në këtë mënyrë subjektivizëm në vendimmarrje, apo edhe në ekzekutimin e akteve administrative.

Të gjitha këto problematika, pasqyrohen në një nivel të ulët shërbimi të administratës ndaj qytetarit, zvarritje në zgjidhjen e problemeve që shqetësojnë shtetasit nën juridiksionin tyre, si dhe mohim të standardeve të një administrate që duhet të jetë në shërbim të individit.

Avokatit i Popullit mbi bazën e këtyre konstatimeve u ka dërguar një sërë rekomandimesh titullarëve të organeve të qeverisjes vendore, por njëkohësisht i ka bërë prezente edhe në raportet vjetore dhe disa raporteve të veçanta që, i ka drejtuar Kuvendit të Shqipërisë siç edhe, “Raporti për të Drejtën e Pronës”, “Raporti për problemet e Strehimit”, apo “Raporti për largimet nga

---

<sup>29</sup> Një trajtim më i plotë dhe i detajuar për natyrën e këtyre çështjeve dhe mënyrën e trajtimit të tyre, gjendet në kapitujt e tjerë të këtij raporti, sipas të drejtave.

puna në Administratë”. Problematikë është hasur edhe në kthimin e përgjigjeve nga njësitë e qeverisjes vendore kundrejt shkresave për shpjegime dhe rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit.

Në bazë të nenit 30, të Ligjit nr.8454/1999, “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, Institucioni në bashkëpunim me organizatat joqeveritare organizon të paktën një herë në vit veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, por dhe të problematikave të shumta të hasura dhe numrit të lartë të ankesave të shtetasve, të adresuara ndaj organeve të qeverisjes vendore, Avokati i Popullit në bashkëpunim me aktorë të shoqërisë civile, organizoi Konferencën Kombëtare me temë “*Qeverisja Vendore dhe të Drejtat e Njeriut*”.

Disa nga konkluzionet kryesore të kësaj Konference janë: nxitja e iniciativave qytetare brenda juridiksionit të njësive të pushtetit vendor, rritja e aksesit të qytetarëve për të qënë pjesë e vendimmarrjes nga njësitë e qeverisjes vendore; rritja e vëmendjes ndaj grupeve vunerabël; zgjidhja e problematikave të familjeve që kanë statusin e të pastrehut nëpërmjet zhvillimit të programeve sociale; nxitja e punësimit të shtetasve nëpërmjet rigjallërimit të sipërmarrjes private duke shfrytëzuar resurset ekonomike, historinë, kulturën dhe karakteristikat e vendit, me qëllim krijimin e mundësive për hapjen e vendeve të reja të punës; trajtimi dhe fokusimi tek grupet më të dobëta, si fëmijët, personat me aftësi të kufizuar, personat në nevojë subjekt i ndihmës ekonomike, gratë e dhunuara; rritja e autonomisë vendore dhe financiare të njësive vendore, etj.<sup>30</sup> Për realizimin tyre kërkohet miratimi sa më parë i akteve ligjore dhe nënligjore nëpërmjet të cilave garantohet forcimi i kompetencave të këtyre njësive të reja administrative, thellimi i procesit të decentralizimit, rritja e autonomisë vendore, ngritja e një administrate vendore profesioniste dhe të depolitizuar, si dhe një mbështetje më e madhe financiare nga buxheti i shtetit.

Tjetër aspekt që ka të bëjë me mirëqeverisjen e këtyre njësive vendore është dhe rritja e bashkëpunimit me shoqatat e grupeve të interesit, të cilat ndihmojnë në njohjen e situatës dhe problematikës së komunitetit, por edhe në gjetjen e zgjidhjeve sa më të favorshme për komunitetin.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në Dhjetor 2015 u angazhua duke dhënë një kontribut të rëndësishëm përmes mendimeve dhe komenteve lidhur me projektligjin në diskutim, të finalizuar dhe miratuar nga Kuvendi me ligjin e ri “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”. Komentet dhe sugjerimet u dhanë pas një konsultimi me Shoqatat në këtë fushë, si dhe duke mbajtur në konsideratë Rekomandimet e Kongresit të Autoriteteve vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës, si dhe të Kartës Europiane të Autonomisë vendore. Ligji “*Për Qeverisjen Vendore*” është tepër i rëndësishëm në kushtet kur është i lidhur ngushtësisht me shërbimet publike, që ofrohen për qytetarët dhe me një vëmendje të veçantë në mbështetje të grupeve të cënueshme në shërbime të tilla sikundër janë strehimi, uji i pijshëm, transporti publik, apo me funksione të cilat lidhen me sistemin arsimor, shërbimin parësor shëndetësor, kujdesin social etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka dërguar në kuadër të rolit proaktiv paraprakisht në Kuvend, disa mendime për projektligjin në diskutim, “*Për Qeverisjen Vendore*”, në të cilat thuhet se:

1. Duhet të mbahet në konsideratë Rekomandimi 349 (2013), të Kongresit të Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Europës, lidhur me legjislacionin e nevojshëm për ti ofruar mundësinë Njësive të Qeverisjes Vendore për të përmbushur funksionet e tyre, për rritjen apo fuqizimin e kompetencave të tyre, për të siguruar mjetet e mjaftueshme financiare

<sup>30</sup> Për më shumë shih kreun Nr. 7.6 Për Konferencën Kombëtare Vjetore

për kompetencat e deleguara, si dhe për të qartësuar dhe shtuar kompetencat e qarkut, qartësinë e kompetencave dualiste të Këshillit të Qarkut dhe Institucionit të Prefektit, përcaktimin e rregullave për pjesëmarrjen e shoqatave përfaqësuese të vetëqeverisjes vendore në procesin e konsultimit me Qeverisjen Qëndrore, me qëllim ngritjen e një strukture të unifikuar administrative, mungesën e instrumentave financiare, fiskale dhe buxhetore të përshtatshme, sidomos për Bashkinë e Tiranës.

2. Konsiderohet i rëndësishëm parashikimi i një dispozitë të veçantë në ligjin organik, lidhur me formalizimin e procesit të konsultimit midis autoriteteve lokale dhe atyre qendrore, për të siguruar konsultimin "në kohën e duhur dhe në mënyrë të përshtatshme, për çështjet që u përkasin drejtpërsëdrejti", siç kërkohet nga Artikulli 4, paragrafi 6, i Kartës, si dhe nga Kongresi i Autoriteteve vendore dhe rajonale të Këshillit të Europës.
3. Nëpërmjet legjislacionit duhet të sigurohet që mbikëqyrja, e cila ushtrohet nga autoritetet qendrore në vendimet e marra nga ana autoriteteve vendore brenda fushëveprimit të kompetencave të tyre të deleguara dhe të përbashkëta, të mos lejojë një kontroll të shpërpjesëtuara mbi çështjet e qeverisjes vendore.
4. Nevojitet nënshkrimi dhe ratifikimi në të ardhmen e afërt, i Protokollit shtesë të Kartës Evropiane të Vetëqeverisjes Lokale, për të drejtën për të marrë pjesë në çështjet e autoriteteve vendore (CETS Nr 207).
5. Duke mbajtur në konsideratë dhe vëmendje këto rekomandime, Institucioni i Avokatit të Popullit konstaton se në përgjithësi projekt-ligji nuk përcjell frymën e decentralizimit dhe bashkëpunimin gjithëpërfshirës dhe nuk ndikon në fuqizimin dhe konsolidimin e qeverisjes, sipas konceptit për decentralizim politik, administrativ dhe fiskal.
6. Në projektligjin "Për vetëqeverisjen vendore", është parashikuar një tipologji e re e funksioneve të qeverisjes vendore, duke eliminuar kësaj dhe ndarjen në "funksione të veta" dhe "funksione të përbashkëta", si dhe nuk është përcaktuar ndarja e funksioneve të përbashkëta, duke e lënë të hapur për t'u rregulluar me akte të tjera nënligjore, që shpeshherë kanë qënë objekt kritikash sa i përket cënimit të autonomisë vendore.
7. Institucioni i Avokatit të Popullit mbështetur në parimin e autonomisë vendore mendon se, funksionet nuk mund të analizohen pa autoritetin për të realizuar shërbimin, kombinimi i të cilave përcakton shkallën e lirisë të autoritetit të qeverisjes vendore. Nga ana tjetër kompetencat e autoriteteve lokale nuk mund të analizohen veçmas brenda vetes së tyre. Ato gjithmonë duhet të merren në konsideratë në kontekstin e marrëdhënieve mes autoriteteve lokale dhe qeverisë qendrore apo/edhe të autoriteteve rajonale
8. Ndaj dhe në këtë kuptim vetëqeverisja vendore, duhet kuptuar si një liri, e cila mund të ekzistojë vetëm kur efektivisht autoriteti vendor ka fuqi për të vepruar (funksione ekskluzive) dhe akses të lirë për të përdorur burimet. Nëse vetëqeverisja vendore nuk disponon fuqi për të vepruar dhe akses të lirë në burime, atëherë kthehet në një ent publik, i cili funksionon për llogari të një autoriteti më të lartë (qeverisja qendrore), i cili është mbajtësi i këtij pushteti. Në përfundim, duket me vend sugjerimi për trajtimin e raportit mes funksioneve dhe kompetencave, pasi është përcaktues për veprimtarinë e qeverisjes vendore, duke përcaktuar në të njëjtën kohë dhe standartet minimale të menaxhimit, për çdo funksion të parashikuar.

9. Lidhur me funksionet eskuzive të autoriteteve vendore, është përfshirë ndër të tjera si funksion i Bashkive në infrastrukturë dhe planifikimi, administrimi, zhvillimi dhe kontrolli i territorit. Në kushtet kur taksa e infrastrukturës mbliidhet dhe administrohet nga qeverisja vendore, Inspektoriati Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit është vazhdimisht në përballje institucionale me I.M.T e Bashkive, dhe kryesisht lejet e ndërtimit jepen nga Agjensia Kombëtare për Planifikimin e Territorit, projektligji duhet të kishte ndërhyrë për të adresuar këtë situatë si dhe për të ndarë qartë përgjegjësitë për zhvillimin dhe kontrollin e territorit.
10. Në Ligj, gjithashtu, parashikohet e drejta e Kryetarit të Bashkisë për të emëruar dhe shkarkuar Administratorët e njësive administrative, duke i dhënë këtij të fundit një status politik, duke krijuar marrëdhënie të brishtë varësie ndaj Kryetarit të Bashkisë dhe forcës politike që ai përfaqëson, në një kohë që administratori duhet të jetë pjesë e nëpunësve civilë, për të qenë më tepër i përgjegjshëm ndaj shërbimeve që iu ofrohen qytetarëve.
11. Gjithashtu, në asnjë dispozitë të ligjit nuk del mënyra sesi do të bëhet rregullimi i marrëdhënieve të punës për punonjësit, pjesë e strukturave të qeverisjes vendore. Këtu sugjerojmë të vendoset një dispozitë specifike për këtë rregullim, duke ju referuar Ligjit “Për nëpunësin civil” dhe Kodit të Punës. Kjo lind si nevojë veçanërisht pas ristrukturimeve, që po bëhen në njësitë e qeverisjeve vendore pas reformës territoriale-administrative.

### **3.3 Respektimi i të drejtave të personave të shoqëruar, të ndaluar, të arrestuar dhe të dënuar në njësitë policore dhe çështje të tjera që lidhen me këto institucione**

Gjatë vitit 2015 në institucionin e Avokatit të Popullit janë administruar 146 ankesa, ndaj organit të Policisë së Shtetit. Nëpërmjet ankesave qytetarët kanë paraqitur pretendime për shkelje të të drejtave të tyre ligjore nga strukturat, ose punonjësit e Policisë së Shtetit.

Objekti i ankesave ka qënë i ndryshëm sikurse mund të përmendim, për torturë dhe keqtrajtime fizike e psikologjike në momentet e arrestimit, apo të shoqërimit në organet e policisë; për arrestime, ndalime apo shoqërime të paligjshme; për kontrole të paligjshme të banesave apo të ambienteve të tjera private; për mosmarrje, mosadministrim, ose mosndjekje të kallëzimeve, apo të kërkesave të bëra nga qytetarët; për vendosje të masave administrative të padrejta; për bllokime të paligjshme të sendeve personale, apo mosmbajtje dhe mosdhënie të procesverbaleve dhe dokumentacionit përkatës.

Nga shqyrtimi i këtyre ankesave ka rezultuar se disa prej tyre dhe konkretisht ato për ushtrim dhune fizike, për mosdhënie të procesverbaleve të kontrollit, të sekuestrimit apo të bllokimit të sendeve, si dhe për mosadministrimin e kallëzimeve të bëra nga qytetarët në organet e Policisë së Shtetit, kanë rezultuar të bazuara. Për rrjedhojë, nga institucioni i Avokatit të Popullit janë bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organeve, të cilat kanë shkelur të drejtat ligjore të ankuesve dhe janë vënë në dijeni strukturat përgjegjëse eprorë.

Dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 108/2014 “Për policinë e shtetit”, parashikojnë edhe detyrimin e Oficerëve të Policisë Gjyqësore për të mbajtur procesverbalin përkatës për kryerjen e kontrollit dhe për vendosjen e sekuestrës, si dhe dorëzimin e kopjes së tyre personit, ndaj të cilit janë kryer këto veprime procedurale. Gjithashtu, ato parashikojnë edhe dhënien personit të interesuar, të kopjes së vendimit të kryerjes së kontrollit, kur rasti e lejon, si dhe të vendimit të sekuestrimit të provave materiale dhe të sendeve.

Në të shumtën e rasteve që kanë rezultuar nga hetimi administrativ si pretendime të bazuara, Avokati i Popullit ka konstatuar se moskryerja e këtyre veprimeve mund të ketë ndodhur nga mosnjohja e ligjit ose nga neglizhenca për zbatimin e tij dhe për përmbushjen e rregullt të detyrës. Këto veprime janë në kundërshtim me legjislacionin në fuqi duke krijuar kështu premisa për ndodhjen e ngjarjeve të pahijshme, sikurse ka patur raste të humbjeve apo vjedhjeve të sendeve të sekuestruara qytetarëve të ndryshëm nga punonjësit e policisë, duke i cënuar atyre të drejtat ligjore të pronësisë.

Në përfundim të shqyrtimit të këtyre rasteve iu janë drejtuar rekomandime Drejtorëve të Policive të Qarkut, të cilat janë pranuar dhe zbatuar.<sup>31</sup>

Nga trajtimi i ankesave, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar marrjen e masave për punonjësit e policisë, të cilët me veprime ose mosveprime nuk kanë zbatuar ligjin, si në rastet e mosregjistrimit, mosadministrimit dhe mosreferimit të kallzimeve të veprave penale në organin e prokurorisë.<sup>32</sup>

Gjatë vitit 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka administruar një grup ankesash të disa banorëve të fshatit Lazarat të qytetit Gjirokastrë të cilët pretendonin për veprime të kundërligjshme të punonjësve të RENEA-s dhe të FNSH-së, gjatë operacionit për kapjen e autorëve të vrasjes së një punonjësi policie, ndodhur në datë 24.06.2015 në Lazarat.<sup>33</sup> Sipas ankuesve, disa nga punonjësit e policisë gjatë ushtrimit të kontrolleve të banesave të tyre ishin sjellë pa etikë me ta, i kishin fyer dhe kishin ushtruar dhunë fizike e psikologjike, duke iu cënuar të drejtat ligjore dhe dinjitetin e tyre.

Një rast të ngjashëm mund të përmendim edhe ankesën e një qytetareje nga fshati Guci e Re, të qytetit Shkodër.<sup>34</sup> Sipas ankesës, punonjësit e Policisë së Shtetit gjatë kryerjes së veprimeve policore për gjetjen dhe kapjen e autorit të vrasjes së dy turistëve çek, ngjarje e ndodhur në muajin korrik 2015, kishin bërë kontrollin e banesës së saj dhe kishin fyer e dhunuar fizikisht djalin e saj, shtetasin M.Gj. sepse, për shkak të ngjashmërisë, e ngatërruan me vrasësin.

Nga shqyrtimi u ankesave u arrit në konkluzionin se, veprimet e punonjësve të policisë, ishin tregues të humbjes së kontrollit dhe të qetësisë së tyre gjatë kryerjes së detyrës ligjore. Veprime të tilla të punonjësve të policisë, jo vetëm çenojnë rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe dëmtojnë e trondisin besimin e publikut tek ky organ, por gjithashtu shkelin të drejtat e njeriut përsa i përket keqtrajtimit dhe torturës.

Në këto raste, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar organit të Prokurorisë, fillimin e ndjekjeve penale ndaj punonjësve të policisë që kishin ushtruar dhunën fizike ndaj ankuesve.

---

<sup>31</sup>Rastin nr. Doc. 201501290, 201501291 ku është rekomanduar:

“1. Analizimi i këtij rasti, nxjerrja e përgjegjësive përkatëse dhe ndëshkimi disiplinor i personave përgjegjës.  
2. Zbatimi me korrektesë i dispozitave ligjore lidhur me mbajtjen e procesverbalit në të gjitha rastet e kryerjes së kontrolleve, të personit, të mjedisit e të banesës, të sekuestrimit të provave materiale dhe të sendeve dhe dhënien e kopjes së tyre dhe të vendimeve për kryerjen e kontrollit apo të sekuestrimit personave të interesuar.  
3. Marrja e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Gjirokastrë me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen.

<sup>32</sup> Rasti me nr. doc. 201501382 ku është rekomanduar:

1. Marrja e masave të nevojshme dhe të menjëhershme me qëllim marrjen e kallzimit shtetasit Mark Gjini dhe referimin e tij në organin e Prokurorisë.  
2. Analizimi i këtij rasti, nxjerrja e përgjegjësive përkatëse dhe fillimi e ecurisë disiplinore ndaj personave përgjegjës.  
3. Marrja e masave të nevojshme për përgjithësimin e këtij rasti në efektivin e Drejtorisë së Policisë të Qarkut Vlorë me qëllim që raste të tilla të mospërsëriten më në të ardhmen.

<sup>33</sup> Rasti me nr. doc. 201501098

<sup>34</sup> Rasti me nr.doc. 2015001302



Gjithashtu për këto raste i është dërguar rekomandim edhe Drejtorit të Policisë së Shtetit, për analizimin e ngjarjeve të cituara më sipër dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete, marrjen e masave të nevojshme me qëllim parandalimin në të ardhmen të veprimeve të tilla të pahijshme dhe të padenja për punonjësit e Policisë së Shtetit.

### **3.4 Respektim i të drejtave të personave e arrestuar, dënuar në Institucionet penitenciare**

Respektimi i të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar ka qënë gjithashtu në fokus të Institucionit të Avokatit të Popullit, përgjatë vitit 2015. Janë paraqitur 211 ankesa individuale, që lidhen me të drejtat e të burgosurve, nga të cilat 139 janë trajtuar dhe përfunduar dhe 72 janë në shqyrtim. Nga rastet e përfunduara, 102 kanë rezultuar të pabazuara në ligj dhe 37 janë zgjidhur në favor të ankuesit gjatë shqyrtimit. Në krahasim me vitin 2014 ka një rritje të dukshme të numrit të ankesave nga persona të arrestuar, apo të dënuar.

Ankesat e marra në shqyrtim janë paraqitur si nga të dënuarit ashtu dhe nga familjarë të tyre. Objekti i ankesave ka qënë kryesisht për cilësinë e shërbimit shëndetësor; refuzim të kërkesës për të përfituar leje shpërblyese; zvarritje e procedurës për të shkuar me leje shpërblyese; zvarritje e procedurës për t'u transferuar në një I EVP tjetër; transferim i padrejtë në një I EVP tjetër.

Në vitin 2015 është shtuar sërish numri i ankesave që lidhen me cilësinë e shërbimit shëndetësor. Gjykojmë se mbipopullimi i lartë i konstatuar në 2015 ka bërë që administrata e burgjeve të mos i përgjigjet në kohë dhe me cilësi kërkesave të të burgosurve për trajtim mjekësor. Shërbimi shëndetësor në burgje duhet të sigurojë diagnostikimin dhe trajtimin e sëmundjeve me medikamente.

Ankesa të ndryshme janë administruar me objekt zvarritjen e procedurave të transferimit të të dënuarve në një institucion sa më afër vendbanimit të familjes. Nga hetimi i këtyre rasteve, ka rezultuar se shkak i vonesës ka qënë mbipopullimi në I EVP. Në rastet kur nga të burgosurit është pretenduar transferim i padrejtë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ka kthyer përgjigje se arsyeja e transferimit të të burgosurit në një I EVP, larg vendbanimit të familjes, ka qënë siguria e tij për shkak të konflikteve me të burgosur të tjerë. Institucioni i Avokatit të Popullit e ka konsideruar të vështirë që të provohet nëse me të vërtetë arsyeja e transferimit ka qënë siguria e të burgosurit apo ndëshkim i tij, për shkak të sjellies në institucion. Gjithashtu edhe lëvizja e të burgosurit brenda institucionit në shumë raste ka qënë e pamundur për shkak të mbipopullimit.

Refuzimi i kërkesës për leje shpërblyese ka qënë objekt i disa ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit. Në rastet e ankesave të të dënuarve për leje shpërblyese dhe leje të veçantë, Institucioni i Avokatit të Popullit nuk mund të ndërhyjë për të dhënë ose jo leje, por vetëm për të verifikuar procedurën e shqyrtimit të këtyre kërkesave. Nga hetimi i këtyre rasteve ka rezultuar se, arsyeja e refuzimit të tyre ka qënë mungesa e besueshmërisë lidhur me qëndrimin e të dënuarit jashtë institucionit. Institucioni nuk ka patur garanci nëse jeta dhe shëndeti i të dënuarit nuk do të cënohej gjatë lejes, ose i dënuari mund të cënonte jetën dhe shëndetin e të tjerëve. Për të vlerësuar këtë mundësi, institucioni ka marrë informacion nga policia e shtetit dhe familjarët e të dënuarit.

Punësimi në burg është një kontribut i rëndësishëm në rehabilitimin e të burgosurve dhe në përgatitjen e tyre për t'u integruar në shoqëri. Puna në Institucionet e Vuajtjes së Dënimit është më shumë sesa përfitimi i aftësive profesionale. Puna i jep të burgosurve një ndjenjë pavarësie, pa të cilën ata plogështohen dhe krijojnë varësi të ndryshme. Megjithatë puna e të burgosurve

duhet të paguhet, kjo e drejtë e tyre vazhdon të mos zbatohet për shkak të mos nxjerrjes së akteve nënligjore. Avokati i Popullit në lidhje me shpërblimin e punës të të burgosurve, që prej Marsit 2013, i ka dërguar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë, ku është kërkuar hartimi i projektvendimit për përcaktimin e kriterëve të shpërblimit të punës të të burgosurve dhe dërgimin e tij sa më parë për miratim në Këshillin e Ministrave. Aktualisht ky rekomandim nuk është zbatuar dhe puna e të burgosurve vazhdon të mospaguhet.

Ende nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar. Avokati i Popullit në mënyrë të vazhdueshme dhe insistuese i ka rekomanduar Ministrisë së Drejtësisë, hapjen e një institucioni të ri mjekësor për sistemimin e personave me probleme të shëndetit mendor, për të cilët gjykata ka dhënë masë mjekësore “*mjekim të detyruar*”, por edhe pse kanë kaluar disa vjet dhe rekomandimi është përsëritur pas çdo ndryshimi në krye të Ministrisë apo Kryeministrisë, problematika e trajtuar në të nuk ka gjetur zgjidhje ende.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka sugjeruar se, për të siguruar një administrim të mirë të IEVP-vë duhet të tregohet kujdes në punësimin e personelit. Paga e tyre duhet të jetë dinjitoze me qëllim për të tërhequr interesin e personave të përshtatshëm; kushtet e punës dhe kompesimet ekonomike duhet të jenë në raport të drejtë me vështirësinë që paraqet puna në burgje. Në adresë të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2015 kanë ardhur një numër i konsiderueshëm ankesash me këtë problematikë. Pas shqyrtimit të tyre, në përfundim të hetimit të ankesave të punonjësve të policisë së burgjeve, të cilët ngrinin pretendimin se nuk po respektoheshin disa të drejta të parashikuara nga legjislacioni që regullon këto marrëdhënie, Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi Kryeministrit ndërhyrjen në organet kompetente për: respektimin e të dretave të punonjësve të policisë së burgjeve në rastet kur ata nuk kryejnë lejen vjetore; rritjen e buxhetit për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve për të pajisur me uniformë punonjësit; trajtimin e barabartë financiar të punonjësve të policisë së burgjeve me punonjësit e policisë së shtetit; rritjen e numrit të punonjësve të policisë së burgjeve. Aktualisht jemi në pritje të qëndrimit që do të mbahet për këto rekomandime.

Në lidhje me problematikën e mësipërme, Avokati i Popullit ka adresuar 73 rekomandime gjatë vitit 2015.

Masa e sigurisë “arrest me burg” dhe dënimi me burg nga ana e Gjykatës gjykojmë se, bazuar në Kodin Penal duhet të zgjidhen si alternativë e fundit në sigurimin dhe ndëshkimin e personave që kryejnë vepra penale, sidomos të atyre me rrezikshmëri të vogël. Kjo gjithashtu do të passjell si rezultat dhe uljen e mbipopullimit në burgje, si dhe uljen e kostove për mbajtjen e kësaj kategorie në institucione penitenciare.

### **3.5 Rastet e torturës, keqtrajtimit dhe ushtrimit të dhunës në njësitë policore dhe në institucionet penitenciare**

Pranimi dhe shqyrtimi me përparësi dhe me rigorozitet i ankesave të qytetarëve ndaj organeve të Policisë së Shtetit për dhunimin fizik të tyre në njësitë policore, si dhe ndaj Policisë së Burgjeve për dhunimin fizik të të parburgosurve dhe të dënuarve në institucionet penitenciare ka qënë dhe do të vazhdojë të mbetet një nga prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit.

Duhet theksuar se kjo problematikë mbetet shqetësuese, pasi përbën një nga shkeljet më të rënda të të drejtave themelore të njeriut, për ***të mos ju nënshtruar torturës, dënimin apo trajtimin mizor, çnjerëzor ose poshtëruar***, e cila garantohet dhe mbrohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (neni 25), Konventa Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të

Njeriut (neni 3), Konventa e OKB-së, Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese, “Protokolli Opsional i Konventës Kundër Torturës dhe ndëshkimeve të tjera ç’njerëzore dhe degraduese (OPCAT)”, Kodi Penal (nenet 86 dhe 250).

Dhuna e ushtruar nga punonjës policie, që në disa raste përbën torturë ose veprime arbitrare, çënon rëndë integritetin fizik e psikologjik të personit dhe lë pasoja në shëndetin dhe në raste të veçanta edhe në jetën e të dhunuarit, deri në humbjen e saj. Ky veprim është i dënueshëm penalisht për personin që e kryen atë. Ndërkohë ai çënon rëndë imazhin e Policisë së Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, si dhe dëmton e trondit besimin e publikut tek këto organe. Gjithashtu ky tregues negativ i Policisë është i papranueshëm në një shtet të së drejtës dhe në një shoqëri demokratike.

Rastet e përdorimit të dhunës nga punonjësit e policisë ndaj qytetarëve janë të vështira për t’u provuar si edhe vërtetuar. Kjo lidhet me shumë arsye e shkaqe, sepse ato kryhen në vende të mbyllura, brenda ambienteve të policisë, në zyra, pa dëshmitarë të jashtëm okulare, por edhe në rastet kur ka të tillë, është e vështirë që të dhunuarit të dalin kundër punonjësve të policisë. Ekziston edhe frike hakmarrjeje tek qytetaret për ti denoncuar rastet e dhunës, si dhe pasiguri e mosbesim në ndjekjen e tyre nga organet e drejtësisë. Që të mundësohet vërtetimi i dhunës policore është e nevojshme që, ankesa të bëhet sa më shpejtë, kur pasojat e saj janë ende të dukshme dhe ndërkohë, duhet bërë hetimi administrativ në vend.

Nga përvoja disa vjeçare e institucionit tonë rezulton se, punonjësit e Policisë së Shtetit të përfshirë në këtë fenomen, për nga hierarkia janë punonjës zbatues të nivelit të ulët dhe të mesëm, sikurse mund të përmendim punonjësit e patrullës së përgjithshme, specialistët e policisë së zonave dhe inspektorët e policisë kriminale (oficerët e policisë gjyqësore).

Gjatë vitit 2015, janë administruar 42 ankesa ndaj organeve të Policisë së Shtetit për ushtrim të dhunës fizike nga ana e punonjësve të saj gjatë shoqërimit, arrestimit në flagrancë, ndalimit apo gjatë marrjes në pyetje në njësitë policore. Disa nga këto raste janë bërë publike nëpërmjet organeve të medias, të cilat i kanë marrë rastet në mënyra e forma të ndryshme, si drejtpërdrejtë, nëpërmjet filmimeve të bëra me aparatet e telefonave celular nga persona të afërm të të dhunuarve, apo edhe kalimtarë të rastit. Këto raste Institucioni i Avokatit të Popullit i ka marrë në shqyrtim me iniciativë. Nga çështjet e shqyrtuara janë zgjidhur në favor të ankuesve 10 ankesa, janë vlerësuar të padrejta 26 dhe janë nxjerrë jashtë juridiksionit 4 prej tyre.

Në rastet për të cilat është bërë e mundur të provohet ushtrimi i dhunës ndaj qytetarëve nga punonjësit e Policisë, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë rekomandimet përkatëse drejtuar organit të Prokurorisë, për fillimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale të “Torturës” dhe të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Në total janë bërë 9 rekomandime për fillimin e hetimeve, nga të cilat 1 rast për veprën penale të “Torturës” dhe 8 raste, për veprën penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Ndërsa për 1 rast i është drejtuar rekomandim strukturave drejtuese të Policisë së Shtetit për dhënien e masës disiplinore. Nga rekomandimet e bëra për fillimin e hetimeve, 8 raste janë pranuar dhe për 1 rast nuk është dhënë ende përgjigje.

Nga hetimi administrativ i rasteve të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit ka rezultuar se shkaqet e ushtrimit të dhunës nga punonjësit e Policisë së Shtetit janë të ndryshme. Disa prej tyre lidhen me mungesën e përgatitjes të përgjithshme dhe asaj profesionale, mosnjohje të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar, moszbatimi i procedurave standarte gjatë kryerjes së veprimeve nga punonjësit e Policisë, presionit të disa drejtuesve për zbulimin me çdo mjet të autorëve, vrasja dhe plagosja e punonjësve të policisë, në një pjesë të rasteve mosndëshkim administrativ dhe penal i autorëve të ushtrimit të dhunës, etj.

Në fillimin me iniciativë të rasteve të bëra publike në media për ushtrimin e dhunës fizike ndaj qytetarëve prej punonjësve të Policisë së Shtetit në mjediset e Policisë, apo jashtë tyre, pas hetimit të gjithanshëm të këtyre rasteve është rekomanduar fillimi i hetimit për veprën penale

*“Kryerja e veprimeve arbitrare”*, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, për 9 raste. Persona të dyshuar në kryerjen e kësaj vepre penale kanë qënë kryesisht drejtues të Policisë së Shtetit si zv/drejtor policie, shefa komisaratesh dhe punonjës policie të rolit bazë. Ka risi sa i përket qëndrimit të mbajtur nga Avokati i Popullit, për zgjerimin e hetimit në lidhje me përgjegjësinë edhe të personave të tjerë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës nga drejtuesit e Policisë në dëm të qytetarëve. Duke patur parasysh detyrimin ligjor të punonjësve të policisë, që nuk kanë marrë masa për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme, organit të Prokurorisë i është rekomanduar ndaj tyre fillimi i hetimit për veprën penale, *“Mosmarrja të masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme”*, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Në trajtimin e rasteve të ankesave të dënuarve apo të paraburgosurve, kur ndaj tyre është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e Policisë së Burgjeve, mund të përmendim rastet e keqtrajtimit të një të dënuari në IEVP “Zahari” Krujë, nga punonjësit e policisë së Drejtorisë të Përgjithshme të Burgjeve, apo të një të dënuari në IEVP Durrës, nga policët e grupit të gatshëm.

Ndërkohë shumë prej çështjeve penale të filluara nga organi i Prokurorisë në bazë të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, pushohen ose edhe kur pranohen e fillohet hetimi, ndryshohet cilësimi juridik i veprës penale nga torturë në kryerje të veprimeve arbitrare, sepse kjo e fundit parashikon lloje dhe masë dënimi më të butë. Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit, i ka rekomanduar Drejtuesit e Policisë së Shtetit:

- Bërjen e një analize të thellë të këtij fenomeni, nxjerrjen e shkaqeve të ndodhjes dhe vendosjen e detyrave konkrete për parandalimin e tij.
- Përgjithësimin e rasteve të dhunës dhe të masave të dhëna ndaj autorëve të tyre.
- Përmirësimin e kurrikulës të Shkollës Bazë të Policisë dhe të Shkollës së Lartë të Sigurisë (Policisë), duke i dhënë prioritet e pasuruar atë me më shumë tema, për njohjen dhe respektimin rigoroz të drejtave të njeriut.
- Drejtuesit e Policisë së Shtetit në qendër dhe ata vendorë, duhet të punojnë më shumë me efektivat për të bërë të mundur njohjen e tyre me aktet normative të brendshme dhe ato ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe sidomos, me përmbajtjen e dispozitës së Kodit Penal, të ndryshuar, për veprën penale të “Torturës”. Ata duhet të marrin të gjitha masat organizative që kjo shkelje ligjore, e cila kryhet nga individ të caktuar në organet e Policisë të parandalohet dhe nëse ndodh të kallëzohet menjëherë prej tyre në organet kompetente.
- Drejtuesit e Policisë së Shtetit duhet të jenë shembull pozitiv për vartësit e tyre dhe në publik, lidhur me korrektësinë në kryerjen e detyrës, në zbatimin e ligjeve dhe veçanërisht lidhur me respektimin e të drejtave të njeriut, si dhe trajtimin me dinjitet të qytetarëve, qofshin ata edhe autorë të veprave penale.
- Trajnimin në mënyrë të vazhdueshme nga ana psikologjike e punonjësve të Policisë së Shtetit me qëllim zbatimin e rregullave të sjelljes dhe etikës gjatë përmbushjes së detyrave, si dhe ruajtjen e qetësisë dhe të kontrollit të veprimeve të tyre gjatë kryerjes së detyrave ligjore edhe në rastet kur kundërshtohen verbalisht apo fizikisht, nga persona të ndryshëm.
- Të qartësohet mirë e drejta e përdorimit të forcës nga punonjësit e policisë për të përmbushur detyrën ligjore, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.
- Të mospromovohen e ngrihen në detyrë punonjësit e Policisë, që kanë qënë autorë të përdorimit të dhunës ndaj qytetarëve.
- Nga titullarët dhe drejtuesit e tjerë të organeve vendore të Policisë të ushtrohet më shumë kontroll dhe të mbahet qëndrim në rastet e ushtrimit të dhunës ndaj qytetarëve, qofshin ata kundërvajtës administrativ, ose edhe autorë krimesh.

Ndërsa ndaj organeve të Policisë së Burgjeve janë administruar 20 ankesa, të bëra nga të paraburgosurit dhe të dënuarit për ushtrim dhune fizike e psikologjike në institucionet

penitenciare. Nga ankesat e administruara kanë përfunduar 19 raste dhe është në ndjekje 1 rast. Për ankesat për të cilat kemi mundur të provojmë ushtrimin e dhunës nga punonjësit e Policisë së Burgjeve ndaj personave të paraburgosur, ose të dënuar penalisht me burgim janë bërë 2 rekomandime drejtuar organit të Prokurorisë, për fillimin e hetimeve për kryerjen e veprave penale të “Kryerjes së veprimeve arbitrare”. Rekomandimet janë pranuar, por pas fillimit të hetimeve, organi i prokurorisë ka vendosur pushimin e procedimit penal. Gjithashtu, në 2 raste të tjera ku pretendohet se ishte ushtruar dhunë fizike në ambientet e IEVP-së 302 dhe IEVP Korçë, nga verifikimet ka rezultuar se këto ambiente ishin të pamonitoruara. Për këto arsye iu dërguan rekomandime institucioneve përkatëse për vendosjen e kamerave.

### **3.6. Respektimi i të drejtës për një proces të rregullt ligjor**

- *E drejta për një proces të rregullt ligjor lidhur me veprimet e Prokurorisë dhe Gjykatave*

E drejta për një proces të rregullt ligjor paraqitet si një garanci për shtetasit ndaj veprimeve të padrejta dhe të paligjshme të organeve të pushtetit shtetëror nga njëra anë, dhe si detyrim i këtyre të fundit për të mos cënuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, pa siguruar respektimin e procedurave ligjore nga ana tjetër. Prosesi i rregullt ligjor është një karakteristikë e pandashme e shtetit të së drejtës, si një e drejtë kushtetuese dhe një e drejtë e afirmuar në akte ndërkombëtare.

Në nenin 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, e drejta për një proces të rregullt ligjor rezulton me një formulim më të gjerë se Kushtetuta e Shqipërisë, ku krahas të drejtës për gjykim të drejtë, publik dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj, përfshihen edhe disa standarte të tjera, të cilat në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë gjenden të shpërndara në disa dispozita.

Kështu, e drejta për t’u dëgjuar para se të gjykohet, e drejta e prezumimit të pafajësisë derisa të provohet fajësia nga gjykata, e drejta e të akuzuarit për tu informuar brenda një afati sa më të shkurtër dhe në gjuhën e tij për akuzën, e drejta për tu mbrojtur, përbëjnë sipas nenit 6, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, thelbin e të drejtave procedurale të procesit të rregullt ligjor, ndërkohë që ato nuk gjenden në përmbajtjen e nenit 42, të Kushtetutës.

Gjatë vitit 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 174 ankesa të adresuara nga qytetarët për veprime të padrejta, ose mosveprime të organit të akuzës dhe të gjykatës. Problematike mbeten pretendimet e ankuesve për zvarritje të pajustificuara të hetimit, apo gjykimit të çështjeve civile dhe penale. Lidhur me organin e akuzës, në jo pak raste, zvarritjet e hetimeve kanë qënë për vepra penale të hetuara nga Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore, dhe Prokuroria për Krime të Rënda Tiranë, nga kjo e fundit deri në 1 vit. Gjatë trajtimit të këtyre ankesave është konstatuar se zvarritjet janë rrjedhojë e moskryerjes së hetimeve të gjithanshme, veprimeve hetimore pa plan dhe jo në vazhdimësi. Më e theksuar kjo, në ato raste kur vendimi i mosfillimit të procedimit penal apo pushimit të çështjes nga Prokuroria, është shfuqizuar nga gjykata. Pas dërgimit të akteve nga gjykata, organi procedues ka zvarritur hetimet në mënyrë të pajustificuar dhe për një kohë të gjatë, shpesh dhe pa realizuar detyrat e lëna në vendimin e gjykatës.

Si shkaqe për zvarritjet vazhdojnë të mbeten kryerja e disa ekspertimeve të ndryshme në një procedim penal, apo dhe administrimi me vonesë i akteve; mosshqyrtimi dhe vlerësimi i kërkesave të palëve në procesin penal sidomos pretendimeve të personit nën hetim; mosparaqitja e palëve sidomos dëshimtarëve dhe në raste më të rralla gjykimi i çështjeve penale në mungesë të të pandehurve.

Një sërë ankesash janë paraqitur edhe ndaj gjyqësorit, kryesisht ndaj Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës së Lartë, pasi në këtë të fundit janë bllokuar prej vitesh dosje gjyqësore pa iu nënshtruar një procesi gjyqësor.

Me qëllim moszvarritjen e proceseve civile e penale, Avokati i Popullit i është drejtuar me rekomandime Kryetarëve të Gjykatave të Rretheve Gjyqësore, Gjykatave të Apelit dhe Gjykatës së Lartë. Vlen të përmëndim se, në disa raste ndërhyrja jonë ka patur impaktin e saj pozitiv, çka ka konsistuar jo vetëm në vlerësimin e rekomandimeve,<sup>35</sup> por dhe në marrjen e masave për shpejtimin e gjykimeve, ose dhe për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Konkretisht, i është drejtuar rekomandim Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, lidhur me marrjen e masave për ekzekutim të menjëhershëm të vendimit gjyqësor, çka edhe është realizuar për një çështje të përfaqësuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit në gjykatë, lidhur me garantimin e një shërbimi të përshtatshëm mjekësor.<sup>36</sup>

Një aspekt tjetër i evidentuar është mosrespektimi i dispozitave procedurale, që parashikojnë të drejtat e palëve në procesin civil apo penal, të cilat paraqiten në:

- a) *Mosdhënien e akteve të ndryshme të sekuestruara gjatë hetimit të procedimeve penale.* Qytetarët në 3 raste, në ankesat e tyre kanë ngritur shqetësimin se organi i Prokurorisë për llogari të hetimit të procedimit penal, ka sekuestruar akte të ndryshme që ata kanë disponuar mbi pasuritë e tyre si, automjete, etj, por ato nuk u janë vënë në dispozicion pas kërkesës së paraqitur prej tyre. Në raste të tjera qytetarët kanë patur ankesa për mosdhënie të akteve të procedimeve penale, apo për mosdërgimin në kohë të dokumenteve të nevojshme pranë Komisionit të Komisarariatit të Policisë Rrugore si, raportin e shërbimit, lejën drejtimit të mjetit, pas përfundimit të hetimit për vepra penale si, “*Drejtimi i mjetit në gjendje të dehur*” etj. Nga mosveprimi i organit procedues dhe zvarritjet për mosdhënie të akteve të procedimit penal në rastet e mësipërme kanë ardhur pasoja nga më të ndryshmet. Ato lidhen me cënimin e interesave të ligjshme të qytetarëve, moskryerjen e veprimeve me automjetet në pronësi për të kryer aktivitetin e biznesit privat apo familjar, apo dhe zvarritjen e procedurave për ankimin në gjykatë, ndaj vendimeve të mosfillimit të procedimit penal, apo pushimit të çështjes nga Prokuroria.
- b) *Mos shqyrtimin dhe vlerësimin e kërkesave apo memorieve me shkrim, që palët kanë paraqitur në procesin penal,* sidomos gjatë fazës së hetimit paraprak, në kundërshtim me pikën 2, të nenit 110, të Kodit të Procedurës Penale, duke mos u shprehur me vendim brenda pesëmbëdhjetë ditëve, dhe në mjaft raste pa njoftuar kërkuuesin. Raste të tilla kanë qënë 4 ankesa. Mos shqyrtimi i kërkesave apo memorieve të personave nën hetim apo përfaqësuesit të tyre janë me pasojë ndaj qytetarëve, pasi si rezultat i mosverifikimit të “pretendimeve” që paraqesin personat nën hetim vijnë zvarritje të hetimit, apo mund të ndodhë marrja e një vendimi përfundimtar të pabazuar, duke cënuar kështu mbarëvatjen e një procesi të rregullt ligjor.
- c) *Mosnjoftimin ose vonesën në njoftimin e palëve për vendimet e marra nga organi i Prokurorisë sidomos kallëzuesit të veprës penale, kryesisht në rastet e vendimeve për mosfillim të procedimit penal.* Ky vendim nuk i është njoftuar palëve menjëherë në 10 raste, ashtu si parashikohet në nenin 291/2 të Kodit të Procedurës Penale. Vonesa për njoftimet e palëve në

<sup>35</sup> Rekomandim i datës 12.10.2015, drejtuar Gjykatës Administrative së Apelit Tiranë për shpejtimin e gjykimit të çështjes të shtetasit H.P, me objekt “Ndërperje të pensionit të pleqërisë”, pasi gjykimi ishte zvarritur për një periudhë kohe prej 4 vjetësh. Rekomandimi është vlerësuar dhe pranuar nga Gjykata

<sup>36</sup> Rekomandim, datë 14.05.2015

procesin penal kanë ndodhur dhe për rastet kur organi i Prokurorisë ka marrë vendim për pushimin e çështjes. Për rastet e pezullimit të hetimit, Prokuroria në pjesën më të madhe të rasteve nuk njofton, apo nuk ia dërgon palëve vendimin përkatës, me arsyetimin se “*ky detyrim nuk parashikohet në nenin 326 të Kodit të Procedurës Penale*”. Avokati i Popullit ka insistuar në respektimin e të drejtës së qytetarit për t’u informuar me vendimet përfundimtare të marra nga Prokuroria, dhe veç kësaj në rekomandimin drejtuar Ministrit të Drejtësisë, është kërkuar ndërmarrja e iniciativës legjislative për një shtesë në dispozitën e Kodit të Procedurës Penale, për ankimin që duhet të bëjnë qytetarët ndaj vendimit të pezullimit të hetimit, parashikuar nga neni 326 i Kodit të Procedurës Penale.

Në përfundim të trajtimit, apo hetimit të pavarur administrativ të ankesave të qytetarëve ndaj organit të akuzës, duke i vlerësuar ato të drejta, Avokati i Popullit ka rekomanduar marrjen e masave me qëllim përmirësimin e punës apo dhe fillimin e hetimit ndaj personave përgjegjës që kanë cënuar në mënyrë flagrante të drejtat dhe liritë e ligjshme të qytetarëve. Rekomandimet kanë qënë për raste konkrete, apo duke i grupuar ato sipas të njëjtit objekt të problematikës së paraqitur.

*Së pari:* Në fillimin me iniciativë të rasteve të bëra publike në media për ushtrimin e dhunës fizike ndaj qytetarëve prej punonjësve të Policisë së Shtetit në mjediset e Policisë, apo jashtë tyre. Pas hetimit të gjithanshëm të këtyre rasteve është rekomanduar fillimi i hetimit për veprën penale “*Kryerja e veprimeve arbitrare*”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal, për 9 raste. Persona të dyshuar në kryerjen e kësaj vepre penale kanë qënë kryesisht drejtues të Policisë së Shtetit si zv/drejtor policie, shefa komisaratesh dhe punonjës policie të rolit bazë. Ka risi sa i përket qëndrimit të mbajtur nga Avokati i Popullit, për zgjerimin e hetimit në lidhje me përgjegjësinë edhe të personave të tjerë të pranishëm gjatë ushtrimit të dhunës nga drejtuesit e Policisë në dëm të qytetarëve. Duke patur parasysh detyrimin ligjor të punonjësve të policisë, që nuk kanë marrë masa për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme, ndaj tyre organit të Prokurorisë i është rekomanduar fillimi i hetimit për veprën penale të “*Mosmarrja të masave për të ndërprerë gjëndjen e paligjshme*”, parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Avokati i Popullit ka filluar me iniciativë rastin e veprimeve të paligjshme të punonjësve të Strukturave Speciale Operacionale të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në datat 26 dhe 27 Qershor 2015, kur pas aksionit në fshatin Lazarat, të Gjirokastrës, për kapjen e autorëve të vrasjes së punonjësit të Forcave Speciale “Renea”, prej tyre janë ushtruar kontrolle dhe keqtrajtuar qytetarët. Për këtë i është rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, fillimi i hetimit për veprën penale “*Kryerja e veprimeve arbitrare*” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal. Rekomandimi është pranuar dhe procedimi penal ndodhet në fazën e hetimit paraprak.

*Së dyti:* Në trajtimin e rasteve të ankesave të dënuarve apo të paraburgosurve, kur ndaj tyre është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e Policisë së Burgjeve. Të tilla janë rastet e keqtrajtimit të dënuarit në IEVP “Zahari” Krujë, nga punonjësit e policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, apo të dënuarit në IEVP Durrës nga policët e grupit të gatshëm.

Me shqetësim janë ndjekur nga ana e Institucionit të Avokatit të Popullit, rastet e “*Arrestimeve në flagrancë*” nga ana e Policisë Gjyqësore të Policisë së Shtetit, të një numri të konsiderueshëm qytetarësh, për veprën penale “*Vjedhja e energjisë elektrike*”. Për këtë qëllim i është rekomanduar Policisë së Shtetit “*Marrja e masave për respektimin e dispozitave procedurale dhe sjelljen korrekte gjatë arrestimit të qytetarëve për këtë vepër penale*”. Duhet të theksojmë faktin se, Prokuroria ka vlerësuar rekomandimet e Avokatit të Popullit, duke informuar për fillimin e hetimeve të procedimeve penale ndaj personave si autorë të dyshuar në kryerjen e veprave penale. Konstatohet se në disa raste pas kryerjes së veprimeve hetimore, Prokuroria ka

vendosur pushimin e çështjes penale. Të tilla raste janë nga Prokuroria e Rrethit Gyqësor Krujë dhe Durrës.

*Së treti:* Në trajtimin e ankesave të qytetarëve me probleme të shëndetit mendor, ndaj të cilëve gjykatat kanë vendosur masën “Mjekim i detyruar dhe shtrimin në një Spital Psikiatrik”, ndërkohë që Prokuroria nuk ka nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për të dërguar këta persona në një Spital Psikiatrik, jashtë sistemit të burgjeve.

Mbi këtë shqetësim më datë 20.10.2015, Institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar me rekomandim Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, duke vënë në dijeni dhe Prokurorin e Përgjithshëm, “Për marrjen e masave për nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit të vendimit nr.77 akti, datë 09.07.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, për vendosjen e masës së sigurimit “Shtrim i përkohshëm në një spital psikiatrik” ndaj shtetasit B.S., dhe transferimin e tij nga mjediset e Qendrës Spitalore të Burgjeve Tiranë në një Institucion Psikiatrik të Specializuar, jashtë sistemit të burgjeve”.

Prokuroria e Përgjithshme ka shqyrtuar rekomandimin dhe në përgjigjen e saj arsyeton se: “Përcaktimi i strukturave spitalore ku duhet të ekzekutohen vendimet gjyqësore për mjekim të detyruar, është një kompetencë që ushtrohet nga Ministria e Shëndetësisë që administron këto struktura. Ky konkluzion bazohet në nenin 45 të ligjit nr.8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”. Me shkresën nr.2679/1 datë 08.07.2008, Ministria e Shëndetësisë ka informuar Prokurorinë se ajo ka përcaktuar Spitalin e Burgut si strukturën spitalore që do të shërbejë për ekzekutimin e masave mjekësore të detyruara deri në përfundimin e ndërtimit të Spitalit Psikiatriko-Ligjor në Durrës. Pas kërkesës sonë për ndonjë ndryshim të mundshëm pas vitit 2008, të vendit ku do të ekzekutohen masat e mjekimit të detyruar, Ministria e Shëndetësisë na ka vënë në dijeni me shkresën nr.5015 datë 02.11.2015, se Spitali i Burgut Tiranë vazhdon të jetë vendi i caktuar për ekzekutimin e masave mjekësore të detyruara të paktën deri në fund të vitit 2016, pasi parashikohet që Spitali Psikiatriko-Ligjor Durrës të përfundojë gjatë vitit 2017”. Duke analizuar në tërësi problemin, qëndrimi i Prokurorisë në vlerësimin tonë nuk na duket i drejtë. Kjo për faktin se, numri i personave me masa mjekësore të detyruara që ndodhen në sistemin e burgjeve, është mbi 150 persona, nga të cilët vetëm 20% janë në Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, kurse pjesa tjetër në IEVP “Zahari” Krujë dhe Durrës. Mbajtja e personave me probleme mendore, me masë mjekësore të detyruar në spitale, apo seksione të IEVP-ve brenda sistemit të burgjeve, përbën një trajtim degradues dhe jo njerëzor dhe është në kundërshtim me të drejtat e njeriut, të sanksionuara në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe nenin 3, të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në këto akte ndërkombëtare, personat me çrregullime të shëndetit mendor trajtohen si të paafte e të cënueshëm, e për rrjedhojë atyre duhet t’u sigurohet trajtim i duhur mjekësor, përshtatshëm e ndihmës dhe përkujdesit mjekësor një një Institucion Psikiatrik të Specializuar. Mbi këtë shqetësim, gjatë vitit 2016 do të realizohet një studim i hollësishëm, në përfundim të së cilit do t’u rekomandohet institucioneve përkatëse, marrja e menjehershme e masave për të zgjidhur përfundimisht këtë problem.

Gjatë trajtimit të ankesave të qytetarëve, pjestarë të familjeve të viktimave, apo të dëmturave nga veprat penale, janë konstatuar shkelje të të drejtave të tyre në hetimin, apo gjykimin e procedimeve penale, ndaj autorëve të veprave penale. Ankesat e qytetarëve kanë qënë kryesisht për rastet e kryerjes së veprave penale si, “Vrasja”, “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, “Mjekim i pakujdesshëm” me pasojë vdekjen. Për të vënë në vend të drejtën që iu është shkelur qytetarëve, Avokati i Popullit më datë 10.04.2015, i ka dërguar një rekomandim Ministrit të Drejtësisë për ndërmarrjen e inisiativës legjislative, për “Propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48, 58 dhe 326 të Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e avokatit mbrojtës në



*procedimin dhe gjykimin penal, për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të viktimës*”. Rekomandimi është pranuar dhe vlerësuar, por ende nuk ka gjetur zbatim.

- **Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit gjyqësor**

Gjatë vitit 2015 janë marrë për shqyrtim gjithësej 85 ankesa, ndaj gjykatave të të gjitha shkallëve. Ajo që vihet re është se ka më tepër ankesa për zvarritje gjykimi ndaj Gjykatave të Apelit dhe në mënyrë të veçantë ndaj Gjykatës së Lartë, pasi aty janë bllokuar prej vitesh dosjet gjyqësore pa u gjykuar ende. Kjo gjë ka nevojë për t'u adresuar sa më shpejt me qëllim zgjidhjen e këtij “backlock” të çështjeve, në Gjykatën e Lartë.

Ankesat e qytetarëve kanë patur për objekt shkelje të ndryshme si, për moszhvillim të një procesi të rregullt, për zvarritje gjykimi; shkelje të procedurave gjyqësore; ankesa ndaj vendimeve gjyqësore duke i konsideruar ato si të padrejta dhe të pabazuara në ligj; për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë; ankesa ndaj Ministrisë së Drejtësisë për zvarritje të procedurave ligjore për transferimin e të dënuarve kosovarë në Republikën e Kosovës, për vuajtjen e dënimit me burgim në shtetin e tyre; ankesa për pezullimin e vendimeve gjyqësore nga Gjykata e Lartë; për mosdhënie të kopjeve të vendimeve gjyqësore etj.

Avokati i Popullit gjatë vitit 2015 në punën e tij gjatë shqyrtimit të ankesë/kërkesave, ka dhënë asistencën e nevojshme duke adresuar me shkrim çdo rast të konstatuar për shkeljen e pretenduar nga qytetarët, në Ministrinë e Drejtësisë, ose në Inspektoriatin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkelje të ndryshme të procedurave gjyqësore të kryera gjatë gjykimin nga gjyqtarë të veçantë, si edhe për shkelje të tjera të ndryshme të kryera nga administrata gjyqësore.

Lidhur me shkeljet e pretenduara të ankuesve, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar rekomandimet dhe pasi ato janë shqyrtuar nga gjykata përkatëse, janë marrë masa organizative duke përfunduar gjykimet në një kohë më të shpejtë. Si rast pozitiv mund të përmendet ankesa e një shtetasi nga Tirana, procesi gjyqësor i të cilit zvarritej që prej vitit 2012. Për këtë, më datë 14.12.2014, i kemi rekomanduar Gjykatës së Lartë, shpejtimin e gjykimin të çështjes civile me objekt: “Pagimin e pensionit ushqimor” të shtetasit G.S, pasi zvarritja në gjykim ishte bërë shkak për moslidhjen e pensionit të pleqërisë. Rekomandimi është duke u shqyrtuar nga Gjykata e Lartë.

Qytetarët në 6 raste janë ankuar për shkelje ligji dhe veprime korruptive, ndaj gjyqtarëve të veçantë. Ankesat bashkë me dokumentet e paraqitura nga qytetarët i janë dërguar për kompetencë shqyrtimi Inspektoriatit të KLD-së. Pasi janë kryer verifikimet përkatëse nga Inspektoriatin, jemi informuar për faktin se, në 2 raste janë marrë masa disiplinore për shkeljet e konstatuara ndaj gjyqtarëve përgjegjës. I tillë është rasti i ankesës së një shtetase nga Tirana, e cila është ankuar ndaj Gjykatës së Apelit Tiranë, për shkelje ligjore, pasi nuk ka dërguar në kohë vendimin gjyqësor për ekzekutim nga Prokuroria Tiranë, për shkak të moszbardhjes në kohë të vendimit. Kjo gjë ka sjellë si pasojë qëndrimin padrejtësisht në burg për 10 ditë, të bashkëshortit të saj. Për këtë shkelje, më datë 30.04.2015 i kemi rekomanduar Inspektoriatit të KLD-së, marrjen e masës masë disiplinore ndaj gjyqtarit R.H., për të cilën është kthyer përgjigje për qëndrimin që do të mbahet, duke ndjekur procedurat përkatëse.

Më datë 18.05.2015, i kemi rekomanduar Inspektoriatit të KLD-së marrjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarit G.Q., për mbajtje padrejtësisht në burg për 16 ditë, të një qytetari nga Durrësi, pasi nuk kishte marrë parasysh dhe vlerësuar një vendim gjyqësor që, kishte lidhje direkte me çështjen objekt shqyrtimi. Gjykata e Apelit Shkodër pas shqyrtimit të ankesës së qytetarit ka vendosur shfuqizimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, duke urdhëruar lirim të menjëhershëm të shtetasit G.B. Rekomandimi është pranuar, duke na informuar për propozimin drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, për masë disiplinore.

Po kështu është vepruar dhe për ankesën e një qytetari nga Tirana, person me aftësi të kufizuar i cili ankohej për zvarritje gjykimi në një çështje penale, nga Gjykata e Lartë Tiranë, në çështjen penale në ngarkim të djalit të tij, i dënuar për veprën penale “Mbajtje dhe kultivim i lëndës narkotike”. Mbi këtë shqetësim më datë 10.03.2015, i kemi rekomanduar Gjykatës së Lartë shpejtimin e gjykimit. Në përgjigje jemi informuar se, çështja është në shqyrtim dhe rekomandimi ynë i është paraqitur relatorit të çështjes.

- *Ndihma juridike falas.*

Në lidhje me ndihmën juridike falas në vendin tonë për rregullimin e këtij fenomeni në praktikën e përditëshme ka hyrë në fuqi Ligji me Nr.10039 datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”, dhe është krijuar Komisioni Shtetëror për dhënien e ndihmës juridike falas nga shteti, në Ministrinë e Drejtësisë.

Ky Komision ka për objekt të veprimtarisë së tij shqyrtimin e ankesave të paraqitura nga qytetarë të ndryshëm, të cilët nuk kanë të ardhura ekonomike dhe financiare të mjaftueshme për të zgjedhur vet një avokat mbrojtës privat, për përfaqësim dhe mbrojtje në çështje të ndryshme gjyqësore.

Janë 12 kërkesa për ndihmë ligjore falas të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2015. Ato i janë adresuar nga Avokati i Popullit për kompetencë shqyrtimi, Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike në Ministrinë e Drejtësisë, dhe për këtë veprim nga ana e Avokatit të Popullit janë vënë në dijeni me shkrim edhe kërkuesit. Ky Komision i ka trajtuar kërkesat e adresuara nga Avokati i Popullit në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10039 datë 22.12.2008 “Për Ndihmën Juridike”.

Nga rastet e paraqitura tek ne konstatohen edhe raste që vonohet shqyrtimi i kërkesave të individëve nga Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike, pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në këtyo raste ata riparaqiten përsëri tek ne duke menduar se, me paraqitjen e kërkesës tek institucioni i Avokati të Popullit, atyre do tu caktohet menjëherë avokati mbrojtës privat, pa plotësuar dokumentat përkatëse dhe pa u shqyrtuar kërkesa e tyre nga Komisioni Shtetëror.

Ndryshimet e bëra me Ligjin me Nr.143/2013”Për disa shtesa në Ligjin Nr.10039”Për Ndihmën Juridike”, u kanë dhënë më shumë mundësi individëve në pamundësi ekonomike dhe financiare për të realizuar të drejtat e tyre pranë gjykatave. Me këto ndryshime është bërë e mundur dhënia e ndihmës juridike nga Klinikat ligjore vendore, të cilat sipas ligjit në fjalë duhet të krijohen në gjithë territorin e vendit, pranë Gjykatave të Apelit.

### ***3.7 Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore civile dhe administrative***

Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore penale, civile dhe administrative janë pjesë e procesit të rregullt ligjor, i cili garantohet në nenin 42/2, të Kushtetutës, nenin 6/1, të Konvetës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut. Procesi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv prej Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor, si dhe autoriteteve të tjera të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre, në një afat të përcaktuar apo të arsyeshëm, ka qenë objekt shqyrtimi gjatë vitit 2015, prej Gjykatës Kushtetuese, e cila ka konstatuar cënimin e parimit për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të titullit ekzekutiv në një afat të arsyeshëm. Siç theksohet në dokumente të njohura ndërkombëtare, zbatimi i plotë, efektiv dhe efikas i vendimeve gjyqësore të formës së prerë është me rëndësi thelbësore për shtetin, me qëllim që të krijojë, forcojë dhe zhvillojë një sistem gjyqësor të respektueshëm nga të gjithë.

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, nga ana e organeve të Administratës Publike në cilësinë e debitorit, gjykojmë se, vjen në kundërshtim me sanksionimin e kryer në nenin 142/3, të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, nenin 451/a, të Kodit të Procedurës Civile, si dhe me parimet mbi të cilat zhvillohet veprimtaria e organeve të administratës publike. Mungesa e fondeve financiare për përmbushjen e detyrimeve në të holla

prej organeve debitore të administratës publike, nuk mund të justifikojë mosekzekutimin e asaj të drejte që shtetasi e ka fituar në rrugë gjyqësore. Kjo është e mirëpërcaktuar si në vendimet e dhëna prej Gjykatës Kushtetuese, ashtu dhe Konvetën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, e cila ka nënvizuar se: *“Asgjë, as mungesa e fondeve nga ana e autoriteteve nuk e justifikon mos ekzekutimin e nje vendimi gjyqësor”*.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015, ka pranuar për shqyrtim 48 ankesa, (nga të cilat, 35 raste drejtohen ndaj Shërbimit të Përmbartimi të Gjyqësor Shtetëror, dhe 13 të tjera ndaj Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor, Privat), në të cilat subjekte të ndryshëm, fizik dhe juridik, janë ankuar për mosekzekutimin në një afat të arsyeshëm të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë, nga ana e organeve të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të administruara gjatë vitit 2015, me objekt mosekzekutimin e titujve ekzekutiv, Avokati i Popullit, gjykon se, shkak i cili ka cënuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor është problematika që mbart Udhëzimi nr.1 datë 04.06.2014, i Këshillit të Ministrave, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”*. Gjithashtu ka rezultuar se, përfaqësuesit e organeve debitore si dhe organet eprore financiare të tyre, nuk mbajnë qëndrim rigoroz në respektim të së drejtës së fituar në rrugë gjyqësore prej subjektit ankues. Për përmirësimin e kësaj situatë, Avokati i Popullit do të vijojë ndërhyrjen pranë organeve përkatëse për rregullimin e saj.

Ashtu sikurse edhe një vit më parë, Avokati i Popullit ka konstatuar se çështja e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të dënimit me gjobë të subjektit vijon të mbetet e pandryshuar, edhe pse i është rekomanduar Kuvendit, përkatësisht Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, me shkresën Nr.K2/I40-7 Prot, datë 09.03.2015, *“Marrja e nismës për ndryshim legjislativ”*.

Institucioni i Avokatit të Popullit pas rekomandimeve drejtuar Ministrit të Drejtësisë, gjatë vitit 2014, për ndryshimin e nenit 45 të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë të mundur paraqitjen e kërkesës pranë Gjykatës Kushtetuese, për shfuqizimin si antikushtetues të nenit 45, të Ligjit nr.122/2013. Shqyrtimi i kësaj kërkesë është kryer nga Gjykata Kushtetuese më datë 17.02.2015. Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës, Gjykata Kushtetuese vendosi me Vendimin nr.30, datë 25.05.2015, rrezimin e kërkesës.

Gjithashtu problematik evidentohet sot, procesi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, me objekt; detyrimin e subjektit debitor privat të paguaj shumën të caktuar në të holla. Në rastin e kryerjes së veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të tij mbi të ardhurat mujore të debitorit, krijohen situata në cënim të interesave jetike të tij. Fakti që deri më sot nuk është mundur caktimi i minimumit jetik, ka bërë që parashikimi i kryer në nenin 533 të Kodit të Procedurës Civile të jetë i pazbatueshëm, prej Shërbimit të Përmbartimit Gjyqësor. Sipas kësaj dispozite, vendosja e masës së sekuestrës mbi pagën e debitorit kryhet pa cënuar minimumin jetik, i cili deri më sot është i papërcaktuar.

Në procesin e shqyrtimit të ankesave, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, Shërbimi i Përmbartimit Gjyqësor Privat, ka kryer veprime për vjeljen e detyrueshme të detyrimit në të holla nga të ardhurat e debitorit, që merret si ndihmë ekonomike. Edhe pse nuk parashikohet në nenin 529, të Kodit të Procedurës Civile, *“Sendet mbi të cilat nuk mund të vihet sekuestraja”*, Institucioni i Avokatit të Popullit planifikon të rekomandojë ndërprerjen e veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e titullit ekzekutiv mbi të ardhurat e debitorit që rrjedhin nga ndihma ekonomike.

Për zgjidhjen e kësaj çështjeje, Avokati i Popullit, ka iniciuar çështjen për amendimin e nenit 529/6 të Kodit të Procedurës Civile, lidhur me përjashtimin nga sekuestrimi i të ardhurave të krijuara nga ndihma ekonomike të debitorit. Gjatë Vitit 2015, konstatohet se, një numër i

konsiderueshëm vendimesh gjyqësore civile të formës së prerë, me objekt detyrimin e institucioneve buxhetore për të paguar shuma të caktuara në të holla ndaj subjekteve, kanë gjetur rrugën e ekzekutimit por pa shkak, ende, një numër vendimesh gjyqësore civile të dhëna në vite nuk po gjejnë të njëjtën zgjidhje edhe pse, Avokati i Popullit ka ndërhyrë pranë autoriteteve të ngarkuar me ligj për ekzekutimin e tyre.

Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, Avokati i Popullit u ka rekomanduar edhe organeve si Këshilli i Lartë i Drejtësisë, ekzekutimin e plotë të vendimeve gjyqësore civile edhe në rastet kur vendoset kthimi në punë i punonjësve<sup>37</sup>.

Edhe pse objektivi i Qeverisë ka qenë dhe është, moslejimi i borxheve të reja, i shprehur ky në VKM nr.50, datë 05.02.2014, *“Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura e të planit të veprimit”*, konstatohet se në tabelën e publikuar prej Ministrisë së Financave, për periudhën Janar - Gusht 2015, detyrimet e prapambetura, që janë krijuar rishtaz, arritën në 1.102,4 milionë lekë. Për detyrimet jashtëkontraktore në të holla, të rrjedhura sipas vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë, rezulton se, organet shtetërore kur nuk kanë aftësi paguese të menjëhershme për shlyerjen e detyrimit në të holla nuk e fusin këtë detyrim si zë të veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit për vitin pasardhës, konform parashikimit të nenit 20, të Ligjit nr.8510, datë 15.07.1999, *“Për detyrimet jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”*.

Organet apo institucionet debitore, me rastin e dorëzimit të detyrimit në të holla, sikurse është vendosur nga gjykata, nuk kanë kryer dhe nuk kryejnë procedurat e përcaktuara në Udhëzimin nr.2 datë 06.02.2012, të Ministrisë së Financave, *“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”*, (neni 62), apo në Udhëzimin nr.1 datë 13.06.1997, të Ministrisë së Financave, sipas Aktit Financiar nr.1, datë 13.10.1997, paragrafi 7, sipas të cilit, përcaktohet detyrimi i titullarit të institucionit debitor të kryej auditimin e gjithë procesit, i cili ka pas sjellë dëmin ekonomik, si dhe të marrë masa administrative e të fillojë procedime civile, kundër personave që kanë shkaktuar dëmin. Mosrespektimi i akteve të lartpërmendura, ka sjellë dhe do të sjellë cenim të interesave pasurore për çdo taksapagues në Republikën e Shqipërisë.

Tjetër shkak i cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë në një afat të arsyeshëm, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, janë edhe një sërë shkaqesh, si:

1. Mungesa e cilësisë profesionale e përmbaruesve gjyqësor, e cila shfaqet në veprimet dhe mosveprimet e tyre gjatë procesit të ekzekutimit të titujve ekzekutiv.
2. Mosnjohja e legjislacionit civil dhe atij procedural nga ana e përmbaruesve gjyqësor.
3. Kryerje veprimesh përmbarimore jashtë objektit të ekzekutimit, si dhe keq interpretim të dispozitivit të vendimit gjyqësor.
4. Mungesa e vullnetit prej përmbaruesve gjyqësor për vendosjen e sanksioneve ndaj subjektit pranë personit të detyruar, sipas vendimit gjyqësor të formës së prerë, apo personave të tjerë në procesin e ekzekutimit, të cilët refuzojnë, kryejnë në mënyrë të parregullt, nuk respektojnë afatet ose kryejnë të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës është vendosur.

---

<sup>37</sup> Rekomandim i datës 28.06.2015, drejtuar KLD-së për ekzekutimin e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Apelit Tiranë, me të cilën është vendosur kthimi në punë i ankuarit në KLD, dhe pagimin e pagës deri në ekzekutimin e plotë të vendimit gjyqësor. KLD-ja ka pranuar pjesërisht rekomandimin tonë duke i paguar pagën ankuarit, por nuk ka pranuar marrjen e tij në punë. Ky qëndrim është mbajtur edhe pas vendimit nr.32 datë 05.12.2013, të Gjykatës Kushtetuese e cila ka vendosur rikthimin në punë të qytetarit K.K.

5. Mosreflektim nga ana e ana e organeve eprore të përmbauesit gjyqësor, për dhënie mase disiplinore sa herë që vërehen shkelje të procedurave për ekzekutim, sidomos në ato raste kur gjykata ka vendosur për anulimin e veprimeve përmbaimore.

Për të mundësuar ndërprerjen e cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor, si rrjedhojë e mosekzekutimit në një afat të arsyeshëm, si dhe rivendosjes të së drejtës së shkelur subjektivit ankues, Avokati i Popullit, rast pas rasti, ka ndërhyrë pranë organit përkatës duke rekomanduar, kërkuar apo propozuar, kryerjen apo moskryerjen e veprimeve të caktuara, të cilat mundësojnë mbrojtjen e të drejtave, lirive apo interesave të ligjshme të individit.

### **3.8 Administrata publike dhe rregullimi i marrëdhënieve të punës**

Institucioni i Avokati i Popullit edhe gjatë vitit 2015 është angazhuar maksimalisht të japë kontributin e tij institucional, për çdo iniciativë, analizë apo çështje, që kërkon të zgjerohet apo edhe garantojë hapësirën e individëve për ushtrimin e të drejtave dhe lirive të tyre themelore në përputhje me, Kushtetutën, aktet ndërkombëtare dhe legjislacionin në fuqi në lidhje me administratën aublike. Sikundër është theksuar edhe në Progres-Raportin e Komisionit European për Shqipërinë, lidhur me administratën publike duhet të vijojë reforma për të vazhduar një proces transparent dhe të bazuar në merita, për rekrutimin dhe shkarkimin e nëpunësve civilë në të gjitha institucionet shtetërore, me qëllim arritjen e objektivitetit për një administratë publike profesionale dhe të depolitizuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015 ka trajtuar në total 186 ankesa individuale, me objekt largimet e padrejta nga puna, për të cilat në 60 raste janë dërguar rekomandimet përkatëse individuale, me qëllim rritjen e mëtejshme të efektivitetit dhe në mënyrë të veçantë për gjetjen e mekanizmave për kontrollin, zbatimin dhe respektimin e të drejtave të punonjësve dhe nëpunësve civilë, të çdo organi të administratës publike në Shqipëri.

Gjithashtu, një pjesë e ankesave të adresuara, kanë qenë ankesa me objekt largimet nga puna për shkak të mospagesës së detyrimeve për energjinë elektrike nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Lidhur me këto raste duke gjykuar se mospagesa e energjisë elektrike nuk është parashikuar si shkak ligjor për largim nga puna, në asnjë prej legjislacioneve që rregullon marrëdhëniet e punës (*Kodi i Punës*), dhe në kushtet kur furnizimi me energji elektrike është një shërbim publik, e kemi konstatuar këtë fakt si shkelje të legjislacionit në fuqi.

Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit ka dërguar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, rekomandime për marrjen e masave të menjëhershme për revokimin dhe konstatimin si të pavlefshëm të Urdhërave të largimin nga puna, në kundërshtim me gjithë dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e punës.

Kjo është një shkelje e të drejtave të punonjësve, pasi zbatimi i një marrëdhënie kontraktuale ashtu siç është dhe ajo me OSHEE-në rregullohet me zbatimin e dispozitave të Kodit të Procedurës Civile, duke ndërprerë shërbimin, si dhe duke kërkuar dëmin në rrugë gjyqësore. Të gjitha rekomandimet e adresura nga Institucioni i Avokatit të Popullit mbi këtë problematikë janë refuzuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve dhe ndërkohë, largimin e tyre nga puna ankuesit e kanë bërë objekt konflikti gjyqësor nga ku rezulton se të gjithë kanë dalë gjyq-fitues.

Problematikë tjetër e evidentuar ka qenë shtrirja e veprimit dhe efektet e ligjit për “*Nëpunësin Civil*”, për punonjësit e njërive të qeverisjes vendore, efektet e të cilit janë vënë re me zbatimin e reformës territoriale-administrative. Nga ankesat e trajtuara kemi konstatuar se megjithëse ligji nr. 152/2013 “*Për shërbimin civil*”, i ndryshuar, i ka filluar efektet e tij ligjore në datë

26.02.2014, rekrutimi në punë i shumë punonjësve të pushtetit vendor është bërë në përputhje me dispozitat që parashikon Kodi i Punës.

Kjo procedurë e kundraligjshme e ndjekur nga ana e njësive përgjegjëse vendore është bërë në kundërshtim me çdo dispozitë ligjore dhe i vetmi penalizim ndaj palëve është bërë në drejtim të nëpunësve duke i larguar ata nga puna, ndërkohë që nga njësia përgjegjëse duhej të evidentoheshin pozicionet e punës dhe të ndiqej procedura e parashikuar në ligjin "*Për shërbimin civil*", për rekrutimin e tyre.

Problematik ka vijuar të mbetet zbatimi i procedurave për shkak të ristrukturimeve të pozicioneve të punës, pjesë e shërbimit civil. Në rastet e ristrukturimeve, duhet të ndërmerren të gjitha procedurat për ngritjen e një komisioni ristrukturimi, me qëllim gjetjen e mundësive për sistemimin e nëpunësve në vende të lira pune, e në pamundësi, propozimi i transferimit të tyre në pozicione pune të ngjashme. (brenda afateve të parashikuara edhe në VKM-në nr. 171 datë 26.03.2014 "*Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil*"). Pra, ristrukturimi i një institucioni nuk përbën shkak për pezullimin e statusit të nëpunësit dhe për më tepër, që pezullimi i statusit duhet të ndërmerret nga njësitet e burimeve njerëzore (në rastet e institucioneve të pavarura, apo ato të pushtetit vendor) dhe jo nga komisioni i ristrukturimit.

Një numër i konsiderueshëm ankesash janë paraqitur lidhur me, transferimet e mësuesve dhe largimet nga puna të një numri të lartë punonjësish të spitaleve rajonale në vend. Lidhur me këto raste, Institucioni i Avokatit të Popullit ka qënë proaktiv sa i përkte trajtimit të këtyre ankesave, pavarësisht mungesës së raportimit të të dhënave mbi procedurat e ndërmarra dhe numrin e punonjësve të prekur nga këto reforma institucionale, nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

Mosveprimet e titullarëve të institucioneve, në gjykim të Institucionit të Avokatit të Popullit, nuk i shërbejnë aspak rritjes dhe përmirësimit të standardeve të shtetit ligjor dhe në shumë raste ulin autoritetin e institucioneve, krijojnë premisa për humbjen e besimit ndaj vënies në vend të të drejtave të shtetasve dhe mund të bëhen shkak edhe për të krijuar raste diskriminimi. I tillë është konsideruar nga institucioni ynë edhe rasti i një edukatoreje në Shkollën e Mesme të Bashkuar "Jani Vreto", Leskovik, ku pas përfundimit të lejes së lindjes, drejtori i kësaj shkolle nuk zbaton vendimin e Zyrës Arsimore Kolonjë, për rikthimin e saj në vendin e mëparshëm të punës. Rasti në fjalë është bërë publik edhe mediatikisht në emisione investigative. Institucioni i Avokatit të Popullit pas procedurave për një hetim administrativ të kësaj ankese, pas verifikimeve në vend, pas takimit zyrtar edhe me drejtorin e kësaj shkolle dhe pas një sërë shkëlqesh të konstatuara ka konkluduar së fundi me një rekomandim, drejtuar Ministres së Arsimit dhe Sportit, "*Për marrjen e masave për dhënien e masës disiplinore "largim nga detyra" ndaj Drejtorit të Shkollës së Mesme të Bashkuar "Jani Vreto", Leskovik*". Lidhur me këtë rast, nuk ka patur asnjë përgjigje zyrtare nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit është fokusuar edhe në një aspekt tjetër, i cili ka të bëjë me sigurinë dhe kushtet në punë të punëmarrësve. Duke marrë shkas nga shkrimet e publikuara në mediat e shkruara, lidhur me disa raste të ndodhura ku punëtorë kanë humbur jetën për shkak të mungesës së kushteve dhe sigurisë në punë, në zbatim të Konventës për, "*Mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë në punë*", të ratifikuar në vitin 2004 nga vendi ynë, të Kodit të Punës, Ligjit "*Për sigurinë dhe shëndetin në punë*", të një sërë direktivave të transpozuar, si dhe progres-raportit të vitit 2015, është kërkuar informacion pranë Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore. Çështjet për të cilat është kërkuar informacion lidhen me numrin e rasteve të konstatuara për punëmarrësit që kanë pësuar aksidente në punë si dhe numrin e rasteve

të punëmarrësve që kanë rezultuar të parregjistruar dhe nuk i janë bërë pagesat e sigurimeve shoqërore, masat që janë ndërmarrë për rastet e konstatuara kur aksidenti ka ndodhur për fajësi të rëndë të punëdhënësit, si dhe numrin e rasteve të konstatuara kur punëdhënësi nuk ka patur autorizimin e duhur administrativ nga inspektori i punës, përpara veprimtarisë së ushtruar.

Për ta parë në disa aspekte këtë çështje, sidomos në ato raste kur ka humbje të jetës së punëtorëve ose dëmtime të shëndetit të tyre, institucioni i Avokatit të Popullit ju është drejtuar njëkohësisht edhe të gjitha Prokurorive pranë rretheve gjyqësore lidhur me, numrin e rasteve të ndjekjeve penale që janë referuar, kallëzuar, si dhe vendimarrjen e organit të akuzës. Në vlerësim të situatës së mësipërme, do të punohet për nxjerrjen e rekomandimeve konkrete për marrjen e masave për forcimin e kontroleve në subjektet problematike për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke ju referuar dispozitave ligjore përkatëse, të cilat do të përfshihen në një raport të veçantë.

Fokus të veçantë për vitin 2015 ka marrë edhe projekt-ligji, për ndryshimet në Kodin e Punës. Institucioni i Avokatit të Popullit për herë të parë ka sugjeruar përfshirjen në këtë Kod të "*Ngacmimit Moral*", nga ana e punëdhënësit, në nenin 32 të tij, ndryshime këto të cilat janë miratuar nga Kuvendi. Këto ndryshime kanë të bëjnë me:

- Garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes së shëndetit mendor dhe fizik të punëmarrësve;
- Përfshirjen e bilbilfryrësve (whistleblowers) në rastin e identifikimit të ngacmimeve morale të punonjësve;
- Barrën e provës që i takon punëdhënësit, për të provuar se veprimet e tij nuk kishin për qëllim ngacmimin moral;
- Garancitë e punonjësve që denoncojnë raste të tilla, që të mos kenë penaltete, ose largime nga puna, ose veprime diskriminuese.

Përfshirja e ngacmimit moral dhe garancive që ofrohen në Kodin e ri të Punës është një risi e cila shënon një hap pozitiv, për të cilën Avokati i Popullit gjatë vitit 2016 do të vazhdojë punën për zbatimin e nenit 32 të kodit të punës.

Institucioni i Avokatit të Popullit në muajin Mars 2015, pas një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile dhe aktorët ndërkombëtarë, ka depozituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Raportin e Veçantë (II) "Mbi Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës", i cili ende nuk është shqyrtuar. Gjithashtu, ka përfunduar përgatitjen e një Raporti të Tretë të Veçantë, "*Mbi Administratën Publike dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës*", i cili ka përfshirë problematika dhe rekomandime për periudhën Shtator 2014 - Maj 2015 dhe është duke punuar mbi një raport tjetër të veçantë, dedikuar vetëm për nëpunësit e pushtetit vendor, pas zbatimit të reformës territoriale-administrative. Gjatë këtij viti Institucioni i Avokatit të Popullit është ftuar nga Ministria e Inovacionit dhe Departamenti i Administratës Publike për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tij, përsa i përket Reformës në Administratën Publike dhe dokumentave të takimeve të përbashkëta mes shtetit shqiptar dhe BE, për Administratën Publike.

Si konkluzion i problematikave të evidentuara më sipër dhe nga monitorimet e ndërmarra ndaj organeve të Administratës Publike, konstatojmë që pavarësisht se ligji "*Për nëpunësin civil*" është plotësuar në disa nene të tij dhe janë miratuar edhe një sërë VKM në zbatim të tij, lë vënd për keqinterpretime në disa raste të largimeve nga puna. Gjithashtu, vazhdojnë të konstatohen parregullsi në procedurat e largimeve nga puna në kuadër të proceseve të ristrukturimit të institucioneve, si për punonjësit që trajtohen sipas Kodit të Punës, ashtu edhe për ata që gëzojnë statusin e nëpunësit civil. Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar në vijim mungesë bashkëpunimi nga shumë prej institucioneve të administratës publike, veçanërisht në rastet e

largimeve nga puna, fakt i cili ka sjellë pengesë të punës dhe mos arritjen në mbledhjen e të dhënave konkrete për informacione të kërkuara.

### 3.9. E drejta për informim

E drejta për informim e fokusuar tek liria e individit për të marrë informacion nga autoritetet publike dhe jo vetëm, është një e drejtë themelore e individit, e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. E afirmuar në një sërë aktesh ndërkombëtare më së shumti të ratifikuar nga vendi ynë,<sup>38</sup> në të cilat përcaktohen standarde të respektimit të saj, regjimi juridik i kësaj të drejte themelore pasqyron në një masë të kënaqshme këto standarde.

Regjimi juridik i sëdrejtës për informim është përcaktuar nga dy ligje kryesore; Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, si dhe nga Kodi i Procedurave Administrative, i miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, që e parashikon funksionin e së drejtës për informim, si një nga parimet bazë të funksionimit të administratës publike.

Kodi i Procedurave Administrative bën një rregullim specifik të së drejtës për informim, duke ia njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ, ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces. Në parim, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 42 ankesa për shkelje të pretenduara të së drejtës për informim. Nga numri i ankesave të marra në total, 25 janë ende në shqyrtim, ndërsa për 17 të tjera ka përfunduar shqyrtimi. Në numrin e ankesave të shqyrtuara, 2 prej tyre janë jashtë kompetencës, 11 ankesa të zgjidhura pozitivisht dhe 2 ankesa të pabazuara, ndërkohë që për 2 ankesa është hequr dorë për ndjekjen e tyre të mëtejshme, nga ana e vetë ankuesve. Ankesat e marra në shqyrtim lidhen me mosrespektimin dhe garantimin e së drejtës për informim gjatë veprimtarisë së organeve të administratës publike.

Problematika të hasura nga trajtimi i ankesave të paraqitura në institucionin e Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2015, kanë të bëjnë me:

- Mosrespektim të afateve kohore të përcaktuara nga Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, për refuzimin, apo plotësimin e kërkesës së paraqitur nga subjektet e interesuara, për informim.
- Mostrajtim të kërkesave për informim nga ana e organeve të administratës publike, sipas regjimit juridik të përcaktuar nga Ligji nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- Mosinformim mbi ecurinë e procedurave specifike ligjore, nga ana e organeve përgjegjëse për mbarëvajtjen dhe përfundimin e tyre. Këto ankesa janë të bazuara në regjimin juridik të përcaktuar nga Kodi i Procedurave Administrative.

Edhe gjatë këtij viti, vërehet se në shumë çështje të zgjidhura në favor të ankuesve për mosveprime, apo zvarritje të konstatuara në trajtimin e kërkesave për informim, sipas Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, është ndrequr në mënyrë të shpejtë nga ana e organeve

---

<sup>38</sup>Disa nga aktet ndërkombëtare më të rëndësishme në këtë fushë janë Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklarata e Këshillit të Europës mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, Konventa e Aarhusit, Karta e të Drejtave të Njeriut të vendeve të Bashkimit Europian, Kodi Europian i Sjelljes së Mirë Administrative, Rekomandimi 2002(2) i Këshillit të Europës për Aksesin në Dokumenta Zyrtare.

Një tjetër konventë shumë e rëndësishme është Konventa e Këshillit të Europës “Për aksesin në dokumentet zyrtare”, Tromso, e adoptuar në mbledhjen e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës, më 27.11.2008, ende e paratifikuar nga ana e shtetit tonë.



përkatëse të administratës publike, pas ndërhyrjes së Avokatit të Popullit.

Megjithë disa përmirësime të regjimit juridik të së drejtës për informim, me hyrjen në fuqi të Ligjit “Për të drejtën e informimit”, përsëri mbetet problem çështja e përcaktimit të rolit kompetencial që Avokati i Popullit ka tashmë në kuadër të veprimtarisë së përgjithshme të administratës publike dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Themi këtë pasi ky ligj, e shtrin konceptin e “autoritetit publik”, përtej atij të “administratës publike”, duke e zgjeruar rrethin e subjekteve që janë të detyruar të japin informacion ndaj publikut.

Është e paqartë kompetenca që i lihet Avokatit të Popullit, në pikën 7, të nenit 24, të ligjit ku thuhet shprehimisht se: “Procedura administrative e parashikuar në këtë nen nuk çënon kompetenca të Avokatit të Popullit, lidhur me mbikqyrjen dhe zbatimin e të drejtave civile, sipas ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar”. Ky lloj dyzimi kompetencash nuk i jep përgjigje pyetjes, nëse do të ketë pasoja për rrugën e ankimit administrativ dhe atij gjyqësor në një kohë të dytë, bazuar në faktin që, subjekti i interesuar është drejtuar tek Avokati i Popullit dhe jo tek Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me një ankesë për mospërbushje të së drejtës për informim.

Në referencë të përmbajtjes së nenit 24, të ligjit, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale përcaktohet si, një organ administrativ, pjesë e ankimit efektiv administrativ ndaj vendimmarrjes së autoritetit përkatës shtetëror, në rastet e trajtimit të kërkesave për informim. Duke marrë në analizë këtë dispozitë në opinionin tonë, sikurse kemi theksuar edhe në raportin vjetor të vitit 2014, rezultoi se, pikat 1–6 të saj bien në kundërshtim me nenet 135-146, të Kodit të Procedurave Administrative. Po kështu është e paqartë, nëse i hiqet e drejta e ankimit administrativ subjektit të interesuar që ka paraqitur kërkesën për informim pranë vetë autoritetit shtetëror, që pretendohet të ketë kryer shkelje të të drejtës për informim.

Është e nevojshme gjithashtu të bëhet parashikimi shprehimisht në ligj, apo me ndonjë akt tjetër nënligjor për lehtësirat, për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuara, pa lënë një marzh diskrecioni tërësisht të papërcaktuar në duart e autoriteteve publike mbi këtë çështje, sikurse aktualisht ndodh në dispozitat e ligjit “Për të drejtën e informimit”.

Numri më i madh i ankesave të shqyrtuara gjatë vitit 2015, ka të bëjë me çështje që lidhen me zbatimin e regjimit juridik të së drejtës për informim të përcaktuar në Ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Kërkesat për informim që i referohen regjimit juridik të së drejtës për informim, sipas Kodit të Procedurave Administrative, kanë evidentuar mangësi në funksionimin e administratës publike, të cilat shpesh ndërthuren edhe me respektimin e të drejtave të tjera.

Problematika e së drejtës për informim, realisht është trajtuar shumë më gjerë sesa numri i ankesave të dhëna në këtë raport, por në kuadër të ankesave të tjera që si objekt kryesor kanë patur një problematikë të ndryshme nga ajo e së drejtës për informim.

Me hyrjen në fuqi të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, regjimi juridik i së drejtës për informim konstatohet se është përmirësuar në shumë elementë të rëndësishëm të tij, të cilat janë theksuar prej kohësh nga institucioni i Avokatit të Popullit, por ne i mbetemi mendimit se ka ende nevojë për rishikim dhe qartësim të dispozitave të këtij ligji, i cili tashmë është në fazën e zbatimit të tij.

Në këtë këndvështrim nevojitet edhe qartësimi i rrugës së ankimit administrativ ndaj shkeljeve të së drejtës për informim, si dhe i pozicionit që ka Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në këtë proces.

Një çështje shumë e rëndësishme mbetet saktësimi dhe qartësimi i kompetencave të Avokatit të Popullit, në raport me të drejtën për informim, sipas regjimit juridik të kësaj të drejte të përcaktuar në ligjin 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

Në gjykimin tonë, kjo çështje nuk mund të arrihet me një marrëveshje administrative institucionale, ndërmjet Avokatit të Popullit dhe Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi këto institucione nuk mund të marrin atributet e Kuvendit të Shqipërisë, apo të Gjykatës Kushtetuese, sa i takon interpretimit, apo përplasjes kompetenciale, sipas përcaktimit të dhënë në dispozitat e ligjit.

### **3.10 E drejta e sigurimeve shoqërore**

Gjatë vitit 2015 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, janë depozituar dhe trajtuar 181 ankesa lidhur me të drejtën e përfitimit nga sigurimet shoqërore. Kanë përfunduar shqyrtimin 150 ankesa, ndërkohë që janë në proces shqyrtimi 31 ankesa.

Qytetarët janë ankuar për mosllogaritje të drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë, për mosnjohjen e vjetërsisë së punës, mosnjohjen si periudhë sigurimi të viteve të dënimit me burg ordiner, moslidhje të pensionit të pleqërisë si nënë me shumë fëmijë, mospërfitim të kompensimit financiar të energjisë elektrike, mosmarrje përgjigje për kërkesat për pension pleqërie, ulje të masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe nxjerrjen debitorë, mosdhënie të pensionit të posaçëm shtetëror, kohën e lindjes së të drejtës për të përfitur pensionin e pleqërisë, mosmarrje të përgjigjes të shqyrtimit të kërkesave ankimore ndaj vendimeve të Degëve të Përfitimeve, pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, ndërprerje të padrejtë të pensioneve të pleqërisë, për mosvënie në dispozicion të kopjeve të dokumentacionit të dosjes të pensionit etj.

***Disa nga problematikat e shqyrtuara të evidentuara nga rastet me iniciativë dhe nga ankesat e trajtuara, paraqiten si më poshtë:***

***Për uljen e moshës për përfitim të pensionit të pleqërisë për kategorinë e ish-punëtorëve tipografë.*** Sindikata e Pavarur e Tipografisë së Shqipërisë, ka paraqitur ankesë lidhur me moshën e daljes në pension pleqërie të ish-punëtorëve tipografë. Sipas shpjegimeve të parashtruara në letrën e tyre, ata kanë një profesion të vështirë dhe nuk kanë përfitur nga puna e tyre e rëndë dhe madje shumë prej tyre, nuk kanë arritur as moshën e pensionit. Vetë teknologjia e asaj periudhe, mbështetur në radhitjen e librave plumb, shkurtonte jetën e tyre dhe ishin nën diagnoza shumë të rrezikshme për jetën nga depozitimi i plumbit në organe si truri, apo plumbi në gjak, duke u cilësuar gjithnjë si minatorë të mbitokës. Institucioni ynë, pas shqyrtimit të kësaj ankese, i është drejtuar Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me rekomandim për marrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin e kushteve të daljes në pension pleqërie, të ish-punëtorëve tipografë<sup>39</sup>. Në përgjigje të qëndrimit të mbajtur për rekomandimin e sipërcituar, Ministria e Mirëqënies sociale,<sup>40</sup> është shprehur se ligji nr.104/2014 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ofron si zgjidhje alternative për këtë kategori, krijimin e skemave profesionale të pensioneve për pagesa shtesë të kontributeve, e përcaktuar në marrëveshje me palët, duke shprehur gjithashtu angazhimin për mbështetjen e kësaj kategorie në iniciativat e tyre ligjore, apo të marrëdhënieve të punës.

Institucioni i Avokatit të Popullit duke marrë në konsideratë këtë profesion si një ndër profesionet e vështira që kanë rrezikuar shëndetin e kësaj kategorie punonjësish i është drejtuar përsëri

<sup>39</sup> Rekomandim datë 28.04.2015

<sup>40</sup>Shkresa nr.12703/1 datë 19.05.2015

Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, për të rimarrë në konsideratë rekomandimin e sipërcituar dhe për të marrë një zgjidhje konkrete. Pavarësisht kësaj, kjo ministri ka kthyer të njëjtën përgjigje pa dhënë zgjidhje konkrete për këtë grup.<sup>41</sup>

**Institucioni i Avokatit të Popullit në mënyrë të herëpashershme ka ngritur çështjen e masën së ulët të pensioneve të pleqërisë, të kategorisë së pensionistëve që kanë dalë në pension të parakohshëm në periudhën 1993-1995.** Duke qenë se prej vitesh kjo çështje ka mbetur pa zgjidhje, Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë iu drejtua një rekomandim, *për marrjen e iniciativës legislative për nxjerrjen e një Vendimi të Këshillit të Ministrave “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve të punonjësve buxhetore të caktuara gjatë vitit 1993, 1994, 1995”*<sup>42</sup>, për të cilën ende nuk ka ardhur një përgjigje.

**Për mosdhënien e së drejtës për të përfituar pensionin e invaliditetit dhe atë familjar, për personat që në 5-vjeçarin e fundit para lindjes së të drejtës nuk janë në marrëdhënie pune.**

Neni 41, të ligjit 104/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”, ua njeh të drejtën e përfitimit të pensionit familjar dhe pensionit të invaliditetit personave që u lind kjo e drejtë. Megjithatë kriteri i vjetërsisë së punës, (pasja e së paku 12 muaj sigurim në 5 vitet e fundit të lindjes së të drejtës), i penalizon ato. Kategoria e personave që pretendojnë për përfitimin e pensionit të invaliditetit, nuk përfitojnë as nga ligji 9355 datë 10.03.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, pasi që të përfitosh pagesën e aftësisë së kufizuar, nuk duhet që të kesh qenë në marrëdhënie pune.

Kriteri i vjetërsisë së punës, është vendosur me ndryshimet e fundit të bëra në ligjin e sigurimeve shoqërore, si rezultat i reformës në pensione. Në nenin 41, nuk ka qenë i parashikuar ky kriter, pasi mjaftonte që personi të kishte vite pune. Në këtë nen thuhej shprehimisht se: “1.Pensionit familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit, dhe jepet në masën..”. Ndërsa në nenin 35, kushtet e përfitimit të pensionit të invaliditetit, ishte përcaktuar se:“... Periudha minimale e sigurimit për pension invaliditeti është sa gjysma e diferencës së moshës së pensionit të siguruar në kohën që bëhet i paaftë dhe moshës 20 vjeç...”

Për këtë arsye, Institucioni i Avokatit të Popullit, ju drejtua në datë 01.06.2015, me një rekomandim Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, *për përmirësim të nenit 35, pika 2, si dhe të nenit 41, pika 1, të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në kuptimin e rivendosjes së parimit të sigurisë juridike.* Ky rekomandim nuk u pranua dhe ndër të tjera në përgjigjen e kthyer na bëhej me dije se, pensioni i invaliditetit jepet për pamundësinë e kryerjes së punës ku personi është i angazhuar. Vlerësimi nga KMCAP-ja, bëhet duke vlerësuar aftësinë për punë në raport me punën ku është i angazhuar. Në qoftë se personi bëhet i paaftë kur nuk ka qenë në punë, *atëherë duhet t’i drejtohet skemës së ndihmës ekonomike për paaftësi, e cila jepet pavarësisht nga kontributet”.*

Duke marrë në konsideratë këtë çështje, Institucioni i Avokatit të Popullit ka gjykuar se personi që bëhet i paaftë duhet të përfitojë atë ç’ka atij i takon për aftësinë e tij të kufizuar, e cila nuk ka të bëjë me dhënien e ndihmës ekonomike. Njëkohësisht, llogaritja e pensionit familjar nuk duhet të lidhet me llogaritjen e pensionit të invaliditetit. Nëse një person ka ndërruar jetë dhe ka patur periudhë kontributive, duhet që shteti t’i japë familjes së tij atë pension që i takonte të përfitonte i ndjeri bazuar në vitet e punës së tij. Për këtë qëllim, iu drejtuam përsëri Ministrit të Mirëqënies

<sup>41</sup>Shkresa nr. 2703/1 datë 19.05.2015

<sup>42</sup> Shkresa nr. K1/E17-13 datë 09.11.2015

Sociale dhe Rinisë,<sup>43</sup> për rimarrjen në konsideratë të rekomandimit të sipërcituar, pa marrë ende një përgjigje për këtë çështje.

Një numër i konsiderueshëm i ankesave kanë patur si objekt mosllogaritjen e drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë dhe në to është kërkuar ndërmjetësimi institucional i Avokatit të Popullit, për rillogaritjen e pensioneve. Pas shqyrtimit të ankesave, ju është rekomanduar Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore, rillogaritje e masës së pensionit të pleqërisë. Rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit janë marrë në konsideratë, duke u ribërë rillogaritjet përkatëse të masës së pensioneve. Disa ankues kanë përfituar rritje të masës së pensionit, si dhe diferencat përkatëse.<sup>44</sup>

Problematikë e evindetuar gjatë këtij viti është edhe trajtimi i ankesave për informim për këtë të drejtë, pasi shtetas të ndryshëm nuk pajiseshin me aktet në dosjen e tyre të pensionit nga institucionet përgjegjëse. Për këtë arsye, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar pajisjen e shtetasve me dokumentat e kërkuara, rekomandime të cilat janë marrë në konsideratë.<sup>45</sup>

### **3.11 E drejta për kujdes shëndetësor**

E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë e cila ka qënë në fokus të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit. Sistemi Shëndetësor në Shqipëri është kryesisht publik, ku edhe pjesa më e madhe e shërbimeve sigurohen nga shteti.

Funksionimi i Kujdesit Shëndetësor rregullohet në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, një sërë ligjeve për kujdesin shëndetësor, për shëndetin publik, për sigurimet shëndetësore në Republikën e Shqipërisë, për shëndetin mendor, si dhe një sërë aktesh ndërkombëtare të ratifikuara nga Shteti Shqiptar në fushën e mjekësisë, kujdesit shëndetësor dhe shëndetit mendor.<sup>46</sup>

Qëllimi i shërbimit shëndetësor parësor është shërbim shëndetësor më i mirë për të gjithë (OBSH, 2014), kështu në lidhje me këtë, OBSH (2014) ka identifikuar pesë elemente kyç për të arritur këtë qëllim: Të ulë ndjeshëm pabarazitë sociale dhe përjashtimin e grupeve të marxhinalizuara (reformat e mbulimit universal në shëndetësi); Organizimi i shërbimeve shëndetësore rreth njerëzve në nevojë dhe sipas pritshmërive (reformat në dhënie e shërbimit); Integrimi i shëndetit në të gjithë sektorët (reforma për politika publike); Ndjekja e modeleve bashkëpunuese për politika dialoguese (reformat drejtuese); dhe Rritja e pjesëmarrjes së palëve të interesuara. Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 110 ankesa në fushën e shëndetësisë në përgjithësi, nga këto 24 raste janë filluar me iniciativë. Objekti i ankesave ka qënë trajtimi mjekësor i pakujdesshëm, kërkesa për kurim jashtë vendit, ankesa për mungesa në medikamente, kryesisht në spitalin onkologjik në QSUT, marrëdhënie

<sup>43</sup> Shkresë drejtuar Ministrit të Mirëqënies sociale dhe Rinisë, datë 04.12.2015

<sup>44</sup> Doculive nr. 201500193, nr 201501107, 201501601.

<sup>45</sup> Doculive nr. 201500679, 201501460

<sup>46</sup> Ligji Nr.10107,datë 30.3.2009“Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.10138 datë 11.05.2009 “Për Shëndetin Publik”, Ligji nr.7870 datë 13.10 1994 “Per sigurimet shendetësore në Republikën e Shqipërisë”të ndryshuar,Ligji nr.8092,date 21.03.1996“Për Shëndetin Mendor”,Ligjin nr.7870,date.13.10.1994“Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”,Konventa e Këshillit të Europës “Për të drejtat e njeriut dhe biomjeksinë” (ratifikuar me ligj Nr. 10339, date 28.10.2010),Konventa kuadër e Organizatës Botërore të Shëndetësisë "Për kontrollin e duhanit"<sup>46</sup>, Konventa e ILO në lidhje me“Sigurinë në punë, shëndetin dhe mjedisin e punës” , Konventa e ILO në lidhje me “Sigurimin dhe shëndetin në miniera”<sup>46</sup>,Konventa Ndërkombëtare e Eliminimit të të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Kombet e Bashkuara,1965.

punësimi, etj. Nga numri i ankesave në total, për 54 ankesa ka përfunduar shqyrtimi, ndërsa 56 të tjera janë në shqyrtim..

Në kuadër të veprimtarisë së tij, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, Institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer gjatë vitit 2015 e në vazhdim, inspektime në Spitalet Rajonale dhe konkretisht Kukës, Tropojë, Burrel, Dibër, Bulqizë, Laç, Lezhë, Fier, Lushnjë, Ersekë, Leskovik, Spitali Traumës Tiranë.

Një çështje e cila paraqitet problematike në shumë prej spitaleve rajonale të inspektuara është infrastruktura e disa prej godinave ku ushtrojnë aktivitetin ato. Konkretisht shumë prej këtyre godinave nuk janë rikonstruktuar fare, ose kanë pasur ndërhyrje të pjesshme në vite, por aktualisht paraqesin probleme. Amortizimi dhe lagështira në ambjentet e përbashkëta të godinave, dhomat e pacientëve e deri te dhomat e operimit janë problematika shqetësuese vit pas viti në këto institucione spitalore. Projektet në shumë prej këtyre spitaleve rajonale ekzistojnë, por mungon financuesi, pasi kostot për ndërtimin e një spitali apo rikonstruksionet e tyre janë të larta.

Në mënyrë që të përmirësohet cilësia dhe standardet e trajtimit të pacientëve të çdo spitali, ose qëndre shëndetësore duhet të ketë në mënyrë standarde: furnizim të vazhdueshëm me energji elektrike dhe ujë të rrjedhshëm të ngrohtë dhe të ftohtë. Kjo gjë mungon në spitale të caktuara si ai i Kukësit, ose Leskovikut, ku furnizimi me ujë kryhej me orar të reduktuar, jo vetëm për spitalin, por edhe për qytetin.

Gjithashtu problematik (megjithëse përmirësuar dukshëm këtë vit), mbetet furnizimi me medikamente kryesisht në QSUT, Tiranë, për shkak të fluksit të pacientëve nga e gjithë Shqipëria. Mungesa permanente ka në spitalin onkologjik për shkak të specifikës dhe shtimit të numrit të pacientëve që trajton ky institucion spitalor në veçanti. Mungesa e mjekëve specialistë në spitalet rajonale në gjithë vendin mbetet problematikë e mbartur vit pas viti, ku dhe zgjidhja me kontrata e mjekëve të dalë në pension nuk përmbush kërkesat dhe nevojat e banorëve në qytetet e vendit. Kjo mungesë e shërbimeve apo aparaturave ndikon që, pacientët të gjejnë rrugë alternative kurimi, siç është fluksi i pacientëve drejt kryeqytetit dhe QSUT-së. Problematike paraqitet edhe mungesa e pajisjeve mjeksore, si edhe amortizimi i pajisjeve ekzistuese në spitalet rajonale, të cilat sjellin më tej mosofrimin me cilësi dhe standard të shërbimit mjekësor në këto zona<sup>47</sup>.

Ministria e Shëndetësisë si institucion përgjegjës ka pranuar këto përgjegjësi dhe problematika të konstatuara, duke u angazhuar se do i ketë përparësi për zgjidhje të mëtejshme dhe planifikime fondesh në buxhetetet pasardhëse.

Një rast tjetër i konsideruar i rëndësishëm përse i takon kategorisë së përfaqësimit është edhe ankesa e disa shtetasve me profesionin farmacistë, të cilët në ankesën e tyre kundërshtojnë një vendim të nxjerrë nga ana e Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë, në datë 29 Maj 2015. Ky vendim i heq të drejtën e ushtrimit të profesionit farmacistëve të cilët kanë mbushur moshën për të dalë në pension. Vendimi i nxjerrë nga Këshilli Kombëtar i Urdhërit të Farmacistëve, në cilësinë e organit të administratës publike në gjykimin tonë është një akt administrativ pjesërisht, absolutisht i pavlefshëm, që nuk mund të prodhojë pasoja për pjesën e pavlefshmërisë së tij. Si i tillë, vendimi Nr.8 datë 29.05.2015, i Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Farmacistëve, për pjesën e përmbajtjes së shtuar të nenit 19, të Statutit të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë, ku parashikohet se: *“Çdo anëtar i Urdhërit të Farmacistëve mund të aplikojë për të qënë drejtues teknik nëse plotëson parakushtet e vendosura në Ligjin “Për*

<sup>47</sup>Lidhur me problematikën sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar, “Rekomandimet” përkatëse drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë.

*Barnat dhe Shërbimin Farmaceutik”, si dhe plotëson kriteret: Të mos ketë mbushur moshën për pension, përjashtuar rastet e të vetëpunësuarve...”, duhet që të konstatohet si absolutisht i pavlefshëm. Institucioni i Avokatit të Popullit në përfundim të hetimit administrativ i paraqiti këtë rekomandim, Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Farmacistëve:<sup>48</sup>*

Rastet e trajtuara me iniciativë kanë qënë kryesisht rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive që lidhen me, trajtimin shëndetësor të pacientëve të ndryshëm, kushtet e ofrimit të shërbimit apo mungesa e ofrimit të këtij shërbimi. Ndër rastet me iniciativë më të rëndësishme të trajtuara nga ana jonë për vitin 2015, ka qënë lançimi që Ministria e Shëndetësisë i bëri nismës për futjen në testim të mjekëve dhe infermierëve. Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideroi këtë nismë si denigruese, joprofesionale dhe abuzive, pasi nuk kishte transparencën e duhur, bashkëpunimin me grupet e interesit dhe institucionin e përcaktuar me ligj, që është “Urdhri i Mjekëve”, në Shqipëri. Në gjykimin e institucionit të Avokatit të Popullit, testimi nuk është mënyra e vetme për fotografimin dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave që ka sot sistemi shëndetësor. Të gjithë drejtuesit e qendrave shëndetësore dhe spitalore, kanë për detyrë pikërisht menaxhimin e burimeve njerëzore, identifikimin e problematikave dhe referimin e tyre në instancat përkatëse, të cilat më pas duhet të kundërveprojnë me trajnime, ose edukime në vazhdim, si mënyra e vetme e ngritjes profesionale të mjekëve, apo infermierëve. Gjithashtu shpallja publike e pa shoqëruar me asnjë akt të shkruar administrativ mbi mënyrën e organizimit, zhvillimit apo implementimit të këtij testimi, nuk ishte serioze dhe transparente. Kjo nismë gjithashtu ndikoi që shumë qytetarë që përballeshin çdo ditë me shërbim shëndetësor, të ishin në panik. Përsa më sipër i'u drejtua një rekomandim Ministrisë së Shëndetësisë, me qëllim rishikimin e kësaj iniciative<sup>49</sup>

Avokati i Popullit përmes rekomandimeve dhe veprimtarisë së tij në vazhdim, ka si qëllim të rrisë ofrimin e standardeve të shërbimit shëndetësor, kundrejt individëve.

### **3.12 E drejta për arsimim**

Arsimi është një nga fushat më të rëndësishme të çdo shoqërie dhe të çdo sistemi. Një numër i të drejtave ekonomike, shoqërore dhe kulturore, sikurse e drejta për zgjedhjen e punës, për të marrë pagë të njëjtë, për punë të njëjtë, për të gëzuar të mirat e përparimit shkencor e teknik dhe për të marrë arsimim të lartë në bazë të aftësive, mund të ushtrohet në mënyrë kuptimplotë nëse është arritur një shkallë minimale e arsimimit. Për minoritetet etnike dhe gjuhësore, e drejta për arsimim është një mjet thelbësor për ta ruajtur dhe forcuar identitetin kulturor. E drejta themelore për arsimim u jep të drejtë të gjithë individëve që t'i sigurojnë format adekuate të sjelljes nga qeveria përkatëse. Shtetet kanë obligim të respektojnë, mbrojnë dhe t'i përmbushin të drejtat për arsimim.

E drejta për arsimim ka si bazë solide në të drejtën ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (Neni 26), Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (Neni 13 dhe 14), Konventën për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit kundër Gruas (Neni 10) dhe Konventën mbi të Drejtat e Fëmijës (Neni 28 dhe 29). Në shkallë rajonale mund të përmendim, Konventën Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Fundamentale të Njeriut (Neni 2 i Protokollit të Parë), Konventën Amerikane

<sup>48</sup> Inicimin dhe përfundimin sa më të shpejtë të procedimit administrativ për konstatimin e pavlefshmërisë së pjesëshme absolute, të vendimit Nr.8 datë 29.05.2015, të Këshillit Kombëtar të Urdhërit të Farmacistëve.” Ky rekomandim u pranua nga ana e këtij institucioni.

<sup>49</sup>Rishikimin e iniciativës së Ministrisë së Shëndetësisë për futjen në testim të mjekëve dhe infermierëve si çënim të parimit të sigurisë juridike për këta punonjës. Krijimin e një procesi transparent dhe bashkëpunues me grupet e interesit për gjetjen e një zgjidhje efektive dhe ligjore për rritjen profesionale të kësaj kategorie.

për të Drejtat e Njeriut (Neni 13 i Protokollit Shtesë të Konventës Amerikane për të Drejtat e Njeriut në sferën e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore) dhe Kartën Afrikane për të Drejtat e Njeriut dhe të Popujve (Neni 17). Në legjislacionin e brendshëm, vend primar zë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji nr. 69/2012, datë 21.06.2012, “Për Arsimin Parauniversitar”, (i ndryshuar), Ligji nr.9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë” nr.9741 dt.21.05.2007, i ndryshuar.

Përmirësimi i qasjes në arsimim për të gjithë, në bazë të parimit të barazisë dhe jodiskriminimit dhe lirisë për të zgjedhur llojin dhe përmbajtjen e shkollës, paraqet shpirtin dhe thelbin kryesor të së drejtës për arsimim. Institucioni i Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2015 ka patur në fokus respektimin e së drejtës për arsim, duke marrë në konsideratë katër elemente të detyrimeve shtetërore lidhur me të drejtën për arsimim, siç janë: *disponueshmëria, mundësia e kësaj, pranueshmëria dhe adaptueshmëria.*<sup>50</sup>

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit, ka marrë në shqyrtim 146 ankesa në fushën e arsimit në përgjithësi, ndër të cilat 16 raste i ka filluar me iniciativë. Objekt i këtyre ankesave kanë qënë kryesisht zbatimi i procedurave për moskthime përgjigjesh nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, probleme administrative nga stafi i universiteteve dhe punonjëseve të administratës, emërimet, transferime ose largime nga puna e mësuesve, ndërprerje e kontratave të punës si mësues jashtë profilit, etj. Nga numri i ankesave të marra në total, për 85 ankesa ka përfunduar shqyrtimi dhe 71 janë ende në shqyrtim.

Problematikat kryesore që janë trajtuar nga institucioni i Avokatit të Popullit lidhur me fushën e arsimit kanë qënë të ndryshme, por ato që kanë spikatur më shumë kanë qënë kërkesat për punësim, largimet e padrejta, transferimet e ndryshme të bëra nga DAR-et dhe ZA-të e rretheve, emërimet pa transparencë, kontestimet e vlerësimeve nga AKP-ja për marrje license apo provim shteti, moskthim përgjigjesh nga Ministria e Arsimit dhe Sportit për studentët që janë prekur nga mbyllja e universiteteve private, segregimi i fëmijëve rom në shkolla të posaçme në Berat dhe Korçë, mungesa e mësuesve ndihmës në shkolla për fëmijët me aftësi të kufizuara, futja në testim e mësuesve dhe pasiguria për vendin e punës etj.

Qendra Evropiane për të drejtat rome, organizatë që punon për emancipimin e komunitetit rom në Shqipëri ka parashtruar ankesat e saj për shkollën 9-vjeçare “Shaban Sollaku”, Moravë, e cila nuk përmbush detyrimet e ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, pasi fëmijët e këtij komuniteti studiojnë në shkollën vartëse “Avdyl Avdia”, një shkollë e segreguar e cila daton prej vitit 2002 në lagjen Stan, Moravë, Berat. Kjo situatë segregimi për shkak të racës përbën një shkelje të së drejtës së komunitetit Rom për t’u arsimuar, në një arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor. E njëjta situatë ndodh edhe me fëmijët e komunitetit Rom që studiojnë në Shkollën 9 vjeçare publike “Naim Frashëri”, Korçë. Segregimi për shkak të përkatësisë në një minoritet, ose komunitet tjetër përbën një shkelje të së drejtës së komunitetit Rom për t’u arsimuar, në një arsim gjithëpërfshirës dhe cilësor. E drejta për arsim është një e drejtë kushtetuese të cilën komuniteti Rom duhet ta gëzojë, ashtu si të gjithë shtetasit shqiptarë dhe me të njëjtën cilësi. Situata që ata paraqesin është një rast unik segregimi në shkolla, me 100 % të nxënësve nga komuniteti Egjiptian dhe Rom, në qytetin e Korçës. Për këto dy problematika

---

<sup>50</sup>Komenti Gjeneral 13 i Komitetit nën Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (PNDESK)

iu janë drejtuar rekomandime Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për marrjen e masave për disegregimin e nxënësve të këtyre komuniteteve.<sup>51</sup>

Shoqata e të verbërve, dega Pogradec, si dhe disa fëmijë të prindërve me aftësi të kufizuar kanë paraqitur shqetësimin që nuk përfitojnë përjashtim nga tarifat e pagesës për provime, megjithëse prindërit i kanë invalidë të grupit të parë. Në bazë të ligjit nr. 8098, dt.28.03.1996 “Për statusin e të Verbrit”, neni 15 citon se: “*Personat e verbër të përcaktuar në nenin 1 të këtij ligji përfitojnë të gjitha të drejtat e parashikuara në ligjin nr.7889, dt.16.12.1994 “Për statusin e invalidit”*. Deri sa ligji përcakton se personat e verbër përfitojnë të gjitha të drejtat që përfitojnë ata me status invalidi, atëherë ligji prevalon mbi çdo akt tjetër, qoftë edhe VKM, dhe si i tillë ai duhet zbatuar edhe në rastin e studentëve me prindër të verbër, ashtu sikundër përfitojnë fëmijët me prindër invalid, cituar në VKM-në nr. 699, datë 22.10.2014. Për sa më sipër është paraqitur rekomandimi përkatës drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për marrjen e masave për përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit.<sup>52</sup>

Një problematikë tjetër që vlen për t’u theksuar ka qënë edhe lançimi i nismës për futjen në testim të mësuesve në të gjithë territorin e vendit. Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit paraqitën ankesën shumë kolektiva mësuesish dhe individë. Nga Institucioni ynë është gjykuar se reformat e ndërmarra nga institucionet shtetërore duhet të jenë të vlerësuara, përsa i përket ndikimit që ato kanë dhe të renditen për të minimizuar efektet negative. Kur reformat sjellin kompromise atëherë mund të themi se kanë arritur qëllimin e tyre, në të kundërt ato sjellin pasiguri, stres, pakënaqësi dhe cënim të dinjitetit njerëzor. Për këtë arsye i është drejtuar rekomandim Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për rishikimin e nismës.<sup>53</sup>

Një çështje tjetër që mori vëmendjen e institucionit tonë ishte dhe shqetësimi i ngritur nga banorët e Lazaratit në takimin me ta gjatë ditëve të hapura, të organizuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, për arsimim e fëmijëve të fshatit. Banorët vetë u shprehën se shkollat kanë infrastrukturën e nevojshme si edhe stafin pedagogjik, por ka mungesë psikologësh në shkolla, roli i të cilit është mjaft i rëndësishëm duke ditur situatën dhe kushtet ku kanë jetuar këta fëmijë. Marrja e masave për caktimin e një psikologu, ose punonjësi social ishte rekomandimi që, Avokati i Popullit i drejtoi Ministrisë së Arsimit dhe Sportit<sup>54</sup>.

---

<sup>51</sup> Rekomandim datë 07.08.2015, Marrjen e masave efektive disegregimi dhe plane afat shkurtra dhe afat gjata për disegregimin e shkollave të segreguara për fëmijët rom dhe egjiptianë në lagjen Stan, Moravë, Berat. “Sigurimin e transportit falas për të transportuar nxënësit e shkollës “Avdyll Avdia”, për në shkollën kryesore si edhe një mediator të komunitetit, që ti shoqërojë nxënësit. Angazhim proaktiv dhe afatgjatë nga institucionet arsimore në të gjitha nivelet si qëndror edhe vendor, me qëllim eliminimin e veçimit fizik të fëmijëve rom dhe egjiptianë nga fëmijët jo rom dhe jo egjiptianë. Rishikimin e politikave arsimore dhe monitorimin e vazhdueshëm, me qëllim që të përjashtohen mundësitë për segregim e këtij komuniteti në të ardhmen, si dhe të ndalohet segregimi për shkak të racës në legjislacionin e brendshëm. Të amendohet legjislacioni dhe të parashikohet detyrimi pozitiv për autoritetet arsimore dhe ato vendore, për të luftuar segregimin për shkak të races. Të kryhet monitorimi i arritjeve të fëmijëve rom në shkollë dhe të parashikohet mbështetje akademike për ata nxënës që mbeten mbrapa. Ngritjen e një mekanizmi qëndror nga ana e MAS që të monitorojë zbatimin e masave disegreguese në të gjitha shkollat e vendit”.

<sup>52</sup> Rekomandim datë 29.07.2015, Marrjen e masave për përjashtimin nga tarifa vjetore e shkollimit edhe të studentëve me prindër të verbër në bazë të ligjit Nr. 8098, dt.28.03.1996 “Për statusin e të Verbrit”. Ky rekomandim u pranua nga MAS dhe u zbatua.

<sup>53</sup> Rekomandim datë 07.07.2015, Rishikimin e nismës suaj për futjen në testim të mësuesve në gjithë Shqipërinë si dhe zbatimin e akteve normative dhe gjetjen e rrugëve ligjore për rritjen e cilësisë në mësimdhënie për nxënësit kudo ndodhen.

<sup>54</sup> Rekomandim për Marrjen e masave për caktimin e një psikologu ose punonjësi social në shkollat e fshatit Lazarat, Gjyrokastër për vitin shkollor 2015-2016 e në vazhdim.



Rastet e trajtuara me inisiativë nga ana jonë kanë qënë kryesisht rastet e bëra publike në median e shkruar dhe vizive që lidhen me kushtet dhe infrastrukturën në shkolla të ndryshme të vendit, mungesën e ngrohjes në muajt e dimrit, apo lagështirën dhe mungesën e artikujve bazë për zhvillimin normal të një ore mësimore si banka, dyer e dritare, të cilat janë problematike në shumë shkolla në zona të largëta. Gjithashtu, me inisiativë është trajtuar edhe pushimi nga puna i mësuesve në fshatin Hotolisht të Librazhdit, problematikë e diskutuar edhe në Kuvend, e cila në sajë të impaktit që ati dhe mënyrës së trajtimit mori zgjidhje.

Gjithashtu Avokati i Popullit në muajin Prill 2015 paraqiti mendimet e tij lidhur me, ndryshimet në ligjin Nr 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim garantimin sa më të mirë të mbrojtjes ligjore të të drejtave të fëmijëve, në kurrikulat mësimore. Sa më sipër, Avokati i Popullit, propozoi në Komisionin për Edukim dhe Mjetet e Informimit Publik, në Kuvendin e Shqipërisë, disa shtesa të cilat nuk u morën parasysh nga ligjvënësi. Këto shtesa jepen si vijon:

- “Në Nenin 6, Parime të Përgjithshme, mbas pikës 2, të shtohet pika 3 dhe 4 si më poshtë: Në tërësinë e vet mjedisi i të nxënësve dhe mësimit në sistemin parauniversitar duhet të pasqyrojë dhe të bazohet në parimet e të drejtave të njeriut. Edukimi me të drejtat e njeriut duhet të sigurojë njohuritë, aftësitë dhe qëndrimet e nevojshme për fuqizimin e nxënësve, prindërve, punonjësve dhe të gjithë aktorëve të shkollës dhe komunitetit, në të gjitha nivelet e sistemit arsimor parauniversitar, me qëllim aftësimin e tyre për të gëzuar dhe ushtruar të drejtat e tyre si dhe për të respektuar dhe mbrojtur të drejtat e të tjerëve”.
- Në Nenin 6, Parime të Përgjithshme, në pikën 5 të shtohet si vijon: “Nxënësit dhe punonjësit në sistemin arsimor parauniversitar gëzojnë mbrojtje nga çdo formë veprimi apo mosveprimi që mund të shkaktojë diskriminim, keqtrajtim apo dëm moral, veçanërisht nga institucioni i Avoaktit të Popullit, i cili në përputhje me misionin e vet kushtetues mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve, përfshirë nxënësit, punonjësit, prindërit dhe të gjithë aktorët e tjerë që veprojnë në nivel shkollë dhe komuniteti.”

Arsimi është edhe një nga fushat që jo vetëm i prin shoqërisë, por edhe ndikohet fuqishëm prej saj dhe ndryshimeve shoqërore. Fakti që sistemet e arsimit janë në ndryshim të përhershëm, nuk tregon paqëndrueshmëri, përkundrazi, ato shërbejnë për t’iu përshtatur sa më mirë ndryshimit të shoqërisë. Por duhet angazhim i përbashkët dhe komunitar që problemet të marrin zgjidhje.

### 3.13. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim

E drejta për strehim sanksionohet si një e drejtë themelore e njeriut në një numër të madh aktesh ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, por aktualisht kjo e drejtë në legjislacionin tonë nuk gjen mbrojtje të përshtatshme dhe në përputhje me aktet ndërkombëtare në këtë fushë. Komiteti për të Drejtat Ekonomike, Sociale, Kulturore pranë Kombeve të Bashkuara, ka vendosur standarde lidhur me të drejtën për strehim. E drejta për strehim nuk duhet të barazohet me pasjen e një çatie mbi kokë, por duhet parë si e drejta për të jetuar diku në mënyrë të sigurtë dhe me dinjitet. E drejta për strehim duhet të sigurohet për të gjithë njerëzit pavarësisht të ardhurave të tyre dhe të implemenohet në një mënyrë që përputhet me burimet e tyre.

Mungesa e një kuadri të përshtatshëm ligjor për respektimin e së drejtës për strehim, sot ka sjellë pasoja në disa çështje sikundër, rasti i dëbimit të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosur tek zona e Liqenit Artificial në Tiranë, mungesa e një strehimi të përshtatshëm, për familjet me të ardhura të ulta, familjet përfituese nga skemat e ndihmës ekonomike, gratë e pastreha viktime të dhunës në familje, apo edhe kategoria e ish qeramarrësve të strehuar në banesat shtetërore.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë këtij viti ka luajtur rol proaktiv në përcjelljen e mendimeve dhe komenteve për draft-strategjinë *“Për Strehimin Social të Republikës së Shqipërisë”*, si dhe përfshirjen institucionale në të gjithë procesin e konsultimit me Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe me aktorë të tjerë në këtë proces.

Vlen për t'u përmendur fakti që gati të gjithë mendimet dhe komentet e Institucionit të Avokatit të Popullit janë përfshirë tashmë në këtë strategji, ku në veçanti dëshirojmë të përmendimin rekomandimin për njësitë e qeverisjeve vendore që duhet të parashikojnë çdo vit në programet sociale të strehimit të tyre që, jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit Rom. Përcaktimi i kuotës mbi 5%, bëhet nga njësitë e qeverisjes vendore, duke u bazuar në numrin e familjeve të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit Rom dhe që kanë paraqitur aplikim, si dhe plotësojnë kriteret për të përfutur nga programet sociale të strehimit.

Përgjatë vitit 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar në total 100 ankesa individuale, me objekt mospërmbushjen nga ana e organeve përgjegjëse, të objektivës sociale të strehimit, kundrejt familjeve që gëzojnë statusin e të pastrehit. Në 10 raste kemi adresuar rekomandime përkatëse drejtuar njësitë të qeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për realizimin e objektivës së strehimit, me qëllim përmirësimin dhe krijimin e lehtësirave, apo vendstrehimeve alternative, veçanërisht për grupet e cënueshme dhe në pamundësi ekonomike.

Individët të cilët gëzojnë statusin e të pastrehit, apo të cilët përfshihen në kategorinë e më të “varfërve”, pa asnjë mundësi financiare, nuk arrijnë të gjejnë zgjidhje dhe nuk përfitojnë nga programet sociale të strehimit. Kjo për shkak se ata janë me ndihmë ekonomike minimale dhe nuk kanë mundësi financiare të paguajnë pjesën tjetër të qerasë kur bëhen pjesë e programit social për strehimin me qera të subvencionuar nga njësitë e pushtetit vendor. Kjo kategori gjithashtu nuk përfiton as nga programet sociale të strehimit të kredive të buta me vlerë të banesës në kosto, për shkak të mos plotësimit të kriterit të të ardhurave me qëllim pagimin e kredisë mujore. Institucioni i Avokatit të Popullit, vitet e fundit ka patur një numër të konsiderueshëm çështjesh të tilla, të cilat nuk kanë gjetur zgjidhje nga njësitë e qeverisjes vendore si edhe nga pushteti qëndror, pavarësisht insistimit të herëpashershëm dhe mediatizimit të këtyre çështjeve.

Gjatë vitit 2015 por jo vetëm, janë konstatuar se ka një numër të konsiderueshëm familjesh (*kryesisht familje të komunitetit Rom*), të cilët përballen me nevoja ekstreme për të siguruar një vendstrehim në kushtet e pamundësisë së pagesës dhe përfitimit nga një prej programeve sociale të strehimit, që ofrohen nga njësitë e qeverisjes vendore. Duke mbajtur në konsideratë kushtet e

vështira klimaterike në stinën e dimrit, temperaturat e ulëta veçanërisht në zonat malore, Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime drejtuar çdo njësie të pushtetit për marrjen e masave organizative për përgatitjen e vend-strehimeve, apo vend-qëndrimeve provizore për grupe të tilla në nevojë emergjente dhe për këdo tjetër që kërkon ndihmë nga organet e qeverisjes vendore, me qëllim parandalimin e situatave që mund të rrezikojnë jetën apo shëndetin e tyre.

Në kushtet kur gjatë muajit Dhjetor 2015, fatkeqësisht u konstatuan raste të cilat rezultuan fatale me humbje jetësh njerëzore për shkak të të ftohtit, si dhe nisur nga heshtja totale e njësisive të qeverisjes vendore kemi ripërsëritur rekomandimin dhe kemi bërë thirrje publike për çdo njësi të qeverisjes vendore, për përmbushjen e detyrimit ligjor të tregimit të përkujdesjes ndaj çdo qytetari në territorin që ato administrojnë e sidomos, për grupet më të cënueshme e të pamundura.

Prej vitit 2012, problematike mbeten ankesat e familjeve të cilat për shkak të zbatimit të Aktit Normativ Nr. 3, datë 01.08.2012 *“Për lirin e banesave pronarëve të ligjshëm nga qytetarët e pastrehë, banues në banesat ish-pronë e subjekteve të shpronësuar”*, u detyruan të lirojnë banesat e tyre. Për vitin 2015, objekti i ankesave të trajtuara për këtë problematikë ka qenë kryesisht nga familje me anëtarë të moshuar pensionistë, gra kryefamiljare, të divorcuara dhe në ngarkim me fëmijë, punëkërkuese të papuna dhe përfitues nga skema e ndihmës ekonomike. Rastet e mësipërme për shkak të pamundësisë ekonomike, i kanë gjetur këto familje të detyruara të jetojnë në kushte tejet çnjerëzore, në disa raste madje edhe në rrugë.

Nisur nga sensibiliteti i kësaj problematike, në mënyrë të vazhdueshme kemi rekomanduar ndaj njësisive të qeverisjes vendore marrjen e masave për ofrimin e një prej programeve sociale të strehimit, bonusit të qirasë sociale, por me keqardhje duhet të evidentojmë mungesën jo vetëm të përgjigjeve, por edhe reagimeve që mund të kishin institucionet përkatëse, sikundër na rezulton nga Bashkia Durrës, apo Bashkia Korçë.

Është në interesin e njësisive të qeverisjes vendore shqyrtimi dhe vlerësimi përfundimtar i shqetësimeve të ngritura për situatat e rënda të jetesës familjare dhe në shumë raste edhe shëndetësore.

Duke mbajtur në konsideratë Reformën Administrative- Territoriale është shumë e nevojshme rishikimi i shpërndarjes së fondeve buxherore, sipas shërbimeve që ofrojnë këto njësi. Duke ju referuar edhe takimeve që kemi ndërmarrë me drejtues të qeverisjes vendore gjatë vitit 2015, është evidentuar si shqetësues fakti se ka një numër të konsiderueshëm bashkish të cilat nuk kanë të evidentuar numrin e familjeve të pastreha. Ka një numër të konsiderueshëm bashkish të cilat ndër vite nuk kanë përfituar asnjë fond për ndërtimin e banesave sociale, apo edhe ofrimin e programeve të tjera sikundër mund të jetë bonusi i qirasë sociale. Për këtë arsye, është e nevojshme përfshirja në strategji e mekanizmave dhe politikave të programeve sociale që të kenë mundësi përfitimi kryesisht grupet vulnerabël me të ardhura të ulta.

Si konkluzion i problematikave të mësipërme, gjerësisht se është i nevojshëm rishikimi i legjislacionit dhe më konkretisht i ligjit Nr.9232/2004 *“Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”*, i ndryshuar.

Gjithashtu, është e nevojshëm dhe emergjent rishikimi i objektivave sociale pas reformës administrative-territoriale në drejtim të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve, ku një vend të rëndësishëm duhet të zërë strehimi social si një e drejtë bazë për individin, jo vetëm nëpërmjet ofrimit të programeve sociale të strehimit, por edhe në drejtim të ofrimit të vendstrehimeve alternative për të gjithë grupet vulnerabël dhe të pamundur.

### 3.14. Ndhimma ekonomike

Programi i ndihmës ekonomike ka si qëllim mbrojtjen e personave në nevojë, të cilët nuk janë në gjendje të sigurojnë një standard të përshtatshëm jetese për veten dhe familjen e tyre. Ndhimma ekonomike parashikohet në Ligjin Nr. 9355 datë.10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji. Ky ligj, përcakton sistemin e ndihmës dhe të përkujdesjes shoqërore, për t’i trajtuar me ndihmë ekonomike familjet e shtetasve shqiptarë, të cilëve ju mungojnë të ardhurat dhe mjetet e jetesës krejtësisht, ose i kanë ato të pamjaftueshme.

Sistemi i pikëzuar digital, i cili filloi të zbatohet në muajin Qershor 2014 nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore në qarqet: Tiranë, Durrës dhe Elbasan, solli risi për sa i përket shpejtësisë në vendimmarrje, por nga ana tjetër solli edhe jo pak probleme në identifikimin e saktë të pretendentëve përfitues.

Ky sistem dixhital, me anë të një formule të pikëzuar të përgatitur nga një studim i Bankës Botërore në përputhje me mundësitë e ofruara nga Qeveria Shqiptare, ka patur si qëllim identifikimin e familjeve në nevojë, përmirësimin e vlerësimit të përfituesve për familjet aplikante dhe përjashtimin e rasteve abuzive në skemën e ndihmës ekonomike.

Pas evidentimit të problemeve nëpërmjet ankesave të qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile, një sërë inspektimeve dhe një hetimi specifik administrativ, institucioni i Avokatit të Popullit, në Dhjetor 2014, iu drejtua me një rekomandim Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, ku kërkohet të rishikohet formula e pikëzimit.

Në muajin Janar 2015, kjo ministri iu përgjigj pozitivisht këtij rekomandimi duke u shprehur e angazhuar për rishikimin e kofiqientëve të sistemit të pikëzimit, për një përfshirje më të gjërë sociale të kategorive në nevojë. Takimi i ekspertëve të Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Bankës Botërore, në zyrën e Avokatit të Popullit, shërbeu në të mirë të këtij procesi, i cili rezultoi në rishikimin e formulës së pikëzimit.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015, ka trajtuar 77 ankesa, për sa i përket ndihmës ekonomike, të cilat kanë qënë si individuale ashtu dhe në grupe. Gjithashtu janë trajtuar me iniciativën e Institucionit edhe raste të bëra publike në media, të cilat si subjekt kanë patur, si individë të veçantë, ashtu edhe familje.

Mund të përmendim një nga rastet e marra me iniciativë ku bëhet fjalë për një familje në Fushë Mamurras e përbërë nga nëntë anëtarë, e cila jetonte në gjendje tejet të vështirë ekonomike, në një banesë të rrënuar, me asnjë kusht normal për mbijetesë. Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit i dërgoi shkresë për shpjegime Bashkisë Kurbin,<sup>55</sup> e cila në përgjigjen e saj shprehej se ishte ngritur grupi i punës për verifikimin e situatës dhe nga ky verifikim rezultoi se, kjo familje ishte me leje banimi në Njësinë Administrative Mamurras, por prej më shumë se dy muajsh jetonte në shtëpi me qera në fshatin Bubq, të Fushë Krujës. Ndër të tjera, Bashkia Kurbin bën të ditur se, meqënëse kjo familje jetonte në varfëri të tejskajshme ka qënë gjithmonë si në vëmendjen e saj, ashtu dhe Fondacionit Betania me qendër në Bubq, të cilat vazhdimisht e kanë e ndihmuar financiarisht.

#### ***Disa nga problematikat kryesore të adresuara nëpërmjet ankesave gjatë vitit 2015 janë:***

1. Mungesa e informacionit ligjor të qytetarëve mbi procedurat dhe kriteret e përfitimit të ndihmës ekonomike.
2. Përjashtimi, ose mos përfshirja si përfitues të familjeve me pak anëtarë, ose një personi të vetëm.
3. Mospërfshirja në skemën e ndihmës ekonomike të familjeve me kryefamiljare gra, të cilat

<sup>55</sup>Nr. Dok. 201502128 dt.11.11.2015 Kërkesa për shpjegime dërguar Bashkisë Kurbin, përgjigja dt.18.12.2015

- janë të divorcuara, ose ju ka vdekur bashkëshorti.
4. Pamundësia e kryerjes së vizitave në familje për evidentimin e gjendjes, sipas mënyrës së parashikuar, nga administratorët shoqëror në njësitë e qeverisjes vendore.
  5. Mosofrimi i programeve nga organet e qeverisjes vendore për të angazhuar përfituesit e ndihmës ekonomike në të mirën e përbashkët, por dhe të vetpërfituesve, duke rritur të ardhurat e këtyre të fundit.
  6. Në disa raste, vonesë në dhënien në kohë të pagesës së ndihmës ekonomike. Kjo, më së shumti ka ndodhur pas zgjedhjeve të pushtetit vendor, si pasojë e vënies në zbatim të reformës administrative.
  7. Mosparashikime fondesh në buxhetet e njësive të qeverisjes vendore, ashtu si parashikohet në legjislacionin në fuqi.

Nga ankesat e trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit nga zbatimi i projektit pilot, rezultoi se nga përgjigjet e ardhura nga njësitë e pushtetit vendor, shumë familje nuk kishin marrë pikët e mjaftueshme pas verifikimit automatik nga sistemi dixhital i pikëzimit.

Referuar verifikimit të situatës në vend, përgjigjeve të ardhura nga institucionet, ankesave që disponojmë por edhe rasteve të tjera bërë publike në median e shkruar dhe vizive, Institucioni i Avokatit të Popullit, ka vijuar takimet me përfaqësues të të gjitha institucioneve shtetërore përgjegjëse.

Gjatë trajtimit të ankesave në këtë fushë është konstatuar se shumë shtetas apo familje janë trajtuar për një periudhë të gjatë me ndihmë ekonomike, deri në momentin kur kjo ndihmë u është refuzuar ose ndërprerë, ashtu si dhe ankesa të shtetasve të cilët për vite me rradhë kanë aplikuar por përsëri kanë rezultuar jo përfitues të ndihmës ekonomike.

Pas verifikimeve të këtyre rasteve nga institucioni i Avokatit të Popullit pranë institucioneve përgjegjëse si Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror apo Njësive Administrative rezultuan se shkak i mospërfitimit të ndihmës ekonomike ka qënë fakti se anëtarë të familjeve aplikuese kanë bërë ndarje të qëllimshme nga trangu familjar, apo paraqitja e deklaratave jo të njëjta nga individë të ndryshëm të cilët kanë riaplikuar pranë njësive administrative, apo dhe kur një ose dy anëtarë të familjes kanë qënë në marrëdhënie pune, gjë e cila kundërshtonte vendimin Nr. 787 date 14.12.2005 “Për përcaktimin e kriterëve të përcaktuara dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike”.

Institucioni i Avokatit të Popullit në funksion të ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike, organizoi një takim të hapur me banorët në Komunën e Lazaratit, Gjirokastër ku gati 90% e banorëve të fshatit të Lazaratit vuajnë problemin e papunësisë dhe disa prej tyre edhe pse pretendojnë se nuk kanë të ardhura për jetesë, janë përjashtuar nga e drejta e ndihmës ekonomike.

Lidhur me këtë çështje Institucioni i Avokatit të Popullit iu dërgoi shkresa për shpjegime, Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë,<sup>56</sup> Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastër, si dhe Bashkisë Gjirokastër. Këto institucione në përgjigjet e tyre sqaruan se, shqetësimi i këtyre banorëve qëndronte dhe se çdo verifikim nga ana e tyre është bërë bazuar në vendimin Nr. 787 datë 14.12.2005 “Për Përcaktimin e Kriterëve të Procedurave dhe të Masës së Ndihmës Ekonomike” .

---

<sup>56</sup>Nr.dok 201501548dt.06.10.2015 Kërkesë për shpjegime dërguar Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokaster, dhe Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, si dhe Bashkisë Gjirokaster dt.11.11.2015, dhe përgjigja DRSHSSH Gjirokasterka dt.23.11.2015, përgjigja e SHSSH Tiranë dt 27.10.2015. Bashkisë Gjirokastër 27.11.2015.

### **3.15. Synimi për një mjedis të shëndetshëm**

Situata mjedisore në Republikën e Shqipërisë dhe zbatimi i legjislacionit të miratuar për këtë fushë nga institucionet qendrore, entet publike dhe organet e qeverisjes vendore, përsa i takon akteve ligjore dhe nënligjore, si dhe Konventave dhe Marrëveshjeve Ndërkombëtare të ratifikuara në Kuvendin e Shqipërisë, ka qënë në prioritet e punës të Institucionit të Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2015 ka vijuar trajtimin e ankesave të paraqitura lidhur me mbrojtjen e mjedisit, cënimin apo prishjen e sistemeve natyrore, që sjellin pasoja të rënda për mjedisin ku jetojmë, si edhe promovimin e një ambienti e mjedisi sa më të pastër dhe të shëndetshëm. Avokati i Popullit gjatë këtij viti ka ndërmarrë tetë raste me iniciativë për të cilat ka kryer veprimet hetimore dhe verifikuese. Krahas këtyre, janë shqyrtuar edhe 30 ankesa të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, ku janë konstatuar veprime në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi, të cilat çenojnë të drejtën për një ambient të pastër e të shëndetshëm.

Ndërmarrja e iniciativës nga ana e Avokatit të Popullit për verifikimin dhe inspektimin e ruajtjes dhe respektimit të standardeve mjedisore, dëshmon në vijimësi rëndësinë që i kushtohet mbrojtjes së individit, përmes fokusimit në çështjet e mjedisit në të cilin ata jetojnë. Pas kryerjes së procedurave administrative të hetimit dhe verifikimit të qëndrimeve zyrtare të organeve të administratës publike, të ngarkuara me ligj për kryerjen e funksioneve dhe detyrave konkrete në fushën e mjedisit, Avokati i Popullit ka dërguar rekomandimet konkrete me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e gjendjes së mjedisit në zonën respektive, si edhe shmangien e mosveprimeve të cilat kanë shkaktuar një situatë ndotjeje.

Republika e Shqipërisë ka tashmë një legjislacion të konsoliduar mjedisor, por gjendja aktuale e mjedisit dhe fokusi që i kushtohet kësaj fushe të rëndësishme, dëshmon për një zbatim të mangët të akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara tashmë në këtë fushë. Përsa i përket zhvillimeve dhe risive në legjislacion, gjatë vitit 2015 nuk ka patur miratime të ligjeve të reja në fushën e mjedisit, por vetëm disa ndryshime në ligjet ekzistuese, si edhe vendime të Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji Nr. 12/2015 datë 26.02.2015, *“Për disa ndryshime në ligjin Nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, “VKM Nr. 387 datë 06.05.2015 “Per rregullat për kontrollin e asgjësimit të PCB-ve/PCT-ve, çndotjen apo asgjësimin e pajisjeve që përmbajnë PCB/PCT dhe/ose asgjësimin e mbetjeve të PCB-ve/PCT-ve të përdorura”, VKM Nr. 352 datë 29.04.2015 “Për vlerësimin e cilësisë së ajrit të mjedisit dhe kërkesat për disa ndotës në lidhje me të”, VKM Nr. 360 datë 29.04.2015 “Për miratimin e listës së Ndotësve Organikë të Qëndrueshëm dhe përcaktimin e masave për prodhimin, importin, vendosjen në treg dhe përdorimin e tyre”, VKM Nr. 507 datë 10.06.2015 “Për listën e detajuar të planeve apo programeve me pasoja negative të rëndësishme në mjedis që do t’i nënshtrohen procesit të VSM-së”, VKM Nr. 633 datë 15.07.2015 “Për miratimin e procedurave dhe të kërkesave për dhënie e skemave të ekomenaxhimit dhe auditimit”, VKM Nr. 219, datë 11.3.2015, “Për përcaktimin e rregullave e të procedurave për Konsultimin me Grupet e Interesit dhe Publikun, si dhe dëgjuesën publike gjatë procesit të vlerësimit strategjik mjedisor”, si edhe VKM 912 datë 11.11.2015 “Për miratimin e metodologjisë kombëtare të procesit të vlerësimit të ndikimit në mjedis”.*

Këto ndryshime dhe rregullime ligjore konsistojnë në çështje mjaft të rëndësishme, me qëllim sigurimin e mbrojtjes të mjedisit. Autoritetet publike në nivel qendror dhe atë vendor, duhet të ndërmarrin masa për parandalimin, minimizimin dhe kompensimin e dëmeve në mjedis, nga projekte të propozuara, që përpara miratimit të tyre për zhvillim, si dhe pjesëmarrjen e publikut dhe OJF-të mjedisore që shprehin interes për vendimmarrjen mjedisore, në përfshirjen dhe në përgatitjen e planeve të veprimit afatshkurtër.

Avokati i Popullit vlerëson në vijimësi si mjaft të rëndësishëm për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit, Ligjin 10440 datë 07.07.2011“*Për vlerësimin e ndikimit në mjedis*”, Ligjin Nr. 10463 datë 22.09.2011“*Për menaxhimin e integruar të mbetjeve*”, Ligjin Nr. 91/2013 datë 28.2.2013 “*Për vlerësimin strategjik mjedisor*”, si edhe akte të tjera nënligjore të miratuara në bazë dhe për zbatim të kuadrit ligjor të sipërcituar. Ndërkohë vlerësohen edhe ndryshimet në kuadrin ligjor ekzistues me qëllim të rritjes së efektivitetit të tyre, si edhe përshtatjes së tyre me ndryshimet në fusha të caktuara specifike të mjedisit.

Në kuadër të iniciativave të ndërmarra nga Avokati i Popullit për garantimin e një mjedisi sa më të shëndetshëm, mund të theksojmë çështje të iniciuara për rastin e fontanimit të gazit natyror në Marinzë,<sup>57</sup> skandalin mjedisor të ARMO-s, si edhe për ndotjen mjedisore në zonën e ish-Uzinës së Laçit.

Lidhur me ankesat dhe problematikat që shqetësojnë individët dhe komunitetet e disa nga zonave janë:

**1. Peticion i banorëve të fshatrave Dushaj dhe Koçaj të Fushë-Bulqizës, në Qarkun Dibër,** në të cilin ngrihet shqetësimi i dëmtimit dhe shfrytëzimit pa kriter i pyjeve në këtë zonë nga një subjekt privat, i cili ka ngritur për këtë qëllim edhe një fabrikë për përpunimin e drurit përgjatë rrugës Kras – Martanesh, në Qafën e Buallit. Sipas banorëve, subjekti i lartpërmendur kërkon të hapë një rrugë përgjatë pyjeve në zonat e Lugut të Menes, Malit të Kuq dhe Malit të Bardhë, të cilat mbajnë me ujë të pijshëm, me ujë vaditës dhe plotësojnë nevojat për ngrohje të familjeve të tyre në periudhën e dimrit. Ndërtimi i kësaj rruge dhe shfrytëzimi pa kriter i pyjeve të kësaj zone, përbëjnë një rrezik të madh jo vetëm ekologjik, por kanë një ndikim dhe në cilësinë e jetesës të këtyre banorëve.

Gjithashtu banorët e kësaj zone shprehen se këto pyje janë ruajtur pa u dëmtuar në vite prej tyre, ndaj dhe nuk kanë lejuar, por e kanë kundërshtuar me forcë hapjen e kësaj rruge në Malin e Bardhë. Në këtë kuadër, ata kërkojnë ndërhyrjen e institucioneve ligjzbatuese për të mos lejuar që ky konflikt mes tyre dhe subjektit privat të thellohet në përmasa të padëshirueshme.

Për sa më sipër, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe banorët kanë vënë në dijeni Inspektoriatin Shtetëror të Mbrojtjes së Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, si dhe Ministrinë e Mjedisit, por ende sot e kësaj dite nuk ka patur një reagim nga ana e tyre.

**2. Zyra Qytetare për Mbrojtjen e Mjedisit (ZQMM) dhe banorët e fshatit Boks, Njësia Administrative Postrinë,** kanë paraqitur një ankesë pranë Avokatit të Popullit, në të cilën ngrihet shqetësimi ndaj subjektit privat “IL PROGETO”, pasi në bazë të një leje minerare të miratuar nga Ministria e Energjitikës dhe Industrisë, ka nisur aktivitetin karrierë sipërfaqësore për nxjerrje guri gëlqeror, duke shkaktuar ndotje mjedisi, shkatërrim të rrugëve përreth zonës, ndotje të lartë akustike, prishje të mureve të shtëpive të banorëve dhe të Kalasë së Kreatulit (monument kulture), etj.

Lidhur sa më sipër, i jemi drejtuar Ministrisë të Energjitikës dhe Industrisë, Ministrisë të Mjedisit, Ministrisë të Kulturës, Bashkisë Shkodër dhe jemi në pritje të përgjigjes nga ana e tyre.

**3. Institucioni i Avokatit të Popullit, përmes medias elektronike është vënë në dijeni për shqetësimin e banorëve të fshatrave Grabovë dhe Argovë, Përmet,** lidhur me prerjen pa kriter

---

<sup>57</sup>Çështja e fontanimit të gazit natyror në Marinzë është një nga çështjet madhore në fushën e mjedisit të ndjekura nga Avokati i Popullit, për të cilën do të gjeni një shpjegim të detajuar në kapitujt në vijim.

të drurëve në një sipërfaqe prej 65 ha, nga një firmë fantazmë, duke shkatërruar në këtë mënyrë një prej pasurive natyrore të mbrojtura në vite, prej vetë banorëve të kësaj zone.

Banorët gjithashtu shprehen në media se, pavarësisht interesimit të tyre pranë strukturave shtetërore, asnjë prej përfaqësuesve të Drejtorisë Rajonale të Shëbimit Pyjor dhe të qeverisjes vendore, nuk u ka dhënë përgjigje kërkesave të tyre. Përballë kësaj situatë të krijuar, kryetarët e fshatrave në emër të komunitetit, kërkojnë ndërprerjen e aktivitetit të kësaj firme duke paralajmëruar se prerja e mëtejshme e këtyre pemëve do të sjellë jo vetëm shpyllëzimin e kësaj zone, por edhe erozion të tokës si pasojë e këtij shpyllëzimi.

Nisur nga objekti i kësaj ankese, i jemi drejtuar me shkresë Drejtorisë Rajonale të Pyjeve, në Qarkun e Gjirokastrës, si dhe Bashkisë Përmet. Jemi në pritje të përgjigjes nga ana e tyre.

Duke iu referuar këtyre rasteve, duhet theksuar fakti se shkak i ekzistencës së një burimi ndotës, ka qenë pikërisht mosveprimi konkret dhe në kohë i organeve shtetërore të ngarkuara me ligj, ndaj subjekteve të ndryshme që shkaktonin ndotjen mjedisore.

Objekti i ankesave kanë qenë ndotjet e ambientit nga agjentë të ndryshëm apo aktivitete të paligjshme e të palicësuara, ndotja e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, si edhe hedhja e mbeturinave në vende publike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në këto zona, të prekura nga ndotjet.

Duke iu referuar problemit të ndotjes akustike, Avokati i Popullit ka konstatuar sërish se nuk ka patur një zgjidhje efektive të këtij problemi, sidomos gjatë sezonit të verës. Pra, ka probleme lidhur me zbatimin efektiv të Aktit Normativ Nr.2 datë 25.07.2012, "*Për krijimin e task-forcës për marrjen e masave të menjëhershme ndaj subjekteve që gjenerojnë zhurmë tej normave të lejuara në qendrat urbane dhe zonat turistike e bregdetare*". Nismat e ndërmarra gjatë sezonit të verës mbeten në kuadrin e aksioneve dhe fushatave të veçuara, ashtu siç janë shumë të ulëta edhe gjobat administrative ndaj subjekteve kundërvajtës, dhe të papërfillshme në raport me aktivitetin që ata ushtrojnë, duke përfshirë edhe orët e vona të natës.

Situata gjatë vijës bregdetare vijon të mbetet shqetësuese përse i përket largimit të ujrave të zeza të hoteleve dhe shtëpive të banimit. Situata në plazhet publike paraqitet e papajtueshme me synimin për një mjedis të shëndetshëm dhe të përshtatshëm për kryerjen e pushimeve. Po ashtu, problematike mbetet edhe situata e ndotjes së plazheve, për të cilat Agjencia Kombëtare e Mjedisit ka kryer edhe një monitorim konkret. Gjatë prezantimit të monitorimit dixhital të cilësisë së ujërave larëse përgjatë gjithë vijës bregdetare në vend për vitin 2015 është raportuar dhe konfirmuar niveli i lartë i ndotjes në rreth 80% të plazheve publike. Faktori kryesor i ndotjes së ujërave bregdetarë të larjes mbeten shkarkimet e ujërave urbane të pa trajtuara, në ujërat pritëse bregdetare në mënyrë direkte dhe indirekte, të cilat shkaktojnë ndotje të ujërave bregdetarë të larjes. Në plazhet në të cilat janë ngritur dhe funksionojnë sistemi i kanalizimeve të shkarkimeve urbane, vërehet përmirësim i cilësisë së ujërave, siç janë plazhi i Kavajës, Durrësit, Sarandës, Qeparoit, Shëngjinit, Velipojës etj. Mosfunksionimi i Impianteve të Trajtimit të Ujërave urbane si në Vlorë, reflektohet në impaktin negativ të ndotjes së ujërave dhe përkeqësimin e gjendjes së cilësisë së ujërave të larjes, siç është gjendja tek plazhi, tek Shkolla e Marinës. Është vërejtur edhe mosmarrja e masave nga qeverisja vendore, në plazhet publike, në drejtim të pastrimit të rërës së plazheve, vendosjes së nyjeve higjieno-sanitare, dusheve publike dhe në menaxhimin e mbeturinave të ngurta.

*Problematikat shqetësuese në fushë e mjedisit në Shqipëri vijonë të mbetet si më poshtë:*

- Ndotja e ajrit është një nga problemet kryesore mjedisore në qytetet e mëdha shqiptare, sidomos në Tiranë. Ndotja vjen kryesisht si pasojë e shtimit të makinave dhe pakësimin të hapësirave të gjelbërimit, pavarësisht projekteve modeste të njësive të caktuara të qeverisjes



vendore, apo edhe strukturave të pushtetit qendror, për mbjelljen e fidanëve të rinj në zona që veçohen për nivele të larta të ndotjes.

- Ndotja e ujërave në Shqipëri vjen si pasojë e hedhjeve të mbeturinave në lumenj e liqene, si dhe derdhjes së ujërave të zeza të papërpunuara.
- Mbledhja e mbeturinave në Shqipëri dhe riciklimi i tyre bëhet në nivele primitive.
- Prerjet e pyjeve dhe zjarret janë shkaqet kryesore për shpyllëzimin dhe zhdukjen e pyjeve në Shqipëri, duke dëmtuar në këtë mënyrë një nga burimet e vlefshme të ruajtjes së parametrave të pranueshëm të mjedisit. Lidhur me këtë shqetësim, Avokati i Popullit vlerëson nismat e fundit të Ministrisë së Mjedisit për vendosjen e moratoriumit, përse i përket prerjes së pyjeve dhe do të ndiqen në vijim me përparësi gjatë vitit 2016.

Avokati i Popullit thekson rëndësinë që duhet t'i kushtohet situatës mjedisore dhe mbrojtjes së ambientit në Shqipëri. Këto fusha kërkojnë një vëmendje të veçantë dhe bashkëveprim të të gjithë individëve dhe strukturave shtetërore, me qëllim që të garantohet kujdesi për shëndetin dhe të rritet cilësia e jetës.

Rëndësia dhe nevoja për veprimin e të gjithë aktorëve të përfshirë direkt, apo indirekt, në ruajtjen dhe garantimin e mjedisit u konfirmua edhe në Konferencën Globale të Klimës në Paris të zhvilluar në Dhjetor 2015. Marrëveshja e arritur gjatë kësaj Konference u nënshkrua nga thuajse të gjithë delegatët e 190 vendeve të botës, mes tyre edhe Shqipëria, duke parashtruar edhe detyra konkrete edhe për vendin tonë, në kuadër të arritjes së niveleve të pranueshme të gjendjes së mjedisit. Marrëveshja përfaqëson një arritje historike pas një përpjekjeje gobale disa dekadëshe, për të pakësuar çlirimin e gazeve të efektit serë, për të cilat shkencëtarët thonë se janë duke shkaktuar rritjen e rrezikshme të temperaturave globale.

Në kuadër të kësaj Marrëveshjeje, Avokati i Popullit do të fokusojë veprimtarinë e tij në kuadër të mbrojtjes dhe garantimit të një mjedisi të shëndetshëm, kryesisht në këto fusha:

- a) Zbatimit të Strategjive Kombëtare për mbrojtjen e mjedisit.
- b) Sigurimit të disa mekanizmave afatgjatë për të kontrolluar përparimin lidhur me objektivat në fushën mjedisore.
- c) Sigurimit të mbështetjes financiare të mjaftueshme, për mirëfunksionimin e mekanizmave shtetërorë përgjegjës në menaxhimin e problemeve mjedisore.

### **3.16. Mbrojtja e konsumatorit**

Aksesi në burimet minimale të jetesës është një nevojë thelbësore njerëzore, një e drejtë themelore, mungesa e së cilës përbën një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut.

Sikundër është theksuar edhe në progres-raportin e Komisionit European, një fushatë ndërgjegjësimi për mbrojtjen e konsumatorit ka nisur që prej vitit 2014, por nevojitet më shumë veprim për t'i dhënë kompetenca konsumatorëve.

Aktualisht, ligji Nr. 9902, datë 17.04.2008, "*Për mbrojtjen e konsumatorit*", i ndryshuar, në nenin 56 të tij i njeht një rol të veçantë Institucionit të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen e interesave të konsumatorit, jo vetëm për ankesa individuale, por edhe raste të një komuniteti më të gjerë në të gjithë vendin.

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka trajtuar 292 ankesa individuale lidhur me shkeljen e të drejtave të konsumatorit, ka adresuar 10 rekomandime drejtuar operatorëve si Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, apo Ujësjellës Kanalizime sh.a. në vend, si dhe ka zgjidhur në favor të qytetarëve 60 ankesa.

Këtë vit një fokus të veçantë kanë marrë të gjithë konsumatorët familjarë në vështirësi dhe pamundësi ekonomike, për pagesën e detyrimeve të prapambetura të energjisë elektrike.

- Familjet të cilat jetojnë në kushte ekstreme varfërie, në përbërje të tyre me fëmijë me aftësi të kufizuar.

- Familjet me një anëtar të moshuar pensionist herë edhe të vetëm kyefamiljarë/e të cilëve u rrezikohet edhe mbijetesa për shkak të varfërisë.
- Familjet e komunitetit rom, në shumë pak raste përfitues të skemës së ndihmës ekonomike,
- Familjet e tjera me individë të papunë, punëkërkuar, dhe të përjashtuar edhe nga skema e ndihmës ekonomike.

Kjo për shkak se gjatë vitit 2015 janë trajtuar një numër i konsiderueshëm ankesash për shkak të ndërprerjes së energjisë elektrike, me debi të akumuluar me vite, në disa raste me akt-marrëveshje për pagesa me këste të detyrimeve të energjisë elektrike, por sërish të ndodhur në udhëkryq për shkak të pamundësisë financiare në pagesat, qoftë edhe të një shumë minimale prej 1000 lekësh.

Akualisht nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, krahas masës financiare në shumën prej 650 lekë për *mbrojtjen e shtresave në nevojë, për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj*”, janë ofruar disa modele për shlyerjen e detyrimit për konsumatorët që rezultojnë debitorë.

- Modeli i parë u ofron familjeve të cilët kanë detyrime ndaj OSHEE, deri në vlerën 100 mijë lekë, të lidhin akt-marrëveshje për pagesë të borxheve me 6 këste mujore. Në rast se abonentët zgjedhin të paguajnë detyrimin me afat deri në një të tretën e afatit të sipërpërmendur, ofrohet reduktim për 50% të kamatvonesave. Pra, abonentët me borxhe deri në 100 mijë lekë nëse i paguajnë brenda dy muajsh, ju falet gjysma e kamatvonesave.
- Skema e dytë përfshin abonentët me detyrime që arrijnë shumën 300 mijë lekë, të cilëve u ofrohen akt-marrëveshje për pagesën e borxhit me 12 këste mujore. Nëse abonentët zgjedhin që të paguajnë detyrimin në afat deri në një të katërtën e afatit, pra në tre muaj atyre u reduktohet në vlera e masës së kamatës, në 50%.
- Modeli tjetër lidhet me konsumatorët me detyrime deri në 600 mijë lekë dhe u ofrohet akt-marrëveshje për pagesën me 24 këste mujore.

Institucioni i Avokatit të Popullit nëpërmjet rekomandimeve të adresuara ka gjykuar se pavarësisht se ekzistojnë skema lehtësuese për pagesën e detyrimeve të prapambetura, apo garanci ligjore për të gjithë ata konsumatorë të cilët rezultojnë debitorë, mbrojtja sociale dhe ekonomike e grupeve të cënueshme nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konsiderohet prioritet. Kjo për shkak se, familjet në nevojë ekstreme nuk arrijnë dot të sigurojnë mbijetesën dhe jo më të përballen me faturat për pagesat e shërbimeve publike. Kjo duhet të shikohet e lidhur ngushtësisht edhe me gjetjen e mundësive për shmangien e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike për këto grupe.

Kështu, në muajin Mars 2015 është adresuar një rekomandim drejtuar Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore për faljen e detyrimeve të papaguara dhe gjetjen e zgjidhjeve alternative nëpërmjet programeve të përballueshme për familjet në nevojë dhe që janë përfitues nga skema e ndihmës ekonomike. Lidhur me sa më sipër, nuk kemi asnjë përgjigje ndaj këtij rekomandimi, por nga ana e OSHEE po aplikohen disa skema për faljen e kamatvonesave duke iu referuara sasisë së pagesës së debisë përkatëse.

Një problematikë tjetër e trajtuar në vitin 2015, lidhet me keqzbatimin e akteve nënligjore nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për faturimet e kryera për muajin Janar 2015, për të gjithë konsumatorët familjarë në vend. Pas miratimit të Vendimit Nr. 148, datë 26.12.2014, nga Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, për ndryshimin e çmimit të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët, tarifa për konsumatorët familjarë ndryshoi në shumën prej 9.5 lekë për kwh ka hyrë në fuqi në datën 01.01.2015.

Avokati i Popullit ka konstatuar se faturimi i kryer për muajin Janar 2015 është përlllogaritur me tarifën e vjeta (*deri në 300 kwh x 7.70 lekë dhe mbi 300 kwh x 13.50 lekë*), duke detyruar në disa raste konsumatorët të paguajnë edhe më tepër. Sipas vendimit përkatës hyrja në fuqi është bërë në datë 01.01.2015 dhe faturimi i konsumit të energjisë elektrike për muajin Janar 2015, duhet

të ishte bërë në përputhje me tarifat e reja të energjisë elektrike të miratuara, ndërkohë që rezulton se ky aplikim është bërë për muajin Shkurt 2015.

Lidhur me këtë rast Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar drejtuar OSHEE dhe ERE marrjen e masave për anulimin e faturimeve të kryera për muajin Janar 2015 dhe rillogaritjen e faturimeve të kryera në periudhën pas datës 31 Dhjetor 2014, për të gjithë konsumatorët familjarë në vend. Gjithashtu, kemi rekomanduar edhe kompensimin në muajt pasardhës në rast të pagesës tepër të energjisë elektrike. Rasti i mësipërm rezulton pa një përgjigje zyrtare, apo reagim me veprime konkrete nga ana e OSHEE.

Një problematikë e mbartur ndër vite lidhet me mosrespektimin e Kontratës Tip të Energjisë Elektrike, nga ana e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike lidhur me, mbifaturim e energjisë elektrike. Mbi këtë problematikë Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar disa rekomandime në mënyrë të vazhdueshme ndër vite duke i trajtuar ankesat rast pas rasti, ku është kërkuar nga drejtuesit përkatës marrja e masave të menjëhershme për anulimin e faturimit dhe korrektimin e faturave përkatëse.

Edhe për vitin 2015, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë vijuar ankesa lidhur me faturimet e padrejta të tarifës së shërbimit për përdorimin e aparateve televizivë për të gjithë ata konsumatorë të cilët, ligjërisht janë të përjashtuar nga pagesa e saj. Lidhur me këto raste Avokati i Popullit ka vijuar adresimin e rekomandimeve kundrejt Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për marrjen e masave të menjëhershme, për anulimin e faturimeve të tarifës së televizionit në mënyrë të padrejtë.

Lidhur me ofrimin e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, sensitive situata ka qenë kryesisht në stinën e verës, ku qytetarët shpesh herë janë përballur me mungesa të vazhdueshme të furnizimit me ujë të pijshëm. Problematike është paraqitur situata kryesisht për konsumatorët pjestarë të komunitetit Rom, të cilët krahas kushteve tejet të këqija të jetesës janë përballur edhe me mungesë në furnizimin me ujë të pijshëm.

Ndaj këtyre rasteve kemi adresuar rekomandime drejtuar Ujësjetës-Kanalizime sh.a. për marrjen e masave për gjetjen e zgjidhjeve për furnizimin me ujë të pijshëm, veçanërisht gjatë stinës së verës, si dhe në përputhje me kushtet higjieno-sanitare, të parashikuara sipas direktivave ndërkombëtare. Në gjykimin e Institucionit të Avokatit të Popullit e drejta për furnizim me ujë të pijshëm, është një e drejtë e rëndësishme dhe si e tillë duhet që asnjë konsumator të mos privohet nga ky shërbim publik që duhet ofruar me një cilësi sa më optimale.

Në vijim të problematikave dhe rekomandimeve që institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar ndaj operatorëve që ofrojnë shërbime publike, sikundër është energjia elektrike dhe furnizimi me ujë të pijshëm, duam të përmendim mungesën e bashkëpunimit në disa raste nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për kthimin e përgjigjeve zyrtare ndaj institucionit tonë. Edhe në ato pak raste kur jemi vënë në dijeni mbi përgjigje konkrete, ato kanë rezultuar tej çdo afati ligjor që parashikon legjislacioni përkatës.

Megjithëse aktualisht janë bërë disa përparime me përafrimin e legjislacionit për sektorin e energjisë elektrike, realiteti tregon se qasja në furnizimin me energji elektrike është gjithnjë e më e vështirë për grupet e cënueshme dhe në risk.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjykon se ka ardhur koha dhe duhet të rishkohet në tërësi skema jo vetëm e pagesës së energjisë elektrike, por edhe ofrimi i vazhdueshëm dhe i pandërprerë i këtij shërbimi për konsumatorët e cënueshëm dhe në risk.

## KREU 4

### Roli i Avokatit të Popullit tek grupet në nevojë

#### 4.1 Fenomeni i gjakmarrjes në Shqipëri

Fenomenin e gjakmarrjes në Shqipëri po e trajtojnë edhe disa vende të BE-së, për shkak të një numri të azilkërkuessve shqiptarë, të cilët pretendojnë se u rrezikohet jeta në Shqipëri si pasojë e këtij fenomeni. Raporte të ndryshme në lidhje me azilkërkuessit nxjerrin se, një ndër faktorët në kërkesat për azil të shtetasve shqiptarë në BE ka të bëjë me gjakmarrjen.<sup>58</sup> Ky shqetësim është pasqyruar edhe në Progres Raportin e fundit (2015) të KE-së për Shqipërinë, ku theksohet se: *“Sa i përket të drejtës së jetës, gjakmarrja mbetet një problem, megjithëse në një shkallë të kufizuar.”*

Në mars 2015, Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë dhe nxorri rekomandimet përkatëse për gjakmarrjen, bazuar në gjetjet e Raportit të Veçantë të Avokatit të Popullit. Rezoluta bën thirrje për Këshillin Koordinues për Parandalimin e Gjakmarrjes, të ngritur që në vitin 2005, si dhe institucionet e tjera shtetërore që të bashkërendojnë punën mes tyre dhe organizatave joqeveritare, si edhe të marrin masat për programet arsimore dhe sociale që të drejtohen në zonat rurale. Për Prokurorinë dhe Policinë, që të shtojnë përpjekjet hetimore dhe për të bërë më shumë në parandalimin e konflikteve, për të ndihmuar familjet e ngujuara me të ardhura të pamjaftueshme, nëpërmjet programeve të posaçme të ndihmës ekonomike dhe mundësive të ofrimit të punësimit të tyre.<sup>59</sup> Kuvendi nëpërmjet kësaj rezulote kërkon angazhimin e të gjitha institucioneve shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, medias dhe shoqërisë civile, të veprojnë bashkërisht për dhënien fund të plagës sociale të gjakmarrjes.

Edhe pas miratimit të kësaj Rezolute nuk është realizuar zgjidhje konkrete nga institucionet shtetërore për zbatimin e detyrave të caktuara nga Kuvendi, për parandalimin e këtij fenomeni dhe për nxjerrjen e akteve nënligjore në bazë për zbatimin e ligjit Nr. 9389, datë 04.05.2005.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në datën 15.04.2015 përgatiti një projekt Memorandum Bashkëpunimi, *“Për ngritjen dhe funksionimin e komitetit ndërinstitucional vendor për të koordinuar përpjekjet në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes”*. Ky memorandum kishte si qëllim ngritjen dhe funksionimin e komitetit ndërinstitucional vendor, për të koordinuar përpjekjet në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes, për institucionalizimin e bashkëpunimit të zyres së Avokatit të Popullit me palët e cituara më lart, të cilat kryejnë veprimtarinë e tyre publike, apo civile në Qarkun Shkodër, në kuadrin e punës së përbashkët dhe garantimit të realizimit të misioneve të përbashkëta për të parandaluar fenomenin e gjakmarrjes dhe të pasojave të tij në këtë njësi administrative, zhvillimit të politikave dhe të strategjive, si dhe zbatimit të ligjeve në favor të mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese të shtetasve të prekur nga fenomeni i gjakmarrjes.

Gjithashtu nëpërmjet këtij Memorandumi u synua që:

- Të realizohet një veprimtari e përbashkët për të koordinuar përpjekjet në luftën kundër fenomenit të gjakmarrjes dhe pasojave të tij në Qarkun e Shkodrës;
- Të mbrohej dhe garantohej e drejta themelore kushtetuese më e rëndësishme e njeriut, ajo e jetës;

<sup>58</sup> Asylum applicants from the Western Balkans comparative analysis of trends, push-pull factors and responses, EASO, 2013, faqe 43.

<sup>59</sup> Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë miratuar në datën 05.03.2015, e cila është botuar në Fletoren Zyrtare të vitit 2015, nr. 38, faqe 1760.

- Respektimi, mbrojtja dhe garantimi i të drejtave kushtetuese themelore të personave të ngjuar, si atë të lëvizjes së lirë, të arsimimit, të punësimit, të përfitimit të kujdesit shëndetësor, të votimit, të lirisë së organizimit, të lirisë së bindjes dhe shfaqjes së saj, etj;
- Të rritej bashkëpunimi në drejtim të forcimit të zbatimit të legjislacionit penal lidhur me zbulimin, kapjen dhe dënimin e autorëve të veprave penale të “*vrasjes për gjakmarrje*”, parashikuar nga neni 78/a i Kodit Penal, të “*kanosjes serioze për tu mbyllur në shtëpi*”, parashikuar nga neni 83/a i Kodit Penal dhe të “*nxitjes për gjakmarrje*”, parashikuar nga neni 83/b i Kodit Penal.

Përfaqësuesit e palëve pjesëmarrëse në parim ranë dakort që të nënshkruhej ky memorandum. Pavarësisht përpjekjeve të institucionit të Avokatit të Popullit, me Drejtuesit vendorë të Policisë së Shtetit dhe të Prokurorisë, si dhe eprorët e tyre, memorandumit i bashkëpunimit nuk u nënshkrua.

Në Qershor 2015, institucioni i Avokatit të Popullit, në vazhdim të përpjekjeve për parandalimin e këtij fenomeni, i drejtoi një rekomandim Kryeministrit, duke kërkuar marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e ligjit Nr. 9389, datë 04.05.2005 “*Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes*”, si dhe përgatitjen dhe miratimin nga Këshilli i Ministrave, të akteve nënligjore të parashikuara në nenet 4, 5 dhe 6 të këtij ligji.

Institucioni i Avokatit të Popullit është në fazën e përgatitjes së një raporti të veçantë të dytë, për fenomenin e gjakmarrjes në të cilin është pasqyruar reagimi i Institucionit të Avokatit të Popullit lidhur me këtë fenomen dhe rekomandimet e bëra, pas dërgimit në Kuvend të Raportit të Veçantë nr. 1, të konkluzioneve dhe rekomandimeve të Konferencës Kombëtare për gjakmarrjen, si dhe të dhënave për situatën aktuale të fenomenit të gjakmarrjes në vend, në bazë të të dhënave zyrtare të administruara nga organet e Policisë së Shtetit, Prokurorisë etj.

***Disa nga konkluzionet dhe rekomandimet për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes janë:***

Strukturat shtetërore nuk janë angazhuar si duhet në mënyrë totale dhe serioze për ta luftuar atë. Ligji Nr. 9389, datë 04.05.2005 “*Për krijimin dhe funksionimin e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes*”, ndonëse ka mbi 10 vjet që ka hyrë në fuqi, nuk ka gjetur zbatim, ndërkohë që zbatimi i tij përbën domosdoshmëri. Presidenti i Republikës nuk ka përmbushur detyrimin ligjor për thirrjen dhe mbledhjen e Këshillit Koordinues në luftën kundër gjakmarrjes, i cili do të shërbente si nxitje për organet e administratës për miratimin e tyre.

Paraqitet imediate, hartimi dhe miratimi i strategjisë kombëtare dhe respektivisht edhe i planit të veprimit për luftën kundër gjakmarrjes në planin ekonomik, social, legjislativ, etj. Po kështu edhe përcaktimi i detyrave dhe i masave konkrete për institucionet shtetërore, shoqërore, shkencore, fetare, etj. Masat e marra për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal, duke rritur dënimin për autorët e vrasjes për gjakmarrje (jo më pak se 30 vjet burgim, ose me burgim të përjetshëm neni 78/a i KP) dhe përfshirja e dy figurave të reja krimi, si “*Kanosja serioze për t’u mbyllur në shtëpi*” (neni 83/a i Kodit Penal) dhe “*Nxitja për gjakmarrje*” (neni 83/b i Kodit Penal, për të cilat parashikohet dënimi me burgim deri në tre vjet), nuk kanë rezultuar të mjaftueshme për të luftuar këtë fenomen.

Evidentimi i saktë dhe i plotë i numrit të familjeve dhe të personave të ngjuar është me rëndësi për të kuptuar përmasat dhe shtrirjen e fenomenit të gjakmarrjes dhe të ngujimit, i cili është një nga pasojat tragjike të tij, gjë që deri tani nuk është bërë si duhet.

Rekomandohet rritja e kapaciteteve gjurmuese dhe hetuese të strukturave të specializuara të Policisë së Shtetit, për të bërë të mundur zbulimin dhe arrestimin e të gjithë autorëve të vrasjeve të pazbuluara me çështje penale të pezulluara gjatë viteve, si dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë për autorët që i fshihen drejtësisë. Por këtu vlen për tu theksuar se, për vitin 2015 nuk është raportuar asnjë rast i ri vrasjeje për motivin e gjakmarrjes.

Duhet të rritet bashkëpunimi me autoritetet homologe të vendeve të BE-së për të evidentuar, verifikuar, hetuar dhe vënë para përgjegjësisë ligjore penale personat që, me anë të përdorimit të dokumentave të fallsifikuara kanë pretenduar si shkak gjakmarrjen për të kërkuar azil në ato shtete, me synimin që t'i jepet fund mashtrimit me përdorimin e gjakmarrjes si argument i pabazë për të kërkuar azil në vendet anëtare.

Ministria e Arsimit dhe Sportit duhet të luajë rol më të madh pozitiv e parandalues për përmirësimin e programeve mësimore, që të sigurohet edukimi me frymën e tolerancës, kundër vetëgjyqësisë, hakmarrjes e gjakmarrjes, si dhe për trajtimin e mësuesve të zonave ku është e përhapur gjakmarrja, duke vazhduar edhe për disa kohë Projektin “Shansi i dytë” nëpërmjet të cilit përfitojnë fëmijët e ngjuar. Megjithatë, synimi kryesor dhe përfundimtar duhet të jetë nxjerrja e fëmijëve nga ngujimi dhe bashkimi, edukimi dhe arsimimi i tyre me shokët në shkollë.

Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, nëpërmjet zyrave rajonale, duhet të ndihmojnë ekonomikisht familjet e ngjuara me të ardhura të pamjaftueshme, si dhe për të ulur nivelin e varfërisë. Gjithashtu ky institucion në bashkëpunim me organet e pushtetit vendor duhet t'u japë zgjidhje problemit të strehimit të familjeve të prekura nga gjakmarrja, të cilët janë rikthyer nga vendet e BE-së për shkak të refuzimit të dhënies së azilit.

Ministria e Shëndetësisë me strukturat e saj rajonale duhet të vazhdojë ofrimin e shërbimit shëndetësor në shtëpitë e familjeve të ngjuara nga gjakmarrja, sipas paketës bazë të Kujdesit Shëndetësor Parësor, me qëllim e ofrimit të shërbimit çdo pacienti.

Gjakmarrja mund të luftohet me efektivitet vetëm në qoftë se strukturat shtetërore, aktorët e sistemi i drejtësisë, shkollat, komunitetet fetare, media dhe shoqëria civile do të punojnë së bashku sipas një strategjie të përbashkët.

## 4.2 Gjendja e të drejtave të minoriteteve në vend

Vizioni i Avokatit të Popullit në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave kolektive të komuniteteve minoritare, apo edhe të drejtave individuale të pjestarëve të këtyre minoriteteve,<sup>60</sup> bazohet në frymën shumë të mirë ekzistuese të bashkëjetesës ndërmjet, popullsisë mazhoritare me atë minoritare dhe konsideron se, minoritetet në Shqipëri janë një pasuri kombëtare e çmueshme për të shkuarën dhe të ardhmen e vendit. Një ndër raportet e posaçme që Avokati i Popullit ka depozituar pranë Parlamentit Shqiptar, në muajt e parë të vitit 2015 (ende i padiskutuar), është edhe ai që ka të bëjë me të drejtat e minoriteteve në vend. Çështjet e trajtuara në këtë raport vazhdojnë të mbeten aktuale edhe gjatë vitit 2015<sup>61</sup>. Ato kanë të bëjnë me:

1. Miratimin e një ligji, ku të përcaktohet definicioni dhe kriteret e njohjes “de jure” të minoriteteve, në përputhje me parashikimet e Konventës Kuadër të Këshillit të Europës “Për mbrojtjen e minoriteteve”, të ratifikuar me ligjin Nr.8496 datë 3.06.1999.
2. Përmirësimin e kuadrit ligjor për mbrojtjen nga diskriminimi, me fokus disa përmirësime në nenin 1, të Ligjit Nr.10221, datë 4.02.2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit”, duke përfshirë në këtë nen si shkaqe për diskriminim; kombësinë; qëllimin e shpallur për të diskriminuar; nxitjen për diskriminim dhe ndihmesën dhe inkurajimin e diskriminimit.

<sup>60</sup>Sot në Shqipëri njihen dy lloje minoritetesh, minoritetet etnike kombëtare ku përfshihet minoriteti Grek, minoriteti Maqedon dhe minoriteti Serbo-Malazez, si dhe minoritetet etnoghjuësore, ku përfshihen minoriteti Vllah dhe minoriteti Rom. Pavarësisht kësaj realiteti i shoqërisë sonë një “defacto” edhe disa komunitete të tjera të ndryshme nga popullsia etnike shqiptare siç janë komuniteti Boshnjak, komuniteti Egjiptian, apo edhe komuniteti Goran.

<sup>61</sup>Në datën 14 Korrik 2015, Avokati i Popullit në bashkëpunim me Zyrën e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, ka organizuar në Gjirokastër, një auditorium mbi të drejtat e minoriteteve, ku edhe janë ringritur si çështje nga ana e vet përfaqësuesve të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend, pikërisht këto çështje.

3. Fillimin dhe përfundimin e procesit për ratifikimin e Kartës Europiane për Gjuhët Rajonale, ose Minoritare.
4. Marrjen e masave konkrete ligjore dhe administrative për përmirësimin e aksesit në strehim,shërbimet e arsimit,shërbimet sociale dhe pjesëmarrjen në jetën publike veçanërisht të minoritetit rom,por edhe të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në vend.Integrimin real të minoriteteve dhe komuniteteve të tjera në jetën e përditëshme,veçanërisht në strukturat qeverisëse në nivel vendor, apo qëndror.
5. Krijimin e kushteve për rritjen e mirëqënies në zonat ku banojnë minoritetet dhe komunitetet e tjera, përfshirë këtu edhe financimin me një buxhet më adekuat për njësitë e qeverisjes vendore,ku ka komunitete minoritare dhe komunitete të tjera në një masë dalluese me pjesën tjetër të popullsisë mazhoritare.
6. Zhvillimin e një censusi të ri të popullsisë, mbi bazën e kriterëve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, ku minoritetet do të gjenin veten për t'u shprehur objektivisht dhe pa rezerva për ekzistencën e tyre.

Në trajtimin e çështjes së të drejtave të minoriteteve në vend dhe jo vetëm, duhet domosdoshmërisht të fokusohemi në disa pika kryesore, që lidhen me; **Mbrojtjen e ekzistencës së minoriteteve; Mbrojtjen dhe promovimin e identitetit të tyre; Barazinë dhe jo-diskriminimin; dhe të drejtën e pjesëmarrjes efektive në vendimmarrje**, pra në jetën sociale dhe politike të shumicës.

Respekti ndaj të drejtave të minoriteteve nuk është një privilegj që shteti dhe shoqëria jonë iu bënë atyre, por një detyrim dhe një proces i natyrshëm që bazohet tek dinjiteti njerëzor dhe diversiteti, duke prezantuar kështu një “investim” madhor që një shoqëri i rezervon vetvetes për të ardhmen.

#### 4.3 Të drejtat e grave në Shqipëri

Të drejtat e grave dhe mbrojtja ndaj dhunës ndaj grave është një fenomen të cilit Avokati i Popullit i ka kushtuar një rëndësi të veçantë. Për këtë qëllim dhe për të sensibilizuar institucionet ndërkombëtare, Institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar raportin hije (raport alternativ) për zbatimin e Konventës CEDAW nga Shteti Shqiptar, drejtuar Komisionit të Kombeve të Bashkuara për Konventën CEDAW<sup>62</sup>.

Dhuna në familje vazhdon të përbëjë një problem shqetësues, me të cilin përballen sidomos gratë në shoqërinë shqiptare. Reagimi në mënyrë të koordinuar në menaxhimin e rasteve të dhunës në familje mbetet një sfidë për anëtarët e Mekanizmit të Koordinimit dhe Referimit të rasteve të dhunës në familje në nivel vendor. Burimet në nivel qendror dhe vendor nuk janë të mjaftueshme për të ndihmuar gratë, viktima të dhunës në familje të rindërtojnë jetën e tyre duke përfshirë mundësitë për punë dhe strehim<sup>63</sup>.

Rekomandohet ngritja dhe forcimi i mekanizmave për barazinë gjinore në nivel qendror dhe vendor. Një analizë gjinore e strategjive sektoriale do të mundësonte adresimin e duhur të nevojave dhe të të drejtave të grave dhe të burrave në sektorë të ndryshëm të ekonomisë dhe shoqërisë. Asistenca dhe ndihma ndaj viktimave të trafikimit të qënieve njerëzore, veçanërisht grave dhe fëmijëve përbën një nga sfidat e vendit tonë, dhe Avokati i Popullit ka synuar edhe

<sup>62</sup>[http://tbinternet.ohchr.org/\\_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2fCEDAW%2fIFN%2fALB%2f21838&Lang=enhttp://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/ALB/INT\\_CEDAW\\_IFN\\_ALB\\_21837\\_E.pdf](http://tbinternet.ohchr.org/_layouts/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=INT%2fCEDAW%2fIFN%2fALB%2f21838&Lang=enhttp://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CEDAW/Shared%20Documents/ALB/INT_CEDAW_IFN_ALB_21837_E.pdf)

<sup>63</sup>Ankesa (nr.doc 201502000) e shtetasës Zh.P, me urdhër mbrojtjeje nga ish bashkëshorti, dhe në pamundësi ekonomike dhe pa strehim (me dy fëmijë) që kërkon ndihmën e Avokatit të Popullit për mundësinë e strehimit të saj në Qendrën e Grave të Dhunuara, Kamëz.

përmirësimet e nevojshme ligjore kryesisht për mbrojtjen e të drejtave të viktimës gjatë procedimit dhe gjykimit penal.<sup>64</sup>

Fuqizimi ekonomik i grave, dhuna në familje dhe akses i grave në shërbimet sociale e në sistemin e drejtësisë, qeverisja e ndjeshme gjinore, konsiderohen si çështje ndër më problematike, me të cilat përballen gratë në Shqipëri. Puna e pushtetit vendor në lidhje me ofrimin e shërbimeve sociale, përmirësimin e shpërndarjes, tipologjisë së shërbimeve shoqërore, llojshmërisë së tyre në përputhje me nevojat e grupeve vulnerable ka nevojë të përmirësohet.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar ndryshimet e nevojshme në Kodin Zgjedhor<sup>65</sup> me synim garantimin e barazisë gjinore jo vetëm në këshillat bashkiakë ku 50% të jenë gra, por edhe në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Pavarësisht ndryshimeve pozitive në Kodin Zgjedhor (barazia gjinore në Këshillat bashkiake si dhe refuzimi i listës së partive politike të kandidatëve për Këshillat bashkiake me qëllim respektimin pa asnjë kompromis të kuotës gjinore prej 50% për anëtarët e Këshillave Bashkiake), institucioni i Avokatit të Popullit mendon se ato janë të pamjaftueshme dhe për këtë arsye do të vazhdojë të llojë për përfshirjen e kuotës prej 50% të grave edhe në Kuvendin e Shqipërisë. Shteti shqiptar duhet të ndërmarrë hapa të shpejta gjithashtu edhe për ndryshimin e sjelljes së publikut dhe nxitjen e pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike dhe përfaqësimit në organet e zgjedhura të pushtetit qendror dhe vendor”.

#### 4.4 Të drejtat e fëmijëve

Të gjitha pasojat e veprimeve të paligjshme, apo të parregullta që mund të kryejnë organet e qeverisjes qendrore apo vendore në veprimtarinë e përditshme ndikojnë drejtpërsëdrejti tek fëmijët. Ndaj kërkohen më tepër investime për ta, dhe jo vetëm nga pikëpamja materiale e financiare, por edhe në kuptimin e ndjeshmërisë dhe të shumëfishimit të energjive kushtuar mbrojtjes më të mirë e promovimit të mirëqënies e zhvillimit të tyre. Duke theksuar nevojën për ndërgjegjësimin për nevojën e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, pa dallime, theksin më shumë e vëmë tek dhënia prioritet fëmijëve në nevojë, të cilët varen nga dora e shtetit. Pushteti vendor, duhet t'i ketë të drejtat e fëmijëve një prioritet brenda axhendës qeverisëse në nivelin lokal.

Gjatë këtij viti janë ndërmarrë për trajtimin me iniciativë 49 raste për të drejtat e fëmijëve dhe janë kryer 11 inspektime në qendrat e përkujdesit rezidencial apo ditore publike për të miturit. Nga 136 raste specifike për të drejtat e të miturve, janë përfunduar me rekomandime 19 raste, ndërkohë që janë mbyllur me zgjidhje pozitivisht apo kërkesa të sqaruara 37 raste. Avokati i Popullit e ka avantazhin ta kryejë veprimtarinë e tij për monitorimin e gjendjes së të drejtave njerëzore edhe të të miturve edhe në institucionet shtetërore të sistemit penitenciar si burgje dhe paraburgim, në organet e Policisë së Shtetit. Dhe në këto raste ka paraqitur rekomandimet apo ka propozuar masa për rregullimin e situatës në shkëlqe, për mbrojtjen e të miturve në kontakt me drejtësinë, të cilat janë pjesë e punës monitoruese nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Duke patur parasysh faktin se fëmijët kanë të drejta dhe nevoja të posaçme, dhe që këto mund të realizohen vetëm me masa të përshtatura enkas për moshën, pjekurinë dhe zhvillimin e tyre, Seksioni i të Drejtave të Fëmijëve ka synuar që në të gjitha korrespondencat me administratën publike për trajtimin e ankesave, kërkesave apo rasteve me iniciativë, të theksojë si parësorin dhe udhërrëfyesin në punën e tyre interesin më të lartë të fëmijës.

<sup>64</sup> Rekomandimi (nr.doc.201500496) drejtuar Ministrit të Drejtësisë “Propozime për shtesa dhe përmirësime në nenet 48, 58 dhe 326 të Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e avokatit mbrojtës në procedimin dhe gjykimin penal për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të viktimës, si dhe ankimit në gjykatë ndaj vendimit të pezullimit të hetimeve, marrë nga organi i Prokurorisë”.

<sup>65</sup>Rekomandimi (nr.doc.201500100) drejtuar 5 kryetarëve të grupeve parlamentare të partive në Kuvendin e Shqipërisë, si dhe pjesëmarrja e AP në mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, të Kuvendit të Shqipërisë me dt.31.03.2015.



Si pjesë e bashkëpunimit me shoqërinë civile, Avokati i Popullit ka bashkëpunuar me Save the Children, Zyra për Shqipërinë, për përgatitjen e një raporti të veçantë lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve për punë në Shqipëri, i cili do të paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë<sup>66</sup>. Në sistemin e monitorimit të zbatimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, Avokati i Popullit synon që jo vetëm të promovojë të drejtat e fëmijëve, por dhe të luajë rolin parandalues, mbrojtës, nxitës dhe proaktiv dhe për të aksesuar shërbimet e ndryshme ekonomike, arsimore, shëndetësore si dhe në drejtësi. Decentralizimi i kompetencave nga pushteti qendror tek qeverisja vendore, ka evidentuar se në përgjithësi qeverisja vendore nuk është përfshirë sa duhet në ushtrimin e përgjegjësive për administrimin efektiv dhe monitorimin e institucioneve të transferuara në varesinë e njësive të kësaj qeverisjeje. Mungesa e kapaciteteve dhe mundësitë e kufizuara financiare bëjnë që qeverisja vendore të mos i përgjigjet kërkesave për ngritjen e shërbimeve të reja në ndjekje të dinamikës së nevojave të fëmijëve<sup>67</sup>. Skema e ndihmës ekonomike përbën një nga masat e mbrojtjes sociale që ka për synim të luftojë nivelin e varfërisë në vend si dhe në mbijetesën e pjesëtarëve më të vegjël të familjeve shqiptare. Mund ta themi që zhvillimi i një vendi varet nga niveli i arsimimit<sup>68</sup>, gjendja shëndetësore<sup>69</sup>, dhe mirëqenia e fëmijëve. Në kushtet e ndarjes së re territoriale është tejet nevojshme që të krijohet një bazë e të dhënave në nivel lokal, duke regjistruar numrin e familjeve në nevojë si dhe numrin e saktë të fëmijëve në secilën kategori ku ka probleme, në mënyrë që të hartohen politika gjithëpërfshirëse sociale në nivelin lokal, e kryesisht buxhetim për shërbime sociale për komunitetin. Ideja e krijimit të një sistemi të decentralizuar të ofrimit të shërbimeve sociale duhet të shihet si një mundësi për t'i ofruar qytetarëve mundësi më të mira për të marrë pjesë në vendimmarrje dhe politikëbërje, duke rritur kështu llogaridhënien e politikëbërësve ndaj qytetarëve. Kur flasim për problematika ku ka nevojë të investohet më shumë jo vetëm para, por më shumë energji pozitive e punë me ndjeshmëri të lartë, e të cilat janë ndeshur gjatë punës së këtij viti janë: -Të miturit që mund të braktisin shkollën (pasi ura që i shpie në shkollë nuk po ndërtohet, apo sepse çatia e shkollës rrezikon të shembet, apo se nuk ka ngrohje, etj, etj problematika në arsim);-Fëmijë që vuajnë sëmundje të rënda në spitale e që buxheti familjar nuk i lejon të kryejnë ndërhyrjet e specializuara jashtë vendit. Fëmijë që nga aftësia e kufizuar nuk mund të përfshihen në procesin mësimor, pasi nuk ka mësues ndihmës në klasë, apo që nuk ka një rampë për ta drejtuar tek klasa; fëmijë që gjithë ditën luajnë në internet të mbyllur në shtëpi, pasi mungojnë parqet e vogla me lodra ku ata të mund të lozin e dëfrenë; fëmijë të komunitetit rom që u duhet të gërmojnë në koshat e plehrave; të mitur që në kontakt me drejtësinë nuk i jepet mbrojtja apo ndihma e duhur juridike<sup>70</sup>, etj. Sfidat që kemi identifikuar janë shtrirja dhe forcimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, hartim politikash që sigurojnë shërbime cilësore shëndetësore, përfshirë sigurimin e fondit të posaçëm për fëmijët me sëmundje të rënda e që kërkojnë trajtim adekuat jashtë vendit; Investimet në rritjen e cilësisë së arsimit, duke synuar

---

<sup>66</sup> Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të këtij draft raporti u paraqitën në Konferencën kombëtare vjetore të fundvitit 2015.

<sup>67</sup>Rekomandimi drejtuar 12 Kryetarëve të Këshillave të qarqeve (nr.doc.201500221) *“Për Forcimin e ringritjen e Njësive të të Drejtave të Fëmijëve në Këshillat e Qarqeve në përmbushje të interesit më të lartë të fëmijës”*.

<sup>68</sup>Rekomandimi (nr. Doc.201500789) drejtuar MAS *“Për marrjen e masave për mospërfshirjen e fëmijëve nxënës shkollash në aktivitetet elektorale të subjekteve të ndryshëm zgjedhore gjatë orarit të mësimin per garantimin sa më të plotë të të drejtave të fëmijëve*. Rekomandimi (nr.doc.201501506) drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve *“Për marrjen e masave për caktimin e një psikologu ose punonjësi social në shkollat e fshatit Lazarat, Gjirokastër”* (nr. doc.201501105) *“Për marrjen e masave për disegregimi dhe plane afat shkurtra dhe afat gjata për disegregimin e shkollave, të segreguara për fëmijët rom dhe egjiptianë në lagjen Stan, Moravë, Berat”*.

<sup>69</sup>Rekomandim (nr.doc.201500464) *“Për marrjen e masave të menjëhershme për të tërhequr Fletat e Drejtimit për KMCAP të shtetaseve V.Ç dhe B.Ç, pranë Spitalit Psikiatrik, Vlorë, me qëllim komisionimin pranë KMCAP-it, Lushnje”*.

<sup>70</sup>Rast me iniciativë (nr.doc 20152279) *“Për keqtrajtimin dhe shoqërimin në polici të 18 vjeçarit M.A, nga dy punonjës të Policisë Fushë Krujë”*.

gjithpërfshirjen dhe qasjen në arsim, parandalimin e braktisjes dhe parandalimin e dhunës në shkollë; Vijimin e mbrojtjes më të madhe sociale për të gjithë fëmijët nën kujdes rezidencial, përfshirë fëmijët e braktisur dhe fëmijët pa përkujdes prindëror, fëmijët me nevoja të veçanta, fëmijët në varfëri, fëmijët e keqtrajtuar, fëmijët viktimë të shfrytëzimit dhe trafikimit, fëmijët e përfshirë në punë të rënda etj. Krijimi i sistemit të integruar të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, ku çdo hallkë lidhet me tjetrën për parandalimin e shkeljeve apo ndërhyrjen për mbrojtjen dhe rehabilitimin e të miturve, menaxhimin dhe ofrimin e shërbimeve mbështetëse nga pushteti vendor përbëjnë sfidat e vitit të ardhshëm.

#### 4.5 Të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara

Gjatë vitit 2015 janë depozituar dhe trajtuar 74 ankesa për këtë kategori. Më poshtë parashtrohen disa nga problematikat e trajtuara gjatë këtij viti.

Një nga çështjet është pasaktësia në terminologjinë e përkthyer të Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara”. Duke qenë se mospërkthimi korrekt në gjuhën shqipe, sjell si pasojë kuptim jo të duhur të Konventës, konceptim jo të saktë të akteve që dalin pas ratifikimit të saj, perceptim të gabuar të detyrimeve, por edhe më tej, në raportimin e shtetit shqiptar për zbatimin e kësaj Konvente, Avokati i Popullit më datë 12.05.2015 i ka rekomanduar Ministrin të Drejtësisë, *ndërmarrjen e iniciativës ligjore për saktësimin e përkthimit të neneve 29 dhe 32 të ligjit nr. 108/2012 “Për ratifikimin e Konventës së OKB-së “Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara*. Ende nuk ka përgjigje për qëndrimin e mbajtur ndaj këtij rekomandimi.

Për aksesin në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar, të cilët janë thuajse në pamundësi për të siguruar mbrojtjen e tyre ligjore në institucionet e drejtësisë për të ngritur një padi dhe për të kërkuar një të drejtë. Edhe gjatë procedimit penal herë pas here ato ndodhen në situata të pafavorshme dhe të pabarabarta. Avokati i Popullit, për të garantuar aksesin në drejtësi të personave me aftësi të kufizuar, më datë 13.05.2015 i'u drejtua me rekomandim Ministrin të Drejtësisë për përmirësimin e legjislacionit procedural, në Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurave Administrative dhe Ligjin “Mbi noterinë”, e cila në përgjigje të rekomandimit, u shpreh se në rastin më të parë do të merrte në analizë rekomandimet për rishikimin e legjislacionit përkatës.

Gjithashtu, duke qenë se Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë ushtron veprimtarinë e saj edhe në zhvillimin e politikave për adresimin e çështjeve për mosdiskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar, më datë 03.08.2015, institucioni i Avokatit të Popullit ju drejtua me rekomandimet e sipërcituara Ministrin të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë dhe për dijeni Ministrisë së Drejtësisë. Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e saj është shprehur se:

1. *Në rastin e parë të ndërmarrjes së iniciativës për rishikimin e Ligjit nr.8116 datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe Ligjit nr.7829 datë 01.06.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar, do të marrë në analizë edhe rekomandimet e përgatitura nga institucioni i Avokatit të Popullit.*

2. *Me Urdhërin nr.695 datë 22.12.2014, ka ngritur grupin e punës “Për hartimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili do të marrë në analizë edhe rekomandimet e përgatitura nga ana e institucionit tonë mbi këtë çështje për ndihmën juridike për këtë kategori.*

3. *Miratimi i Kodit të ri të Procedurave Administrative ka përfshirë në nenin 17 të tij “Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit”*

Për këtë institucioni i Avokatit të Popullit mbetet në pritje të zbatimit të rekomandimeve.<sup>71</sup>

<sup>71</sup> Doculive nr.201500240

Me qëllim përfaqësimit më të lartë në vendimarrje të shoqatave, që në përbërjen e tyre kanë anëtarë me aftësi të kufizuar, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.<sup>72</sup> Kjo ka dalë edhe nga ankesat, ku sugjerohet se duhet të rritet numri i organizatave që marrin pjesë në Këshillin Kombëtar për Aftësinë e Kufizuar, me qëllim që të rritet edhe pjesëmarrja e tyre në vendimarrje, për të përçarur pranë atij Këshilli problematikat që ata hasin në jetesën e përditshme.

Personat që gëzojnë Statusin e të Verbërve, nuk kanë përfituar indeksimin e masës së pagesës së aftësisë së kufizuar, sa herë që është rritur paga minimale në shkallë vendi për periudhën 2005-2010. Për këtë çështje, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.<sup>73</sup>

Një çështje tjetër e hasur është rinovimi i Librezës së Invaliditetit pranë QSUT-së për personat me aftësi të kufizuara, të cilët jetojnë në qytete të ndryshme të Shqipërisë në një kohë që prej vitesh janë përfitues të grupit të invaliditetit (persona paraplegjike e tetraplegjike), kur vendimi nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë në Punë është dhënë “Përgjithmonë”. Ky problem është ngritur nga shumë persona me aftësi të kufizuar, të cilët e kanë të pamundur të vijjnë për t’u ekzaminuar në Tiranë, jo vetëm nga ana shëndetësore, por edhe financiare, në një kohë që ekzaminimet mund të kryhen edhe në Spitalet Rajonale. Për këtë, Avokati i Popullit i është drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale.<sup>74</sup>

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vemendje dhe çështje të tjera si shkurtimi i buxhetit për personat invalidë. Për këtë arsye i është drejtuar Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, e cila ndër të tjerash është shprehur se shkurtimi i buxhetit planifikohet të bëhet si rezultat i një procesi vlerësimi të përfitimeve të personave me aftësi të kufizuar, të cilët shpesh të nxitur nga pagesa ndjekin disa cikle shkollore të njëpasnjëshme dhe nuk nxiten drejt programeve të punësimit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar që të nxiten studime për fakultet i dytë për ata persona me aftësi të kufizuar, të cilët kanë arritur rezultate të larta dhe kanë dëshirë të vazhdojnë studimet edhe në një fakultet të dytë.

Një çështje të cilët institucioni i Avokatit të Popullit e ka shqyrtuar gjatë vitit 2015 është mosdhënia e të drejtës për të përfituar rimbursimin për shpenzimet në blerjen e karburantit dhe vajit lubrifikant. Pavarësisht se ISSH ka informuar se, në *bashkëpunim me Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë po punon për ndryshimet e nevojshme ligjore, të cilat duhet të paraqiten për miratim në Këshillin Administrativ të ISSH-së*,<sup>75</sup> përsëri kjo çështje ka mbetur pa u zgjidhur.

Në kuadër të zgjedhjeve lokale 2015, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme që personat më aftësi të kufizuar të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre kushtetuese, të drejtën e votës, institucioni i Avokatit të Popullit, ju drejtua Komisionit Qëndror Zgjedhor për të na informuar në lidhje me masat e marra për zbatimin e dispozitave përkatëse të parashikuara në Kodin Zgjedhor. Pavarësisht mungesës së një përgjigje zyrtare, KQZ publikoi në faqen e internetit të saj, masat e marra për votimin e personave me aftësi të kufizuara. Çdo qendër votimi do paisej me shabllonin përkatës për të verbërit dhe me infrastrukturën e duhur për personat me probleme të tjera. Është investuar për fletët e votimit me alfabetin “brail”. Gjithashtu, me ndihmën e ndërkombëtarëve janë mundësuar “rampet”, të vendosura në qendrat e votimit ditën e zgjedhjeve.

<sup>72</sup> Doculive nr.201501359

<sup>73</sup> Doculive nr.201501358

<sup>74</sup> Doculive nr.201501348, nr.201501366, nr.201502602

<sup>75</sup> Doculive nr.201500833

Problematikat e referuara edhe në Raportin e vitit 2014, vazhdojnë të jenë ekzistuese dhe nuk kanë gjetur ende zgjidhje. Këtu mund të përmendim, mungesën e përshtatshmërisë në ambientet publike dhe private, mungesën e aksesit në transportin urban publik dhe mosrimbursimin e biletës, moszbatimin e dispozitave ligjore për punësimin, mungesën e aksesit në arsimin publik të fëmijëve me aftësi të kufizuara, mungesën e statistikave për personat me sëmundje të rënda mendore, mosnëgritjen e qendrave rehabilituese rezidenciale për personat me sëmundje të rënda mendore.

Sa më sipër, nevojitet një bashkërendim më i mirë i punës mes gjithë institucioneve shtetërore dhe aktorëve të shoqërisë civile, për të ndërmarrë hapat e duhura që realisht personave me aftësi të kufizuara t'u ofrohen shërbimet e munguara sipas standardeve europiane, me qëllim që ata të kenë të drejta të barabarta me pjesën tjetër të popullsisë.

#### **4.6 Të moshuarit**

Të moshuarit ndeshen shpesh me barriera shoqërore që ndikojnë mjaft në jetën e tyre. Gjithmonë e më shumë të moshuar jetojnë të vetmuar, ndërkohë që gjendja ekonomike e tyre është më e rëndë se pjesa tjetër e shoqërisë.

Për të garantuar dhe forcuar të drejtat e të moshuarve, kërkohet që të miratohet Statusi i Moshës së Tretë. Kjo çështje është prezantuar edhe në Raportin vjetor 2014, ku kemi thjeshtuar faktin se institucioni ynë ka ndërmjetuar për këtë çështje më herët.

Më datë 17.02.2015, por edhe 6 muaj më pas i është drejtuar një rekomandim Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për propozimin për miratim të projektligjit “Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë”, që ende sot ka mbetur pa një përgjigje.

Në kuadër të zgjedhjeve lokale 2015, me qëllim krijimin e kushteve të nevojshme që personat e moshuar, të cilët strehohen në qendrat rezidenciale, më datë 03.06.2015, u jemi drejtuar drejtuesve të Shtëpive të të Moshuarve, Tiranë, Kavajë, Shkodër, Fier dhe Gjirokastrë për masat e marra për t'u mundësuar këtyre personave që të ushtrojnë në mënyrë të plotë dhe të qetë të drejtën e votës. Në përgjigje të kërkesave tona, Shtëpia e të Moshuarve Tiranë, Gjirokastrë dhe Fier, na informoi se të gjithë të moshuarit janë pajisur me dokumenta identifikimi dhe janë marrë të gjitha masat që ata të ushtrojnë të drejtën e votës.<sup>76</sup>

Në mbrojtje të të drejtave të të moshuarve, janë kryer inspektime në Shtëpitë e të Moshuarve Gjirokastrë, Shkodër, Fier, Kavajë. Duke qenë se, standardet e shërbimeve në qendrat rezidenciale dhe ditore për të moshuarit duhet të garantojnë të drejtat e tyre, ju janë adresuar rekomandimet përkatëse Bashkive dhe Shërbimit Social Shtetëror për përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre. Institucioni i Avokatit të Popullit vazhdon të insistojë se duhet të ketë më shumë qendra rezidenciale dhe ditore për të moshuarit.<sup>77</sup>

#### **Minimumi jetik**

Ende sot, përcaktimi i nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri ose siç quhet ndryshe “minimumi jetik” nuk është përcaktuar. Minimumi jetik përfaqëson madhësinë e të ardhurave në para që duhet të ketë çdo person për të siguruar kushte minimale për jetesë. Personat që sigurojnë më pak të ardhura se minimumi jetik konsiderohen të varfër. Në këtë kuadër evidentimi i

<sup>76</sup> Doculive nr.201500811

<sup>77</sup> Doculive nr.201502260, nr.201502395.

varfërisë do të quhej i mangët pa përcaktuar minimumin jetik. Stadi aktual i zhvillimit që po ecën shoqëria shqiptare, e bën të domosdoshëm përcaktimin e minimumit jetik.

Kjo çështje lidhet me nevojat që ka njeriu për të siguruar mbijetesën në kushtet aktuale, por edhe më tej, bazuar në të, përcaktohen edhe nivelet e përfitimeve në skemat e mbrojtjes sociale, sigurimeve shoqërore, sistemit të pagave, çështje e referuar, rekomanduar dhe raportuar disa herë nga institucioni i Avokatit të Popullit. Më herët nga institucioni i Avokatit të Popullit i është rekomanduar Kryeministrit, ngritja e një grupi pune për studimin dhe përcaktimin e nivelit minimal të standardit të jetesës në Shqipëri. Pavarësisht pranimin të rekomandimit nga ana e Kryeministrit dhe kërkesës drejtuar nga kjo e fundit,<sup>78</sup> Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për ngritjen e këtij grupi pune, ende nuk është realizuar ndonjë zhvillim konkret.

Në Mars 2015 dhe në vazhdim,<sup>79</sup> institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për hapat e ndërmarra dhe pavarësisht gadishmërisë së shprehur për të filluar punën për këtë çështje, ky angazhim rezulton ende i papërbushur.

#### **4.7 Ish të përndjekurit politikë dhe dëmshpërblimi financiar**

Ankesat e individëve, të dënuar politikë të ish regjimit komunist, si dhe të trashëgimtarëve të tyre gjatë vitit 2015, kanë të bëjnë me pretendimet për: përsheptimin e procesit të ndarjes së kësteve të dëmshpërblimit financiar; mostrajtimin dhe mosinformimin në lidhje me kërkesat e paraqitura për dëmshpërblim financiar; mosgjatjen e eshtrave nga të afërmit, të ish të dënuarve politikë, të vdekur gjatë vuajtjes së dënimit; për pamundësinë e paraqitjes së kërkesave për dëmshpërblim financiar.

Gjatë këtij viti janë trajtuar 20 ankesa për këtë kategori, nga të cilat 5 janë në shqyrtim dhe për 15 prej tyre ka përfunduar shqyrtimi. Problematikat e evidentuara lidhen me çështjet e trajtuara në rekomandimet tona:

1. Për nevojën e realizimit të iniciativës legislative, për një ndryshim në VKM nr.419 datë 14.04.2011 “Për miratimin e afateve dhe të skemës së shpërndarjes së fondeve të dëmshpërblimit, për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist”, me qëllim përcaktimin e një afati përfundimtar të arsyeshëm, për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit financiar. Këshilli i Ministrave ka nxjerrë VKM nr.684 datë 15.10.2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.419 datë 14.04.2011”, i cili në thelb është rregullim i çështjeve teknike të mënyrës se si do të bëhet shpërndarja e fondeve të miratuara nga qeveria për dëmshpërblim. Por edhe ky vendim nuk ka përcaktuar një afat taksativ për përfundimin e procesit të dëmshpërblimit.

2. Për plotësimin e bazës së nevojshme ligjore, përmes përcaktimit të një skeme pensioni, e cila do të mundësojë procesin e dëmshpërblimit financiar për kategorinë e personave të internuar, ose të dëbuar gjatë regjimit komunist, të përcaktuar në gjermën “c”, të nenit 6, të Ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Këshilli i Ministrave nuk ka miratuar ende këtë skemë pensioni.

3. Për nxjerrjen e akteve nënligjore për trajtimin e të internuarve nga regjimi komunist, në zbatim të parashikimeve të bëra në gjermën “b”, të nenit 6 dhe në nenin 10, Ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar. Këto akte nënligjore nuk janë nxjerrë ende.

<sup>78</sup> Shkresa nr. 2386 datë 16.06.2014 drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ku është kërkuar...

“Organizimi i punës për ngritjen e një grupi pune, me drejtues dhe ekspertë, të cilët pasi të kenë studiuar gjendjen në vend, të japin rekomandime konkrete për mënyrën dhe procedurat që duhet të ndiqen për të përcaktuar nivelin minimal të standardit të jetesës në Shqipëri. Rekomandimet e grupit të punës do t'i përcillen Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, i cili në ushtrim të funksioneve të tij, të ndërmarrë hapat konkretë për iniciimin e akteve përkatëse për përcaktimin e minimumit jetik në Shqipëri”.

<sup>79</sup> Me shkresën nr. 474/2 datë 09.03.2015 dhe 25.09.2015

Çështje kryesore mbetet kryerja e një procesi dëmshpërblimi financiar, taksativisht të përcaktuar në kohë, e ndjekur nga një çështje tjetër, që ka të bëjë me trajtimin e atyre subjekteve që duhet të përfitojnë sipas përcaktimeve të ligjit “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politikë të regjimit komunist”, i ndryshuar, por që nuk kanë mundur të paraqesin në kohën e parashikuar nga ligji kërkesat për dëmshpërblim financiar. Për këtë grupim të dytë nevojitet miratimi i një baze ligjore të re, për përfshirjen e tyre në këtë proces.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se një nga çështjet e vonuara dhe ende të pazgjidhura të shoqërisë sonë, ka qenë miratimi i një ligji gjithpërfshirës e të mbështetur në parimet ekzistenciale të një shoqërie demokratike, për hapjen e dosjeve. Përmes një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile ka përgatitur dhe i ka dërguar një rekomandim në muajin Mars 2014, Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, për të realizuar iniciativën përkatëse ligjore. Një zhvillim shumë pozitiv në këtë drejtim dhe pëmbushje e rekomandimit tonë është miratimi dhe hyrja në fuqi, e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”. Vlerësojmë tashmë se, një vëmendje e posaçme nga ana e qeverisë duhet t’i kushtohet zbatimit konkret të ligjit për hapjen e dosjeve që duhet të nisi me përzgjedhjen e kandidaturave për ngritjen e Autoritetit drejtues, por edhe me miratimin e akteve nënligjore që do të mundësojnë zbatimin praktik të tij.

Nevoja për “Lustracionin”, si një proces që përfshin në vetvete ndër të tjera edhe “hapjen e dosjeve”, është e lidhur ngushtë me krijimin e besimit në opinionin publik, për kryerjen e një procesi real, që do të bëjë transparencën e krimeve dhe pasojave të tyre nga sistemi i mëparshëm dhe që do të sigurojë të qeverisurit sot se klasa aktuale qeverisëse dhe individë në nivele të tjera postesh publike, nuk do të mbartin paragjykimin dhe frymën antidemokratike të përsëritjes të asaj ç’ka ka ndodhur në të shkuarën. Për këtë qëllim i është dërguar një rekomandim Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë dhe Kryetarit të Kuvendit, për ndërmarrjen e iniciativës legjislative, për miratimin e bazës ligjore që do të mundësojë procesin e “Lustracionit”.

*Ky rregullim ligjor duhet të prekë procedurat dhe kërkesat e rekrutimit, si dhe të ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punonjësve civilë në administratën publike, të përfaqësuesve të pushtetit gjyqësor, organit të prokurorisë, pa përjashtuar këtu zgjedhjen, apo ndërprerjen e mandatit të funksionarëve të lartë publikë, sipas standardeve dhe kritereve kushtetuese dhe ndërkombëtare, të cilave duhet t’iu nënshtrohet procesi i “Lustracionit”. Po kështu, rregullimi ligjor duhet të përfshijë objektivitetin e propozimeve dhe vendimmarrjen respektive për dhënie dekoratash, titujsh nderi, medaljesh dhe titujsh vendorë të nderit, nga ana e organeve shtetërore që kanë këtë të drejtë.*

Duke qenë të ndjeshëm dhe proaktivë në këtë çështje është gjykuar se, shembulli i fillimit të një procesi të tillë duhet të konkretizohet me institucionet e pavaruara të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe më konkretisht, me institucionin e Avokatit të Popullit. Për këtë arsye, përmes një rekomandimi drejtuar Ministrit të Drejtësisë, është kërkuar që të ndërmerret iniciativa legjislative për shtimin e dispozitave të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, me parashikime që mundësojnë procesin e lustracionit në këtë institucion. Kuptuar këtu dispozitat që flasin për fillimin dhe mbarimin e mandatit të Avokatit të Popullit, si dhe të Komisionerëve. Personeli i zyrës së institucionit të Avokatit të Popullit bën pjesë në shërbimin civil të Republikës së Shqipërisë. Në këto kushte, është rekomanduar se do të ishte e përshtatëshme që në referencë të procedurave të rekrutimit të kandidatëve që konkurojnë për të qenë pjesë e këtij personeli, apo edhe të parashikimeve për përfundimin e marrëdhënieve të punës në shërbimin civil, të përcaktohen disa kritere që duhet të shtohen në kuptimin e dispozitave kryesore me karakter përgjithësues, në Ligjin nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar. Ky është momenti i duhur që procesi i Lustracionit, të bëhet bashkë me Dekriminalizimin, dhe Reformën në Drejtësi për t’i garantuar Shqipërisë dhe demokracisë së saj, një stad të ri dhe një të ardhme më të sigurtë.

Një vend specifik gjatë vitit 2015, ka zënë edhe veprimtaria e institucioneve shtetërore kompetente për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar, gjatë viteve të regjimit komunist, të cilëve ende nuk i'u është gjetur vend-varrimi. Sikurse është theksuar në Raportin Vjetor të vitit 2014, janë të shumta rekomandimet që Avokati i Popullit u ka drejtuar institucioneve përkatëse, për krijimin e strukturave efektive dhe mundësimin e kryerjes së një procesi real dhe rezultativ.

Propozimi së fundmi nga qeveria e një Plan-Veprimi konkret, për gjetjen e të zhdukurve është një hap i rëndësishëm, që tregon vullnet për zgjidhjen një herë e mirë të këtij shqetësimi madhor për gjithë shoqërinë shqiptare. Ky zhvillim pozitiv shkon në të njëjtën linjë dhe në zbatim të plotë të masave të rekomanduara paraprkishtë nga Avokati i Popullit, me rekomandimin e datës 25 Qershor 2014.

#### **4.8 Të drejtat e Komunitetit LGBTI (Interseks)**

Të drejtat e personave LGBTI-(interseks) konsiderohen si pjesë të pandashme e tërësisë së të drejtave të njeriut, dhe për këtë është shprehur qartë se nuk duhet të ketë pengesa ligjore për personat e komunitetit LGBTI në realizimin e të drejtave, të cilat gëzohen nga pjesa tjetër e shoqërisë.

Siç është përmendur edhe në Raportin Vjetor të vitit 2014, takimi i organizuar nga Avokati i Popullit me Këshillin e Evropës dhe Ministrinë së Mireqënies Sociale dhe Rinisë për diskutimin mbi disa ndryshime në Ligjin nr.9062, Datë 05.08.2003 “Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë”, dhe më konkretisht ndryshimin e neneve 163 dhe 164, në lidhje me “Bashkëjetesën midis dy personave të të njëjtit seks, si dhe kushtet dhe procedurat e regjistrimit, pasojat e regjistrimit, dhe mënyrat e përfundimit të bashkëjetesës dhe marrëdhëniet personale e pasurore ndërmjet bashkëjetuesve të cilat rregullohen me ligj të veçantë”, u finalizua me një rekomandim të datës 22.09.2015, dërguar Ministrisë të Drejtësisë.<sup>80</sup>

Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e saj, të datës 21.10.2015, është shprehur se e ka pranuar rekomandimin e institucionit të Avokatit të Popullit, për rishikimin e Kodit të Familjes mbi institutin e bashkëjetesës, duke mbajtur në konsideratë parimet kushtetuese dhe zhvillimet në legjislativën në fuqi.

Në zbatim të Rezolutës së Miratuar nga Kuvendi, në datën 07.05.2015 “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBTI”, nëpërmjet të cilës inkurajohet institucioni i Avokatit të Popullit për monitorimin e respektimit të të drejtave dhe lirive kushtetuese e ligjore të personave LGBTI në Shqipëri, si dhe të masave që duhet të ndërmerren nga institucionet përgjegjëse për respektimin e tyre”, Avokati i Popullit ka marrë disa iniciativa. Kështu i janë kërkuar shpjegime Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, si dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, lidhur me detyrat e lëna në këtë rezolutë për këto institucione.

Gjithashtu në këtë rezolutë citohet se “...Nxit Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë që, nëpërmjet Inspektoratit Shtetëror të Punës, të kontrollojë zbatimin nga punëdhënësit të dispozitave ligjore që pritet të ndryshohen, në mënyrë që të garantojë zbatimin e tyre në praktikë nga punëdhënësit publikë ose privatë...”

Duke u bazuar në këto rezolutë, si dhe në zbatim të rekomandimit tonë të datës 13.04.2012, për ndërmarrjen e iniciativës legjislative për disa ndryshime në ligjin 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, për përfshirjen në pikën 2, të nenit 9, të ligjit 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, si shkaqe për diskriminim “orientimin seksual dhe identitetin gjinor”, si dhe përfshirjen në fund të nenit 9, të një paragrafi të ri, në të cilin do të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin.

<sup>80</sup> Nr. Dok.201501690 dt.22.09.2015 Rekomandim drejtuar Ministrisë të Drejtësisë , përgjigja dt.21.10.2015

Lidhur me marrjen e masave anti-diskriminuuese në mjedisin e punës, Avokati i Popullit i kërkoi informacion Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë lidhur me detyrat e lëna për këtë institucion në këtë rezolutë.<sup>81</sup> Nga kjo e fundit në datë 29.12.2015 u informuam se për disa nga realizimet e detyrave që kjo ministri ka ndërmarrë në mbrojtje të komunitetit LGBTI, hartimin dhe zbatimin e politikave që parashikojnë jo vetëm krijimin e shanseve të barabarta në akses për përfitime të drejtëpërdrejta apo shërbime, por dhe masa pozitive për disa grupe vulnerabël ku veç të tjerëve ka qenë pjesë dhe komuniteti LGBTI, në mënyrë që të ofrohen mundësi të barabarta dhe mbrojtje nga diskriminimi në fushat e punësimit, marrëdhënieve të punës etj.

Disa nga masat e rëndësishme të ndërmara nga MMSR janë dhe përmirësimet që i janë bërë Kodit të Punës, në lidhje me garantimin e të drejtave të personave LGBTI në fushën e marrëdhënieve të punës. Ministria, nëpërmjet Inspektoriatit Shtetëror të Punës, do të ndjekë në vazhdimësi zbatimin e dispozitave të Kodit të Punës që kanë të bëjnë direkt me mbrojtjen e të drejtave të komunitetit LGBTI. Gjithashtu, punonjësit e ISHP do të vazhdojnë të trajnohen lidhur me të drejtat e këtij komuniteti.

Një pikë tjetër e Rezolutës “Për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të personave që i përkasin komunitetit LGBTI”, ishte dhe nxitja e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve për trajnimin e stafit mësimor për mbrojtjen më të mirë të të drejtave të personave LGBT, me qëllim moslejinin e çdo forme diskriminimi të tyre, për shkak të orientimit seksual ose identitetit gjinor, zhvillimin e veprimtarive kulturore kundër homofobisë në institucionet arsimore, me pjesëmarrjen edhe të përfaqësuesve të komunitetit LGBTI.

Të drejtat e komunitetit LGBTI fillojnë që nga e drejta për të jetuar, e drejta për siguri dhe mbrojtje nga dhuna, liria e shprehjes, punësimi, shëndeti, strehimi, mosdiskriminimi etj. Një e drejtë shumë e rëndësishme është dhe mbetet arsimit. Këtu përfshihet e drejta për arsim pa diskriminim për shkak të orientimit seksual, ose identitetit gjinor.

Në zbatim të rekomandimit tonë dt 18.07.2012 drejtuar Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ku kemi kërkuar përfshirjen në kurrikula dhe programe mësimore të njohurive dhe informacioneve për komunitetin LGBTI, si dhe trajnimin e stafit akademik për moslejinin e çdo forme diskriminimi, duke siguruar mbrojtje dhe disiplinë në institucionet arsimore për shkak të përkatësisë së tyre seksuale, Ministria e Arsimit dhe Shkencës ka informuar se kurrikula e re e arsimit parauniversitar është ndërtuar mbi respektimin e parimit të mosdiskriminimit.<sup>82</sup> Në të janë përfshirë informacione për komunitetin LGBTI, me qëllim krijimin e një mjedisi të rregullt dhe të sigurtë pa dhune, pa fyerje përjashtim social, apo trajtim çnjerezor lidhur me orientimin seksual, ose identitetin gjinor. Gjithashtu në përgjigjen e saj ministria sqaron se, në muajt Prill-Korrik 2015, Instituti i Zhvillimit të Arsimit trajnoi mësuesit e klasave të para dhe të gjashta për kurrikulën e re, në të gjithë Shqipërinë. Shërbimet mjekësore ndaj personave LGBTI vazhdojnë të jenë jo-miqësore. Gjatë aktivitetit të Avokatit të Popullit mund të përmendim organizimin e një Auditoriumi për të drejtat e komunitetit LGBTI. Në datën 15 Dhjetor 2015 një ndër panelet në Konferencën Vjetore të Avokatit të Popullit, me temë “Qeverisja Vendore dhe Qendrore”, ishte e kryesuar edhe Ambasada Pink, e cila paraqiti në përgjithësi problematikat që shqetësojnë komunitetin LGBTI.

Institucioni i Avokatit të Popullit, do të vazhdojë aktivitetin e tij në drejtim të përmirësimit të situatës së zbatimit të masave të parashikuara për komunitetin LGBTI, të përfshira në Prioritetin 5, të Komisionit European për Shqipëri.

<sup>81</sup> Nr.dok.201501691 dt.09.11.2015 shkresë Drejtuar Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë. përgjigja dt.29.12.2015

<sup>82</sup> Nr.dok.201501691 dt 09.11.2015 Shkresë drejtuar Ministrise së Arsimit dhe Sportit, përgjigja dt.28.12.2015



## **KREU 5**

### **Roli promovues/proaktiv i Avokatit të Popullit në respektim të të drejtave të njeriut**

#### **5.1. Shërbimet ndaj qytetarëve nëpërmjet rritjes së rolit proaktiv të institucionit dhe funksionimit të zyrave rajonale**

Vizioni i Avokatit të Popullit i shprehur edhe në strategjinë 3-vjeçare të institucionit (2012-2015), e cila mbështetet dhe financohet në realizimin e saj nga Qeveria e Danimarkës, ka patur në fokusin e tij mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të qytetarëve, përmes kultivimit të një kulture të re dhe standardeve më të larta në ofrimin dhe cilësinë e shërbimeve, si dhe në rritjen e aksesit të qytetarëve për të adresuar në kohë ankesat e tyre, ndaj veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike, pranë institucionit të Avokatit të Popullit.

Që nga viti 2014 e në vijim, institucioni i Avokatit të Popullit e ka zgjeruar shtrirjen e tij me ngritjen e të 7 zyrave rajonale në shtatë qendrat më të mëdha administrative nga veriu në jug të vendit dhe konkretisht në bashkitë: Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Pogradec, Sarandë dhe Dropull. Ngritja dhe funksionimi i zyrave rajonale, është kontribut i një bashkëpunimi institucional të Avokatit të Popullit me drejtuesit e njësisë të qeverisjes vendore për sigurimin e zyrave, mbështetjen financiare të Qeverisë të Danimarkës për kompletimin e zyrave me të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme të punës, si dhe një bashkëpunim efikas me organizatat e shoqërisë civile, të cilat bënë të mundur sigurimin e personave që sot janë përfaqësues të Avokatit të Popullit në këto rajone, duke punuar me përkushtim ndaj kësaj detyre në mënyrë tërësisht vullnetare, pa asnjë lloj përfitimi financiar.

Zyrat rajonale me përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, janë pika të rëndësishme kontakti me qytetarët për marrjen e ankesave, por njëkohësisht prania e tyre në këto rajone ka ngushtuar distancën dhe ka afruar institucionin e Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve. Zyra rajonale e Dropullit është e një rëndësie dhe specifike të veçantë për Avokatin e Popullit. Në fokusin e saj, përfshihet marrja e ankesave dhe informacionit rreth problemeve që shqetësojnë popullsinë minoritare që jeton aty. Por njëkohësisht ajo është dhe një simbol i garantimit të të drejtave kushtetuese të minoriteteve në Shqipëri dhe prezencës të shtetit me mekanizma që ju vijnë sa më parë në ndihmë kësaj popullate.

Gjatë vitit 2015 me specialistët e pritjes të qytetarëve janë organizuar trajnime, seminare, si dhe pjesëmarrje në konferenca dhe vizita pune brenda dhe jashtë vendit, pasi forcimi i kapaciteteve të punonjësve në zyrën e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarëve dhe në zyrat rajonale, ka qenë dhe mbetet në fokusin e punës të Avokatit të Popullit. Këto aktivitete kanë ndikuar në ngritjen profesionale, rritjen e performancës, përmirësimin e etikës dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve, në forcimi i një komunikimi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm me qytetarët, për t'ju përgjigjur interesimit të tyre rreth objektit të ankesave dhe rrugët që duhet të ndjekin për zgjidhjen e të drejtës të pretenduar prej tyre.

Ngritja e zyrave rajonale ka sjellë prezencën e institucionit të Avokatit të Popullit më pranë qytetarëve, duke ju mundur informacione të nevojshme mbi rolin dhe funksionin e institucionit të Avokatit të Popullit, marrjen e ankesave dhe dërgimin në kohë për shqyrtim nga ekspertët sipas seksioneve, si dhe kthimin e përgjigjeve qytetarëve brenda një kohe të shkurtër dhe optimale.

Me qëllim që të bëhet e mundur vazhdimësia dhe qëndrueshmëria e këtyre zyrave rajonale edhe pas përfundimit të projektit danez, institucioni i Avokatit të Popullit ka kërkuar pranë Këshillit të Ministrave dhe ka marrë aprovimin, për parashikimin e një shpërblese monetare të caktuar për përfaqësuesit rajonal të Avokatit të Popullit, që ata të punojnë në këto zyra me kohë të pjeshme.

Në kushtet që ofron zhvillimi i teknologjisë dhe informacionit, Avokati i Popullit ka hapur gjithashtu dhe një sërë shërbimesh online në interes të qytetarëve që kanë mundësi akses

në internet, për të kryer plotësimin e ankesave “online”. Kështu në faqen zyrtare të Web-it të institucionit, tashmë funksionon Portali i veçantë “online”, ku qytetarët mund të bëjnë ankesat e tyre dhe në çdo kohë mund të kontrollojnë se kush nga ekspertët e institucionit e trajton ankesën, njihet me përgjigjet e institucioneve me të cilët lidhet objekti i ankesës, si dhe mund të marrin përgjigjen përfundimtare të ankesës. Aplikimi i ankesës online përmes Portalit, konsiderohet si një mundësi mjaft efektive për qytetarët dhe njëkohësisht kjo mënyrë rrit së tepërmi dhe transparencën e institucionit përballë qytetarëve. Gjatë vitit 2015 numri i ankesave nga portali nuk ka qenë shumë i lartë, pasi kjo është një praktikë e re dhe ende jo shumë e aplikueshme nga qytetarët.

Gjithashtu, një numër i konsiderueshëm i qytetarëve kanë adresuar ankesat e tyre edhe nëpërmjet adresave zyrtare të email-it, të Avokatit të Popullit, adresave zyrtare në rrjetin social Facebook, numrit të telefonit të publikut **0689034648**, i cili qëndron hapur gjatë 24 orëve, si dhe numrit jeshil **0800 1111**.

Në të gjitha rastet kur qytetari dërgon ankesën e tij online apo me telefon, specialistët e zyrës të pritjes bëjnë verifikimin e objektit të ankesave, identifikimin e të dhënave personale të ankuesit, si dhe adresat me kontaktet e tyre, me qëllim që ankesa të mos konsiderohet pa objekt dhe anonime. Këto alternativa konsiderohen si një mundësi për të marrë sa më shumë ankesa nga qytetarët, por njëkohësisht dhe si një mënyrë komunikimi me miqtë e Avokatit të Popullit, rreth temave dhe debateve në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut në vendin tonë.

Organizimin e “Ditëve të Hapura” nga Avokati i Popullit, komisionerët dhe stafi i institucionit, i kanë kthyer në një traditë të suksesshme në marrëdhëniet e institucionit të Avokatit të Popullit me qytetarët, me administratën dhe drejtuesit e qeverisjes vendore, si dhe me përfaqësuesit dhe rrjetin e shoqërisë civile në nivel lokal.

Në takime, qytetarët janë informuar mbi objektin e punës të Institucionit, është komunikuar me ta mbi rrugën e ndjekur për zgjidhjen e ankesave, si dhe janë pranuar për shqyrtim ankesat që kanë si objekt kundërshtimin e veprimeve dhe mosveprimeve të administratës publike. Më tej, trajtimi i ankesave i është nënshtruar një hetimi dhe ekspertizë më të gjërë nga ana e ndihmës/komisionerëve, duke konsideruar qytetarin jo vetëm një subjekt të së drejtës dhe detyrimet që ka administrata publike për plotësimin e tyre, por si janë zbatuar këto detyrime në raport me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e së drejtës.

Gjithashtu në kushtet e mungesës të informacionit, një pjesë e qytetarëve janë këshilluar dhe orientuar, për rrugët ligjore që duhet të ndjekin për të kërkuar dhe vendosur në vend të drejtën e pretenduar prej tyre.

Gjatë vitit 2015, aktiviteti “Ditët e Hapura” është zhvilluar në pjesën më të madhe të bashkive dhe njësive administrative të vendit, nga veriu në jug.

Konkretisht nga ana e zyrës së Avokatit të Popullit për vitin 2015, janë realizuar 35 aktivitete në Bashkitë dhe Njësitë administrative përkatëse, si: Vlorë, Kukës, Tropojë, Korçë (Prefektura), Bilisht, Pogradec, Lushnje, Fier, Korçë (Bashkia), Lazarat, Elbasan, Sarandë, Fushë-Arëz, Pukë, Rëshen (Mirditë), Ersekë (Kolonjë), Njësia Administrative Leskovik (Ersekë), Përmet, Këlcyrë, Bashkia Vau I Dejës, Koplík, Shkodër, Klos, Bulqizë, Peshkopi, Lezhë, Burel, Laç, Krujë, Delvinë, Finiq, Sarandë, Konispol, Selenicë, Himarë.

Në këto aktivitete është realizuar komunikimi i drejtëpërdrejtë me qytetarët e këtyre Bashkive edhe sipas ndarjes së re territoriale administrative, janë marrë ankesat dhe shqetësimet e tyre, të

cilat janë trajtuar nga ekspertët e zyrës së Avokatit të Popullit në këto aktivitete rast pas rasti individualisht, janë bërë përgjithësime shoqëruar me rekomandimet përkatëse drejtuar institucioneve përgjegjëse kompetente. Problematikat e shtrura nga qytetarët ju janë bërë prezent drejtuesve të njëjste vendore për t'i konsideruar në punën me administratat e tyre, si dhe kemi bërë sensibilizimin e shqetësimeve të qytetarëve në takimet me grupet e shoqërisë civile dhe median lokale. Gjithashtu në këto aktivitete janë kryer inspektime në shtëpitë e kujdesit për të moshuarit, në spitalet rajonale dhe qendra shëndetësore, në shkolla, kopshtet për fëmije, në Institucione të ndryshme të përkujdesit social ndaj fëmijëve jetimë, në komisaritet e policisë, etj. Gjatë këtyre aktiviteteve janë dhënë informacion, këshillime dhe orientim për zgjidhje ankesash, janë marrë për trajtim me shkrim gjithsej **583** ankesa të cilat më pas janë trajtuar individualisht sipas problematikës, theksojmë se edhe kur ankuesit na janë drejtuar me ankesa në grup i jemi përgjigjur secilit ankues individualisht. Për çdo problematikë të konstatuar janë bërë veprime shoqëruar me rekomandimet përkatëse, pasqyruar në tabelën përmbledhëse të rekomandimeve për vitin 2015.

Gjithashtu në vijim, në vitin 2016 është planifikuar dhe do të realizohen aktivitete të “Ditëve të Hapura” në 38 bashki të vendit, në përfundim të të cilave Avokati i Popullit do të përgatisë dhe dërgojë në Kuvend, një Raport të Veçantë mbi problematikën e konstatuar në të gjitha bashkitë në tërë territorin e vendit.

Për periudhën e vitit 2015, në zyrën e shërbimeve ndaj qytetarëve, zyrat rajonale dhe përmes mjeteve të tjera të komunikimit, atij postar dhe online, janë depozituar **4203** ankesa pranë institucionit të Avokatit të Popullit, nga të cilat **2735** ankesa kanë qenë pjesë e objektit të punës së institucionit të Avokatit të Popullit dhe janë cilësuar “brenda juridiksionit dhe kompetencës” dhe **1468** ankesa janë trajtuar në formën e “këshillimeve dhe orientimeve”, mbi rrugët ligjore që duhet të ndjekin qytetarët për trajtimin e mëtejshëm të ankesave dhe institucionet që duhet t'u drejtohen.

Për vitin 2015, situata e përgjithshme e ankesave të depozituara dhe të trajtuara nga institucioni i Avokatit të Popullit paraqitet si më poshtë:

- Ankesa pranë Zyrës së Shërbimeve ndaj Qytetarëve	-	<b>1476</b>
- Ankesa në rrugë postare`	-	<b>1554</b>
- Ankesa nga Ditët e Hapura	-	<b>424</b>
- Ankesa nga Zyrat Rajonale	-	<b>228</b>
- Ankesa online ( <i>Portali, e-mail dhe rrjete sociale</i> )	-	<b>346</b>
- Ankesa me telefon ( <i>telefon fix, mobil dhe numrin jeshil</i> )	-	<b>175</b>

Rol të rëndësishëm në mirëfunksionimin dhe ngritjen e cilësisë së punës të institucionit, ka luajtur Zyra e Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarit. Nisur nga përmbajtja e ankesave të prezantuara nga qytetarët, të cilat nuk janë objekt i punës të Avokatit të Popullit, specialistët ju kanë ofruar qytetarëve këshillimin ligjor, mbi rrugët që duhet të ndjekin për rivendosjen e së drejtës së pretenduar prej tyre.

Krahas detyrës për pritjen e qytetarëve dhe dhënien e informacionit të nevojshëm mbi procedurat e marrjes të ankesave, zyra e pritjes dhe shërbimeve ndaj qytetarit ka shërbyer dhe si një “filtër” për ndarjen e ankesave me objekt “brenda juridiksionit dhe kompetencës” dhe në “këshillime dhe orientime”, mbi bazën e kërkesave të ligjit për “Avokatin e Popullit”.

Numrin më të madh të ankesave të vlerësuara jashtë objektit të punës të Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2015 e përbëjnë ankesat e qytetarëve që kundërshtojnë vendimet e formës së prerë të gjykatave, si dhe vendimet e prokurorive për pushim të çështjeve të caktuara. Ndaj këtyre ankuesve, qytetarëve u është dhënë këshilla ligjore për të ndjekur shkallët e ankimimit sipas shkallëve të sistemit gjyqësor. Gjithashtu, në lidhje me ankesat me objekt kundërshtimin e

vendimeve për pushim të çështjeve në prokuroritë e rretheve gjyqësore, qytetarët janë këshilluar t'i drejtohen me ankesë dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Një grup i konsiderueshëm qytetarësh janë drejtuar tek Avokati i Popullit, me ankesa që kanë objekte të ndryshme si, për probleme punësimi, mos përfitim të tokës bujqësore, kundërshtim të vendimeve të marra nga ana e KMCAP-it rajonal dhe qendror, në lidhje me pagesat e aftësisë së kufizuar etj, ankesa këto për të cilat qytetarët janë këshilluar t'u drejtohen institucioneve përkatëse ligjzbatuese, apo t'u drejtohen edhe gjykatave në rastet kur e përmban dhe ligji.

Konflikti brenda familjes ngelet shqetësues për shoqërinë dhe shtetin shqiptar. Në rastet e këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar dhe orientuar të parandalojnë ngjarjet e rënda, duke bashkëpunuar ngushtësisht me organet e policisë dhe të prokurorisë dhe në rastet e konstatimit të vonesave dhe zvarritjeve nga ana e këtyre organeve, t'i drejtohen menjëherë Avokatit të Popullit për të ushtruar të drejtën e tij kushtetuese dhe ligjore. Në lidhje me ankesat për mbrojtjen e fëmijëve dhe të grave nga dhuna e ushtruar nga persona brenda dhe jashtë familjes, personat ankues janë këshilluar t'i drejtohen organeve të policisë dhe më tej gjykatës, për tu pajisur me urdhëra mbrojtjeje sipas ligjit.

## **5.2. Nxitja e të drejtave të njeriut në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Raporteve të Veçanta**

Institucioni i Avokatit të popullit gjatë vitit 2015 ka vijuar për sensibilizimi dhe ngritjen e çështjeve lidhur me të drejtat e njeriut, nëpërmjet raporteve të veçanta.

Gjatë vitit 2015, janë përgatitur disa raporte, ku disa prej tyre jo vetëm janë diskutuar me grupet e interesit, aktorët e shoqërisë civile dhe aktorët ndërkombëtare, por njëkohësisht janë depozituar në Kuvend.

### **1. Raporti i II i veçantë për “Administratën publike dhe Marrëdhëniet e Punës”**

Institucioni i Avokatit të Popullit me shkresën Nr. Prot 90 datë 26.03.2015, pas një procesi konsultimi me aktorë të shoqërisë civile dhe aktorët ndërkombëtare, ka depozituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Raportin e Veçantë (II) mbi “Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës”, i cili ende nuk është shqyrtuar.

Në kushtet kur reforma në administratën publike është shumë e rëndësishme, me qëllim jo vetëm krijimin e një administrate efçente por edhe për stabilitetin e punonjësve në shërbimin civil kemi gjykuar si të nevojshëm, hartimin në vijimësi të një raporti të dytë mbi Administratën Publike. Në këtë raport është pasqyruar një ndërthurje e të dhënave statistikore dhe problematikave të konstatuara gjatë trajtimit të ankesave të paraqitura pranë institucionit të Avokatit të Popullit, për periudhën Janar-Shtator 2014, si dhe çështjet kryesore objekt shqyrtimi të punës sonë, duke përfshirë punonjësit në marrëdhënie pune me kontratë pune dhe punonjësit pjesë e shërbimit civil. Gjithashtu, raporti paraqet të dhëna statistikore jo vetëm nga institucionet e Administratës Qendrore, institucioneve në varësi të tyre, por edhe nga Gjykatat Administrative të Rretheve Gjyqësore, si dhe ajo e Apelit, me qëllim krijimin e një panorame më të qartë mbi numrin e punonjësve të larguar nga puna për periudhën: Janar-Shtator 2014, motivacionet e largimeve nga puna, institucionet që kanë patur numrin më të madh të largimeve nga puna, apo edhe nxjerrjen e të dhënave mbi rastet e zgjidhjeve të marrëdhënieve të punës, të cilat janë bërë objekt shqyrtimi gjyqësor.

### **2. Raporti i veçantë për “Aktivitetin e MKPT-së”**

Në zbatim të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 27, të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe për rëndësinë e gjetjeve dhe

trajtimin me përparësi të tyre, përmes shkresës me Nr. 204 Prot., datë 21.10.2015, i'u dërgua Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Kryetarit të Kuvendit, Këshillit të Ministrave dhe Prokurorit të Përgjithshëm, Raporti i Veçantë Vjetor 2014, mbi aktivitetin e Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT). Në raportin voluminoz prej 287 faqesh paraqiten në detaje krahas të dhënave mbi funksionimin e MKPT-së, bashkëpunimet dhe përfaqësimet institucionale, përmbledhjet me gjetje për komisaritet e drejtoritë e qarqeve, institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, repartet ushtarake, qendrat rezidenciale, e spitalet psikiatrike në vend, si dhe raportet e detajuara të nisura në formë rekomandimesh mbi secilin institucion të inspektuar. Raporti ofronte mundësinë për të analizuar dhe vlerësuar progresin dhe sfidat e të drejtave të njeriut në institucionet e privimit nga liria, si dhe përpjekjet dhe punën që Avokati i Popullit ka realizuar në rolin e MKPT- së, për të mbrojtur dhe promovuar më tej të drejtat e njeriut në to.

### **3. Raporti i veçantë për “Të drejtën e pronës”**

Avokati i Popullit, nisur nga fakti se gjatë vitit 2015 ka patur në fokus të veçantë respektimin e së drejtës së pronës, si dhe në kuadër të ndryshimeve të ligjit nr.133, datë 05.12.2015, “*Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave*”, ka përgatitur dhe dorëzuar për shqyrtim pranë Kuvendit, një Raport të Veçantë.

Në këtë Raport të Veçantë dërguar Kuvendit në datën **19.11.2015**, janë evidentuar një sërë problematikash të konstatuara në vite, duke përfshirë analizën e legjislacionit, problematikat e ngritura për shkak të trajtimit të ankesave, praktika gjyqësore dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane e të Drejtave të Njeriut, si dhe rekomandimet dhe konkluzionet për adresimin e problematikës.

### **4. Raporti i veçantë për “Veprimtarinë e IKMT-së”**

Pranë institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë periudhës 01.09.2014, e deri më datë 31.05.2015, janë paraqitur një sërë ankesash individuale ndaj veprimtarisë së ish INUK-ut, sot Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në procesin e prishjes së ndërtimeve, për të cilat pronarët janë shpronësuar sipas akteve ligjore në fuqi, apo prishjes së ndërtimeve informale për të cilat subjekti posedues i ndërtimit ka aplikuar me vetëdeklarim, ose jo për legalizimin e tyre.

Nisur nga problematika e parashtruar në këto ankesa dhe të konstatimeve tona gjatë shqyrtimit të tyre, nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur një raport i veçantë mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator 2014 - Maj 2015. Ky raport analizon veprimtarinë e IKMT-së, konkretisht për ndërhyrjet e kryera në disa zona, si ajo e Selitës, Tiranë (*ku po zbatohet projekti i ndërtimit të unazës së re të qytetit*); zona e Udenishtit, Pogradec, (*ku po zbatohet projekti i rehabilitimit të segmentit rrugor Lin-Pogradec*), si dhe zona e segmentit rrugor Rrogozhinë – Lushnjë.

Ky raport i është dërguar Kuvendit, **në datën 22.12.2015**.

### **5. Raport i veçantë për “Aksesin e Furnizimit me Energji Elektrike për Konsumatorët e cënueshëm”**

Me shkresën nr.prot.284 datë 29.12.2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka depozituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, disa propozime mbi aksesin e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e cënueshëm, në formën e një raporti të veçantë.

Ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike, në muajin Janar 2015 u pasua me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, por kjo gjë në shumë raste është e pamjaftueshme për konsumatorët me të ardhura të pamjaftueshme, për të përballuar pagesën e saj. Duke gjykuar se, pavarësisht se ekzistojnë skema lehtësuese për pagesën e detyrimeve të prapambetura, apo garanci ligjore për të gjithë ata konsumatorë të cilët rezultojnë debitorë, mbrojtja sociale dhe ekonomike e grupeve të cënueshme nuk është e mjaftueshme dhe duhet të

konsiderohet prioritet, për shkak se familjet në nevojë ekstreme nuk arrijnë dot të sigurojnë mbijetesën dhe jo më të përballen me faturat për pagesat e shërbimet publike. Kjo duhet të shikohet e lidhur ngushtësisht edhe me gjetjen e mundësive për shmangien e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike për këto grupe.

#### **6. Raporti i veçantë për “Punën e fëmijëve”**

Në kuadrin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërinë civile, Avokati i Popullit ka bashkëpunuar me Save the Children, Zyra për Shqipërinë, për përgatitjen e një raporti të veçantë lidhur me shfrytëzimin e fëmijëve për punë në Shqipëri, i cili do të paraqitet në Kuvendin e Shqipërisë. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore të draft-raportit u paraqitën në Konferencën Kombëtare Vjetore të fund vitit 2015, si dhe në një forum të hapur me këtë temë organizuar nga Save the Children dhe instituti SEDA, ku ndër të tjera u promovua edhe veprimtaria e Avokatit të Popullit në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Qëllimi i këtij raporti është të evidentojë gjendjen aktuale të nivelit të punës së fëmijëve në Shqipëri, si dhe dhënien e rekomandimeve për reduktimin e këtij fenomeni. Kjo është në vazhdim të iniciativave të përbashkëta që, zyra e Avokatit të Popullit ka me Save the Children, për të evidentuar fenomenin e “punës së detyruar të fëmijëve”, si një nga shkeljet më të rënda të të drejtave njerëzore në Shqipëri, për të analizuar shkaqet dhe aspektet e ndryshme sociale të tij, për të shmangur paligjshmërinë e për të dhënë rekomandimet e përbashkëta si për parandalimin, ashtu dhe adresimin e punës së fëmijëve. Raporti do të depozitohet në periudhën në vijim.

#### **7. Raporti i veçantë nr. 2 për “Fenomenin e gjakmarrjes”**

Avokati i Popullit përgatiti Raportin e Veçantë Nr. 2, për fenomenin e gjakmarrjes. Në këtë raport janë pasqyruar, reagimi i institucionit të Avokatit të Popullit, lidhur me këtë fenomen dhe rekomandimet e bëra pas dërgimit në Kuvend, të Raportit të Veçantë nr. 1; konkluzionet dhe rekomandimet e Konferencës Kombëtare për gjakmarrjen, si dhe ato më pas; organizimi i disa aktiviteteve sensibilizuese për gjakmarrjen në Qarkun e Shkodrës gjatë vitit 2015; situata aktuale e fenomenit të gjakmarrjes në vend, në bazë të të dhënave zyrtare të administruara nga organet e Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë; azilkërkuesit shqiptarë në shtetet e zonës Schengen; mashtrimet me motivin e gjakmarrjes për të kërkuar azil në shtetet anëtare të BE-së dhe reagimi i strukturave ligjzbatuese shqiptare. Gjithashtu janë pasqyruar edhe disa konkluzione dhe rekomandime për parandalimin e fenomenit të gjakmarrjes në vendin tonë. Ky raport do të pasohet me një proces diskutimi gjatë vitit 2016 dhe më pas do të depozitohet në Kuvend.

#### **8. Raporti i II i veçantë për “Administratën publike dhe Marrëdhëniet e Punës”**

Institucioni i Avokatit të Popullit, në vazhdim të Raportit të II për Administratën publike ka përgatitur një Raport të III, për “Administratën Publike dhe Rregullimin e Marrëdhënieve të Punës”.

Në kushtet kur reforma në administratën publike qendrore dhe vendore është shumë e rëndësishme me qëllim jo vetëm krijimin e një administrate eficiente por, edhe për stabilitetin e punonjësve në shërbimin civil, kemi gjykuar si të nevojshëm hartimin në vijimësi të një raporti të tretë, mbi Administratën Publike. Në këtë raport janë përfshirë të gjitha infomacionet nga institucionet shtetërore për vitin 2015, duke ndërthurur problematikat e konstatuara nga ankesat dhe nga rastet e ndjekura me iniciativë me të dhënat statistikore.

Raporti në periudhën në vijim do të nënshtrohet një procesi konsultimi dhe më pas do të depozitohet në Kuvend.

### **9. Raporti “Zhvendosja e komunitetit Rom edhe Egjiptian të vendosur në zonën e Liqenit Artificial në Tiranë”**

Institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur një raport të veçantë për trajtimin e rastit me iniciativë, përsa i përket ndërhyrjes të ndërmarrë nga ana e Bashkisë Tiranë, për zhvendosjen e familjeve të komunitetit Rom/Egjiptian, të vendosura prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës. Emergjencia që paraqiste trajtimi i kësaj çështjeje, ka vijuar hetimin administrativ me kërkesën për shpjegime drejtuar, Bashkisë Tiranë, lidhur me masat që ishin marrë nga ky institucion për zgjidhjen e kësaj çështjeje,<sup>83</sup> disa bashkive të tjera në vend, Shërbimit Social Shtetëror, si dhe me kontakte në terren me familjet Rome/Egjiptiane dhe me organizata joqeveritare, apo me aktivistë romë.

Avokati i Popullit përmes qëndrimit të tij proaktiv konstaton se, ky është një rast i përsëritur që, përpos mungesës së një legjislacioni të nevojshëm specifik vendas, për trajtimin e rasteve të zhvendosjeve me dhunë, nxjerr nevojën imediate të implementimit të parimeve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare, që rregullojnë këtë çështje dhe që janë të detyrueshme për shtetin shqiptar. Të gjitha këto konstatime janë përmbledhur në një raport të veçantë, që do t'i dërgohet Kuvendit në vazhdim.

### **10. Raporti studimi mbi Shërbimin Shëndetësor në Shqipëri**

Duke vlerësuar të drejtën për kujdes shëndetësor, si një prej çështjeve më të rëndësishme të një shteti social, si dhe si një element të rëndësishëm të së drejtës që ka çdo individ për të jetuar i shëndetshëm, u hartua një raport në bashkëpunim me organizatën shqiptare jo-fitimprurëse “Partnerë për Fëmijët”, që ka për mision përmirësimin e jetës së fëmijëve përmes partneritetit me një rrjet partnerësh lokalë dhe ndërkombëtarë.

Është një studim gjithëpërfshirës dhe udhërrëfyes për të gjitha palët, në veçanti për ofruesit e shërbimeve shëndetësore në drejtim të vizionit të përcaktuar. Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në evidentimin e gjendjes së respektimit dhe zbatimit të ligjit, i cili reflekton respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në këto institucione, por dhe për vlerësimin e funksionimit të strukturës institucionale, të përshtatur me profesionalizëm, sipas standardeve të kërkuara në përputhje me ligjin, si dhe vlerësimin të kushteve infrastrukturore ekzistuese në ambientet e këtyre institucioneve. Të gjitha këto konstatime janë përmbledhur në një raport të veçantë, që do t'i dërgohet Kuvendit në vazhdim.

### **11. Studimi mbi Shërbimin Arsimor në Shqipëri**

Ky Raport është hartuar bashkë me organizatën “Partnerë për Fëmijët”, i cili ka qëllimin të përkrahë, të bashkërendisë, të rregullojë dhe të promovojë arsimim cilësor për të gjithë qytetarët. Arsimi shqiptar ka qenë njëbashkëudhëtar i denjë, që po ecën krah për krah me atë europian. Vëmendja jonë duhet drejtuar në problemet e rritjes dhe të zhvillimit, profesionalizmit të zhvillimit të arsimit dhe kulturës shqiptare me atë europiane. Problematikë e përvitshme dhe ende e pazgjidhur mbetet fenomeni i braktisjes së shkollës nga fëmijët e rrugës, fëmijët e ngujuar nga gjakmarrja, apo të tjerë që ndodhen në varfëri të skajshme. Të gjitha këto konstatime janë përmbledhur në një raport të veçantë, që do t'i dërgohet Kuvendit në vazhdim.

### **5.3. V ënia në lëvizje e Gjykatës Kushtetuese, nga Avokati i Popullit.**

---

<sup>83</sup> Kemi kërkuar të vihemi në dijeni të faktit nëse Bashkia Tiranë kishte kryer një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare dhe trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu, kemi kërkuar informacion edhe mbi mënyrën se si ishte menduar dhe se, si do të zgjidhej problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na vënë në dispozicion një kopje të njoftimit zyrtar që iu ishte komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku ato banonin, brenda afatit të shpallur 10 ditor.

Institucioni i Avokatit të Popullit, ka paraqitur në Gjykatën Kushtetuese, në datë 23.04.2015, një kërkesë për një çështje mjaft të rëndësishme, duke marrë shkas nga disa ankesa individuale. Nëpërmjet kësaj kërkesë, i kërkohej Gjykatës Kushtetuese që të shpallte si antikushtetuese ndryshimin e nenit 14, të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, me ligjin nr. 183/2014, në të cilën parashikohej se “...**Ankimi gjyqësor kundër vendimit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së territorit dhe atij të njësisë vendore nuk pezullon ekzekutimin e tij. Në rast se, në bazë të vendimit të formës së prerë të gjykatës, vendoset pranimi i padisë, i dëmtuari ka të drejtë të kërkojë nga inspektoriat që ka dhënë vendimin, dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar...**”

Në mendimin e Avokatit të Popullit, ky amendament, jo vetëm që përbën një regres të drejtash, por edhe shkel një sërë parimesh kushtetuese. Argumentat e ngritura në Gjykatën Kushtetuese se paragrafi i dytë, i nenit 17, të ligjit nr. 183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, shkel një sërë të drejtash dhe parimesh, si vijon:

### **1. Lidhur me të drejtën për jetën familjare dhe parimin e proporcionalitetit**

Në mënyrën se si është riformuluar Neni 14 (nga neni 17, i ligjit nr.183/2014), bën një kufizim të së drejtës për sigurinë e banesës dhe të ruajtjes nga dëbimet e detyrueshme, në kundërshtim me nenin 17, të Kushtetutës, si dhe duke shkelur mbrojtjen që garanton neni 8, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas jurisprudencës përkatëse të Gjykatës së Strasburgut.<sup>84</sup>

Heqja e mundësisë së pezullimit nga gjykata e zbatimit të aktit administrativ që passjell dëbimin (siç është vendimi për prishjen e banesës), heq mundësinë e individëve të prekur që të kërkojnë nga një gjykatë e paanshme, që të vlerësohet rast pas rasti, nëse jemi përpara kufizimit të së drejtës për strehim nga akti i administratës publike, (konkretisht nga vendimi i IKMT-së), duke marrë parasysh të gjitha detyrimet që shtetit i lindin në bazë të kërkesave të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Prishja e banesës sjell doemos dëbimin e individëve nga banesa përpara prishjes së saj dhe ky është një dëbim i detyrueshëm (me forcë). Nëse gjykatat nuk kanë mundësinë që të marrin në konsideratë faktin që paditësit rrezikojnë të mbeten të pastrehë dhe për këtë arsye ta konsiderojë këtë rrezik iminent, të rëndë dhe të pariparueshëm, në rastet kur individët mund të jenë në kushtet e pamundësisë financiare për të siguruar banesë alternative (me qira), atëherë në mënyrë efektive kemi shkeljen e nenit 8, të Konventës, përmes një ndërhyrjeje joproporcionale. Më i rëndë paraqitet rasti i grupeve vulnerabël, siç është komuniteti rom dhe egjiptian. Këto përcaktime bien ndesh me standardet e OKB-së mbi të drejtën e strehimit, në mënyrë të veçantë në situatën aktuale të strehimit të komunitetit rom dhe egjiptian.

### **2. Lidhur me parimin e sigurisë juridike**

Sipas këtij parimi, ligjvënësi nuk mund të përkeqësojë në mënyrë të paarsyeshme gjendjen ligjore të personave, të mohojë të drejtat e fituara, ose të shpërfillë interesat legjitime të tyre. Në rastin konkret ndryshimi i dispozitës përkeqëson situatën juridike të shtetasve, të cilët eventualisht preken nga një akt administrativ i IKMT-së, ose njësisë vendore. Konkretisht në nenin 14 të tekstit të mëparshëm të ligjit, ankimi administrativ pezullonte ekzekutimin e aktit, ndërsa nuk ndalohej shprehimisht pezullimi i tij në rastin e ankimit gjyqësor, duke bërë që dispozitat e zbatueshme drejtpërdrejtë, të ishin ato të Kodit të Procedurës Civile dhe ligjit nr. 49/2012, për sigurimin e padisë (përkatësisht nenet 324 e vijues përpara datës 04.11.2013, dhe nenet 29- vijues pas datës 04.11.2013).

<sup>84</sup> Referencë, çështja Yordanova dhe të Tjerët v. Bullgarisë dhe çështja, Connors v. Britanisë së Madhe, si dhe Vendimi nr. 1 dt. 06.02.2013 i Gjykatës Kushtetuese.



### **3. Lidhur me parimin e mosdiskriminimit**

Gjykata e Strasburgut në çështjen *Yordanova dhe të Tjerë v. Bullgarisë* (aplikimi nr. 25446/06, akt gjykimi i datës 24 prill 2012), konsideron se, duke mos marrë në konsideratë specifikat e kushteve të jetesës së romëve dhe zbatimin në mënyrë rigoroze të rregullave për legalizimin e objekteve të tyre, Bullgaria kishte diskriminuar tërthorazi familjet rome. Gjendja e tyre ndryshon me atë të bullgarëve etnikë në një masë të madhe për shkak të dështimit të shtetit për të zbatuar politika efektive për strehimin e romëve. Në mënyrë të ngjashme, ka pasur diskriminim për shkak të dështimit të autoriteteve për të marrë parasysh se familjet rome rrezikoheshin të dëboheshin dhe ato kishin dështuar për t'i gjetur një strehim alternativ për familjet e dëbuara.

Këto argumente janë të zbatueshme edhe në kontekstin shqiptar, pasi siç është konstatuar tashmë, familjet rome/egjiptiane përballen me një kërcënim veçanërisht akut të dëbimit, për shkak të dështimit të vazhdueshëm të autoriteteve shqiptare, të respektimit dhe mbrojtjes efektive dhe adekuate të së drejtës së tyre për strehim. Në këtë kontekst po trajtohet në Gjykatën e Strasburgut, çështja *Baku dhe të Tjerët v. Shqipërisë* (Aplikimi nr. 43928/13, komunikuar më 29 janar 2015).

### **4. Lidhur me cënimin e të drejtës për një ankim efektiv, për proces të rregullt ligjor, si dhe cënimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve**

E drejta për ankim efektiv, duke qenë esenciale për mirëfunksionimin e një sistemi demokratik, ka gjetur sanksionim edhe në Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut (neni 13). Gjykimi i veprimeve të administratës mund të preket nga vese të tilla si konflikti i interesave, mungesa e interesit për të pranuar një gabim të mëparshëm, mungesa e gadishmërisë për të paguar reparacione etj. Për të gjitha këto arsye, kontrolli gjyqësor i veprimtarisë administrative, duke qenë teorikisht i zhveshur nga veset që mund të karakterizojnë administratën dhe i fokusuar vetëm në aspektin e ligjshmërisë është i domosdoshëm, për garantimin maksimal të të drejtave të personave privatë, duke u dhënë palëve mundësi të barabarta përpara një gjykate të paanshme.

Fakti që ankimi gjyqësor sidoqoftë nuk pengohet, nuk është i mjaftueshëm për të parandaluar dhe aq më tepër, për të dëmshtëpërblyer një situatë të pakëndshme siç është ajo e krijuar nga pengesa për të mbrojtur sigurinë e banesës. E thënë ndryshe, ligji pranon ankimin gjyqësor, por pas krijimit eventual të dëmit, me idenë se në rast gabimi të administratës, qytetari do të dëmshtëpërblehet. Ndërsa pyetjet që nuk gjejnë adresim në ligj janë: Si mund të dëmshtëpërblehet një person, i rritur a i mitur qoftë, me aftësi të plotë apo të kufizuara, i cili mbetet pa strehë për shkak të ekzekutimit të aktit administrativ, deri në momentin që do të jetë ekzekutuar vendimi gjyqësor i formës së prerë dhe me anën e mjeteve financiare të fituara si dëmshtëpërblim, ankuesi do të arrijë të restaurojë banesën e tij, apo jo?

Në Vendimin nr. 32/2003, Gjykata Kushtetuese ka vënë theksin tek ndarja dhe balancimi ndërmjet pushteteve, duke konstatuar se kontrolli gjyqësor ndaj akteve me karakter administrativ është shprehje e parimit të kontrollit dhe balancimit të pushteteve, i cili qendron në themel të pavarësisë së organeve.

Nga ana tjetër është e vërtetë që Gjykata ka mundësi teorikisht të marrë masa pezullimi për sigurimin e padisë, (neni 29, i ligjit nr. 49/2012), por ky instrument procedural mbetet i paefektshëm për tre arsye:

**Së pari**, pezullimi i vendimeve të IKMT-së nëpërmjet procedurave gjyqësore është praktikisht i pamundur edhe për shkak se mundësia ligjore që të jep ligji nr. 49/2012, nëpërmjet kërkesave për marrjen e masave të përkohshme nga gjykata për pezullimin e akteve administrative, nuk është një mundësi reale dhe praktike. Kjo për shkak se gjykatat kanë efektivisht pak mundësi të pranojnë kërkesa të tilla për shkak të Vendimit Unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 10/2004, sipas të cilit nuk mund të merret masa e përkohshme e sigurimit të padisë, nëpërmjet pezullimit të aktit administrativ, kur objekt ankimi është vetë akti.

**Së dyti**, heqja e mundësisë së pezullimit të aktit administrativ me ligj (neni 14) me pretendimin se gjyqtari i ka të gjitha mundësitë që referuar Kodit të Procedurës Civile të marrë masën e sigurimit të padisë me pezullimin e aktit normativ, në dritën e Vendimit Unifikues të sipërpërmendur, mbart rrezikun e arbitraritetit gjatë zbatimit në praktikë. Për këtë arsye është e nevojshme që ligji të parashikojë mundësinë që individët, të cilëve u cënohen disa të drejta shumë delikate, siç janë të drejtat themelore të njeriut, nga zbatimi i dispozitës në fjalë, të kërkojnë nga gjykata sigurimin e padisë dhe pezullimin e zbatimit të aktit, dhe gjykata të ketë mundësinë ta pranojë këtë kërkesë kur bindet se është përpara një dëmi të rëndë dhe të riparueshëm, përfshirë këtu edhe rastin e shndërrimit të individit në të pastrehë, pa i'u siguruar më parë një strehim të përshtatshëm alternativ.

**Së treti**, në mbështetje të sa përmendëm më sipër, ka shembuj konkrete nga praktika gjyqësore që tregojnë se si një parashikim ligjor i ngjashëm me nenin 14, objekt gjykimi, mund të çojë në vendimarrje të diskutueshme të gjyqtarëve.

E drejta e pezullimit të aktit, objekt shqyrtimi gjyqësor, është një e drejtë që lidhet pazgjidhshmërisht me procesin e rregullt ligjor, parashikuar nga neni 42, i Kushtetutës dhe neni 6/1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Mënjanimi i pezullimit si një prerogativë e natyrshme e organeve gjyqësore në ushtrimin e pushtetit të tyre do të thotë, përveç cënimit të ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve, edhe pengim i realizimit të një procesi të rregullt në parametrat që kërkon dispozita e mësipërme kushtetuese, ashtu si dhe neni 6, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ashtu siç shprehet Gjykata Kushtetuese, në Vendimin nr. 32/2003:

*“Mënjanimi në mënyrë arbitrare i kësaj kompetence të organeve gjyqësore në shqyrtimin e ankimeve ndaj ligjshmërisë së akteve të administratës publike vështirëson, ose bën të pamundur efektivitetin e ankimit, kërkesë thelbësore që buron nga neni 13, i Konventës dhe nga neni 8, i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut.*

Me një vendim të shpallur në fund të muajit Nëntor 2015 (ende i pazbardhur), Gjykata Kushtetuese e ka rrëzuar këtë kërkesë të Avokatit të Popullit.

#### **5.4.Roli i institucionit të Avokatit të Popullit në dhënien e mendimeve dhe komenteve për draft-ligjet për vitin 2015 në mënyrë proaktive, ose me kërkesë të institucioneve përkatëse**

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015 ka ndjekur me vëmendje ndryshimet legislative në vend duke dhënë komentet dhe sugjerimet për draft- ligje të ndryshme sa herë është kërkuar nga institucionet ligjvënëse, ashtu si dhe me iniciativë të vetë institucionit.

Gjatë vitit 2015 janë dhënë gjithësej mendime dhe sugjerime për **28 draft-ligje nëpërmjet** shkresave ashtu si dhe pjesëmarrjes në seanca dëgjimore. Sa më poshtë disa nga projekt-ligjet më të rëndësishme për të cilat është dhënë mendim dhe sugjerime konkrete.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë sugjerime konkrete për **Kodin e Punës**, të cilat janë marrë në konsideratë dhe janë reflektuar nga Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe nga Kuvendi i Shqipërisë, me miratimin e tij në Dhjetor 2015. Institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar përfshirjen si shkaqe për diskriminim *“orientimin seksual dhe identitetin gjinor”*, si dhe vendosjen e një paragrafi të ri, në të cilin të përcaktohet se mbi cilën palë bie barra e provës, për rastet kur pretendohet se ka patur diskriminim mbi personin, duke parashikuar barrën e provës mbi punëdhënësin. Një sugjerim ka qënë edhe përfshirja në Kodin e Punës e *“shkeljeve disiplinore”*.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka sugjeruar përfshirjen në projektligjin e ri, të Kodit të Punës, në nenin 32, ngacmimin moral nga ana e punëdhënësit, sugjerim i marrë në konsideratë. “Ngacmimi moral” si përkufizim gjendet në një serë legjislacionesh të vendeve evropiane si një

garanci e punëmarrësve në vendin e tyre të punës. Duke rekomanduar gjithashtu përfshirjen e garantimit të sigurisë dhe të shëndetit mendor dhe fizik, përfshirjen e bilbilfryrësve, përcaktimin e barrës së provës punëdhënësit dhe garanci të tjera.

Mendime dhe sugjerime janë paraqitur jo vetëm me shkrim, por edhe si pjesë e tryezave të diskutimit për **Kodin e Procedurave Administrative**. Një ndër çështjet kryesore të ngritura nga institucioni i Avokatit të Popullit është edhe përshtatja dhe harmonizimi i dispozitave të Kodit të Procedurave Administrative me dispozitat e ligjit “Për Avokatin e Popullit”, lidhur me procedurat në hetimin administrativ. Kjo për të bërë të mundur proceduralisht, që të ketë efekt rasti i parashikuar në ligjin “Për Avokatin e Popullit”, për kërkesat për pezullim të akteve administrative, deri në shqyrtimin e rekomandimit të adresuar nga Avokati i Popullit.

Ligji **“Për shërbimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”**, ka pësuar gjithashtu ndryshime gjatë vitit 2015, për të cilat institucioni i Avokatit të Popullit i ka paraqitur sugjerimet dhe komentet e tij, Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë me kërkesë të kësaj të fundit. Është sugjeruar përfshirja e të gjitha grupeve të interesit në marrjen e shërbimeve shoqërore; lidhur me procedurat e pranimit në sistemin e shërbimeve; për bashkëpunim ndërinstytucional sipas fushave përkatëse sipas shërbimeve që do të ofrohen: lidhur me rolin e Inspektoriatit të Shërbimeve Sociale. Duke qenë se aktualisht funksionon Inspektoriat Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili është organi i specializuar i pushtetit ekzekutiv për mbrojtjen dhe zbatimin e përpiktë të legjislacionit të punës në fushën e marrëdhënieve të punës dhe të mbrojtjes sociale, nuk ka pse të krijohet një institucion i ri, por të fuqizohet më tej, duke u ngritur edhe Inspektoriate Rajonale. Gjithashtu, është sugjeruar përfshirja e mekanizmave të ankimit administrativ, pasi nuk janë parashikuar në ligj.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë mendime mbi projektligjin ***“Për një shtesë në Ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”***, dërguar Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, pranë Kuvendit të Shqipërisë. Në projekt-ligj është parashikuar se, “paga për efekt të llogaritjes së kontributeve si dhe kriteret e përcaktimit të saj, deri në nivelin e pagës maksimale, caktohen nga Këshilli i Ministrave”. Pra, në këtë dispozitë nuk është përcaktuar se cila është paga maksimale, por ajo do të caktohet nga Këshilli i Ministrave. Ndërkohë që në relacionin bashkangjitur, thuhet se: “Ndryshimi propozon që të vetpunësuarit, si profesion i lirë, do të paguajnë kontribut shoqëror në masën 23% të pagës maksimale 97030 lekësh”. Në këtë kontekst, gjykojmë se ka mospërputhje të relacionit me projektligjin e propozuar.

Mendime dhe sugjerime janë dhënë për projektligjin ***“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”***.

Sugjerimet kryesore kanë qenë kryesisht për fushën kompetenciale që i jepet Autoritetit për korrigjimin e çdo informacioni që rezulton i pasaktë, pas konstatimit nga vet Autoriteti, apo verifikimit me kërkesë të personit të interesuar; Kufizimin në përcaktimin e degëve në të cilat janë diplomuar kandidatët për anëtarë të autoritetit, si dhe sigurimin nga ana e tyre të garancisë së sigurisë, në përputhje me parashikimet e ligjit nr.8457 date 11.02.1999 “Për informacionin e klasifikuar “Sekret Shtetëror””; lidhur me mbarimin e mandatit; Rishikimin e dispozitës që detyron personat fizikë, apo juridikë privatë për vënien në dijeni të Autoritetit për zotërimin e dokumenteve të ish sigurimit të shtetit, apo të kopjeve a dublikatave të tyre; përcaktimin e afatit për kthimin e dokumentave të marra në shqyrtim nga ana e Autoritetit, harmonizimin e dispozitave në ligjin për informacionin e klasifikuar, etj.

Në muajin Prill 2015, Avokati i Popullit paraqiti mendimet e tij lidhur me ndryshimet në ligjin nr 69/2012 ***“Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”***, me qëllim

garantimin sa më të mirë të mbrojtjes ligjore të të drejtave të fëmijëve në kurrikulat mësimore. Sa më sipër i'u propozua Kuvendit të Shqipërisë, konkretisht Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ndryshimet perkatëse. Ndryshimet e propozuara nuk u reflektuan dhe nuk u morën parasysh nga ligjvënësi.

Gjatë vitit 2015 janë dhënë mendime edhe sugjerime për ndryshimet e **Kodit Zgjedhor të RSH-së**, me synimin e garantimit të barazisë gjinore (pra 50%) në mënyrë të plotë në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë; që në Këshillat e ardhshëm bashkiakë 50% të jenë gra, duke krijuar kështu akses të barabartë të grave dhe burrave për përfaqësimin në organet e qeverisjes vendore, si dhe shtimin në përmbajtjen e tij, *“të refuzimit të listës së partive politike në rastet kur nuk plotësojnë barazinë e plotë të përfaqësimit të gjinive”*.

Propozimet u paraqitën dhe në seancë dëgjimore në mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, në Kuvendin e Shqipërisë, në datën 31.03.2015, të cilat patën reflektim pjesërisht në ndryshimet e miratuara.

Avokati i Popullit ka dërguar mendime dhe sugjerime për disa ndryshime të **Kodit të Familjes dhe projektligjit “Për Procedurat e birësimit dhe Komitetin Shqiptar të Birësimit”**, të ndryshuar, në datën 06.11.2015, pranë Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, si dhe u dëgjua në seancë dëgjimore.

Sugjerimet konkrete lidhur me këto ndryshime kishin të bënin me përcaktimin e afateve për birësim si orientuese dhe jo detyruese, me qëllim që shtetet të bëjnë përpjekjet maksimale të dokumentuara për të realizuar birësim në vendin e origjinës. Në mendimin e institucionit të Avokatit të Popullit, arsimi i detyrueshëm i prindit birësues nuk duhet të jetë skualifikues, fakt i cili është reflektuar edhe në ndryshimet që u miratuan.

Me shkresën me Nr. 179/1 Prot. datë 09.10.2015, janë përcjellë pranë Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, komentet për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8328 datë 16.04.1998, *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, të ndryshuar”.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në përgjigje të shkresës së Ministrit të Drejtësisë, për pjesëmarrje në diskutimin e projekt- ligjit *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, ka dhënë mendime dhe sugjerimet e tij. Opinionet rreth parashikimeve të kryera në këtë projekt-ligj, institucioni i Avokatit të Popullit i ka drejtuar edhe në Komisionin e Çështjeve Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pranë Kuvendit, të dhëna këto publikisht edhe në seancën dëgjimore të realizuar në datë 20.11.2015, për këtë qëllim.

Institucioni i Avokatit të Popullit, nëpërmjet faqes zyrtare në internet të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë është vënë në dijeni edhe mbi diskutimet në komisionet parlamentare të projekt-ligjit të ri, *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*, miratuar tashmë me Ligjin Nr.139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”*. Avokati i Popullit dërgoi mendimet dhe komentet e tij, lidhur me rishikimin e kompetencave të njëjësive të qeverisjes vendore, buxhetit, vendimmarrjes, rolit të qytetarëve dhe shoqatave, etj, sugjerime të cilat nuk u morën në konsideratë nga Kuvendi.

Komente dhe sugjerime janë dhënë për **Kodin Penal**, lidhur me ndryshimet për veprat penale në fushën e doganave dhe tatimeve, për projekt- ligjin *“Për Këshillin Kombëtar të Shoqërisë civile”*, etj.

Janë dhënë mendime dhe sugjerime gjithashtu mbi Draft- Planin e Veprimit për personat me aftësi të kufizuar 2016-2020, Draft- Strategjisë për Strehimin, etj.

## 5.5. Forcimi dhe bashkëpunimi me median dhe median sociale; Revista e institucionit

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë gjithë vitit 2015 ka qenë mjaft aktiv dhe me një prezencë të gjerë në median e shkruar, atë vizive, si dhe portalet on-line. Kjo gjë ka garantuar përmbushjen e premtimit të Avokatit të Popullit, z. Igli Totozani, që me emërimin në këtë detyrë, se institucioni që drejton do të jetë gjithmonë transparent, i hapur dhe në shërbim të publikut.

Prezenca në media për problematika dhe aktivitete të institucionit ka shërbyer edhe në një tjetër drejtim: atë të njohjes së gjerë dhe integritetit publik të Avokatit të Popullit. Në këtë drejtim është punuar në ofrimin e mundësive për informacion të saktë dhe në kohë reale për publikun e gjerë, për persona që kanë paraqitur ankesa pranë institucionit, apo të tjerë të interesuar për sqarimin dhe informimin mbi të drejtat që u garanton ligji.

Fokusi i punës së përditshme me media ka qenë përcjellja e informacioneve të nevojshme, aktiviteteve të institucionit, e sidomos problematikave për gjetjen e zgjidhjeve, duke qenë sa më të arritshëm nga qytetarët, partnerët ndërkombëtarë, apo palët e tjera të interesuara.

Si synim prioritar gjatë prezantimit publik të problematikave të ndryshme të qytetarëve, apo grupimeve dhe kategorive të ndryshme, ka qenë tërheqja e vëmendjes së autoriteteve qendrore dhe vendore mbi domosdoshmërinë e përmirësimit të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Kjo punë e përbashkët me mediat ka sjellë rrjedhimisht forcimin e partneritetit mes Avokatit të Popullit dhe medimeve të të gjitha llojeve, të cilat realisht i konsiderojmë aleatë shumë të ngushtë.

Viti 2015 mund të vlerësohet si një nga periudhat me intensitetin më të lartë të trajtimit të çështjeve të të drejtave të njeriut në media.

Një vëmendje e posaçme në media i është kushtuar nga Avokati i Popullit trajtimi i çështjeve që lidhen me:

- Strehimin, punësimin, si dhe përmirësimin e kushteve të jetesës së komunitetit rom dhe egjiptian;
- Përmirësimi i kuadrit ligjor për pronat dhe kthimin e kompensimin e pronarëve legjitimë;
- Kujdesi dhe gjetja e zgjidhjeve afatgjata për strehimin dhe sistemimin e personave të pastrehë, të varfër dhe në nevojë;

- Vlerësimi i saktë dhe dëmshpërblimi real i personave të prekur nga përmytjet e njëpasnjëshme si në veri, ashtu edhe në jug të vendit;

- Trajtimi i fenomenit të gjakmarrjes dhe rekomandimet e njëpasnjëshme për këtë çështje, sidomos për garantimin e të drejtave të fëmijëve të ngujuar. Këtu përmendim edhe një donacion vullnetar të punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit, për disa fëmijë jetimë të ngujuar nga gjakmarrja në fshatin Mazrek të Shkodrës. Me fondet e mbledhura për këta fëmijë u blenë ushqime dhe veshje për të kaluar këtë dimër.

- Problemet e krijuara me politikat e gabuara penale janë trajtuar gjerësisht në media nga Avokati i Popullit, i cili ka kundërshtuar në vijimësi që familjet dhe personat që e kanë të pamundur të shlyejnë faturat e energjisë elektrike, pasi jetojnë vetëm me ndihmën ekonomike, nuk duhet kurrsesi të burgosen. Kjo politikë penale është kundërshtuar edhe për burgosjet e personave për ndërtime pa leje.

- Të drejtat e fëmijëve kanë qenë prezente në shumë qëndrime mediatike të Avokatit të Popullit, ku është insistuar për më shumë të drejta. Janë me dhjetra rastet e hetuara sidomos për mungesën e ngrohjes në shkolla, apo keqtrajtime të fëmijëve si dhe mungesë aksesit në shërbime të ndryshme. Këtë fundviti përmes një tjetër donacioni vullnetar nga stafi i institucionit u bë e mundur edhe organizimi i një feste me dhurata dhe ëmbëlsira për fëmijët e shtruar në Pediatri të Spitalit Universitar “Nënë Tereza” në Tiranë, me qëllimin për të krijuar një atmosferë festive edhe për ta.

- Të drejtat e grave, ato të personave LGBTI, problemet me pagesat e Personave me Aftësi të Kufizuara, të drejtat e minoriteteve, etj kanë qenë çështje të tjera të cilat kanë marrë rëndësinë e duhur për nga trajtimi në institucion në bashkëpunim të ngushtë me median.

Përmes intervistave të Avokatit të Popullit, z.Igli Totozani në televizionet kombëtare dhe ato lokale është synuar promovimi i të drejtave të grupeve vulnerabël, por edhe qartësimi i kompetencave të Avokatit të Popullit, si dhe mbrojtjes që ai u bën të drejtave, lirive, interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës.

Gjithashtu, për të shmangur keqkuptimet mbi mënyrën e funksionimit të Avokatit të Popullit, jemi përpjekur të ndërtojmë një imazh sa më të qartë të institucionit dhe natyrës së tij rekomanduese mbi çështje të ndryshme me karakter publik. Një gjë e tillë parandalon edhe pritshmëritë e gabuara publike.

Gjatë vitit 2015 Avokati i Popullit, z. Igli Totozani, ka qenë prezent në shumë studio televizive e emisione, si dhe ka realizuar shumë intervista për media brenda dhe jashtë vendit. Në funksion të krijimit të një institucioni transparent dhe tërësisht në mbrojtje dhe respekt të të drejtave dhe lirive të njeriut, komisionerë, ndihmës komisionerë dhe ekspertë të institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë gjithashtu të pranishëm në media mbi çështje dhe problematika të ndryshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit përpiqet që gjatë punës së tij, të jetë afër njerëzve, afër problemeve, jo vetëm si distancë morale, por edhe fizike. Disa vite më parë institucioni ynë hapi dyert në kuptimin e parë të kësaj fjale, për njerëzit që kishin nevojë për ndihmë, të udhëhequr nga vetëdija se në një vend si Shqipëria duhet shkuar përtej shpalljes së statistikave, apo deklaratave thjesht parimore

Me qëllim krijimin e një ure të re komunikimi, u mendua një mënyrë e re, një revistë, por edhe si parathënien e një kontrate të re bashkëpunimi mes institucionit dhe qytetarëve. Ideja e kësaj revistës, siç e dëshmon edhe përmbajtja e saj, nuk është thjesht një revistë ku flitet vetëm për institucionin tonë, por është një revistë e të gjithëve, e qytetarëve dhe për qytetarët, e punonjësve të Administratës Publike dhe për punonjësit e Administratës Publike, e shoqërisë civile dhe për shoqërinë civile. Pra publiku ka revistën e tij, ku mund të shprehë lirshëm opinionet e tij.

Në 12 numrat e botuar gjatë vitit 2015, çdo numër ka trajtuar një problematikë të lidhur ngushtë me të drejtat e njeriut dhe problemet që prekin qytetarët. Janë trajtuar tema si: 1) Rekomandimet pa përgjigje (për rëndësinë e të cilave nuk po ndalemi pasi kësaj problematike i është kushtuar një pikë e veçantë në këtë Raport vjetor); 2) Minimumi jetik (Shqipëria është ndër të paktat vende në Europë që nuk e ka të deklaruar Minimumin Jetik); 3) Dhuna ndaj grave (fenomen që ende vazhdon të regjistrojë viktima në Shqipëri); 4) Shërbimi spitalor (kushtet, mungesat dhe konkluzionet jo optimiste të një raporti të veçantë për këtë temë drejtuar Kuvendit); 5) Dhuna nga uniformat blu (ku veçohen 7 raste dhune në komisariate dhe jashtë tyre nga funksionarë të rëndësishëm të Policisë së Shtetit, për të cilët Avokati i Popullit ka kërkuar fillimin e procedimeve penale); 6) Problematikat e Azilkërkuësve (shkaqet që i shtyjnë shqiptarët të kërkojnë azil dhe masat që duhen marrë për parandalimin e këtij fenomeni); 7) Problematika e pronave; 8) Procesi i Lustracionit (rekomandimet për ndryshimin dhe miratimin e bazës së nevojshme ligjore); 9) Problematikat e nëpunësve civile të Administratës Publike dhe atyre të Pushtetit Vendor (veçanërisht largimet nga puna); 10) Të drejtat e njeriut për vitin 2015 (problematikat dhe aktiviteti i institucionit të Avokatit të Popullit në përmirësimin e kësaj gjendjeje); 11) Fenomeni i gjakmarrjes (bazuar mbi një raport të dytë mbi këtë fenomen dërguar Kuvendit); 12) Puna e fëmijëve në Shqipëri (përmirësimi i kuadrit ligjor dhe atij institucional në Shqipëri).

Revista e institucionit të Avokatit të Popullit ka një tirazh prej 1500 kopje, 1300 nga të cilat me anë të një agjensie shpërndarjeje dërgohen në të gjitha qytetet kryesore të Shqipërisë dhe qytetarët mund ta marrin falas në pikat e shpërndarjes së gazetave, por njëkohësisht i shpërndahet edhe organizmave të huaja për të drejtat e njeriut që veprojnë në vendin tonë, si dhe trupit diplomatik.

Botimi i kësaj reviste mundësohet falë ndihmës financiare që institucioni ynë përfiton në kuadër të projektit Danez.

Përprojekjet kryesore të stafit të institucionit është dhe do të vazhdojnë të jenë që kjo revistë të jetë një mjet sa më efikas për ruajtjen dhe forcimin e komunikimit me publikun.

## **5.6. Roli proaktiv dhe bashkëpunues i Avokatit të Popullit me organizatat jofitimprurëse**

Bashkëpunimi i Avokatit të Popullit me shoqërinë civile vazhdoi me të njëjtat ritme dhe cilësi edhe gjatë vitit 2015. Në këtë kontekst, Bordi Këshillimor për të Drejtat e Njeriut, i krijuar si një trupë konsultative-këshillimore që me marrjen e mandatit nga z. Igli Totozani, i siguroi Avokatit të Popullit konsulencë dhe këshilla për një numër çështjesh të rëndësishme që lidhen me të drejtat e njeriut, veçanërisht për grupet vulnerabël si romët, LGBTI, çështjet e pronësisë, etj.

Përgjatë vitit 2015, vlen të përmendet veçanërisht, puna e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom të vendosur në rrethinat e liqenit artificial të Tiranës, prej nga ku u zhvendosën nga Bashkia, nëpërmjet një aksioni të nisur në muajin shtator të vitit 2015. Përgjatë gjithë ditëve dhe javëve që pasuan, eksperët e Avokatit të Popullit ndoqën në terren situatën dhe hap pas hapi bënë përpjekje për dialog me autoritetet bashkiake në funksion të respektimit të shtetit ligjor dhe të drejtave të qytetarëve. Shoqëria civile iu bashkëngjiti këtij aksioni të Avokatit të Popullit që në thirrjen e parë. Shumë nga deklaratat publike mbanin firmën e organizatave të shoqërisë civile si Romët për Integrim, Respublika, Civil Rights Defenders, organizatat për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, etj., por edhe të një numri aktivistësh rom, kryesisht të rinj nga radhët e këtij komuniteti. Krahas Bashkisë së Tiranës, Avokati i Popullit vendosi lidhje edhe me bashkitë pritëse prej nga ku supozohej se kishin ardhur disa prej këtyre familjeve dhe ku do të riktheheshin, sipas burimeve të Bashkisë së Tiranës. Ende vazhdon puna për gjurmimin dhe situatën e re të këtyre familjeve. Vlen të thuhet, se në proces e sipër, Avokati i Popullit ka ofruar edhe rekomandimet përkatëse për hapat dhe masat e nevojshme ligjore. Po ashtu, ai ka mbajtur në korrent të situatës edhe komunitetin ndërkombëtar përmes dërgimit të materialeve informative, por edhe përmes mbledhjeve të përbashkëta me organizatat e shoqërisë civile.

Përgjatë vitit 2015, u përforcua në mënyrë të veçantë roli proaktiv i Avokatit të Popullit në bashkëpunimin me shoqërinë civile. Problematikat e ngritura nga përfaqësuesit e shoqërisë civile u janë bërë të njohura drejtuesve të njësive vendore për t'i trajtuar e zgjidhur në punën e tyre të përditshme. Kjo është bërë e mundur përmes një numëri trajnimesh për pushtetin lokal që Avokati i Popullit organizoi në një numër bashkish në të gjithë vendin. Në të njëjtën kohë dhe paralelisht është punuar edhe me median, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal, për ndërgjegjësimin sa më të gjerë si të publikut, edhe të vendim-marrësve dhe politikë-bërësve.

Një kontribut shumë të madh në zhvillimin e marrëdhënieve dhe ndihmën e ndërsjellë midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile në të gjithë vendin ka dhënë edhe projekti për forcimin e komunikimit të Avokatit të Popullit me njësitë e pushtetit vendor dhe organizatat e shoqërisë civile, financuar nga Programi DANIDA i Mbretërisë së Danimarkës. Vlen të përmendet që falë mbështetjes daneze, Avokati i Popullit në vitin 2015 arriti të kishte një revistë të tijën mujore për komunikimin e gjerë me qytetarët, shoqërinë civile dhe pushtetin lokal në të gjithë vendin. Kjo revistë është shpërndarë falas duke kontribuar më tej në njohjen e punës së institucionit nga qytetarët si dhe të veprimeve që Avokati i Popullit mund të ndërmarrë në të mirë së zgjidhjes së problemeve të tyre. Për botimin e kësaj reviste, institucioni ka ftuar pa asnjë dallim të gjitha organizatat e shoqërisë civile që të kontribuojnë me shkrime dhe artikuj duke u bërë pjesë e rritjes së nivelit të ndërgjegjësimit të publikut dhe forcimit të kulturës demokratike në vend. Që në krye, institucioni i Avokatit të Popullit e konceptoi këtë botim periodik si një urë komunikimi midis tij dhe qytetarëve, institucioneve shtetërore dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Gjatë vitit 2015, si pjesë e projektit të Mbretërisë së Danimarkës për forcimin e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit me shoqërinë civile, pushtetin lokal dhe median, u përmyll programi i granteve të vogla, në kuadër të të cilit institucioni zbatoi pesë projekte me disa nga OJF-të më të specializuara në vend të përzgjedhura nga një komitet seleksionues ndërkombëtar. Këto organizata zbatuan projektet e tyre në tre nga fushat kryesore në të cilat operon projekti dhe më konkretisht, a) pushteti vendor, b) burgjet dhe qendrat e paraburgimit, dhe c) shoqëria civile dhe media. Për realizimin e këtyre projekteve organizatat e përzgjedhura punuan ngushtësisht me institucionin e Avokatit të Popullit për një periudhë mbi një vjeçare. Një nga qëllimet e zbatimit të këtyre projekteve ishte forcimi i bashkëpunimit të institucionit të Avokatit të Popullit me organizatat e shoqërisë civile. Në përfundim të këtij programi u arrit të prodhohen materiale të ndryshme promovuese, botime, studime etj., si fletëpalosje me karakter informues dhe promovues, postera, një studim “Mbi sistemin shëndetësor në Shqipëri,” një studim “Mbi sistemin arsimor në Shqipëri,” disa manuale si “Të drejtat e personave LGBTI,” “Udhëzues për pushtetin vendor lidhur me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe të rinjve në qeverisjen vendore,” “Udhëzues për inspektimin e shërbimeve shoqërore në Shqipëri,” “Udhëzues për monitorimin e të drejtave të njeriut në institucionet shëndetësore,” një studim i legjislacionit shqiptar për shërbimet dhe sigurimin shëndetësor: “Udhëzues për Avokatin e Popullit lidhur me monitorimin dhe vlerësimin e standardeve të përkujdesjes sociale për personat me aftësi të kufizuara në strukturat publike rezidenciale dhe ditore në nivel qendror dhe vendor”, etj. Të gjitha këto materiale janë prezantuar në tryeza të rumbullakta si dhe janë ndarë me institucionet relevante.

Një pjesë e rëndësishme e bashkëveprimit të Avokatit të Popullit me organizatat e shoqërisë civile, u mishërua edhe në auditoriumet që u organizuan si në Tiranë, ashtu edhe në rrethe. Të konceptuara si platforma për dëgjimin e zërit të qytetarëve dhe shoqërisë civile, këto auditoriume u dhanë zë shqetësimeve më të mëdha në vend, si çështjeve të pronësisë, të dejtave të minoriteteve, çështjeve të varfërisë e minimumit jetik, hapjes së dosjeve, gjakmarrjes, aftësisë së kufizuar, por nuk munguan edhe çështjet e të drejtës mjedisore dhe çështjet me rezonancë për të ardhmen.

Në datë 17 dhjetor 2015, në përputhje me Ligjin e Avokatit të Popullit, institucioni organizoi konferencën e tij vjetore në të cilën u ftuan organizatat e shoqërisë civile, drejtuesit e zgjedhur rishtazi të pushtetit vendor, përfaqësues të trupit diplomatik dhe të organizatave ndërkombëtare në Tiranë, autoritete shtetërore, etj. Si objekt për konferencën u përgjodhën problemet e decentralizimit, të cilat u gjykuan veçanerisht të rëndësishme në kontekstin e reformës administrative dhe territoriale dhe sfidave me të cilat do të përballet pushteti lokal. Si dhe me çfarë mjetesh do të përballoheshin këto sfida, ishte boshti i diskutimeve të konferencës. Në këtë Konferencë, siç është bërë tashmë traditë, fjala do të ishte për aktorët dhe përfituesit e kësaj reforme, duke iu vënë në dispozicion një mundësi më tepër për të parashtruar opsionet dhe për t'u dhënë zë shqetësimeve të tyre.

Me mbështetjen e Projektit danez gjatë vitit 2015, u organizuan edhe tryeza të përbashkëta me përfaqësues të shoqërisë civile në qytete të ndryshme të vendit si në Tiranë, Gjirokastër, Sarandë, etj. Këto tryeza të përbashkëta i kanë shërbyer zhvillimit të marrëdhënieve dhe forcimit të komunikimit midis institucionit të Avokatit të Popullit dhe organizatave të shoqërisë civile.

Por çka është më e rëndësishme, është fakti se pjesa më e madhe e veprimeve të ndërmara me shoqërinë civile janë kurorëzuar me raporte të veçanta dërguar Kuvendit të Shqipërisë dhe rekomandime konkrete si për autoritetet e pushtetit lokal, ashtu edhe ato të pushtetit qendror përgjegjëse për problematikat përkatëse.

## **5.7. Aktivitete promovuese në kuadër të respektimit të të drejtave të njeriut**

Gjatë vitit 2015 institucioni i Avokatit të Popullit zhvilloi një veprimtari të ngjeshur me aktivitete promovuese në drejtim të ngritjes dhe adresimit të problemeve që shqetësojnë qytetarët në



përgjithësi dhe grupet e caktuara të interesit në veçanti. Një pjesë e madhe e këtyre aktiviteteve u mbështetën financiarisht nga Projekti Danez që po asiston institucionin që prej vitit 2012, në zbatim kjo edhe të planit vjetor të aktiviteteve të miratuar me vendim të Komitetit Drejtues të projektit<sup>85</sup>.

Më poshtë një përmbledhje e shkurtër e disa prej aktiviteteve e ndarë sipas tre komponentëve kryesorë:

Në kuadër të komponentit të pushtetit vendor, brenda vitit 2015 institucioni i Avokatit të Popullit organizoi me sukses **8 auditoriume** për disa nga temat më të rëndësishme që shqetësojnë qytetarët e vendit. Caktimi i temave u bë si rezultat i një analize të kujdesshme të institucionit sipas problematikave të konstatuara nga qytetarët, por edhe si rezultat i diskutimit me grupet e interesit, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, stafet akademike në vend në ambientet e të cilave u zhvilluan një pjesë e mirë e këtyre auditoriumeve, shoqërinë civile, etj. Këto tema u debatuan në diskutime të moderuara midis ekspertëve të fushave përkatëse me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të institucioneve të ndryshme shtetërore, shoqërisë civile, grupeve të interesit, studentëve dhe komunitetit. Në këto debate publike një kujdes i veçantë i është kushtuar dhënies së mundësisë publikut për t'u dëgjuar dhe për t'i bërë pyetje përfaqësuesve të institucioneve shtetërore të pranishëm në panel. Qëllimi i institucionit të Avokatit të Popullit ka qenë rritja e ndërgjegjësimit për shqetësimet që kanë qytetarët, identifikimi i zgjidhjeve dhe eksplorimi i mundësive për bashkëpunim dhe bashkërendim më të ngushtë midis strukturave përgjegjëse për adresimin e këtyre problemeve.

Institucioni i Avokatit të Popullit realizoi këto auditoriume përgjatë vitit 2015:

1. Respektimi i të drejtave dhe standardeve të personave të privuar nga liria, në bashkëpunim me Zyrën e OSBE, në Tiranë;
2. Gjakmarrja, organizuar në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së, në qytetin e Shkodrës;
3. Gjendja e të drejtave kolektive të minoriteteve në Shqipëri, organizuar në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së, në qytetin e Gjirokastrës;
4. Trajtimi i të kaluarës komuniste të Shqipërisë, organizuar në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së, në Tiranë;
5. Kur do të ketë Shqipëria një minimum jetik të deklaruar?, organizuar në bashkëpunim me Zyrën e OSBE-së, në Tiranë;
6. Të drejtat e komunitetit LGBTI në Shqipëri, organizuar me rrjetin e organizatave të shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e këtij komuniteti në vendin tonë, në Tiranë, ku panelisti i nderit në këtë auditorium ishte i dërguari i posaçëm i Departamentit Amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut të Personave LGBTI;
7. Investimet publike që shkojnë për realizimin e të drejtave të fëmijëve, organizuar në bashkëpunim me Save the Children, në Tiranë;
8. Zhvillimi ekonomik i vendit dhe harmonizimi me politikat mjedisore, organizuar në bashkëpunim me Zyrën e Qendrës Rajonale të Mjedisit (REC), në Tiranë.

Vlen të përmendet fakti se pas auditoriumeve përkatëse institucioni i Avokatit të Popullit ka dalë me propozime konkrete si dhe ka hartuar rekomandime lidhur me temat e diskutuara, si p.sh pas auditoriumit për të drejtat e personave LGBTI i është drejtuar rekomandim Ministrisë së Drejtësisë lidhur me ndryshimet në Kodin e Familjes sa i përket bashkëjetesës brenda të njëjtës gjini, ndryshime që janë miratuar, ose rikonfirmimi i gjetjeve të raportit të veçantë për minoritetet në auditoriumin me të njëjtën temë apo dhe propozime konkrete për krijimin e një strukture të përbashkët lokale në Shkodër kundër fenomenit të gjakmarrjes, krijimin e një bordi këshillimor me shoqatat mjedisore për këshillime të përbashkëta në fushën e mjedisit, etj.

Përgjatë vitit 2015, përfundoi **cikli i trajnimeve me përfaqësuesit e pushtetit vendor** në një pjesë të madhe të bashkive të vendit, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit në aspekte të ndryshme të të drejtave të njeriut si e drejta e pronës, e drejta për arsimim, e drejta për informim, grupet e

<sup>85</sup> Ref. paragrafi 8.5 i raportit

marxhinalizuara, e drejta mjedisore, mbrojtja e konsumatorit, ndihma ekonomike, juridiksioni dhe kompetencat e institucionit të Avokatit të Popullit, raporti i tij me pushtetin vendor, mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve prej organeve të administrates shtetërore në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore civile të formës së prerë, marrëdhëniet e punës në shërbimin civil, etj. Në total për vitin 2015 u realizuan 10 trajnime përkatësisht në bashkitë Gjirokastrë, Përmet, Burrel, Peshkopi, Krujë, Librazhd, Kavajë, Gramsh, Pukë, Ersekë, të cilat i bashkëngjiten 14 trajnimeve të tjera të zhvilluara në vitin 2014, duke e çuar në total në 24 numrin e trajnimeve dhe në rreth 750 numrin e punonjësve të trajnuar nga stafet e njëjësive vendore. Ekspertët e institucionit të Avokatit të Popullit përgjatë vitit 2015 realizuan edhe dy trajnime dy ditore me përfaqësues të zyrave rajonale në Tiranë dhe Shkodër me qëllim rritjen e performancës, përmirësimin e etikës dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve. U zhvillua një seminar për prezantimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të studimit “Monitorimi i aksesit të personave me aftësi të kufizuara në shërbimet publike në Shqipëri”.

Si pjesë e komponentit të burgjeve dhe qendrave të paraburgimit, Avokati i Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) në kuadër të Presidencës një vjeçare të Rrjetit të MKPT-ve të Europës Juglindore që mbajti në periudhën Tetor 2014 – Tetor 2015, organizoi në Tiranë dy workshope rajonale dhe një konferencë me grupin shëndetësor dhe të jurisprudencës, me qëllim rritjen e bashkëpunimit, shkëmbimin e eksperiencave dhe organizimin e aktiviteteve të tjera të përbashkëta për një përmbushje sa më të qenësishme të mandatit të MKPT-ve në rajon. Në secilin ëorkshop morrën pjesë rreth 22-24 ekspertë nga MKPT të ndryshme të rajonit. Institucioni i Avokatit të Popullit në bashkëpunim me OJF ka realizuar dy trajnime me rreth 60 punonjës të personelit të burgjeve dhe paraburgimeve në Vlorë dhe Kavajë. Qëllimi i këtyre trajnimeve ka qënë rritja e cilësisë dhe qasja interaktive për të ndryshuar mentalitetin e personelit në burgje dhe paraburgime për çështje të lidhura me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, shëndetin mendor, trajtimin e të paraburgosurve, mekanizmat mbikëqyrës si dhe shpjegimi i rolit dhe funksionit të institucionit të Avokatit të Popullit në Rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

*Në kuadër të komponentit të shoqërisë civile dhe medias, janë zhvilluar **tryeza të rrumbullakta me përfaqësues të shoqërisë civile dhe grupet e ndryshme të interesit** në qytete të ndryshme të vendit dhe problematikat janë ndjekur në vijimësi nga ekspertët e institucionit. Në bashkëpunim me përfaqësues të shoqërisë civile është organizuar konferenca vjetore e institucionit për pushtetin vendor dhe të drejtat e njeriut, me qëllim diskutimin me aktorë të tjerë të rëndësishëm të mundësive për ofrimin e një niveli sa më të lartë shërbimesh publike qytetarëve të vendit.*

Janë zhvilluar disa tryeza të rrumbullakta me përfaqësues të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë dhe mësues të shkollave 9-vjeçare lidhur me futjen e mjeteve të edukimit të të drejtave të njeriut në kurrikulat e sistemit shkollor parauniversitar.

Institucioni i Avokatit të Popullit filloi **një program intershipi për stafin e tij** duke dërguar një person që njeh gjuhën e vendit pritis për të punuar për një periudhë një mujore pranë një institucioni homolog (*internshipi i parë u realizua pranë Ombudsmanit Austriak, ndërsa i dyti pranë Ombudsmanit të Maltës*), me qëllim rritjen e kapaciteteve, lidhur me funksionimin institucional, trajtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve të pavaruara, hartimin e raporteve dhe rekomandimeve sipas praktikës më të mirë të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

Krahas aktiviteteve të mësipërme, janë mbështetur nga Projekti Danez edhe prodhimi i materialeve të ndryshme promovuese, ku një vend të rëndësishëm zë revista mujore e institucionit, inspektive si në qendrat penitenciare ashtu edhe ato rezidenciale që ofrojnë shërbime publike, është mbështetur dhe trajnuar stafi i institucionit nëpërmjet organizimit të vizitave studimore, organizimit të Ditëve të Hapura, pajisjeve të nevojshme për kryerjen e inspektiveve, librave për qendrën e informimit, etj.

## KREU 6

### Disa nga çështjet kryesore të veprimtarisë së Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015, në kuadër të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut

#### 6.1 Monitorimi i zgjedhjeve dhe rekomandimet përkatëse për kuotën gjinore

Në kuadër të zgjedhjeve vendore 2015, Avokatit të Popullit, ka ndërmarrë me iniciativë trajtimin e çështjeve lidhur me aksesin dhe lehtësinë e ushtrimit të së drejtës së votës. Çështjet e trajtuara kanë patur të bëjnë me, ushtrimin e së drejtës së votës të personave të moshuar në Shtëpitë e të Moshuarve në disa qarqe/rrethe të vendit; aksesit të personave me aftësi të kufizuar për të votuar, zbatimit të dispozitave të Kodit Zgjedhor që garantojnë barazinë gjinore, si dhe të respektimit të dispozitave ligjore që garantojnë afishimin dhe shpërndarjen e materialeve propagandistike gjatë fushatës zgjedhore. Veprimtaria e Avokatit të Popullit është fokusuar në analizën e dy periudhave, atë të *fushatës zgjedhore* dhe të *ditës së votimit*.

**Gjatë fushatës zgjedhore:** Avokati i Popullit, veç mesazhit publik për ushtrimin e lirshëm dhe të pakushtëzuar të së drejtës të votës, me anë të një letre të hapur ka sjellë në vëmendje të kandidatëve konkruues të zgjedhjeve vendore, problematikat mbi transparencën, luftën kundër korrupsionit, mirëqeverisjen, ndihmën ekonomike, programet sociale, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, problemet me bazë gjinore, strehimin, punësimin, kujdesin shëndetësor, kushtet për arsimim, moshën e tretë, dhunën në familje, minoritetin rom dhe komunitetin LGBTI, etj, që duheshin patur parasysh për përmirësimin e punës në organet qeverisëse që, kandidatët fitues do të drejtonin, apo merrnin pjesë si përfaqësues.

\*Avokati i Popullit i është drejtuar me anë të një rekomandimi, Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (për dijeni Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve), për marrjen e masave në mënyrë që, të gjitha Drejtoritë Arsimore në vend të mos lejonin pjesëmarrjen e nxënësve të arsimit 9 vjeçar, atij të mesëm, si dhe të personelit pedagogjik të tyre, në mitingjet, apo aktivitetet elektorale të forcave të ndryshme politike, gjatë orarit zyrtar.

\*Në datën 12.06.2015 me një rekomandim drejtuar Kryetarëve të Bashkive, Avokati i Popullit ka kërkuar zbatimin me rigorozitet nga ana e tyre të ligjit, për sa i takon afishimit të materialeve propagandistike. (Janë përgjigjur vetëm dy bashki).

\*Avokati i Popullit ka risjellë në vëmendje të KQZ-së, dispozitat e Kodit Zgjedhor, që garantojnë barazinë gjinore, si dhe nenin 108, që përcakton procedurat e votimit për zgjedhësit që nuk mund të votojnë, duke filluar që nga regjistrimi në listat e zgjedhësve, infrastruktura e përshtatshme për personat paraplegjikë e tetraplegjikë, si dhe për personat që nuk shikojnë. Në datat 4 dhe 5 Qershor 2015, grupe të Avokatit të Popullit kanë inspektuar qendrat e votimit në qytetet Kukës dhe Tropojë. I është dërguar edhe një kërkesë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, me qëllim garantimin e të drejtës për të votuar, të personave të cilëve iu është kufizuar liria fizike.

**Ditën e votimit:** datë 21 Qershor 2015, institucioni i Avokatit të Popullit, së bashku me Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit në qytetet Shkodër, Fier, Berat, Sarandë, Dropull, Kukës dhe Pogradec, ka qënë i hapur dhe në dispozicion të qytetarëve, gjatë gjithë orarit zyrtar të votimeve, nga ora 07:00-19:00.

Pas monitorimit të drejtpërdrejtë për respektimin e parashikimeve të bëra në nenin 108, të Kodit Zgjedhor, të 104 qendrave të votimit në Bashkinë Tiranë, si dhe të qendrave të caktuara të votimit në disa bashki të tjera, si në Kamëz, Fier, Gramsh, Ersekë, Korçë, Pogradec, Devoll, Krujë, Kukës, Tropojë etj, ka rezultuar se:

- infrastruktura e qendrave të vrojtuar të votimit ka qënë në pothuajse 60 % të rasteve, e papërshtatshme për akses të lehtësuar nga ana e personave PAK.

- në të gjitha qendrat e votimit të vrojtuar mungonte infrastruktura specifike, për akses të lehtësuar të qendrës së votimit nga ana e personave të verbër. Në shumë raste mungonin mjetet

e posacme për votimin në mënyrë të pavarur dhe të fshehtë të të verbërve. Edhe në rastet kur ato disponoheshin ishte problem evident lënia e shenjës së dallueshme të votimit, që mund të identifikonte subjektin për të cilin ishte votuar, nga ana e të verbërve.

Në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit, ka ndjekur procesin përgatitor dhe ka monitoruar procesin e votimit, në datë 21 Qershor 2015, në IEVP “Mine Peza”, Institucionin e Veçantë Shëndetësor të Burgjeve, IEVP “Ali Demi”, IEVP Durrës, IEVP Rrogozhinë, IEVP Peqin, IEVP Fier dhe IEVP Elbasan. Nga monitorimi rezultoi se:

- Nga ana e stafëve të IEVP-ve, nuk ka patur kuptim të qartë dhe janë vërejtur mangësi, në njohjen dhe zbatimin e kuadrit ligjor për zgjedhjet vendore.
- Ligji “Për gjendjen civile” neni 18, pika 1/b, pika 2 dhe pika 3, ku përcaktohet procedura e regjistrimit dhe e ç‘regjistrimit të vendbanimit në institucionet e vuajtjes së dënimit, rezultonte i pazbatuar. Për rrjedhojë janë konstatuar probleme në përgatitjen dhe shpalljen e listave të zgjedhësve, në përputhje me nenin 56, të Kodit Zgjedhor.
- Nuk është garantuar e drejta e votës për personat e paraburgosur dhe të dënuar, për shkak të mospasjes së ID-së, apo pashaportës, në momentin e votimit. Këto dokumente ndodheshin në dosjet e tyre personale në komisaritet e policive, në prokurori, apo edhe gjykatë.
- Qendrat e votimit kanë patur mangësi infrastrukurore për lehtësimin e aksesit në to, të personave të paraburgosur dhe të dënuar, me aftësi të kufizuara, si dhe nuk është zbatuar në çdo rast neni 108, i Kodit Zgjedhor në të cilin parashikohet procedura e votimit për zgjedhësit që, nuk mund të votojnë vetë. Sa i përket personave të paraburgosur e dënuar, të cilët janë deklaruar analfabetë, kishte parregullsi në procesin e mbajtjes së proces-verbaleve dhe të lejimit të personave për të zgjedhur në mënyrë të lirë personin që do të ndihmonte në proces.

Avokati i Popullit, nisur nga vizioni dhe detyrimi i shtetit shqiptar për të ndërmarrë hapa të shpejta për ndryshimin e sjelljes së publikut ndaj pjesëmarrjes së gruas në çështjet publike dhe përfaqësimit në organet e zgjedhura të pushtetit qendror dhe vendor, joefikasitetit të masave penalizuese ndaj partive politike të parashikuara në Kodin Zgjedhor, si dhe për garantimin e barazisë së shtetasve dhe krijimit të mundësive të barabarta të përfaqësimit e pjesëmarrjes përmes balancës gjinore, i ka rekomanduar në muajin Mars 2015, kryetarëve të grupeve parlamentare, në Kuvendin e Shqipërisë, ndërmarrjen e inisiativës legjislative për realizimin e ndryshimeve të nevojshme në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me synimin e:

- a- garantimit të barazisë gjinore (pra 50%) në mënyrë të plotë në përbërjen e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, me synimin që në zgjedhjet e ardhshme në Kuvendin e Shqipërisë të ketë një numër jo më pak se 70 gra deputete.
- b- garantimit që në këshillat e ardhshëm bashkiakë 50% të jenë gra, duke krijuar kështu akses të barabartë të grave dhe burrave për përfaqësimin në organet e qeverisjes vendore.
- c- shtimit në përmbajtjen e tij, “...*të refuzimit të listës së partive politike në rastet kur nuk plotësojnë barazinë e plotë të përfaqësimit të gjinive*”.

Ky rekomandim është pasqyruar pjesërisht, në ndryshimet më të fundit që i janë bërë Kodit Zgjedhor.

## 6.2 Çështja e Legjislacionit të pronave

Hartimi i një strategjie të re për arritjen e zgjidhjes përfundimtare të problemit të pronësisë në një afat sa më të shkurtër, mbetet prioritet për organet përkatëse të Administratës Publike. Edhe

pse ekziston një numër i konsiderueshëm dokumentesh strategjike, që përmendin në mënyrë të fragmentuar çështjet e pronësisë, nuk i është dhënë zgjidhje shteruese dhe gjithëpërfshirëse kësaj të drejte. Hartimi prej Këshillit të Ministrave, i Ligjit *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”*, si dhe miratimi i tij prej Kuvendit, me Ligjin nr.133, datë 05.12.2015, nuk jep zgjidhje të së drejtës të pronësisë në respektim të parimeve kushtetuese. Për këtë shkak, institucioni i Avokatit të Popullit ka prezantuar në seancën dëgjimore datë 20.11.2015, zhvilluar pranë Komisionit të Çështjeve Ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut, vërejtjet e tij rreth parashikimeve të Ligjit, i cili, sikurse dihet, nuk u dekretua prej Presidentit të Republikës.

Reforma ligjore e iniciuar prej Këshillit të Ministrave, lidhur me të drejtën e pronës, sikurse parashikuar në Ligjin nr.133, datë 05.12.2015, *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”*, gjykojmë se, nuk i jep zgjidhje 3 objektivave të vendosura në VKM nr.236, datë 23.04.2014, *“Për miratimin e plan veprimit për zbatimin e vendimit pilot të Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut “Manushaqe Puto dhe të tjerë kundër Shqipërisë”*, për shkak se, ky ligj, mbart parashikime të cilat nuk vijnë në përputhje me parime të Kushtetutës. Vërejtjet dhe sugjerimet e përgatitura prej Avokatit të Popullit ndaj ligjit të lartpërmendur kanë të bëjnë, me;

1. Ndryshimin e parashikimeve të cilat kufizojnë të drejtën e kërkimit për njohjen me të drejtë kthimi, apo kompesimi të pronës në një afat 60 ditor nga hyrja në fuqi e ligjit pranë Agjensisë së Kthimit dhe Kompesimit të Pronave (AKKP), si dhe pamundësin e rivendosjes në afat të së drejtës së kërkimit të njohjes së pronës pranë kësaj Agjensie. Kufizimi me ligj i së drejtës të kërkimit të njohjes me të drejtë kompesimi të pasurisë së paluajtshme pranë ATP-së, në një afat të caktuar, siç është parashikuar në projektligjin *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, neni 27/1, apo parashikimi i pamundësisë së zgjatjes si dhe rivendosjes në afat të kërkesës për njohjen e pronës në rrugë gjyqësore, bien ndesh me nenin 41,42 të Kushtetutes, si dhe parashikimit të nenit 113/b, të Kodit Civil. E drejta e kërkimit të njohjes së pronësisë do të ekzistojë edhe pas përfundimit të veprimtarisë së ATP-së. Kjo e drejtë si e paparashkrueshme, do të mund të ushtrohet nga ana e subjekteve të shpronësuar, me rastin e përfundimit të veprimtarisë së ATP-së, në rrugë gjyqësore. Në këtë kontekst, gjykojmë se në projektligjin *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompesimit të pronave”*, nuk duhet të gjejë pasqyrim vendosja e afateve për kërkimin e njohjes së pronësisë, apo pamundësisë të zgjatjes si dhe rivendosjes në afat të kërkesës për njohjen e pronës në rrugë gjyqësore, për shkak se, nuk vjen në përputhje me parimin e zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, sikurse sanksionuar në nenin 42, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Lidhur me këtë çështje, AKKP-ja në shkresën nr.18038/1 Prot, datë 30.06.2015, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shprehet se: *“Nga ekspertët e Këshillit të Europës, Bankës Botërore, është ngulmuar në heqjen përfundimisht të afatit të pranimit të kërkesave për njohjen, kthimin/kompesimin e pronës, por nga ana jonë është gjykuar si më efikase vendosja e afatit prekluziv”*. Efikasiteti i procesit nuk mund të justifikojë shkeljen e parimeve kushtetuese. Realiteti i sotëm, provon se ka interesim të shtuar e të vazhdueshëm prej subjekteve pronar rreth kërkimit të së drejtës së pronësisë, kështu që, nuk mund të flitet për rritje të efektivitetit me rastin e vendosjes së afateve të kërkimit të kësaj të drejte prej individëve pronarë.

- 2- Mosparashikimin e mundësisë së njohjes dhe kompesimit të pasurisë së luajtshme të konfiskuar subjekteve pronar, sikurse ka ndodhur me Ligjin Nr. 9235, datë 29.07.2004 *“Për kthimin dhe kompesimin e pronave”*.
- 3- Mosparashikimin e kthimit fizik, në natyrë të pronës, në rastet kur ajo përmbush kushtet

- për kthim fizik të saj, sikurse ka ndodhur dhe ndodh me ligjin në fuqi Nr.9235/2004.
- 4- Përkeqësimin e situatës juridike në procesin e shqyrtimit të kërkesave të administruara deri më sot prej AKKP-së, apo ekzekutimin e vendimeve të dhëna prej saj deri më sot.
  - 5- Ndryshimin e parashikimeve lidhur me vlerësimin e pronave, të cilat u janë njohur me të drejtë kompesimi subjekteve kërkuar.
  - 6- Ndryshimin e parashikimit lidhur me afatin e dërgimit për regjistrim të vendimeve të marra në vite prej AKKP-së, pranë zyrave vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.
  - 7- Ndryshimin e parashikimeve lidhur me kompetencat dhe përgjegjësitë e dhëna Agjencisë së Trajtimit të Pronave (ATP).
  - 8- Parashikimin e dëmit jashtëkontraktor që ju është bërë dhe ju bëhet subjekteve, të cilët kanë depozituar kërkesa pranë AKKP-së.

Përkundër dhënies së vlerësimeve për Ligjin nr.133, datë 05.12.2015, *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”*, Avokati i Popullit, ka përgatitur dhe dorëzuar për shqyrtim pranë Kuvendit, një Raport të Veçantë *“Mbi problematikat që lidhen me të drejtën e pronës”*. Në këtë Raport të Veçantë, dërguar Kuvendit në muajin Nëntor 2015, janë evidentuar një sërë problematikash të konstatuara në vite, për shmangien e të cilave janë dhënë një numër rekomandimesh sikurse pasqyruar në të, të cilat duhet të gjenin pasqyrim në Ligjin nr.133, datë 05.12.2015, *“Për trajtimin e pronës dhe përfundimin e procesit të kompensimit të pronave”*.

### **6.3 Çështja e Marinzës**

Lidhur me ngjarjen e fontanimit të pusit të naftës nr.5761, në shpim e sipër prej operatorit privat Shoqëria “Banker’s Petroleum” S.p.a, ndodhur më datë 01.04.2015, në vendburimin e naftës Patos-Marinëz, institucioni i Avokatit të Popullit ka iniciuar shqyrtimin e çështjes lidhur me mundësinë e cënimit të shëndetit, jetës, mjedisit, apo pasurisë së banorëve të Fshatit Marinëz, Fier, duke kushtuar vëmendje maksimale veprimtarisë së organeve të Administratës Publike, për rikthimin në normalitet të gjendjes së krijuar në këtë zonë.

Këtij qëllimi i ka shërbyer monitorimi i vazhdueshëm i situatës në terren, marrja e informacioneve përkatëse në vijimësi tek organet, të cilat kanë për detyrë matjen e shkallës së intoksikimit të ajrit, ujit dhe tokës përreth zonës ku ndodhi fontanimit.

Nisur nga garancitë e dhëna prej Kushtetutës, në nenet 15 dhe 21 të saj, ku thuhet se:

*“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik”.*

*2. Organet e pushtetit publik, në përmbushjen të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre”*

*“Jeta e personit mbrohet me ligj”*,

si dhe në nenin 2, të Konventës europiane të të drejtave të Njeriut, në të cilin parashikohet midis të tjerave se: *“E drejta e çdo njeriu për jetën mbrohet me ligj. ...”*,

Institucioni i Avokatit të Popullit, referuar situatës së konstatuar, të dhënave të administruara, i ka rekomanduar me shkresën datë 15.05.2015, Ministrit të Shëndetësisë, Ministrit të Mjedisit, Bujqësisë, Ministrit të Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, Ministrit të Energjisë dhe Industrisë, marrjen e një sërë masash, të cilat garantojnë eliminimin e pasojave, si dhe mosrrezikimin e shëndetit dhe jetës së banorëve në këtë zonë, deri edhe evakuimin e banorëve referuar analizave të kryera prej organeve shtetërore (deri më datë 16 Prill 2015), të vëna në dispozicion të Institucionit të Avokatit të Popullit.

### ***Gjithashtu i është rekomanduar organeve të lart përmendura;***

1. Mbajtja në kontroll të vazhdueshëm dhe sistematik të nivelit të ndotjes në vendburimin e Marinzës, në shkallë rajonale e më gjerë, nivelit të pastërtisë ekologjike të ajrit, ujrave, tokave, të kulturave bujqësore dhe produkteve blegtorale, duke zhvilluar në mënyrë periodike (ditore apo javore) analiza mikrobiologjike, fiziko-kimike dhe toksikologjike të detajuar, karakteristike për të gjitha substancat toksike në mjedisin naftëmbajtës të Marinzës, me qëllim garantimin e shëndetit, jetës dhe pasurisë së banorëve të zonës së Marinzës, Fier.
2. Kryerjen me përgjegjësi të kontrollit sistematik për ruajtjen në mënyrë permanente të nivelit higjeno-sanitar, kimik, në të gjithë zonën e vendburimit të naftës në Marinëz, në përputhje me normat ndërkombëtare.
3. Ruajtjen e nivelit të pastërtisë ekologjike të ajrit, ujrave, tokave dhe bimëve në të gjithë zonën, veçanërisht, kontrolli i ndotjeve të mjedisit nga derdhjet dhe rrjedhjet e naftës, ujrave të ndotura, mbeturinave të naftës, ose të gazeve toksike nga pusët e naftës, nga rezervuarët, tubacionet ose autobotet e naftës, nga detonacionet ose shpërthime me pasoja sizmike dhe akustike ndaj zonave të banuara.
4. Kryerjen e kontrollit shëndetësor të specializuar falas bashkë me ekzaminimet laboratorike mjekësore të nevojshme, për të gjithë banorët e Marinzës që janë ekspozuar ndaj mjedisit toksik(ajër, ujra, tokë, bimë), si dhe të nevojës për trajtime suplementare të personave me komplikacione eventuale deri në kurimin e tyre.
5. Marrjen e masave për moslejimin e konsumit të produkteve bujqësore dhe blegtorale të prodhuara në zonën e ekzpozuar nga ndotja me element toksik.
6. Marrjen e masave të cilat mundësojnë rehabilitimin e sipërfaqes së tokës të intoksikuar.
7. Marrjen e masave për furnizimin me ujë të pijshëm të banorëve të zonës së Marinzës, në mënyrë të pandërprerë.
8. Marrjen e masave të nevojshme në ndihmë të banorëve të Marinzës, që janë dëmtuar nga shpërthimet e pusit të naftës, për tu kompensuar në përputhje me vlerësimet e miratuara duke bërë edhe çvendosjen e atyre që ju është dëmtuar banesa me rrezik shëmbje si dhe për pasojë të rrëshqitjeve të shtresave të sipërme të tokës pas shpërthimit të pusit.
9. Marrjen e nismës për ngritjen e një komisioni ekspertësh shqiptarë prej Këshillit të Ministrave, nën kryesinë e një anëtari qeverie, për studimin e nevojës së shpërnguljeve të banorëve të fshatit Marinëz, Fier.

Në përgjigjet e dhëna të rekomandimit, Ministria e Shëndetësisë, konfirmon se ka udhëzuar strukturat në varësi për mundësimin e zbatimit të rekomandimeve të dhëna dhe se brenda datës 01.09.2015, do të mundësojë informimin e institucionit të Avokatit të Popullit. Deri më sot, ky informacion, nuk është dhënë ende.

Ministria e Mjedisit, konfirmon se, në zbatim të rekomandimeve të dhëna ka ngarkuar Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve për realizimin e inspektimeve në terren me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave të menjëhershme dhe afatgjata për uljen e nivelit të pasojave të ardhura nga fontanimi i pusit në shpim e sipër, pra, rikthimin e normalitetit mjedisor në këtë zonë. Gjithashtu, sipas Ministrisë së Mjedisit, është duke u hartuar një plan për rehabilitimin e kësaj zone, plan i cili pas përfundimit të hartimit të tij do të mundësojë njohjen e kostos dhe mënyrën e financimit për eliminimin e kësaj situatë të krijuar. Lidhur me rezultatet e planit të nisur Ministria e Mjedisit bën të ditur se do të informojë në një afat të pa përcaktuar.

Në dijeninë e institucionit të Avokatit të Popullit, është kryer prej Shoqërisë “Banker’s Petroleum” S.p.a., kompesimi në të holla i 42 familjeve, të cilat kanë pësuar dëme në pasurinë e tyre, si dhe ka marrë masa për rehabilitimin e sipërfaqeve të tokave të prekura nga intoksikimi. Duke i konsideruar qëndrimet e shprehura të organeve, rreth rekomandimit, të pamjaftueshme i është kërkuar Kryeministrit, me shkresën datë 03.08.2015, ushtrimi i autoritetit pranë organeve

në varësi, për mundësimin e marrjes së masave sikurse është rekomanduar prej institucionit të Avokatit të Popullit. Deri më sot nuk ka përgjigje rreth kësaj kërkesë.

#### **6.4 Çështja për shpërnguljen me forcë të komunitetit Rom**

Bazuar në informacionin e marrë nga artikuj të botuar në median e shkruar, por edhe nga kronika të transmetuara në median audio vizive, institucioni i Avokatit të Popullit, në përputhje me paragrafin e tretë, të nenit 13, të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka filluar shqyrtimin me inisiativë të ndërhyrjes që parashikohej të ndërmerrej nga ana e Bashkisë Tiranë, për zhvendosjen e familjeve të komunitetit rom/egjiptian, të vendosura prej disa vitesh në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës. Emergjencia që paraqiste trajtimi i kësaj çështjeje, ka vijuar hetimin administrativ me kërkesën për shpjegime drejtuar Bashkisë Tiranë, lidhur masat që ishin marrë nga ky institucion për zgjidhjen e kësaj çështjeje,<sup>86</sup> si dhe me kontakte në terren me familjet rome/egjiptiane dhe me organizata joqeveritare, apo me aktivistë romë. Nga të dhënat paraprake të marra në terren ka rezultuar se ishin rreth 50 familje rome/egjiptiane të vendosura në zonën pranë Liqenit Artificial, të Tiranës, që banonin afërsisht në po të njëjtin numër barakash. Ky komunitet përbëhej nga rreth 200 individë, mes të cilëve gra, fëmijë, pleq, të cilët kishin një periudhë prej rreth 5 vitesh që banonin në barakat që kishin ndërtuar vetë.

Për shkak të shpejtësisë së ndodhjes së ngjarjeve dhe trajtimit faktik që Bashkia Tiranë (në mungesë të dhënies së informacionit për ne si institucion) po i bënte kësaj çështjeje,<sup>87</sup> u konsiderua si një ndërhyrje e domosdoshme dhe urgjente dërgimi në datën 8.10.2015, titullarëve të Bashkisë Tiranë, ku theksohej se:

- Zhvendosja e komunitetit rom/egjiptian, po kryhej pa patur një akt administrativ bazë, produkt i një procedimi normal administrativ për organet e administratës publike, ku përfshihet edhe Bashkia Tiranë, duke cënuar kështu të drejtën për një proces të rregullt ligjor, ndaj pjestarëve të komunitetit rom/egjiptian, si dhe të drejtën e kundërshtimit të aktit zyrtar, në rrugë administrative, apo gjyqësore.
- Zhvendosja, apo dëbimi i paralajmëruar me forcë i këtyre familjeve përbënte një ngjarje të përsëritur për komunitetet e përkatësisë rome/egjiptiane, të vendosura në zona periferike, në qytetet më të mëdha të vendit. Ajo po kryhej në mungesë të një komunikimi dhe konsultimi të domosdoshëm, midis Bashkisë Tiranë dhe komunitetit të prekur, për përcaktimin e zgjidhjeve oportune.
- Bashkia Tiranë nuk dispononte një plan të mirëmenduar, të mbështetur në një njohje të plotë të tipologjisë së komunitetit, gjendjes të secilës prej familjeve, qoftë në aspektin e aksesit për një strehë të sigurt, aksesit në skemat e mbrojtjes sociale, gjendjen e tyre ekonomike dhe të pasojave që do të vuante secila prej tyre, në rast zhvendosjeje, nga zona e Liqenit Artificial të Tiranës. Zhvendosja e pastudiuar shkelte të drejtën për strehim, si dhe cënonte dhe të drejtën e komunitetit për jetën familjare, si dhe të drejtën për jetën.
- Zhvendosja (dëbimi me forcë) i këtij komuniteti, nuk po kryhej në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare të dëbimeve të detyrueshme; nuk po respektoheshin detyrimet e parashikuara në akte të rëndësishëm të OKB-së, Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut, si dhe në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

<sup>86</sup> Kemi kërkuar të vihemi në dijeni të faktit nëse Bashkia Tiranë kishte kryer një studim paraprak të gjendjes së këtyre familjeve, përbërjes së tyre, mundësive financiare dhe trajtimit të mundshëm me strehim. Gjithashtu, kemi kërkuar informacion edhe mbi mënyrën se si ishte menduar dhe se, si do të zgjidhej problemi i strehimit të këtyre familjeve nga ana e Bashkisë Tiranë, duke na vënë në dispozicion një kopje të njoftimit zyrtar që iu ishte komunikuar familjeve të sipërcituara, për largimin nga territori ku ato banonin, brenda afatit të shpallur 10 ditor.

<sup>87</sup> Në datë 07.10.2015, në shkelje të të gjitha parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të trajtimit të rasteve të dëbimit me forcë, u ushtrua presion për zhvendosjen e këtyre familjeve, nëpërmjet prezencës së një numri të madh punonjësish të Policisë Bashkiake, Tiranë, në zonën ku ndodhet ky komunitet.



Sa më sipër, i është rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Tiranë dhe Kryetarit të Këshillit Bashkiak, Tiranë, zgjidhja e situatës në përputhje me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të zbatueshme në vendin tonë, me qëllim që këtij komuniteti t'i ofroheshin zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjata, që synonin dukshëm përmirësimin e kushteve të jetesës së tij.

Pas rekomandimit dhe nga një trajtim tërësor që i është bërë çështjes në vazhdim, rezulton se alternativat e ofruara nga ana e Bashkisë Tiranë për vetë mungesën e koherencës së tyre, mungesën e bashkëpunimit real me Bashkitë Elbasan, Pogradec, Berat dhe Devoll, si dhe pamundësinë e trajtimit të familjeve të komunitetit, në Qendrën e Emergjencave Civile, në Tufinë, Tiranë, nuk ishin zgjidhje e problematikës së familjeve të komunitetit në fjalë. Problematikë tjetër në këtë çështje ka qenë situata e paqartë e pronësisë mbi truallin ku ishte vendosur ky komunitet, pasi Bashkia Tiranë pretendonte se kishim të bënim me truall shtetëror, ndërkohë që vet komuniteti dhe persona pretendentë si pronarë private, flisnin për truall në pronësi private. Avokati i Popullit është duke e verifikuar zyrtarisht këtë situatë, gjë që në rast konstatimi të pronësisë private, rëndon shkeljen ligjore të trajtimit të çështjes.

Sikurse rezulton pas zhvendosjes, gjendja e familjeve të komunitetit rom/egjiptian, që ishte vendosur dhe më pas dëbuar nga zona e Liqenit Artificial, në Tiranë, nuk është përmirësuar pas largimit nga kjo zonë, por është përkeqësuar. Rikthimi i disa familjeve afër së njëjtës zonë, shpërndarja e tyre në komunitetet e tjera rome, në Tiranë, si dhe mungesa e një plani konkret për përmirësimin e jetesës së tyre pas zhvendosjes, tregon se kjo ngjarje nuk zgjidhi problematikat shqetësuese të këtij komuniteti, por i rëndoi ato, duke krijuar një rreth vicioz përsëritës të problemit dhe moszgjidhjes së tij.

Avokati i Popullit përmes qëndrimit të tij proaktiv konstaton se ky është një rast i përsëritur që përpos mungesës së një legjislacioni të nevojshëm specifik vendas, për trajtimin e rasteve të zhvendosjeve me dhunë, nxjerr nevojën imediate të implementimit të parimeve dhe standardeve më të mira ndërkombëtare që rregullojnë këtë çështje dhe që janë të detyrueshme për shtetin shqiptar.

Të gjitha këto konstatime janë përmbledhur në një raport të veçantë që do t'i dërgohet Kuvendit, në një kohë të shpejtë nga ana e Avokatit të Popullit.

## **6.5 Çështja e strehimit të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian**

Institucioni i Avokatit të Popullit e ka trajtuar çështjen e strehimit, si një ndër çështjet më prioritare për të cilën jo vetëm ka përgatitur studime, raporte të veçanta drejtuar Kuvendit të RSH-së, por njëkohësisht u ka adresuar një sërë rekomandimesh institucioneve të pushtetit qendror dhe atij vendor, për përmirësimin e situatës. Veçanërisht sa i takon çështjes së konsiderimit të nevojave për strehim dhe ekzistencës si grup në pozita të pambrojtura të komuniteteve të minoritetit rom, apo komunitetit egjiptian në Shqipëri, theksojmë se sot, këto komunitete janë grupe vulnerabël dhe në risk. Sistemi ynë social, kuptuar këtu strehimin, regjistrimin në gjendjen civile, përfitimim e ndihmës ekonomike, arsimimin, punësimin, formimin profesional, kujdesin shëndetësor dhe çdo beneficë që ky sistem, ua siguron qytetarëve të vet, i pranon formalisht individët pjesëtarë të këtyre komuniteteve, por faktikisht i përjashton ata. Pra, barazia formale ekziston, por ajo nuk është kthyer në një barazi reale thelbësore për individët pjesëtarë të këtyre komuniteteve.

Së fundmi, në kuadër të Draft- Strategjisë Kombëtare të Strehimit, ku trajtohet gjerësisht problematika e strehimit në vend, kuptuar këtu gjendjen aktuale si dhe një koncept të dhënë për rrugët që duhet të ndiqen për përmirësim dhe adresimin e duhur të gjendjes së krijuar me strehimin në vend, referuar nevojave që konstatohen në disa nivele të popullsisë, me fokus të veçantë grupet në pozita të pambrojtura, institucioni i Avokatit të Popullit ka shprehur sugjerimet e tij.

Problematikë serioze mbetet çështja e ngritur me forcë prej disa vitesh nga ana e Avokatit të Popullit,<sup>88</sup> që ka të bëjë me nevojën për ndryshimet dhe përmirësimet e duhura, që duhet të pësojë ligji nr.9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane”, i ndryshuar, sa i takon garantimit, ndaj komuniteteve rome/egjiptiane që janë një grup vulnerabël dhe në risk, të barazisë thelbësore në trajtimin konkret të çështjes së strehimit. Ky konkluzion del direkt edhe nga analiza që i bëhet mënyrave të parashikuara shprehimisht me ligj, për trajtimin e këtyre komuniteteve me strehim, ku mënyra më e njohur e përdorur është ajo përmes “Granteve të vogla”, fakt që nuk zgjidh në thelb çështjen e strehimit të komuniteteve rome/egjiptiane.

Si pika kryesore të propozuara ndër të tjera nga Avokati i Popullit janë; plotësimi dhe qartësimi i pikës 2, të nenit 4, pikës 1, të nenit 6 dhe pikës 1, të nenit 19, të Ligjit 9232/2004, apo delegimin e rregullimit të çështjes së kufijve të të ardhurave me një akt nënligjor; në nenin 39/1, “Dispozita tranzitore”, të ligjit 9232/2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve në zonat urbane” (i ndryshuar), duke sugjeruar shtimin e përcaktimeve, të cilat do të rregullojnë strehimin e qytetarëve rom/egjiptian, brenda një periudhe pak më shumë se 4-vjeçare; parashikimi çdo vit nga njësitë e qeverisjes vendore në programet sociale të strehimit të tyre, që jo më pak se 5% e vendeve nga çdo program, të plotësohen nga familje të cilat deklarojnë se i përkasin komuniteteve rome/egjiptiane; familjet të cilat deklarojnë se i përkasin komuniteteve rome/egjiptiane, të konsiderohen si kategori prioritare për trajtim nga programet sociale të strehimit, për të gjitha kriteret e parashikuara në nenin 5 të ligjit, si dhe për përparësitë, apo pikëzimet e vendosura nga njësitë e qeverisjes vendore në zbatim të këtij ligji; përfitimin nga programi i banesave sociale me qera, brenda kuotës së parashikuar në pikën 6 të këtij neni, nga familjet që deklarojnë se i përkasin komuniteteve rome/egjiptiane, të cilat kanë të ardhura në nivelin e parashikuar në nenin 6 dhe 19, të ligjit; familjet të cilat deklarojnë se i përkasin minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian, përfitojnë subvencion sipas nenit 24 të ligjit, në masën 100% të vlerës së qirasë.

Një gjetje e mirë për trajtimin e duhur të komuniteteve rome dhe egjiptiane, është aplikimi i ndërthurur i modeleve aktuale të njohura në BE-së, për strehimin, përkatësisht modelin “Gjeneralist”, që si faktor kryesor në grupet e synuara merr të ardhurat që ato kanë, si dhe modelin “Rezidual”, që si faktor kryesor në grupet e synuara kap treguesit e pozitive të pambrojtura që çojnë në përjashtim por që duhet të gjej zbatim.

Po kështu, institucioni i Avokatit të Popullit ka sugjeruar se është i nevojshëm krijimi i skemave të ndryshme të strehimit, jo të lidhura ngushtësisht me kriterin financiar, pasi p.sh një familje që është në skemën e përfitimit të ndihmës ekonomike, apo një pensionist, sot e ka të pamundur të përfitojë nga programet sociale të strehimit që ofrohen, për shkak të mospërbushjes së kriterit ekonomik.

Në këtë kontekst trajtimi, është theksuar në vërejtjet dhe sugjerimet e Avokatit të Popullit se zhvillimi që mungonte në përmbajtjen e këtij dokumenti është rishikimi dhe përmirësimi i dispozitave ligjore në kuadër të diskriminimit pozitiv, për grupe, apo kategori të caktuara. Gjithashtu është theksuar se, duke e konsideruar në termat e një Strategjie “Mëmë”, është shumë i rëndësishëm, parashikimi sipas të cilit përcaktohet miratimi i strategjive specifike bazuar në nevojat për strehim të komuniteteve rome/ egjiptiane. Një pikë e veçantë në strategji duhet të lidhet me zbatimin e parimit të proporcionalitetit ku të mbahet parasysh pasoja e ndërhyrjes dhe rrezikut të lënies pa banesë të familjeve, masa konkrete për ofrimin e alternativave të strehimit që këto familje të mos mbeten në rrugë, me fokus të veçantë ndaj familjeve të komuniteteve

---

<sup>88</sup> Rekomandimi i dërguar nga ana e Avokatit të Popullit me shkresën nr.292 datë 29.10.2013, Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

rome/egjiptiane. Kjo problematikë është vërejtur sidomos në rastet e zhvendosjes së familjeve të këtyre komuniteteve, gjatë zbatimit të projekteve për ndërtimin e veprave publike.

Si një çështje e rëndësishme e kuadrit të masave për përmirësimin e jetesës së minoritetit rom dhe komunitetit egjiptian në vend, strehimi kërkon zgjidhje reale, të qëndrueshme, afatgjatë dhe në përputhje me parimet dhe standardet ndërkombëtare që trajtojnë këtë fushë, përkundër situatave të përsëritura të zhvendosjes me forcë nga vendbanimet të komuniteteve rome/egjiptiane, që janë evidentuar kohë pas kohe nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit.

## 6.6 Politika Penale

Gjatë muajve të parë të vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur me vëmendje veprimet e kryera nga Organet e Policisë së Shtetit lidhur me “Arrestime në flagrancë” të një numri të konsiderueshëm të shtetasve për arsye se dyshoheshin si autorë të veprave penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, të ndryshuar dhe të “Ndërtimit të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, të ndryshuar. Sipas raportimeve të bëra në media nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, numri i të arrestuarve në flagrancë nga ky organ çdo ditë në të gjithë vendin, vetëm për vjedhje të energjisë elektrike shkonte deri në 20 persona.

Ndërkohë nga inspektimet e kryera prej punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit u konstatua se, ambientet e sigurisë në Organet e Policisë së Shtetit dhe në IEVP-të në vend, sidomos ato të paraburgimit, ishin dhe janë të tejmbushur dhe pothuajse me dyfishin e kapacitetit të tyre me persona ndaj të cilëve, Policia Gjyqësore ka aplikuar “arrestin në flagrancë” dhe gjykatat kanë caktuar masën e sigurisë “arrest në burg”.

Gjithashtu u konstatua se, ambientet ku mbahen, ruhen e trajtohen këta persona nuk sigurojnë as kushtet dhe standardet minimale për jetesë të kësaj kategorie personash, të garantuara nga Konventat Ndërkombëtare dhe legjislacioni i brendshëm. Si të tilla mund të përmendim mungesën e hapësirës së nevojshme në dhomat e sigurisë dhe në qelitë, mungesën e krevatëve, të dyshekëve, mungesën e asistencës sociale, të kujdesit shëndetësor, të medikamenteve mjekësore, deri në cënimin e të drejtës për të dalë në ajrim, etj.

Për shkak të mbipopullimit, të mungesës së kapacitetit dhe të kushteve materiale minimale të ambienteve ku mbaheshin e trajtoheshin, personave të arrestuar dhe të paraburgosur po iu cënoheshin të drejtat ligjore.

Në një kohë që çdo person i paraburgosur, apo i dën timer i kushton shoqërisë tonë rreth 500 euro në muaj, për më tepër që arrestimi i një personi sjell pasoja sociale, ekonomike e psikologjike në familjen përkatëse dhe më gjerë në rrethin miqësor e shoqëror të tij.

Duke mbajtur në konsideratë kushtet dhe kriteret e caktimit të masave të sigurimit personal ndaj autorëve të dyshuar të veprave penale të parashikuara nga dipozitat e Kodit të Procedurës Penale, respektivisht nenet 228, 229, 230 dhe 230/1 të këtij kodi rezulton se, *arrestin në burg mund të vendoset vetëm kur çdo masë tjetër sigurimi është e papërshtatshme për shkak të rrezikshmërisë së veçantë të veprës dhe të pandehurit.*

Sipas gjykimit të Avokatit të Popullit, *rrezikshmëria shoqërore e këtyre dy veprave penale dhe e autorëve të tyre nuk është e lartë.* Ky fakt provohet edhe nga masa e dënimit të parashikuara nga dispozitat ligjore përkatëse respektivisht, deri në 3 vjet burg për veprën penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike” parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, dhe me gjobë, ose deri në 1 vit burg për paragrafin e parë të nenit 199/a të Kodit Penal për veprën penale të “Ndërtimit të paligjshëm”, si dhe deri në 5 vjet burg për paragrafin e dytë të po këtij neni.

Është me rëndësi të theksohet se, qëllimi i rëndësishëm është edhe shlyerja e detyrimit që kanë debitorët duke përfshirë edhe personat e akuzuar për kryerjen e veprës penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, ndërsa duke aplikuar masën e shtrëngimit “arrest në burg”, e vështirëson një gjë të tillë.

Ndërkohë gjykohet se, nuk duhet anashkaluar edhe fakti shumë i rëndësishëm që ka të bëjë me qëndrimin jo konsistent të shtetit ndaj këtij fenomeni gjatë viteve të fundit.

Është fakt i njohur publikisht se për shumë vite, ndonëse këto dy figura të veprave penale kanë qënë të përfshira në Kodin Penal, respektivisht vjedhja e energjisë elektrike qysh në vitin 2001, ndërsa ndërtimi i paligjshëm në vitin 2008, ato pothuajse nuk janë zbatuar nga organet kompetente shtetërore. Gjithashtu nuk janë të pakta rastet që herë pas here nga organet e shtetit është aplikuar falje për energjinë elektrike të pa paguar nga qytetarët abonentë.

Po kështu mund të thuhet edhe lidhur me ndërtimet e paligjshme, të cilat janë “nxitur” e “stimuluar” nga shteti nëpërmjet procesit të legalizimit, i cili megjithëse ka patur afate përfundimi, në fakt ai është shtyrë disa herë. Pra, institucione të ndryshme shtetërore me sjelljen dhe qëndrimin e mbajtur ndaj këtyre dy fenomeneve që përbëjnë vepra penale, në një farë mënyre kanë lejuar qytetarët të konsumojnë elementët e këtyre dy figurave të veprave penale në fjalë.

Ndodhur në këto rrethana është gjykuar nga Avokati i Popullit se, arrestimi në masë i autorëve të dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulseve telefonike” dhe për “Ndërtim të paligjshëm”, nuk është masë e drejtë dhe proporcionale.

Vendosja e masës së arrestimit në flagrancë ose ndalimit të autorëve të veprave penale nga Policia Gjyqësore, si dhe kërkesa e prokurorisë drejtuar gjykatës për caktimin e masës së sigurimit personal “arrest në burg”, duhet të aplikohet si rast përjashtimor dhe si masë e fundit për personat e dyshuar si autorë të kryerjes së veprave penale të cilat parashikojnë dënime të rënda penale. Kjo masë e fundit duhet të aplikohet në përshtatje me shkallën e nevojave të sigurimit, të jetë në raport me rëndësinë e faktit dhe me sanksionin që parashikon vepra penale, si dhe kur masat e tjera nuk janë të përshtatshme, për shkak të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj.

Për këto arsye ligjore i është adresuar nga ana institucionit të Avokatit të Popullit, një rekomandim Ministrit të Punëve të Brendshme, Drejtorit të Policisë së Shtetit, Prokurorit të Përgjithshëm, Ministrit të Drejtësisë, Këshillit të Lartë të Drejtësisë që, *ndaj autorëve të veprave penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike ose impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, të ndryshuar, dhe për “Ndërtim të paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, të ndryshuar, të aplikohet ndjekje penale në gjendje të lirë dhe masa sigurimi personal më të buta se sa “arrest në burg”.*<sup>89</sup>

Në lidhje me këtë rekomandim, nga Prokurori i Përgjithshëm, Ministri i Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë u informuam se e kanë vlerësuar, por ende nuk vihet re ndonjë masë lidhur me zbatueshmërinë e tij.

## **6.7 Çështjet të cënimit të të drejtave të personave të ndaluar, të paraburgosur dhe të dënuar**

Avokati i Popullit, në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, gjatë inspektimeve të kryera në vitin 2015, në Institucionet Penitenciare në vend, si dhe në ambientet e sigurisë të organeve të Policisë së Shtetit, ka konstatuar se:

- Në disa institucione paraburgimi si dhe në seksionet e paraburgimit të disa IEVP-ve të tjera, mbahen persona të cilët janë dënuar me vendim të formës së prerë nga gjykatat respektive.

<sup>89</sup> Rasti me nr. Doc. 201500495

- Në disa raste këta të dënuar janë të vendosur në të njëjtat dhoma me të paraburgosurit, e për rrjedhojë të gjitha aktivitetet i kryejnë bashkë në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 8328 datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.
- Në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit, mbahen dhe trajtohen të paraburgosur ndaj të cilëve gjykatat respektive kanë dhënë vendime për caktimin e masës së sigurisë “arrest me burg”, pasi nuk janë pranuar nga IEVP-të me justifikimin e mbipopullimit të ambienteve të tyre.
- Në disa prej ambienteve të sigurisë të organeve të policisë së shtetit, mbahen dhe trajtohen persona të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, me burgim në mungesë, për një periudhë 5-20 ditë, pasi nuk pranohen nga IEVP-të pa urdhër të veçantë të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve.

Për sa më sipër Avokati i Popullit më datë 03.09.2015 u rekomandoi institucioneve përgjegjëse marrjen e masave për zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, duke kryer:

1. Transferimin e menjëhershëm të të arrestuarve ndaj të cilëve është caktuar një masë sigurimi personal “arrest në burg” nga gjykata, si dhe të dënuarve me vendim gjyqësor të formës së prerë me burgim në mungesë, nga ambientet e sigurisë të organeve të Policisë së Shtetit, në seksionet përkatëse të IEVP-ve;
2. Transferimin e menjëhershëm të dënuarve me burgim, për të cilët vendimi gjyqësor ka marrë formë të prerë, nga seksionet e paraburgimit, në seksionet përkatëse të IEVP-ve ku trajtohen personat e dënuar.

Në përgjigje të rekomandimeve, institucionet u shprehën pranuese të konstatimeve dhe referuan sa më poshtë vijon:

- Prokuroria e Përgjithshme,<sup>90</sup> vlerëson se konstatimet e Avokatit të Popullit qëndrojnë. Këto konstatime janë shqetësime e probleme të ngritura edhe nga Prokurori pranë institucioneve përkatëse, gjatë procedurës së ekzekutimit të masave të sigurimit, apo të ekzekutimit të vendimeve penale. Në lidhje me rekomandimet e dhëna u janë komunikuar Prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së parë, Sektorit të Ekzekutimeve të Vendimeve Penale, që të ndërmarrin të gjithë veprimet procedurale dhe administrative, për të mos u bërë pengesë në transferimin e menjëhershëm të të arrestuarve dhe të dënuarve në seksionet përkatëse të IEVP-ve sipas akteve nënligjore në fuqi.
- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit,<sup>91</sup> bën me dije se me qëllim përmbushjen e detyrimeve ligjore për transferimin në IEVP të personave me masën e sigurisë “arrest me burg” dhe personave të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, është nënshkruar dhe është vënë në zbatim, Marrëveshja e bashkëpunimit midis D.B.Burgjeve dhe D.P.Shtetit me nr. 2157/1, datë 17.03.2015 dhe nr. 1054/1, datë 16.03.2015 “Për rritjen e sigurisë në IEVP, sigurimin e të burgosurve dhe të paraburgosurve që trajtohen me leje, respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria në ambientet e policisë dhe dokumentimin e veprimtarisë kriminale”. Zbatimi i detyrimeve reciproke të parashikuara në këtë akt ka bërë të mundur përmirësimin e gjendjes dhe situatës së mbipopullimit të ambienteve të dhomave të sigurisë në njësitë policore të D.P.Q, Tiranë, si rezultat i mos transferimit të menjëhershëm të të arrestuarve në IEVP, por jo në eliminimin e plotë të këtij fenomeni. Gjithashtu, është referuar nga DPPSH se, si rezultat i bashkëpunimit të vazhdueshëm me D.P. Burgjeve është shkurtuar koha e transferimit të personave të dënuar deri në disa ditë (2-7 ditë), kohë e cila ka të bëjë me rrugën zyrtare të dërgimit dhe mbërritjes

<sup>90</sup> Shkresë nr. 2767/1 Prot., datë 04.11.2015

<sup>91</sup> Shkresë nr. 76/2 Prot., datë 17.02.2015

në komisaritet e policisë të urdhrave të D.P. Burgjeve për caktimin e IEVP-së ku do të transferohet i dënuari.

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve,<sup>92</sup> bën me dije se referuar të dhënave të dërguara nga IEVP-të, numri total i të dënuarve të cilët kanë marrë vendim të formës së prerë, por që ndodhen ende në paraburgime është 49 persona, prej të cilëve ndodhen 3 persona në IEVP Lezhë, 2 në IEVP Vlorë, 7 në IEVP Rrogozhinë, 8 në IEVP Durrës, 1 në IEVP Sarandë, 8 në IEVP Berat, 2 në IEVP Vaqarr, 16 në IEVP Elbasan, 1 në IEVP Tropojë dhe 1 në IEVP Mine Peza. Sipas DPB-së, mos transferimi i personave të paraburgosur ka ardhur si rezultat i mos mbërritjes së urdhrat të ekzekutimit nga prokuroritë respektive.

Nga inspektimet që kanë pasuar rekomandimet e dhëna nga institucioni i Avokatit të Popullit dhe përgjigjet e marra nga institucionet përgjegjëse, është konstatuar se problematika ka vijuar të jetë e pranishme.

## **6.8 Çështjet e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT)**

Me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.183/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit”, (pas datës 6.02.2015), një nga organet kryesore për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme është Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, (ish Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar).

Ky inspektoriat është një organ i administratës publike, me kompetenca vendimmarrëse/ekzekutive, që nga vendosja e gjobave, pezullimi i punimeve të ndërtimit, e deri tek prishja e ndërtimeve të kundërligjshme.

Gjatë periudhës 01.09.2014, e deri më datë 31.05.2015, janë paraqitur ankesa individuale ndaj veprimtarisë së ish INUK-ut, sot Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në procesin e prishjes së ndërtimeve për të cilat pronarët janë shpronësuar sipas akteve ligjore në fuqi, apo prishjes së ndërtimeve informale për të cilat subjekti posedues i ndërtimit ka aplikuar me vetëdeklarim, ose jo për legalizimin e tyre. Nisur nga problematika e parashtruar në këto ankesa dhe të konstatimeve tona gjatë shqyrtimit të tyre, nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur një raport i veçantë mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator 2014 - Maj 2015. Ky raport analizon veprimtarinë e IKMT-së, konkretisht për disa zona si ajo e Selitës, Tiranë (ku po zbatohet projekti i ndërtimit të unazës së re të qytetit); zona e Udenishtit, Pogradec, (ku po zbatohet projekti i rehabilitimit të segmentit rrugor Lin-Pogradec), si dhe zona e segmentit rrugor Rrogozhinë – Lushnjë.

Nga një total prej 56 ankesash të shqyrtuara për aktivitetin e IKMT-së në zonat e sipërcituara, por bazuar edhe në shqyrtimin e ankesave të tjera individuale, që lidhen me veprimtarinë e këtij organi, janë arritur këto konkluzione:

- Janë konstatuar raste të përsëritura, kur ankuesit janë gjendur para situatës së cënimit të pronës së tyre, nga ndërhyrjet e ish INUK-ut, sot IKMT, pa u vënë në dijeni dhe pa patur paraprakisht një njoftim zyrtar, ose një akt vendimmarrjeje për ndërhyrjen që do të kryhej. Kjo gjë ka cënuar të drejtën e ankuesve për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor.
- IKMT-ja nuk ka zbatuar procedurat e detyrueshme ligjore të veprimit të tij kompetencial, edhe në rastet kur ka përligjur ndërhyrjen e tij, vetëm mbi bazën e vendimmarrjes paraprake, të një organi tjetër të ndryshëm nga ai. Në këto raste, IKMT-ja, shërben dhe duhet të shërbejë edhe si një filtër i ligjshmërisë së vendimmarrjeve paraprake të organeve të tjera, që kërkojnë angazhimin e tij, në kuadër të zbatimit të ligjshmërisë në fushën e inspektimit të ndërtimit. Çdo procedurë administrative që fillohet nga ana e IKMT-së nuk duhet dhe nuk mund të trajtohet thjesht si zbatim i një vendimmarrje paraprake nga një organ tjetër, që vepron në një

<sup>92</sup> Shkresë nr. 6136/1 Prot., datë 21.07.2015,

juridiksion të ngjashëm me atë të IKMT-së. Procedimet konkrete administrative që duhet të zhvillohen rast pas rasti nga IKMT-ja, nevojitet të kenë si një element të domosdoshëm hetimin aktiv nga ana e vet këtij organi, të rrethanave, provave, veçantisë së problematikës së paraqitur me qëllim që të parandalohen shkelje të ligjit.

- Në procesin e prishjes së ndërtimeve informale, rezulton se lidhur me këto ndërtime IKMT-ja, nuk ka marrë në konsideratë, si dhe nuk ka verifikuar procedurën e mundshme të aplikimit të kryer pranë organit të ALUIZNI-t, për legalizimin e objekteve në të cilat ka ndërhyrë. Ky mosveprim bie ndesh me parashikimin e kryer në nenin 23/1, të Kodit të Procedurave Administrative.
- IKMT-ja ka dështuar në shumicën e rasteve të shqyrtuara nga AP, në zhvillimin e një procedimi të rregullt dhe të ligjshëm administrativ, sikurse ka patur mungesë bashkëpunimi dhe harmonizimi të veprimtarisë me organe të tjera që veprojnë në fushën e urbanistikës, siç edhe ALUIZNI.
- Është konstatuar mungesë transparence në veprimtarinë e këtij organi, i referuar shpesh nga ankuesit në ankesat e tyre, por edhe i evidentuar edhe gjatë veprimtarisë sonë institucionale.
- Dëmi financiar i shkaktuar nga ana e IKMT-së, edhe në prishjen e objekteve të ndërtuara me leje që, paraprakisht janë përfshirë në procesin e shpronësimit për interes publik, si dhe të atyre të përfshirë në procesin e legalzimit dhe për të cilët nuk ka patur ende vendimmarrje nga ana e ALUIZNI-t, pa respektuar procedurat ligjore përkatëse, përbën kosto shtesë që në mënyrë të kundërligjshme i shtohet detyrimeve që shteti duhet t'u paguaj në këto raste subjekteve të dëmtuara.
- Punonjësit e IKMT-së në kryerjen e funksioneve publike, me mosveprimet dhe veprimet e tyre të kundërligjshme, të cilat përbëjnë mospërmbushje të rregullt të detyrës kanë dëmtuar interesat e ligjshme të shtetasve, duke konsumuar vepra penale.

Raporti i Veçantë mbi veprimtarinë e IKMT-së, për periudhën Shtator 2014 – Maj 2015, i është dëgjuar Kuvendit, në datën 22.12.2015.

### **6.9 Largimet nga Administrata publike, në qverisjen vendore dhe qendrore, testimi, etj**

Largimet nga puna për Administratën Publike të përkthyer në shifra si përmbledhje e të dhënave që kemi grumbulluar nga 14 ministri dhe institucionet e varësisë së tyre, në tre Raporte të Veçanta "Mbi Administratën Publike dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës", për periudhën **Shtator 2013- Maj 2015, rezulton se ka një numër total prej 4093 punonjësish të larguar nga Administrata Publike.**

Nga numri i punonjësve të larguar, rezulton se 1021 gëzojnë statusin e nëpunësit civil, ndërkohë që pjesa tjetër prej 3072 janë punonjës të cilët trajtohen sipas dispozitave të Kodit të Punës. Nga numri total i punonjësve të larguar, rezulton se 1314 punonjës janë larguar nga puna në mënyrë të menjëhershme si pasojë e ristrukturimeve të institucioneve. 200 punonjës rezultojnë të larguar nga puna me dorëheqje, kryesisht bëhet fjalë për pozicionet e politike (pjesë e stafeve politike). Ndërkohë që 1000 punonjës, prej të cilëve 597 me Kod Pune dhe 403 Nëpunës Civil, janë larguar nga puna me masa disiplinore.

Në periudhën Janar- Shtator 2014, konstatohet se Ministria e Mjedisit ka patur edhe numrin më të madh të punonjësve të larguar nga puna si pasojë e ristrukturimit kryesisht të Drejtorive të Shërbimit Pyjor, duke raportuar një numër total prej 571 punonjësish për gjithë institucionet e varësisë të cilët janë larguar për shkak të suprimimit të vendeve të punës, ndërkohë që për periudhën Shtator 2014-Maj 2015, konstatohet se Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ka patur edhe numrin më të madh të personave të larguar nga puna për shkak të masave disiplinore, me një numër total 254 punonjësish, prej të cilëve 141 nëpunës civil dhe 113 punonjës me Kod Pune.

Lidhur me të dhënat e përcjella nga gjykatat administrative dhe ajo e apelit administrativ për periudhën Shtator 2013- Maj 2015 rezulton se ka në total 3506 kërkesë-padi, të depozituara në gjykatat administrative, numër në të cilën janë të paevidentuara kërkesë-paditë në disa gjykata, të cilat nuk kanë kthyer përgjigje pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Si dhe në periudhën Shtator 2014-Maj 2015, rezulton se janë marrë 762 vendime për dëmshpërblime financiare për largime të padrejta nga puna dhe 23 vendime për rikthim në punë të nëpunësve të larguar.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka ndjekur procedurën **për testimin e mjekëve dhe infermierëve në të gjithë sistemin shëndetësor në Shqipëri**. Në gjykim të Avokatit të Popullit ky testim është në kundërshtim me ligjin, për shkak se:

- Referuar paketës ligjore për rregullimin e marrëdhënieve të punës dhe profesionit të mjekëve, ekziston ligji Nr.123/2014 “*Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë*”, dhe specifikisht për këtë rast neni 3, e në vijim.
- Institucioni i Avokatit të Popullit, është shprehur se nuk është testimi mënyra e vetme për fotografimin dhe identifikimin e nevojave dhe problematikave që ka sot sistemi shëndetësor. Të gjithë drejtuesit e qendrave shëndetësore dhe spitalore, kanë për detyrë pikërisht menaxhimin e burimeve njerëzore, identifikimin e problematikave dhe referimin e tyre në instancat përkatëse, të cilat më pas duhet të kundërveprojnë me trajnime apo edukime në vazhdim, si mënyra e vetme e ngritjes profesionale të mjekëve apo infermierëve.
- Gjithashtu përjashtimi nga testimi vetëm i pedagogëve të mjekësisë është abuziv pasi ligji Nr.10107/2009 “*Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë*”, nuk përcaktonte përjashtime për edukimin e vazhdueshëm profesional për asnjë kategori mjekësh.
- Procese të tilla konkurimi janë të kundraligjshëm dhe në shkelje të të drejtave të njeriut si dhe bien ndesh edhe me një ndër parimet kryesore sikundër është ai i “*sigurisë juridike*”. Parim i cili nënkupton, besueshmërinë e qytetarëve tek shteti dhe pandryshueshmërinë e ligjit për marrëdhëniet e rregulluara.

**Lidhur me reformën për testimin e mësuesve**, institucioni i Avokatit të Popullit ka depozituar mendime dhe sugjerime pranë Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në Kuvendi e Republikës së Shqipërisë.

Nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit duhet të gjenden rrugë të efektshme dhe ligjore për zhvillimin profesional të mësuesve, në bashkëpunim të ngushtë me sindikatat e mësuesve, të cilat operojnë me statusin e partnerit social, me qëllimin e vetëm: ofrimin nga çdo institucion arsimor të një mësimdhënieje cilësore për të gjithë nxënësit ku ata mësojnë dhe jetojnë, si rruga e vetme drejt një të ardhmeje europiane.

Pra, përse kohë që ligji nr. 69/2012 “*Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë*”, shprehet për element të caktuar të funksionimit të një procesi të rregullt rekrutimi, apo zhvillimit të vazhdueshëm profesional, çdo formë tjetër e aplikuar nga MAS dhe që është në kundërshtim me këtë ligj, në gjykimin e institucionit të Avokatit të Popullit do konsiderohet antiligjore dhe e padrejtë.

**Lidhur me largimet nga puna për shkak të reformës-territoriale administrative**, institucioni i Avokatit të Popullit ka gjykuar se, zbatimi i kësaj reforme nuk është shkak për përfundimin e marrëdhënieve të punës sepse deri në datë 31.12.2017, në çdo njësi administrative funksionin administrata e njësisë vendore si dhe struktura dhe organika e administratës së njësisë administrative është pjesë e strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë. Referuar këtyre dispozitave ligjore të miratuara për rregullimin e situatës për një periudhë tranzitore,



transferimi në strukturën dhe organikën e administratës së bashkisë është automatike dhe personeli aktual duhet të konsiderohet i punësuar në bashkitë e reja. Vetëm organet e qeverisjes vendore të konstituara pas zgjedhjeve të vitit 2015 do të organizohen dhe funksionojnë bazuar në ndarjen administrativo-territoriale të përcaktuara në ligj. Me rastin e transferimeve duhet të verifikohen emërimet në shërbimin civil, si dhe duhet të ngrihen dhe të funksionojnë komisionet e ristrukturimeve për verifikimin e çdo pozicioni pune për transferimet përkatëse.

#### **6.10 Çështje të lidhura me kalimet e paligjëshme të kufirit, procedurat e kërkimit të azilit dhe të përfitimit të statusit të refugjatit**

Çështja e krizës së refugjatëve dhe migrantëve sot në Europë është çështje e të drejtave të njeriut dhe duhet të përshkojë në mënyrë tërësore politikën shtetërore të vendeve pritëse apo të transitit dhe të atyre vendeve që kanë shuma gjasa të preken nga kjo krizë. Trajtimi humanitar i refugjatëve dhe migrantëve është detyrim për çdo vend, po aq sa ç'është edhe njohja e të drejtave që u takojnë bazuar në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, Konventën e vitit 1951, në lidhje me Statusin e Refugjatëve dhe Protokollin shtesë të saj të vitit 1967, si dhe në Direktivat e Këshillit të Bashkimit Europian nr. 95 të vitit 2011 dhe nr. 32 dhe 33 të vitit 2013.

Në lidhje me flukset ekzistuese dhe ato të pritshme të migrantëve dhe refugjatëve, Shqipëria mbetet në një gjendje ende të papërgatitur në mënyrën e duhur. Ndërsa vazhdimisht shihet një numër i madh njerëzish që përpiqen të kalojnë në territorin e disa vendeve të Bashkimit Europian me çdo mjet, duke u mirëpritur për më shumë në këto vende, autoritetet shqiptare të azilit nuk ndjekin të njëjtin ritëm dhe kuptim me këto zhvillime. Personat që kapen duke kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin për të ardhur apo për t'u larguar nga Shqipëria edhe pse janë qartësisht pjesë e këtyre flukseve, edhe pse kërkojnë në vijim mbrojtje nga Republika e Shqipërisë dhe janë qartësisht në kushtet e fitimit të kësaj mbrojtje, u mohohet tërësisht, apo u shtyhet pa fund hyrja në procedurat e azilit. Kjo i lë ata tërësisht të zbuluar përballë rrezikut të vendimeve të gjykatave që nuk marrin parasysh nevojën e tyre për mbrojtje dhe pozitën e tyre specifike si refugjatë, çka çon së fundmi drejt kthimit në vendet nga kanë ardhur dhe shkeljen nga Shqipëria të parimit të moskthimit, *non – refoulement*.

Institucionit i Avokatit të Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe në bashkëpunim të ngushtë me Agjencinë e Kombeve të Bashkuara për Refugjatët në Tiranë (UNHCR), ka monitoruar në vijimësi Qendrën e Trajtitimit të të Huajve të Parregullt në Shqipëri dhe Qendrën e Azilkërkuesve, pikat e ndalimit kufitar, si dhe ka parë nga afër pikat të cilat shihen si të mundshme për të ndërtuar kampe të pritjes, apo të ndihmesës për kalimin tranzit të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

Nga inspektimet në këto qendra është vënë re se, kapaciteti i tyre në hapësirë dhe në burime financiare e njerëzore është i pamjaftueshëm jo vetëm për raste të flukseve masive, por edhe për raste të rritjes graduale të numrit të azilkërkuesve, apo të migrantëve të parregullt në një kohë të shkurtër.

Nga inspektimet në pikat e kalimit kufitar, si dhe në pikat e mundshme – kampe të pritjes, apo të ndihmesës për kalimin transit të migrantëve, konfirmuar edhe nga burime të Policisë Kufitare, është konstatuar se ka shumë sfida që duhen tejkaluar – qoftë edhe në një kuadër emergjence, në mënyrë që ato të konceptohen si qendra funksionale jo vetëm për regjistrimin dhe ndihmesën shumë afatshkurtër ndaj personave në nevojë, por edhe si qendra rezidenciale që do të mundësojnë një qëndrim më afatgjatë të personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare në to. Mbi pikat e kalimit kufitar, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit marrjen e masave të menjëhershme:

- për mbajtjen dhe përditësimin e një liste përkthyesish për gjuhët kryesore nga vijën e huajt e parregullt në çdo pikë kalimi kufitar;
- për përpilimin, shpërndarjen, përdorimin dhe afishimin në mjedise të dukshme e lehtësisht të aksesueshme në çdo pikë kalimi kufitar të formularëve të intervistimit të të huajve të në gjuhët që ata i kuptojnë;
- për përpilimin dhe shpërndarjen e materialeve informuese me të drejtat e detyrimet e secilës prej kategorive të të huajve të parregullt që rezultojnë nga intervistimi/përzgjedhja në gjuhët që ata kuptojnë në çdo pikë ku të huajt e parregullt shoqërohen e mbahen të ndaluar;
- që sistemi TIMS të jetë vazhdimisht funksional e të pasqyrojë të gjitha kategoritë e të huajve të parregullt që rezultojnë nga intervistimi;
- për të krijuar mjedise pritje funksionale dhe të mirëmbajtura, sipas standardeve, duke filluar nga pikat kufitare të largëta ku ka kalim më të madh të mundshëm të të huajve të parregullt. Në këto mjedise duhet të ofrohet furnizimi me ushqim dhe ujë të pijshëm, si edhe kujdesi shëndetësor i nevojshëm, sidomos për rastet kur grupet e të ndaluarve janë më shumë nga sa mund të trajtojë zakonisht një vendkalim kufitar.

Sa i përket çështjes së ngritjes së qendrave pritëse dhe tranzitore në Shqipëri, duke mbajtur parasysh se Shqipëria e ka të pamundur të ndërtojë kampe rezidenciale ku supozohet se, personat në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare do të jetojnë për kohë të gjatë; se ndihma ndërkombëtare për këtë qëllim do të donte kohë për të qenë efektive dhe se kjo ndihmë dhe gjithçka tjetër është në një shkallë të rëndësishme e ndërvarur me prirjen e vazhdueshme të këtyre personave për të shkuar drejt vendeve të caktuara të BE, është e nevojshme që shteti të marrë masat e nevojshme për pritjen dhe trajtimin e personave në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare që paraqiten në kufij, apo kapen brenda territorit. Për këtë është e rëndësishme që:

1. Qeveria e Republikës së Shqipërisë të vazhdojë të nxisë nismat rajonale e më gjerë për të mundësuar bashkërendimin e trajtimit dhe të ofrimit të ndihmës në Ballkanin perëndimor. Kriza migratore me të cilën po përballen vendet e rajonit ka rrënjë të thella e nevojë për vendimmarrje politike, por edhe për një qasje thellësisht humane nga të gjithë vendimmarrësit e zbatuesit. Bashkëpunimi rajonal mes vendeve të ndryshme duhet të nxitet duke parë me interes jo vetëm kuota për çdo vend por edhe bashkërendim në regjistrimin, trajtimin dhe ofrimin e zgjidhjeve afatgjata për refugjatët. Zgjidhja më e mirë e krizës është vetëm zgjidhja e çështjeve në burimin e tyre ndaj edhe qeveria shqiptare duhet ta shohë këtë zgjidhje me përparësi e t'i përkushtojnë asaj të gjitha mjetet e duhura.
2. Qeveria e Republikës së Shqipërisë të mundësojë së pari njohjen e këtyre personave para ligjit duke i pajisur ata me dokumentacion bazë të nevojshëm për një sërë procesesh administrative që lidhen me statusin e tyre këtu, por që është edhe parakusht për të mundësuar një ndarje funksionale të ndihmës humanitare. Ndërhyrjet e nevojshme në ligj apo në aktet nënligjore duhet të bëhen pa vonesë, duke mbajtur parasysh kohën e shkurtër në dispozicion, nevojat humanitare të përmendura më lart dhe përvojat më të mira ndërkombëtare e rajonale në këtë fushë.
3. Qeveria e Republikës së Shqipërisë të shpallë, në përputhje me Ligjin për Azilin në Republikën e Shqipërisë, njohjen e mbrojtjes së përkohshme për shkaqe të fluksit masiv për personat e ardhur nga Siria, për faktin e thjeshtë se lufta është shkaku i përbashkët i largimit të tyre. Është e paarsyeshme që procedurat normale për përcaktimin e statusit të ndiqen për ta si edhe për çdo të ardhur nga çdo vend tjetër. E njëjta logjikë është e nevojshme të ndiqet edhe për të gjitha rastet e ardhjeve masive nga vendet e tjera, duke pasur parasysh se për rastet e mbrojtjes si pasojë e flukseve masive, është sfondi i

përbashkët i persekutimit që përcakton gjasat që personat të jenë në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare.

4. Në rast të ngritjes së kampeve pritëse, apo të tranzitit – ku për të gjithë faktorët e përmendur më lart është e qartë që ngritja e qendrave për një profilizim të përkohshëm dhe për lejimin e lëvizjes së lirë drejt vendeve të tjera mund realisht të jetë zgjidhje, të zbatohen me përpikëri standardet më të mira ndërkombëtare në këtë fushë.
5. Organet e drejtësisë dhe ato të Policisë së Shtetit të shohin fenomenin e personave që kapen duke u përpjekur të lënë territorin shqiptar me dokumente të falsifikuara në mënyrë të ndjeshme ndaj nevojave të tyre për mbrojtje ndërkombëtare, duke qenë se këta persona mund të jenë refugjatë. Ky këndvështrim duhet të ketë synim që të përcaktojë pozitën e tyre në kuadrin e flukseve migratore e atyre të përbëra nga persona në nevojë për mbrojtje ndërkombëtare e jo të trajtohen si të gjitha rastet e tjera të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara sepse kjo vetëm rëndon edhe gjendjen humanitare të personave, por edhe shpenzimet publike të Republikës së Shqipërisë, që detyrohet t'i mbajë ata të ndaluar në qendra të mbyllura ose institucione për ekzekutimin e vendimeve penale.
6. Të përforcohen me bazë materiale dhe me shërbime të përkthimit ekipet që kryejnë procedurën e përzgjedhjes së të huajve të parregullt në kufi apo në drejtoritë rajonale të kufirit në mënyrë që të sigurohet mundësia që çdo i huaj që gjendet në mënyrë të parregullt në territorin shqiptar, të kuptojë qartë të drejtat e veta dhe të shprehë qartësisht nëse kërkon azil në Republikën e Shqipërisë. Në një rast të tillë, të sigurohet lidhje e menjëhershme me autoritetet e azilit.
7. Të mundësohet i plotë monitorimi dhe vëzhgimi i pavarur i zbatimit të procedurës së përzgjedhjes si edhe kushtet e pritjes apo të ndihmesës humanitare në qendrat e tranzitit, nga pjesë të shoqërisë civile, apo organizma të ndara nga pushteti ekzekutiv të tilla si UNHCR, IOM, etj.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka mbikqyrur e do të vazhdojë të mbikqyrë trajtimin në respekt të të drejtave të njeriut për refugjatët dhe migrantët, aksesin e tyre në procedurat e azilkërkimit. Ai do të punojë për parandalimin e trajtimit çnjerëzor e degradues, përforcimin e masave integruese dhe të unitetit familjar, promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike e sociale, garantimin e masave mbrojtëse për trajtimin e grupeve në nevojë si dhe mbrojtjen e të drejtave përmes bashkëpunimit ndërmjet kufijve.

## 6.11 Energjia elektrike

Në muajin Dhjetor 2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka depozituar pranë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë disa propozime mbi aksesin e furnizimit me energji elektrike për konsumatorët e cënueshëm. Nisur nga aktualiteti, ku çdo ditë e më shumë janë rritur ankesat e ndërprerjeve të energjisë elektrike në disa raste me muaj, për shkak të pamundësisë në përbalimin e pagesave të saj, qasja me energjinë elektrike është bërë gjithnjë e më e vështirë për grupet e cënueshme dhe në risk. Duke mbajtur në konsideratë ndryshueshmërinë në çmimin e energjisë elektrike, pamundësinë në pagesën e saj, kjo e lidhur me faktorin ekonomik, shumë qytetarë sot po përballen me mungesë në akses për furnizimin e vazhdueshëm me energji elektrike e ndërë më së shumti tani në afrimin edhe të stinës së dimrit.

Sipas treguesve të nivelit të varfërisë rreth 14.3% të familjeve jetojnë në varfëri absolute (*e përcaktuar në Shqipëri si numri i personave me konsum mujor real nën 4891 lekë*), si dhe rreth 2.2% jetojnë në varfëri ekstreme (*e përcaktuar si numri i personave që kanë vështirësi në përmbushjen e nevojave bazë ushqimore*). Sot aktualisht rreth 7.3% e familjeve shqiptare trajtohen me ndihmë ekonomike. Në realitet nuk është ky numri i familjeve që kanë nevojë për mbështetje nga skema, pasi numri i kërkesave është shumë më i madh.

Ndryshimi i çmimit të energjisë elektrike, në muajin Janar 2015 u pasua me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për mbrojtjen e shtresave në nevojë, por në shumë raste është e pamjaftueshme për konsumatorët me të ardhura të pamjaftueshme për të përballuar pagesën e saj. Duke ju referuar Direktivës 2009/72/EC, në lidhje me rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë elektrike, përcaktohet se duhet të sigurohet një seri e të drejtave për furnizimin me energji elektrike brenda cilësisë teknike, transparente dhe jo diskriminuese dhe shteti duhet të marrë masa adekuate për mbrojtjen e konsumatorit të cënueshëm.

Gjithashtu, referuar Direktivës 2003/54/EC të Këshillit dhe Parlamentit Europian “*Në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe që shfuqizojnë Direktivën 96/92 / EC*”, kreu II i saj, i referohet kompensimit financiar, dhe në veçanti duhet të sigurohen masa adekuate për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, **duke përfshirë masat për të ndihmuar dhe për të shmangur ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike.**

Duke gjykuar se, pavarësisht se ekzistojnë skema lehtësuese për pagesën e detyrimeve të prapambetura, apo garanci ligjore për të gjithë ata konsumatorë të cilët rezultojnë debitorë, mbrojtja sociale dhe ekonomike e grupeve të cënueshme nuk është e mjaftueshme dhe duhet të konsiderohet prioritet për shkak se, familjet në nevojë ekstreme nuk arrijnë dot të sigurojnë mbijetesën dhe jo më të përballen me faturat për pagesat e shërbimeve publike. Kjo duhet të shihet e lidhur ngushtësisht edhe me gjetjen e mundësive për shmangien e ndërprerjes së furnizimit me energji elektrike për këto grupe.

Gjithashtu, duke sjellë në vëmendje edhe agjendën e miratuar në samitin e Kombeve të Bashkuara, në muajin Shtator 2015, “*Për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030*”, objektivën numër 7 e cila lidhet me sigurimin, aksesin dhe furnizimin me energji elektrike, të përballueshëm, të qëndrueshëm, institucioni i Avokatit të Popullit ka rekomanduar:<sup>93</sup>

1. Kryerjen e një studimi nga ana e Ministrisë së Energjitikës në bashkëpunimin e Ministrinë e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë për të identifikuar numrin e familjeve në varfëri ekstreme dhe absolute, të cilat përballen me mbijetesë dhe vuajnë për të siguruar ushqim dhe ngjitjen e një sistemi data-bazë për këto familje.
2. Ofrimin e zgjidhjeve të menjëhershme që këto familje të mos privohen nga e drejta për akses në furnizimin e nevojshëm me energji elektrike, duke siguruar minimumin e mundshëm, ndricimin në banesë. Në gjykimin e Avokatit të Popullit, kjo duhet të shoqërohet me një paketë ndryshimesh ligjore me qëllim ndryshimin edhe të skemave për aksesueshmërinë në këtë shërbim për grupet vulnerabël
3. Është i nevojshëm krijimi i mundësive të diferencuara në mënyrën se si do të ofrohet energjia elektrike dhe krijimi i skema lehtësuese të përballueshme për pagesat e energjisë elektrike për këto familje. Aktualisht është koha dhe duhet të krijohen programe specifike vetëm për konsumatorët në nevojë.

## **6.12 Çështjet kryesore në vizitën në fshatin Lazarat, Gjirokastrë**

Gjatë punës së institucionit të Avokatit të Popullit i është kushtuar një vëmendje e veçantë edhe trajtimit të ankesave dhe problematikave që kanë të bëjnë me një komunitet të gjerë banorësh dhe garantimin e një trajtimi sa më dinjitoz të shqetësimeve dhe problemeve që ata kanë ngritur, pranë strukturave respektive. Në këtë kuadër Avokati i Popullit, gjatë muajit Korrik 2015 e në vazhdim ka kryer një sere takimesh në fshatin Lazarat të Gjirokastrës, me banorë të kësaj zone,

<sup>93</sup> Shkresa drejtuar Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në datë 30.12.2015

për të marrë ankesat e tyre mbi problematikat që shqetësojnë këtë komunitet banorësh dhe që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut.

Avokati i Popullit ka administruar ankesat respektive të banorëve, si dhe ka iniciuar ndjekjen e shqetësimeve të parashtruar nga ana e tyre, të fokusuara konkretisht në këto fusha:

- Keqtrajtimi nga punonjësit e policisë të Strukturave Speciale Operacionale, në dëm të disa shtetasve, banues në Lazarat të Gjirokastrës. Mbi këtë shqetësim është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, në përfundim të të cilit i është rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë fillimi i hetimit për veprën penale “*Kryerja e veprimeve arbitrare*”, parashikuar nga neni 250 e 25 i Kodit Penal. Në përgjigje të rekomandimit të Avokatit të Popullit, jemi informuar se tashmë ka filluar hetimi nga ana e strukturave të Prokurorisë.
- Faturimet aforfe për të cilat i është rekomanduar strukturave të OSHEE-së marrja e masave të menjëhershme, për instalimin e matësve të energjisë elektrike për çdo abonent, që në të ardhmen konsumatori të mos paguajë më faturimeve aforfe. Nuk ka akoma një përgjigje zyrtare pavarësisht dy kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit, për tu shprehur mbi rekomandimet zyrtare.
- Probleme me furnizimin me ujë të pijshëm dhe faturimin aforfe të tij. Lidhur me këtë shqetësim, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kryetares së Bashkisë Gjirokastrë marrjen e masave të menjëhershme për furnizim normal me ujë të pijshëm, si edhe instalimin e matësve të konsumit të ujit për çdo abonent, me qëllim që të shmangen faturimet aforfe. Nuk ka akoma një përgjigje zyrtare pavarësisht dy kërkesave të institucionit të Avokatit të Popullit për tu shprehur mbi rekomandimet zyrtare.
- Problemi i funksionimit të sistemeve të kullimit dhe vaditjes së tokave në sektorin e bujqësisë duke shkaktuar në këtë mënyrë edhe mangësi në shfrytëzimin efikas dhe me rendiment të tokës bujqësore. Avokati i Popullit ka hartuar një rekomandim drejtuar strukturave të Bordit të Kullimit dhe Drejtorisë së Bujqësisë në Gjirokastrë, me qëllim që të merren masa për përmirësimin e sistemeve të vaditjes dhe kullimit, si edhe ofrimin e programeve mbështetëse në këtë fushë.
- Një nga çështjet me rëndësi ishte dhe arsimimi i fëmijëve të fshatit. Banorët vetë u shprehën se shkollat kanë infrastrukturën e nevojshme si dhe stafin pedagogjik, por ka mungesë psikologësh në shkolla, roli i të cilit është mjaft i rëndësishëm duke ditur situatën dhe kushtet ku kanë jetuar këta fëmijë. Sa më sipër ne i rekomanduam Ministrisë së Arsimit dhe Sportit marrjen e masave për caktimin e një psikologu, ose punonjësi social në shkollat e fshatit Lazarat, Gjirokastrë, për vitin shkollor 2015-2016 e në vazhdim.
- Gjithashtu, problematikë tjetër ishte edhe shërbimi shëndetësor në këtë zonë. Banorët u shprehën se qendra shëndetësore nuk kishte kushte të përshtatshme, kishte vetëm një mjek për komunën, i cili nuk është me kohë të plotë. Gjithashtu mungonte shërbimi dentar dhe farmaceutik në këtë komunë. Për këtë, Avokati i Popullit kërkoi shpjegime nga Ministria e Shëndetësisë dhe DRSH-ja Gjirokastrë, të cilët e pranuan realitetin dhe u angazhuan për zgjidhjen e problematikës me angazhime konkrete.

### **6.13 Përmbytjet dhe procedura e dëmshpërblimeve**

Avokati i Popullit ka vijuar edhe gjatë vitit 2015 trajtimin e rasteve ku janë ngritur pretendimet për mospërfitim të shumave të dëmshpërblimit, si pasojë e fatkeqësive natyrore.

***Konkretisht rezultojnë të regjistruara dhe po ndiqen në vijim:***

1. Ankesa lidhur me procedurat që po ndiqen nga organet shtetërore për dëmshpërblimin e banorëve të Bregut të Lumit, pas përmytjeve të ndodhura me datë 16.10.2013. Nga ana e Ministrisë së Punëve të Brendshme jemi informuar me shkresën me nr. 5963/1 prot. datë 13.08.2015 se është i pamundur likuidimi i banorëve, për shkak të pamundësisë financiare. Në këto kushte ato do të kërkojnë së shpejti një shtesë fondi për përballimin e shumave të dëmshpërblimit të banorëve, dosjet e të cilëve plotësojnë kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.
2. Ankesat e disa shtetasve që kanë të bëjnë me mospërfitimin nga fondet e emergjencës për riparimin e dëmeve të shkaktuara nga përmytjet,<sup>94</sup> zvarritje në akordimin e fondeve të emergjencës për vite me radhë, ankesa për mosmarrjen e masave nga njësitë e pushtetit vendor për konstatimin e dëmeve për shkak të reshjeve të shiut, si edhe kompesimin e tyre, ankesa për procedura “ping-pong” të ndërmarra nga institucionet shtetërore, të cilat nuk japin një zgjidhje, etj.  
Në përgjigje të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, Ministria e Brendshme ka theksuar së ka vështirësi financiare për të përballuar rastet e shumta të fatkeqësive natyrore në të gjithë vendin dhe vlerësimin e mundësisë, për alokimin e fondeve në të ardhmen.
3. Po gjithashtu një çështje e hershme dhe që po ndiqet në vijim nga ana e Avokatit të Popullit është edhe problemi i dëmshpërblimit të banorëve të qytetit të Shkodrës, për dëmet e shkaktuara në banesat dhe orenditë e tyre shtëpiake, në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 842 datë 06.12.2011 “Për miratimin e vlerës së kompensimit të dëmeve të shkaktuara në kulturat bujqësore e në biznese, nga reshjet e shiut dhe përmytjet, në qarkun e Shkodrës”. Po ashtu mbetet e pazgjidhur çështja e kompesimit të dëmeve për individët, të cilëve u janë dëmtuar banesat dhe orenditë në qytetin e Shkodrës, pra që nuk ishin në fushën e zbatimit të VKM të sipërcituar.  
Ministria e Punëve të Brendshme<sup>95</sup> më herët ka informuar se, nuk është detyrim i kësaj të fundit për të kërkuar miratimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave, për mbulimin e efekteve financiare të dëmtimeve nga përmytjet dhe se është Ministria e Financave, që duhet të kërkojë lëvrimin e fondeve për këtë qëllim. Ndërkohë, që Ministria e Financave në përgjigje të shkresës së Avokatit të Popullit ka reaguar, duke e dërguar për kompetencë këtë çështje tek Ministria e Brendshme.

Për shkak të rëndësisë së këtyre çështjeve, si edhe duke patur parasysh faktin se tashmë ka shumë raste të cilat mbeten të patrajtuara për shkak të mungesës së kapaciteteve financiare, Avokati i Popullit i është drejtuar<sup>96</sup> edhe Kryetarit të Komisionit Parlamentar për Ekonominë dhe Financat pranë Kuvendit të Shqipërisë, lidhur me problematikën e shtetasve për mospërfitimin e fondeve të emergjencës dhe nevojën e parashikimit të fondeve shtesë për përballimin e këtyre rasteve. Në një kohë që përmytjet dhe dëmet e shkaktuara të shtetasve vazhdojnë dhe detyrimet shtohen, nuk ka ende asnjë qëndrim zyrtar nga Kuvendi i Shqipërisë, lidhur me zgjidhjen e kësaj çështje.

<sup>94</sup> Dërguar rekomandim zyrtar, dhe ankuesi ka përfituar një shumë prej 150 mijë lekë, por jo shumën e plotë sipas preventivit të dëmeve

<sup>95</sup> në shkresën e saj me nr. 3530/2 prot. datë 22.09.2014

<sup>96</sup> me shkresën me nr. K3/G31-6 prot. datë 25.06.2015

## **KREU 7**

### **Sfidat dhe arritjet në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2015**

Institucioni i Avokatit të Popullit si një institucion kushtetues i vetëm në llojin e tij, vazhdon ende të përballlet me një sërë sfidash ashtu si dhe arritje gjatë veprimtarisë së tij në vitin 2015.

Arritjet e institucionit të Avokatit të Popullit janë shënuar në ***bashkëpunimin me shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtare*** jo vetëm në aktivitete të përbashkëta por njëkohësisht edhe aksione të tilla me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut. Megjithatë është vënë re se shoqëria civile nga viti në vit po përjeton rrudhje dhe turrje si rezultat i largimit të donatorëve të tuaj dhe pamundësisë për të mobilizuar fonde nga burimet e brendshme, e cila përbën një sfidë në të ardhmen për gjithë shoqërinë në tërësi. Pikërisht këto mangësi është përpjekur të adresojë edhe institucioni i Avokatit të Popullit me punën e bërë gjatë vitit 2015.

Arritjet janë shënuar në ***bashkëpunimin me median***, ku në shumë raste në përpjekjet për ti dhënë një zgjidhje ankesave dhe shqetësimeve të shumë qytetarëve që i drejtohen institucionit, media është parë si një aleat i rëndësishëm duke na ndihmuar në mediatizimin e problematikave, me qëllim “zgjimin” e administratës publike dhe personave përgjegjës të saj.

Arritjet janë shënuar edhe në ***rritjen e besimit të qytetarit*** tek institucioni i Avokatit të Popullit duke e parë si një mundësi për zgjidhjen e problemeve të tyre, por edhe si një “derë e hapur” të halleve të tyre të përditshme. Kjo është bërë e mundur nëpërmjet rritjes së shërbimit profesional të pritjes së shtetasve e cila krijon edhe impaktin e parë të komunikimit me qytetarët si dhe nëpërmjet rritjes së përfaqësimit të Institucionit në 7 rrethe të tjera me zyrat rajonale.

Por sfidë mbetet ende zgjidhja e problematikave të shtetasve që adresohen tek institucioni i Avokatit të Popullit, ku shpesh ***mospërgjigja dhe mosbashkëpunimi me institucionet shtetërore*** e rëndon më tepër.

Mungesa e kthimit të përgjigjeve nga institucionet shtetërore është bërë pengesë në shumë raste për kryerjen e hetimit administrativ, duke u bërë kështu një pengesë reale në veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit. Moskthimi i përgjigjeve të rekomandimeve të adresuara dhe moszbatimi i atyre të pranuar përbën gjithashtu sot, një problematikë dhe një sfidë për veprimtarinë e Avokatit të Popullit.

Në 19 shkurt 2015, institucioni i Avokatit të Popullit festoi ***15 vjetorin e krijimit***, duke përfaqësuar gjatë këtyre viteve një institucion që ka ditur të ruajë vlerat demokratike dhe pavarësinë e tij. Institucioni i Avokatit të Popullit, ju akreditua nga Presidenti, titulli “Nderi i Kombit”, me motivacionin: ***“Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohje për kontributin e qenësishëm 15 vjeçar, në ruajtjen dhe mbrojtjen e lirive thelbësore të njeriut”***.

Arritje jo vetëm e institucionit të Avokatit të Popullit por e gjithë vendit, ishte ***akordimi për herë të tretë i “Statusit A”***, si niveli më i lartë i akreditimit, nga Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Kombëtare të të drejtave të njeriut. Ky status ju akordua institucionit tonë pas njohjes dhe vlerësimit të përpjekjeve të rëndësishme të Avokatit të Popullit për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2008, përfshirë ngritjen e zyrave rajonale dhe forcimin e angazhimit në sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.

Sfidë vazhdon të mbetet roli i institucionit të Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues i pavarur, që qëndron mbi palët, në një shoqëri si kjo e jona, ku polarizimi politik mbetet i qenësishëm.

## **7.1. Vështirësitë e hasura në marëdhënien me institucionet e Administratës Publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit**

Edhe këtë vit problemi kryesor me të cilin është ndeshur institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë bashkëpunimi jo i duhur nga ana e institucioneve të administratës shtetërore.

Kjo mungesë bashkëpunimi ka konsistuar në disa aspekte:

1. Moskthimi i përgjigjeve për kërkesat për shpjegime.
2. Moskthim të përgjigjeve ndaj rekomandimeve.
3. Moszbatim të rekomandimeve të pranuar nga institucionet shtetërore.

Vazhdon të mbetet shqetësuese, moskthimi i përgjigjeve të kërkesave për shpjegime dhe moskthimi i përgjigjeve ndaj rekomandimeve të adresuara, duke refuzuar kështu bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, si një fenomen tashmë i përsëritur dhe që nuk po gjen ende zgjidhje. Në kundërshtim me sa parashikohet në nenin 22, të ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku parashikohet detyrimi i *organeve të administratës për t’ju përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit*, sipas të cilit: “*Organet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigjja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarë ai organ*”, organet e administratës publike, nuk kthejnë përgjigje edhe pas kërkesave të përsëritura.

Për zgjidhjen e kësaj problematike, e cila duhet thënë se është shfaqur edhe në vitet e mëparshme, nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë përpjekje në rrugë administrative, si duke ridërguar kërkesat për kthimin e përgjigjeve të munguara, ashtu edhe duke ju drejtuar organit epror, por edhe këto përpjekje nuk e kane zgjidhur problemin.

I vetmi mekanizëm që ligji “Për Avokatin e Popullit” parashikon, është ai i parashikuar në nenin 22/1, *Sanksionet për mosbashkëpunimin me Avokatin e Popullit*, sipas të cilit: “*Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga autoriteti kompetent fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil*”, por në kushtet kur vetë titullari i institucionit që duhet të kthente përgjigje, nuk bashkëpunon me institucionin tonë, kjo dispozite bëhet shumë e vështirë për tu zbatuar.

Gjatë vitit 2015, rezulton se nga 349 rekomandime të adresuara në total, 68 janë pa përgjigje. Po të njëjtin fat kanë kërkesat për shpjegime, të cilat pavarësisht përsëritjeve të herë pas herë shpesh përsëri mbeten pa përgjigje.

Për vitin 2015, nga numri total i shkresave 2857, 211 mbeten pa përgjigje, kujtojmë këtu që në disa raste shkresat janë dërguar më shumë se një herë institucioneve shtetërore.

Kategoria e dytë, është numri i rekomandimeve të adresuara në krahasim me ato të pranuar, duke bërë kështu një dallim midis atyre të refuzuara. Institucionet shtetërore në një pjesë të rekomandimeve të adresuara ndaj tyre, i kanë refuzuar ato.

Për sa i përket grupit të tretë të rekomandimeve, janë ato të cilat janë pranuar nga institucionet shtetërore por nuk janë zbatuar. Kjo ndodh për arsye të ndryshme, por në mënyrë të përmbledhur mund të themi se kjo vjen si rezultat i: mungesës së vullnetit administrativ, politik, edhe/ose financiar.



Në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit, shtojmë se ka edhe një detyrim tjetër ligjor, i cili do të ndihmonte në kuptimin dhe zbatimin e rekomandimeve të institucionit tonë, por që si gjatë vitit 2015, ashtu edhe më parë, rezulton të mos jetë zbatuar asnjëherë. Më konkretisht neni 22, i ligjit “Për Avokatin e Popullit”, parashikon se: *“Avokati i Popullit duhet të njoftohet dhe ka të drejtë të marrë pjesë e të flasë në mbledhjet e organeve kolegjale të administratës publike, ku merret në shqyrtim rekomandimi, kërkesa apo propozimi i tij”*, por me perjashtim të rasteve kur diskutohen raportet e veçanta të institucionit tonë nga Kuvendi, në asnjë rast tjetër institucioni ynë nuk është thirrur për të marrë pjesë në rastet kur shqyrtohen rekomandimet, kërkesat, apo propozimet tona.

Një mekanizëm tjetër shumë i rëndësishëm që ligjvënësi ka parashikuar për institucionin tonë, janë edhe Raportet e Veçanta. Ky mekanizëm do të ishte më efikas në rast se do të përmirësoheshin dy momente. Momenti i parë është ai i kohës ndërmjet dërgimit të një Raporti të Veçantë nga institucioni ynë dhe shqyrtimit të këtij Raporti nga Komisionet përkatëse të Kuvendit. Kjo pasi në mjaft raste, Raportet tona të Veçanta janë diskutuar disa vite pas dërgimit të tyre, duke humbur kështu aktualitetin. Po kështu kujtojmë se ka ende një sërë raportesh të Veçanta, të cilat nuk janë shqyrtuar ende nga Kuvendi

Momenti i dytë ka të bëjë me zbatimin e Rezolutave të Kuvendit, për Raportet e Veçanta të institucionit tonë. Ajo çka konstatojmë me shqetësim, është fakti se edhe pas:

- Evidentimit të problematikave të fushës, hartimit të Raportit të Veçantë dhe dërgimit të tij nga ana e institucionit tonë në Kuvend,
- Shqyrtimit nga Komisionet e Kuvendit të Raporteve tanë të Veçantë dhe miratimit të Rezolutës përkatëse nga ana e Kuvendit, sërish situata vazhdon të jetë e njëjtë, pra nuk ka reagim nga ana e institucioneve shtetërore, për të cilat caktohen detyra në Rezolutën përkatëse dhe që kanë detyrimin ligjor për ti dhënë zgjidhje problemeve të caktuara.

Duke pasur parasysh statusin e veçantë kushtetues që ka institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe faktin që rekomandimet e institucionit tonë lidhen me shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nga institucionet shtetërore, mosmarrja e masave në rastet e moskthimit të përgjigjeve, apo moszbatimi i rekomandimeve të institucionit tonë, prek ekuilibrat institucional të një shtetit demokratik.

Një bashkëpunim jo i mirë me institucionin e Avokatit të Popullit çënon dhe ul nivelin e mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të parashikuara si në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga vendi ynë, ashtu edhe nga legjislacioni vendas.

Gjithashtu dëmtohet edhe imazhi i vendit në raport me partnerët ndërkombëtare dhe organizatat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, që bashkëpunojnë me vendin tonë, të cilat në raportet e tyre kërkojnë bashkëpunimin me institucionin e Avokatit të Popullit, si dhe rekomandojnë rritjen e zbatueshmërisë së rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Gjithashtu kujtojmë se, në raportet kryesore të BE-së dhe Sh.B.A-së lidhur me Shqipërinë, raportet dhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit kanë shërbyer si pika reference dhe burim i besueshëm të dhënash.<sup>97 dhe 98</sup>

Nisur nga organizimi i brendshëm i punës në institucion, në varësi të rëndësisë së rekomandimit, apo në varësi të subjektit që i drejtohet, rekomandimet edhe gjatë vitit 2015 janë dërguar si nga Avokati i Popullit, ashtu edhe nga Komisionerët.

<sup>97</sup> Shih Progresin e Raportit të Fundit të BE-së, faqe 10 dhe 45.

[http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu\\_albania/...](http://eeas.europa.eu/delegations/albania/documents/eu_albania/...)

<sup>98</sup> Shih Raportin e fundit të Departamentit Amerikan të Shtetit: <http://albanian.tirana.usembassy.gov/...>

## Numri total i rekomandimeve të bëra gjatë vitit 2015 nga institucioni i Avokatit të Popullit, ka qenë 349.

Nga rekomandimet e bëra në vitin 2015, rezulton se:

1. Rekomandime të pranuar janë 160,
2. Rekomandime të refuzuara janë 51,
3. Rekomandime pa përgjigje janë 68,
4. Rekomandime në shqyrtim janë 70

Sa më sipër shprehet edhe në përqindje, në tabelën më poshtë.



Shqetësues mbetet fakti se ende të dhënat tregojnë që niveli i rekomandimeve pa përgjigje është në të njëjtat vlera si vitet e kaluara (19% të rekomandimeve nga institucionet për vitin 2015).<sup>99</sup>

### 7.2. Vështirësitë dhe arritjet në marrëdhëniet me qytetarin

Avokati i Popullit i ka kushtuar në vijimësi një rendësi të veçantë funksionimit në çdo kohë, me kulture e profesionalizëm Zyrës së Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarëve, që prezanton Institucionin dhe krijon impaktin e parë të komunikimit me qytetarin. Ngritja dhe konsolidimi i zyrave të pritjes dhe të shërbimeve ndaj qytetarit në Tiranë dhe në 7-të zyrat rajonale, kanë përmirësuar teknikat e komunikimit duke sjellë Institucionin e Avokatit të Popullit më afër qytetarit dhe problemeve të tij.

Në Zyrën e Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarëve në çdo orë të ditës gjatë orarit zyrtar, qytetarët ndjehen të mirëpritur të sjellin ankesat apo kërkesat e tyre dhe ata përfitojnë gjithë çfarë mund t'ju ofrojë institucioni i Avokatit të Popullit.

Cilësia në rritje e shërbimeve dhe e performancës me etikë profesionale dhe qytetare, ofruar nga Zyra e Pritjes dhe e Shërbimeve ndaj Qytetarëve, kontaktet e drejtëpërdrejta me qytetarët, këshillimet, orientimet, dhënia e informacionit, kanë synuar dhe kontribuar në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve ndaj Institucionit të Avokatit të Popullit.

Qytetarët në mënyrë të veçantë kanë nevojë për zgjidhje konkrete të problemeve dhe shqetësimeve të tyre dhe vendosjen në vend një të drejtë të mohuar nga administrata publike. Në këtë aspekt Avokati i Popullit ka krijuar një bashkëpunim të ngushtë dhe institucional me

<sup>99</sup> Lista e plotë e të cilave është në tabelën në aneks bashkangjitur këtij raporti

administratën publike, shoqërinë civile dhe median, të cilat luajnë një rol kyç në zgjidhjen e shumë prej ankesave të qytetarëve. Por Zyra e Pritjes dhe Shërbimeve ndaj Qytetarëve has shpesh edhe vështirësi në punën e përditshme në marrëdhënie me qytetarët, për shkak të mos njohjes nga ana e tyre të ligjit për Avokatin e Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit luan një rol parandalues, mbrojtës e proaktiv në kuadër të të drejtave dhe lirive të njeriut. Rekomandimi është mjete ligjor kryesor i Avokatit të Popullit, me qëllim vënien në vend të së drejtës së shkelur nga organi i administratës publike. Qytetari që e mbështet besimin e tij tek institucioni i Avokatit të Popullit për zgjidhjen e problemit për të cilin ankohet, shpesh shqetësohet që Avokati i Popullit është thjesht rekomandues dhe jo detyrues ndaj organeve të administratës publike. Detyra e Zyrës së Shërbimeve ndaj Qytetarëve është në këto raste, të njohë qytetarin me vlerën dhe forcën rekomanduese që mbart rekomandimi i Avokatit të Popullit, për zbatueshmëri nga ana e organeve të administratës publike.

Një vështirësi e përhershme e prezantuar pranë Zyrës së Shërbimeve ndaj Qytetarëve është kërkesa e qytetarëve, që në mosdije të moskompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit për përfaqësim të asnjë pale në gjykatë, kërkojnë pikërisht përfaqësim në gjykatë, me pretendimin se institucioni i Avokatit të Popullit ka në varësi avokatinë e Republikës së Shqipërisë. Në rastet e këtyre kërkesave, qytetarët janë orientuar për të kontaktuar me avokatë privatë dhe kur qytetari ankohet për mospasjen e mundësive financiare për të lidhur një avokat privat, kërkesat e tyre i janë deleguar për kompetencë Komisionit Shtetëror për Ndihmë Juridike Falas, në kuadër të memorandumit të bashkëpunimit.

Një numër të konsiderueshëm të këshillimeve dhe orientimeve e zënë ankesat me objekt “konflikte civile midis individëve”, për shkak të cënimit të të drejtës së pronësisë të pretenduara nga palët, dhe në përmbajtjen e të cilave kërkohet ndërhyrja e institucionit të Avokatit të Popullit për zgjidhjen e konfliktit. Mirëpo, për shkak të mosbesueshmërisë së tyre tek organet e drejtësisë e kërkojnë, jo rrallë herë, me insistim zgjidhjen nëpërmjet institucionit i Avokatit të Popullit. Në përgjigje të këtyre ankesave, qytetarët janë këshilluar t’i drejtohen gjykatës për zgjidhjen e të gjitha llojeve të konflikteve.

Arritje në këtë vit, është shënuar në uljen e numri të ankesave jashtë kompetencës dhe juridiksionit duke bërë kështu që ato të adresohen drejt duke i dhënë këshillimet përkatëse.

### **7.3. Sfidat në bashkëpunimin me median dhe shoqërinë civile**

Avokati i Popullit, në funksion të përmbushjes së misionit si mbrojtës dhe garantues i lirive dhe të drejtave të njeriut në Shqipëri, e konsideron *si një aleat mjaft të rëndësishëm, median dhe rolin e saj.*

Në përpjekjet për t’i dhënë zgjidhje ankesave dhe shqetësimeve të shumë qytetarëve që i drejtohen institucionit, kemi parë si një mundësi zgjidhjeje edhe prezantimin publik të problematikave, me qëllim “zgjidhjen” e administratës publike dhe personave përgjegjës të saj. Në jo pak raste Avokati i Popullit vihet në vështirësi për të ndihmuar qytetarët dhe kategori të ndryshme sociale, pasi rekomandimet e institucionit mbeten pa përgjigje e për rrjedhojë pa zgjidhje. Në situata të tilla kemi ndërhyrë përmes mediatizimit të problemeve. Daljet publike si të Avokatit të Popullit, por edhe të nëpunësve të tjerë të institucionit, kanë qenë të shumta dhe të herëpashershme. Përveç konferencave për shtyp të mbajtura në institucion, kemi prezantuar në media dokumente dhe rekomandime drejtuar ministrave, kryetarëve të bashkive dhe drejtorive të niveleve të ndryshme, për të pasur reagime pozitive prej tyre, në ofrimin e zgjidhjeve.

Në përballjen me këtë sfidë kemi përdorur elementë alternativë të komunikimit, ku do të veçonim hartimin e një strategjie të posaçme komunikimi. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm në krijimin e një atmosfere bashkëpunimi dhe korrekte me median, kanë luajtur edhe kontaktet e drejtpërdrejta mes Avokatit të Popullit dhe gazetarëve. Vlen të theksohet se klima e besueshmërisë është krijuar edhe përmes integritetit dhe saktësisë së informacioneve të bëra publike nga institucioni.

Mbrojtja e shumë çështjeve në shërbim të shtresave në nevojë është realizuar përmes konferencave për media, si nga Avokati i Popullit dhe stafi i tij, po ashtu edhe përmes deklaratave zyrtare që gjejnë një pasqyrim të menjëhershëm dhe të saktë nga mediat online, si dhe televizionet e të gjitha formateve, si ata gjeneralistë ashtu edhe informativë.

Një sfidë komunikimi me publikun ka qenë edhe angazhimi i Avokatit të Popullit në rrjetin social Facebook, si dhe në pasqyrimin e shumë materialeve dhe aktivitetëve në Youtube. Duke kuptuar rëndësinë e mediave sociale nuk mund të anashkallonim këtë risi, si një mundësi shumë e mirë dhe e shpejtë për të qenë sa më pranë dhe sa më të drejtpërdrejtë me publikun. Avokati i Popullit ka një faqe zyrtare, si dhe komunikon me qytetarët edhe nëpërmjet platformës Facebook. E kemi konceptuar këtë platformë si një mundësi të mirë për të rritur nivelin e përfshirjes demokratike të qytetarëve, por edhe pjesëmarrjen e tyre në përcaktimin e prioriteteve të institucionit. Në këtë platformë komunikimi jemi përpjekur të promovojmë njohuritë mbi fusha të drejtave të njeriut që kanë interes për publikun, por edhe të shumë aktivitetëve që zhvillon institucioni i Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit e konsideron *shoqërinë civile* si një nga partnerët e tij kryesorë në realizimin e misionit të tij për të kontribuar në përmirësimin e jetës së qytetarëve.

Një instrument shumë i rëndësishëm në tërheqjen e opinionit dhe ekspertizës së shoqërisë civile është Bordi Këshillimor i ngritur pranë Avokatit të Popullit, me anëtarësi të përzgjedhur nga vetë organizatat e shoqërisë civile, i cili i siguron Avokatit të Popullit këshilla dhe konsulencë për çështje të ndryshme që shqetësojnë qytetarët dhe opinionin publik.

Gjatë punës për përgatitjen e raporteve speciale, rekomandimeve, apo aksioneve publike të ndërmarra nga Avokati i Popullit, bashkëpunohet ngushtësisht me shoqërinë civile dhe grupet e interesit. Megjithatë është vënë re se shoqëria civile nga viti në vit po përjeton rrudhje dhe turrje si rezultat i largimit të donatorëve të tuaj dhe pamundësisë për të mobilizuar fonde nga burimet e brendshme. Nga përvoja e punës tonë me disa organizata të shoqërisë civile që përfituan grante të administruara nga partnerët ndërkombëtarë në kuadër të projektit danez, Avokati i Popullit konstatoi se me mbarimin e projektit, bashkëpunimi dobësohej. Kjo tregon se pjesa më e madhe e këtyre organizatave operojnë në baza projekti dhe jo në baza misioni. Një situatë e tillë dëmton qëndrueshmërinë e punës së tyre, pasi kjo lloj qasjeje bën që organizatat të mos specializohen, por të rendin pas projekteve pavarësisht fokusit të punës së tyre. Në anën tjetër, kjo dobëson zërin dhe aktivizmin e tyre. Është e njohur tashmë se shoqëria jonë vuan nga mungesa e një kulture që do të mundësonte mbijetesën e sektorit civil nga burimet e brendshme, si dhe nga mungesa e spikatur e aktivizmit social. Pikërisht këto mangësi është përpjekur të adresojë edhe institucioni i Avokatit të Popullit me punën e bërë gjatë vitit 2015.

Sa u takon mundësive që ofrohen nga programi IPA i Komisionit Europian për shoqërinë civile, duhet thënë se me përjashtim të disa organizatave që operojnë në Tiranë, pjesa tjetër e shoqërisë civile kanë dobësi serioze në përmbushjen e kërkesave të donatorit si në aspektin teknik të paraqitjes së projekt-propozimeve, ashtu edhe në sigurimin e bashkëfinancimeve.

Vështirësitë me të cilat ndeshet, bëjnë që shoqëria civile të mpakë forcën e reagimit të saj dhe të adoptojë një qëndrim më të zbutur ndaj pushtetit. Kjo diktohet, ndër të tjera, edhe nga fakti që ajo është e varur nga autoritetet edhe për statistika e shifra që do të mundësonin hartimin e raporteve dhe studimeve në kuadrin e konsulencave apo ekspertizave të siguruar nga donatorët.

Pavarësisht ligjit për informimin publik, shumë nga ministrinë apo agjencinë qendrore, me mënyra të ndryshme pengojnë aksesin e tyre në informacione dhe të dhëna që duhet të jenë në dispozicion të çdo qytetari.

Përveç fondit që qeveria qendrore ve në dispozicion të shoqërisë civile përmes Agjencisë për Mbashtetjen e Shoqërisë Civile do të duhet që edhe qeverisja vendore të alokonte fonde për këtë qëllim dhe të kontraktonte OJF-të në nivel vendor për disa nga shërbimet sociale që ofron. Sa më sipër janë çështje që sektori i OJF-ve i ka ngritur në vijnësi, ndaj ne i kemi mbështetur dhe këto shqetësime, me qëllim marrjen e masave konkrete dhe sa më energjike, për të shpëtuar këtë sektor nga asfiksi.

#### **7.4 15-Vjetori i Avokatit të Popullit**

Në 19 shkurt 2015 institucioni i Avokatit të Popullit festoi 15 vjetorin e krijimit. Me këtë rast, në Pallatin e Brigadave u organizua një festë jubilarë, e cila synonte ndër të tjera të shënonte edhe një herë gurët kilometrikë përgjatë një dekade e gjysmë themelimi dhe funksionimi, të njërit prej institucioneve që garantojnë mirëfunksionimin e qeverisjes dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në botën e vlerave demokratike ku aspirojmë të integrohemi.

I pranishëm në këtë ceremoni, Presidenti i Republikës i akordoi institucionit të Avokatit të Popullit titullin “Nderi i Kombit”, me motivacionin: ***“Në shenjë vlerësimi dhe mirënjohje për kontributin e qenësishëm 15 vjeçar, në ruajtjen dhe mbrojtjen e lirive themelore të njeriut”.***

Në këtë ceremoni morën pjesë përfaqësues të institucioneve shtetërore, shoqërisë civile, politikës, medias, ambasadorët më të rëndësishëm të akredituar në Tiranë, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të komuniteteve fetare etj. Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i Kuvendit, z. Ilir Meta e cilësoi përfshirjen e institucionit të Avokatit të Popullit në Kushtetutë si një ndër arritjet kryesore të demokracisë në vend. ***“Ne e mbështesim plotësisht aktivitetin dhe fuqizimin e mëtejshëm të këtij institucioni, i cili ndikon mjaft pozitivisht me rekomandimet e tij në procesin e zbatimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri, në përmirësimin e legjislacionit tonë sipas standardeve ndërkombëtare dhe në promovimin e parimeve të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të llogaridhënies dhe efikasitetit të administratës dhe institucioneve të tjera ku Avokati i Popullit shtrin monitorimin e tij,”*** – **theksoi ne fjalën e tij kryetari i Kuvendit, z. Meta.**

Nga fjala e Avokatit të Parë të Popullit, z. Ermir Dobjani, te fjala e zotit Igli Totozani, Avokati i Popullit në detyrë, të pranishmit u njohën me arritjet dhe problemet e ndeshura hap pas hapi në rrugën e krijimit të njërit prej institucioneve kushtetuese garante të demokracisë dhe mirëqeverisjes në Shqipëri. Të dy avokatët e popullit shënuan ndihmën e pakursyer të Mbretërisë së Danimarkës që në hapat e parë të institucionit, por edhe sot në fazën e konsolidimit të tij, duke bërë që ky institucion të kthehet në një gur themeltar për shtetin e së drejtës dhe qeverisjes së mirë.

Në fjalën e tij zëvendës kryeministri, z. Niko Peleshi, theksoi rëndësinë që qeveria shqiptare i kushton bashkëpunimit me Avokatin e Popullit. Të pranishmit u përshëndetën nga Presidenti i Nderit i Shoqatës së Ombudsmanëve të Mesdheut, z. Abdelaziz Benzakour; Ambasadori Amerikan në Tiranë, z. Donald Lu, zv/kryetari i Delegacionit të Bashkimit Europian në Tiranë, z. Clive Rumbold, Kryetari i Prezencës së OSBE në Tiranë, z. Florian Raunig, Kreu i Zyrës së Këshillit të Evropës në Shqipëri, z. Marco Leidekker, Koordinatorja e Përhershme e Kombeve të Bashkuara në Shqipëri znj. Zineb Toumi-Benjelloun, Ambasadori i Mbretërisë së Danimarkës, z. Mads Sandau-Jensen. Kurse në emrët të shoqërisë civile përshëndeti znj. Meleqe Rrenja, kryetare e shoqatës “Gruaja Rome e së nesërme.”

Të gjithë folësit vlerësuan rolin dhe kontributin e institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen, respektimin dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri gjatë këtyre viteve.

## 7.5 Konferenca Kombëtare e Avokatit të Popullit

Në bazë të nenit 30 të ligjit nr. 8454/1999 “*Për Avokatin e Popullit*”, i ndryshuar, institucioni ynë në bashkëpunim me organizatat joqeveritare duhet të organizojë, të paktën një herë në vit, veprimtari kombëtare për gjendjen e të drejtave dhe lirive të njeriut në Republikën e Shqipërisë. Në zbatim të këtij detyrimi, në datën 17 dhjetor 2015, në bashkëpunim me shumë aktorë të shoqërisë civile, pushtetit vendor, institucioneve të tjera shtetërore dhe organizatave të ndryshme ndërkombëtare që veprojnë në vendin tonë, u organizua Konferenca Kombëtare me temë “*Qeverisja Vendore dhe të Drejtat e Njeriut*”.

Përzgjedhja e kësaj temë u motivua jo vetëm nga fakti që pushteti vendor ka shumë detyrime për marrjen e masave me qëllim përmirësimin e jetës së njerëzve (*veçanërisht të atyre që janë vulnerabël e pa përkrahje*), por edhe nisur nga sfidat që paraqet zbatimi i reformës së re administrative dhe territoriale. Kujtojmë se institucioni ynë gjatë gjithë veprimtarisë së tij, por veçanërisht vitet e fundit, ka patur në vëmendje të veçantë veprimtarinë e njësive të pushtetit vendor me qytetarët. Kjo për shkak jo vetëm të detyrimeve ligjore, por edhe sepse pjesa më e madhe e ankesave që hetohen dhe trajtohen nga institucioni ynë, kanë lidhje me veprimet (apo mosveprimet) e administratave të qeverisjes vendore.

Gjatë punimeve të konferencës u evidentua fakti që grupet e cënueshme janë përherë e më shumë të ekspozuar nga sfidat e një tranzicioni të vështirë dhe të vendosura në skajet e shoqërisë, me standarde të ulëta ekonomike; me mundësi të pakta arsimimi; me nivel tepër të lartë papunësie; me aftësi të kufizuara lëvizjeje; me praninë e një realiteti dhe mentaliteti social jo shumë integruar.

Nga të gjithë aktorët u ra dakord se duhet të intensifikohet lufta kundër diskriminimit ndaj çdo grupi të cënueshëm, veçanërisht në nivel vendor, ku ka një ndikim të drejtpërdrejtë dhe të menjëhershëm mbi jetën e qytetarëve, duke marrë masa konkrete, veçanërisht kur kemi të bëjmë me fëmijët dhe gratë. Qasja e plotë në arsim, punësim, strehim dhe në kujdesin shëndetësor duhet të jetë standardi normal për gjithë qytetarët, përfshirë romët, personat aftësi të kufizuara, pakicak dhe personat LGBTI që përballen me intolerancë, veçanërisht në nivel vendor. Nga konferenca rezultoi se pavarësisht progresit që është bërë në nivelin e pushtetit vendor me reformën territoriale administrative, përsëri mbetet shumë për të bërë, me qëllim sqarimin e funksioneve dhe përgjegjësisë të njësive të reja të pushtetit vendor, si dhe rritjen e kapaciteteve financiare dhe administrative të tyre.

Në këtë Konferencë vjetore, u arrit qëllimi që të mblidheshin dhe të diskutonin së bashku të gjitha palët, duke përfshirë institucionet shtetërore, organizmat ndërkombëtare, shoqërinë civile, grupet e interesit, etj.

Konferenca vjetore nëpërmjet panelistëve mori përsipër të trajtojë një sërë temash duke nxjerrë konkluzionet përkatëse dhe për të dhënë një sërë rekomandimesh, adresuar organeve të njësive vendore si dhe pushtetit qëndror.

Paneli i parë diskutoi mbi *të drejtën e informimit*, problematikat që shfaqen, ligji i ri për të drejtën e informimit, mungesa e burimeve njerëzore në Mekanizmin për të drejtën e informimit

dhe të dhënat personale për zbatimin e këtij ligji, moszbatimi i ligjit nga një sërë njësish të qeverisjes vendore, ndryshimet e shpeshta në administratë si dhe mungesa e kulturës në dhënien e informacionit, etj.

Në panelin e dytë u diskutua lidhur me të ***drejtat e fëmijëve në përgjithësi*** dhe me ***shfrytëzimin e punës së fëmijëve në veçanti***, mungesa e të dhënave për numrin e këtyre fëmijëve, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve pranë njësive të pushtetit vendor dhe vazhdimësia e tyre, krijimi i një sistemi të integruar për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qendror dhe vendor, marrja e masave konkrete për ndalimin e fenomenit të shfrytëzimit të fëmijëve për punë dhe t'ju sigurojnë fëmijëve arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës në respektim të të drejtave të tyre.

Në panelin e tretë u diskutua **për të drejtat e grave**, duke referuar problematika si mungesa e buxhetimit për mekanizmat e referimit të dhunës, viktimat e dhunës në familje dhe nevojën për mbrojtje duke përfshirë dhe atë financiare, ngritjen dhe fuqizimin e strukturave shtetërore në mbështetje të barazisë gjinore, krijimi dhe fuqizimi i rrjetit të nëpunësve gjinorë, fuqizimi i mekanizmit kombëtar të barazisë gjinore, si dhe promovimi i ekuilibrave gjinorë në vendimmarrje si sfida për tu adresuar.

Lidhur me ***personat me aftësi të kufizuara*** u diskutua në panelin pasardhës, në të cilën u diskutuan problematikat që prekin këtë kategori, diskriminimi, përjashtimi shoqëror, mungesa e shërbimeve të posaçme, rritja e rolit të organizatave në përbërje me anëtarë të kësaj kategorie, mosreflektimi në mënyrën e duhur të parashikimeve ligjore në kundërshtimin me nenin 12, të Konventës të OKB-së, indeksimi i pagesave, nxitja e punësimit, përjashtimi nga taksat vendore të invalidëve të punës, etj.

Në panelin e pestë u diskutua për ***moshën e tretë***, miratimi i statusit të kësaj moshe, ngritja e qendrave rezidenciale dhe ditore, garantimi i të drejtave të tyre, ngritja e një databaze me të dhënat me këtë kategori, rritja e vëmëndjes nga institucionet shtetërore, etj.

Në panelin e gjashtë u diskutua **për minoritetet**, kryesisht për minoritetin Rom dhe komunitetin Egjiptian, mosadresimi si duhet i fondeve të akorduara për këto grupe, arsimi, shëndetësia, strehimi, ratifikimi i Kartës rajonale të gjuhëve minoritare, etj.

***Komuniteti LGBTI*** ishte gjithashtu pjesë e diskutimeve të kësaj Konferencë Kombëtare, ku problematikë është evidentuar lidhur me sistemin arsimor, aksesin në shërbime shëndetësore, punësimin, ndërgjegjësimin, përfshirjen e njohurive për këtë grup në kurrikula, etj.

***Shëndetësia dhe arsimi*** si dy fusha tepër të rëndësishme u diskutuan në një panel tjetër, duke marrë kështu vëmëndje të diskutantëve jo vetëm për politikat e reja fiskale për profesionet e lira, por kryesisht edhe për mungesën e shërbimit cilësor dhe dinjtioz, mungesën e mjekëve, korrupsionin në këto dy sektorë, rritjen e numrit të sëmurëve të shëndetit mendor, etj.

***Lidhur me bashkitë***, sipas edhe ndarjes së re territoriale administrative, nga diskutantët u referuan problematika të ndryshme dhe rekomandimet përkatëse për nxitjen e veprimtarisë së shoqërisë civile, planifikimet buxhetore më të mirë studiuar, mungesën e një statusi për shfrytëzimin e tokës të ndarë sipas ligjit 7501, pjesëmarrjen më të gjerë të qytetarëve në vendimmarrjet e qeverisjes vendore, etj.

Gjatë konferencës nga ana e institucionit tonë, u evidentuan edhe një sërë sfidash e problematikash, që lidhen me njësitë e qeverisjes vendore, si vijon:

- **Zbatimi i strukturës së re organizative**, për shkak të suprimimit të një numri të konsiderueshëm të njësive vendore duhet të jetë i mirëstudiuar, transparent, si dhe i mbështetur në ligj, me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe përmirësimin e jetës të qytetarëve;
- Rritja e buxhetit dhe rritja e numri të programeve sociale për të mbuluar nevojat të shtetasve **me strehim**;
- **Punësimi i** shtetasve duhet të jetë në fokus të njësive të qeverisjes vendore për të ofruar zgjidhje atraktive për sipërmarrës të ndryshëm;
- Vëmëndja ndaj **grupeve vulnerabël** duhet të jetë një objektivi për njësitë e reja të pushtetit vendor me qëllim jo vetëm identifikimin e nevojave specifike për të gjitha komunitetet, por njëkohësisht ofrimit dhe të shërbimeve të tilla që të plotësojnë nevojat e tyre. Kujdes duhet treguar me respektimin e të drejtave të minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian. Trajtimi dhe fokusimi tek grupet më të dobëta, si: fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, personat në nevojë subjekt i ndihmës ekonomike, gratë e dhunuara, etj. Këtyre grupeve do duhet tu kushtohet më shumë vëmëndje nga njësitë vendore, nëpërmjet programeve që do të ndërmerren tashmë, duke mbuluar një rajon më të gjërë.
- **Rritja e bashkëpunimit me shoqatat dhe grupet e interesit** do të ndihmojë në njohjen e situatës dhe problematikës së komunitetit, por edhe gjetjen e zgjidhjeve sa më të favorshme për komunitetin.

Një përmbledhje e punimeve të konferencës i është dërguar Kuvendit. Institucioni i Avokatit të Popullit do të vijojë përpjekjet në mbrojtje të interesave të shtetasve shqiptarë në raport me organet e qeverisjes vendore, si nëpërmjet monitorimit të zbatimit të legjislacionit të qeverisjes vendore, ashtu edhe për respektimin e parimit të decentralizimit, apo të ofrimit të të gjithë shërbimeve për shtetasit në nivel vendor.

## **7.7 Vlerësimi me statusin A, të institucionit të Avokatit të Popullit**

Me qëllim që Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut të konceptohen dhe të veprojnë në përputhje me Parimet e Parisit dhe të veprojnë si institucione lidere në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ato i nënshtrohen procesit të akreditimit i cili kryhet çdo 4 vjet. Disa nga kriteret që udhëheqin procesin e akreditimit janë: gëzimi nga ana e institucionit të një mandat të gjerë, bazuar në normat dhe standardet universale të të drejtave të njeriut; autonomia nga qeveria; pavarësia e garantuar në kushtetutë ose statut; pluralizmi; burimet e përshtatshme financiare dhe pasja e kompetenca të qarta për hetimi dhe investigimi.

Nivelet e akreditimit të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut janë tre: “A”, “B”, “C”, ku A është statusi më i lartë. Institucionet me statusin A, mund të marrin pjesë me të drejta të plota në punime dhe takime rajonale dhe ndërkombëtare të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut, të mbajnë pozicione drejtuese në Zyrën e Komitetit Ndërkombëtar Koordinues (ICC), ose në një nga nën-komitetet e saj. Gjithashtu, mund të marrin pjesë në sesionet e punimeve të Këshillit për të Drejtat e Njeriut dhe të ndërhyjnë sipas fushave të caktuara në axhendë.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Shqipërisë **është akredituar me Statusin “A”** për herë të parë në vitin 2004; është riakredituar në vitin 2008, dhe në vitin 2015 pas një procesi verifikimi, arriti të ruante të njëjtin status. Më konkretisht në nëntor 2013 nën-komiteti për Akreditimet rekomandoi **shtyrjen e riakreditimit për në sesionin e dytë të 2014**, duke njohur dhe vlerësuar përpjekjet e rëndësishme të Avokatit të Popullit për zbatimin e rekomandimeve të vitit 2008, përfshirë ngritjen e zyrave rajonale dhe forcimin e angazhimit në sistemin ndërkombëtar të të drejtave të njeriut.



Kështu, në përmbushje të këtyre rekomandimeve, Avokati i Popullit zgjeroi në mënyrë të dukshme praninë dhe kontributin e tij në rrjetet ndërkombëtare si Rrjeti Europian i Institucioneve të Drejtave të Njeriut (European Network of National Human Rights Institutions - ENNHRI), AOM (Organizata e Ombudsmanëve të Mesdheut), AOMF (Organizata e Ombudsmanëve dhe Mediatorëve Frankofonë), në vetë ICC, etj.

Po ashtu institucioni i Avokatit të Popullit, luajti një rol aktiv edhe në dërgimin e raporteve paralele (apo siç quhen ndryshe “raportet hije” në organizmat respektive të OKB-së në kuadrin e Kontrollit Periodik Universal (Universal Periodic Review- UPR), Mekanizmit të Procedurave të Posaçme (United Nations Special Procedures Mechanism), etj. Gjithashtu gjatë vitit 2015 u forcua ndërveprimi i institucionit edhe me strukturat Europiane si Komisioni Europian kundër Racizmit dhe Intolerances (European Commission against Racism and Intolerance-ECRI, pranë Këshillit të Evropës) dhe strukturat e tjera që mbrojnë të drejtat e grupeve të caktuara shoqërore apo atyre me aftësi të kufizuar, minoritetet, personat LGBTI, etj.

Gjatë periudhës më të fundit të akreditimit, institucioni u përfshi në një veprimtari të fuqishme të promovimit të drejtave të njeriut, së bashku me shoqërinë civile dhe mediat, me të cilat ka vendosur dhe ushqen një marrëdhënie dypalëshe të frytshme. Krahas kësaj, ai hartoi një humër raportesh speciale të cilat përveçse me Kuvendin e Shqipërisë, janë ndarë gjerësisht me shoqërinë civile dhe komunitetin ndërkombëtar.

Për të gjitha këto arsye Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Kombëtare të Drejtave të Njeriut, ***i akordoi për herë të tretë institucionit të Avokatit të Popullit statusin “A”, që është edhe niveli më i lartë i akreditimit.***

## **KREU 8**

### **Avokati i Popullit dhe veprimtaria ndërkombëtare**

Dimensioni ndërkombëtar i veprimtarisë së Avokatit të Popullit, në ndërveprim me faktorët brenda dhe jashtë vendit, përbën një aspekt thelbësor të angazhimeve institucionale në përbushje të misionit kushtetues për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut. Viti 2015 ka shënuar një veprimtari të ngjeshur diplomatike të institucionit si në rrafshin dypalësh, ashtu edhe në atë shumëpalësh në kuadër të organizatave dhe mekanizmave rajonale dhe ndërkombëtare. Rëndësi të posaçme në aktivitetin e Avokatit të Popullit ka patur kontributi në kuadër të procesit të integritetit në Bashkimin Europian, duke qenë të drejtat e njeriut një prioritet i mëvetësishëm, por njëkohësisht edhe pjesë integrale e reformave dhe prioritetëve në kuadër të Progres Raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë.

Riakreditimi i Avokatit të Popullit si institucion me Statusin A, nga Komiteti Ndërkombëtar Koordinues i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC) nënvizoi ndër të tjera forcimin e ndërveprimit institucional me sistemin e organizatave dhe mekanizmave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Falë aktivizimit dhe kontributit proaktiv në rrafshin ndërkombëtar, Avokati i Popullit z. Totozani, u rizgjodh në Tetor 2015 në strukturat drejtuese të Organizatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Vendeve Frankofone (AOMF), si edhe në Nëntor 2015 në bordin botëror të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI).

Viti 2015 është karakterizuar nga një axhendë e gjerë angazhimesh të Avokatit të Popullit në cilësinë e Presidentit të Organizatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), veçanërisht referuar krizës së flukeseve migratore. Gjithashtu, Avokati i Popullit ka vijuar të kontribuojë aktivisht në përbushjen e mandatit në postet drejtuese ku është zgjedhur me herët gjatë vitit 2014, si anëtar i Bordit Drejtues për Europën (ECC/ENHRI) dhe i Bordit të ICC-së. Në drejtimin e Avokatit të Popullit, në tetor 2015, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) pranë institucionit përmylli Kryesimin një-vjeçar të Rrjetit të MKPT-ve në Evropën Juglindore (NPM-SEE), duke koordinuar dhe realizuar një sërë veprimtarish të rëndësishme rajonale dhe ndërkombëtare. Avokati i Popullit ka vijuar komunikimin dhe bashkëpunimin me një sërë organizatash dhe institucioneve të rëndësishme ndërkombëtare në kuadër të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), Këshillit të Europës (CoE), Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë (OSBE), si edhe Bashkimin Europian.

Viti 2015 shënon gjithashtu edhe kurorëzimin e procesit të anëtarësimit me të drejta të plota të institucionit të Avokatit të Popullit në Rrjetin Europian të Ombudsmanëve për Fëmijët (ENOC).

Avokati i Popullit mban marrëdhënie shumë aktive edhe në rrafshin dypalësh me institucionet homologe në rajon, BE dhe më gjerë, si edhe me përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare që operojnë në vend dhe përfaqësitë diplomatike e akredituara në Tiranë. Gjatë vitit 2015 është shënuar një intensifikim i aktivitetit rajonal, përmes komunikimit dhe bashkëveprimit të drejtpërdrejtë me institucionet homologe nga vendet e Ballkanit në kontekstin dypalësh, por edhe në kuadër të rrjeteve dhe organizatave rajonale e ndërkombëtare. Gjithashtu, gjatë vitit 2015 veprimtaria e institucionit të Avokatit të Popullit është karakterizuar nga një ndërveprim i zgjeruar dhe i qëndrueshëm me faktorin ndërkombëtar në Shqipëri, në funksion të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave të njeriut dhe të grupeve vulnerabël, si edhe nismat ligjore dhe reformat institucionale në vend.

Në bashkëveprimin me komunitetin ndërkombëtar brenda dhe jashtë vendit, veprimtaria e Avokatit i Popullit i vë theks të veçantë përthithjes, promovimit dhe kontekstualizimit të praktikave të mira dhe standardeve të të drejtave të njeriut, në nivel Europian dhe ndërkombëtar – duke përfshirë edhe jurisprudencën europiane në fushën e të drejtave të njeriut.

Në këtë drejtim, rëndësi i është dhënë fuqizimit të kapaciteteve institucionale përmes vizitave studimore, programeve të shkëmbimit, kualifikimit të vazhdueshëm në trajnime të profilizuara, si edhe pjesëmarrjes aktive në nismat dhe grupet tematike të punës në kuadër të institucioneve dhe organizatave rajonale dhe ndërkombëtare. Pjesë tejet e rëndësishme e veprimtarisë së institucionit të Avokatit të Popullit, gjatë vitit 2015 ka vijuar të jetë monitorimi i zbatimit të detyrimeve që Shqipëria ka si palë në konventat dhe instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Gjithashtu, Avokati i Popullit është angazhuar aktivisht në ndërgjegjësimin dhe lobimin pranë faktorit ndërkombëtar, në funksion të mobilizimit të mbështetjes së duhur lidhur me zhvillime problematike në vend për të drejtat e njeriut dhe grupet vulnerabël. Kontributet e Avokatit të Popullit në rrafshin ndërkombëtar, kanë mundësuar ndër të tjera edhe pjesëmarrjen e Shqipërisë në dialogun ndër-kulturor dhe projekti-min e perspektivave dhe eksperiencës shqiptare në gjirin e organizatave dhe institucioneve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut.

### **8.1. Institucioni i Avokatit të Popullit, në mbajtjen e Presidencës së AOM**

Avokati i Popullit vijon *mandatin e tij dy-vjeçar si President i Organizatës së Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)* në të cilin u zgjodh me unanimitet të plotë gjatë punimeve të Asamblesë së Përgjithshme të mbajtura në muajin Qershor 2014. Viti 2015 paraqet një veprimtari të spikatur në rrafshin Europian dhe ndërkombëtar të AOM-it, nën kryesimin e z. Totozani. Në bashkëveprim të ngushtë me Bordin Drejtues, Sekretariatit e AOM-it dhe institucionet anëtare, janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmbushje të objektivave dhe projekteve të organizatës. Në funksion të forcimit të kapaciteteve organizative, ndër të tjera u përgatit *Studimi i Praktikave të Mira nga Institucionet e AOM –it*, si edhe u mbajt në Rabat (Marok), në Tetor 2015, seminari trajnues me fokus sfidat dhe potencialet për institucionet e Ombudsmanit karshi teknologjive të reja të informimit dhe komunikimit. Gjithashtu janë ndjekur hapat përgatitore për një sërë projektesh të rëndësishme që kurorëzohen gjatë vitit 2016, duke përfshirë këtu organizimin e misionit mbështetës për institucionin e Ombudsmanit të Tunizisë në bashkëpunim me Komisionin e Venecias, si edhe ngritjen e Institutit të Maltës, si një qendër trajnime dhe kualifikimi për AOM dhe më gjerë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut.

Viti 2015 paraqet një veprimtari të spikatur në rrafshin Europian dhe ndërkombëtar të AOM-it nën kryesimin e Avokatit të Popullit, z. Totozani, veçanërisht referuar *krizës së refugjatëve dhe emigrantëve në hapësirën e gjerë të Mesdheut*. Në Shtator 2015, në cilësinë e Presidentit të AOM-it, z. Totozani i drejtoi një letër Presidentit të Komisionit Europian, z. Jean Claude Juncker, duke nënvizuar rëndësinë e garantimit të një përqsajeje bazuar tek drejtat e njeriut për politikat dhe angazhimet afat-shkurtra dhe afat-gjata karshi sfidës së flukseve mikse migratore. Nga ana tjetër, z. Juncker shprehu vlerësimin për mbështetjen ndaj institucioneve të BE-së nga ana e rrjetit të institucioneve të të drejtave të njeriut të AOM-it. Avokati i Popullit, në kryesimin e AOM-it gjatë vitit 2015, ka ndërmarrë një rol proaktiv për ndërgjegjësimin e aktorëve lokalë, rajonalë dhe ndërkombëtarë lidhur me zhvillime problematike për të drejtat dhe liritë themelore. Ndër të tjera, gjatë muajit Nëntor 2015, AOM publikoi një deklaratë mbi profilizimin e refugjatëve/ emigrantëve në bazë të kriterit të kombësisë/shtetësisë, duke nënvizuar rëndësinë e shmangies së praktikave të tilla diskriminuese nga vendet rajonale që janë pjesë e “Itinerarit Ballkanit” të flukseve migratore drejt Europës.

Në funksion të krijimit të sinergjive në axhendën e angazhimeve ndërkombëtare, Avokati i Popullit gjithashtu mundësoi që tematika e refugjatëve dhe azilkërkuesve të ishte në fokus të *seminarit ndërkombëtar që institucioni bashkë-organizoi me Komisionin Europian* në kuadër të programit *TAIEX* dhe që u mbajt në Nëntor 2015 këtu në Tiranë. Në këtë veprimtari të

rëndësishme morën pjesë ndër të tjerë Ombudsmanë nga vendet rajonale të cilat janë anëtare të AOM.

Me qëllim sensibilizimin dhe lehtësimin e bashkëpunimit me aktorët ndërkombëtarë, në muajin Dhjetor 2015 u publikua buletini informues elektronik me fokus veprimtaritë e AOM dhe anëtarëve të saj, kundrejt zhvillimeve të valës së paprecedentë të refugjatëve dhe emigrantëve.

Nën drejtimin e Avokatit të Popullit në cilësinë e Presidentit të AOM-it, janë ndjekur në vijimësi një sërë procesesh dhe projektesh me rëndësi për organizatën duke përfshirë edhe procesin paraprak për realizimin e studimit krahasimor me fokus, problematikën e flukseve mikse migratore.

Gjithashtu është konsoliduar plani strategjik për sigurimin e financimeve në shërbim të projekteve të përbashkëta dhe ngritjes së kapaciteteve të organizatave anëtare, duke përfshirë një sërë vizitash dhe negociatash me zyrtarë të institucioneve të rëndësishme të BE-së dhe institucioneve/organizatave ndërkombëtare në Bruksel, Strasburg dhe Gjenevë. Në këtë kuadër, janë vendosur kontaktet me synim përthithjen e mbështetjes financiare dhe krijimin e partneriteve duke përfshirë Këshillin e Europës, Bashkimin Europian, Organizatën për Bashkëpunim dhe Zhvillimin Ekonomik, si edhe mekanizmat në kuadër të sistemit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Gjithashtu gjatë vitit 2015, u krijua Komiteti i Pranimeve pranë AOM, i cili ka administruar aplikimet për anëtarësim, në funksion të zgjerimit potencial të organizatës me katër institucione të reja anëtare.

Referuar objektivave të AOM-it për fuqizimin e marrëdhënieve me publikun dhe vizibilitetin e organizatës, vlen për t'u përmendur përgatitja për lançimin e platformës së re "online". Finalizimi i këtij portali në krye të vitit 2016 gjatë kryesimit të AOM nga Avokati i Popullit, do të përbëjë edhe një vlerë të spikatur dhe kontribut të qëndrueshëm për organizatën në vijimësi.

## **8.2. Bashkëpunimi i institucionit të Avokatit të Popullit, me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare**

Gjatë punimeve të Kongresit IX të Shoqatës së Ombudsmanëve dhe Mediatorëve të Frankofonisë (AOMF), mbajtur më 13–15 tetor 2015, në Kebek të Kanadasë, **Avokati i Popullit z. Totozani u rizgjodh unanimitisht Anëtar i Bordit Administrativ të AOMF-së**. Kjo veprimtari e rëndësishme u përmbyll me një Deklaratë të përbashkët, me anë të së cilës bëhet thirrje për forcim dhe konsolidim të institucioneve të ndërmjetësimit, si promotore të vlerave demokratike, të shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut. Me tematikën "*Ombudsmanët/Mediatorët: promotorë të qeverisjes së mirë dhe gardianë të integritetit të administratës*", kongresi ishte rast i mirë që ombudsmanët dhe mediatorët e të gjitha vendeve frankofone të shkëmbenin perspektivat mbi sfida të tilla si rolin e tyre konkret në kontekstin e krizës së qeverisjes shtetërore si dhe integritetin e transparencën e administratës. Kongresi i AOMF-së miratoi gjatë punimeve të tij anëtarësimin me të drejta të plota të institucionit të Ombudsmanit të Kosovës.

Punimet artistike të fëmijëve shqiptarë u prezantuan krahas atyre nga Benini, Franca, Mauritania, Senegali dhe Kanadaja, si pjesë e një ekspozite artistike dhe katalogu me fokus të drejtat e fëmijëve, prezantuar gjatë zhvillimit të Kongresit IX, të AOMF-së. Institucioni i Avokatit të Popullit koordinoi dhe mundësoi përfshirjen e fëmijëve në këtë projekt ndërkombëtar, i cili synoi ndërgjegjësimin e fëmijëve për të drejtat e tyre dhe për punën e Ombudsmanëve, si edhe shprehjen artistike nga ana e tyre e të drejtave që ato gëzojnë nga Konventa e OKB-së, për të Drejtat e Fëmijëve.

Në muajin Tetor 2015, **Avokati i Popullit z. Totozani u rizgjodh si anëtar i Bordit Botëror pranë Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI)**, në vijim të mandatit të tij në këtë post gjatë

vitit 2014. Referuar rëndësisë dhe shtrirjes së kësaj organizate – me rreth 150 institucione anëtare nga Europa, Azia, Australia dhe Paqësori, Amerika Latine dhe Karaibet, si edhe Amerika e Veriut – vlen të theksohet se përfaqësimi në këtë nivel drejtimi përbën një arritje të spikatur për institucionin e Avokatit të Popullit në arenën ndërkombëtare. Në kuadër të bashkëpunimit dhe mbështetjes së ndërsjelltë mes institucioneve homologe anëtare, si pjesëtar i Bordit European, Avokati i Popullit ka mbështetur angazhimet dhe deklaratat zyrtare të IOI-së në mbrojtje të institucionit të Ombudsmanit nga vendet anëtare, të cilët përballen me një terren të vështirë për përmbushjen e misionit të tyre, përfshirë këtu vështirësi dhe pengesa që lidhen me presionin politik, mungesën e bashkëpunimit ndër-institucional, si edhe kufizimin e burimeve financiare dhe mbështetëse në dispozicion. Ndër të tjera, përmes rrjetit të komunikimit dhe platformës online të IOI-së, institucioni i Avokatit të Popullit ka shpërndarë gjerësisht raportet periodike dhe ato të veçanta tematike, si edhe ka sensibilizuar faktorin ndërkombëtar lidhur me zhvillime problematike dhe çështje të aktualitetit të të drejtave të njeriut në Shqipëri. Diskutime lidhur me IOI ishin pjesë e vizitës zyrtare që Avokati i Popullit zhvilloi në 7 korrik 2015, në Vjenë (Austri), në Institucionin e Ombudsmanit Austriak (AOB), pranë të cilit është atashuar edhe Sekretariati i Përhershëm i IOI-së.

Angazhimet dhe bashkëpunimet në kuadër të **Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të të Drejtave të Njeriut (ICC) dhe krahut European të kësaj organizate botërore (ENNHRI)** përbëjnë veprimtari me peshë specifike të veçantë në axhendën e veprimtarive ndërkombëtare. Në datat 9–13 mars 2015, Avokati i Popullit z. Totozani mori pjesë në punimet e **Sesionit të 28-të vjetor** të ICC-së në Gjenevë (Zvicër). Në fokus të këtij takimi të rëndësishëm periodik, u trajtua ndër të tjera Plani Strategjik 2013–2015 si edhe koordinimi dhe bashkëpunimi i ICC-së me mekanizmat dhe institucionet rajonale dhe globale që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut. Në kuadër të vizitës së tij në Gjenevë, Avokati i Popullit zhvilloi ndër të tjera takime me përfaqësues të Zyrës së Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe Komitetin për të Drejtat e Njeriut (KDNJ) pranë OKB-së. Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit ka vijuar të japë kontributin e vazhdueshëm në cilësinë e anëtarit të Byrosë së ICC-së, e cila përbëhet prej 16 anëtarësh nga 4 rajonet e ndryshme të botës dhe që përfaqëson një nga organet më të rëndësishme të ICC-së.

Më 6 – 9 Tetor 2015, Avokati i Popullit z. Totozani, mori pjesë në **Konferencën e 12-të të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC)**,<sup>100</sup> e cila këtë vit u mbajt në Merida/ Jukatan të Meksikës. Në fokus të kësaj veprimtarie të spikatur në nivel ndërkombëtar për të drejtat e njeriut ishte tematika “*Objektiva për Zhvillim të Qëndrueshëm: Çfarë roli për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut?*” Konferenca e bashkë-organizuar nga ICC, Komisioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut i Meksikës (CNDH) dhe Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), **konkludoi me miratimin e Deklaratës së Meridas, një dokument historik pikë referimi që inkurajon të gjithë NHRI-të**, në përputhje me mandatet e tyre referuar Parimeve të Parisit, të bashkëpunojnë në ndërtimin e kapaciteteve të ndërsjellta dhe shkëmbimin e përvojave për të kontribuar në një qasje bazuar tek të drejtat e njeriut të Axhendës për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

---

<sup>100</sup> Gjatë vitit të mëparshëm 2014, Ndën-komiteti për Akreditimin pranë ICC-së, në kontesktin e vlerësimit periodik katër-vjeçar, riakreditoi institucionin e Avokatit të Popullit si institucion me Statusin A, për përputhshmërinë me Parimet e Parisit të OKB-së në zbatimin e mandatit të tij të gjerë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, duke përfshirë ndërveprimin dhe bashkëpunimin me sistemin ndërkombëtar të institucioneve dhe mekanizmave të të drejtave të njeriut. Shih edhe nënkreun 7.7 të këtij raporti.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka qenë vecanërisht aktiv dhe ka kontribuar në një sërë procesesh dhe veprimtarish në kuadër të **ENNHRI-t, rrjetit të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në rajonin e Europës**. Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit z. Totozani ka vijuar angazhimet e tij në cilësinë e anëtarit të Bordit Drejtues (ECC) të ENNHRI-t, duke përfshirë vendimmarrjen për objektivat strategjike, projektet dhe partneritetet, si edhe duke mbështetur veprimtarinë e Sekretariatit të ENNHRI-t, me seli në Bruksel.

Në kuadër të grupeve tematike të punës të ENNHRI-t, institucioni i Avokatit të Popullit ka dhënë kontributin e vet të vazhdueshëm përmes shkëmbimit të informacionit dhe ekspertizës përmes platformave “online” të komunikimit, si edhe përmes pjesëmarrjes në kalendarin e takimeve periodike. Referuar ENNHRI-t, kontribute të vazhdueshme janë dhënë gjithashtu edhe në grupet e punës për të drejtat e refugjatëve dhe azilkërkuesve, si edhe për mbështetjen e institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut që përballen me vështirësi në zbatimin e mandatit të tyre.

**Platforma OPRE** është një iniciativë e re e krijuar nga Këshilli i Europës dhe CAHROM, në partneritet me ENNHRI FRA dhe EQUINET, në të cilën institucioni i Avokatit të Popullit është përfaqësuar në dy takimet e zhvilluara gjatë vitit 2015 nga Komisioneri i Seksionit të Administratës.<sup>101</sup> Kjo platformë u lançua më herët gjatë vitit 2015, së bashku me një Deklaratë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e bashkëpunimit mes institucioneve kombëtare dhe organizmave ndërkombëtare, në katër drejtime kryesore: azili dhe migracioni, barazia për Romët, krimet e urrejtjes, si edhe të drejtat ekonomike dhe sociale. Çështje në fokus kanë qenë ndër të tjera edhe lehtësimi i aksesit për romët dhe nomadët ndaj drejtësisë dhe mekanizmave për raportimin e krimeve të urrejtjes dhe diskriminimit, si edhe problematika e strehimit për Romët dhe zhvendosjeve me forcë në mungesë të alternativave për strehim. Përmes Platformës OPRE, qëndrimi i Avokatit të Popullit lidhur me zhvendosjen e komunitetit Rom pranë liqenit artificial në Tiranë si dhe çështjet që kanë të bëjnë me strehimin janë shpërndarë gjerësisht në funksion të ndërgjegjësimit të faktorit ndërkombëtar.<sup>102</sup>

Institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua nga Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë gjatë punimeve të **Asamblesë së Përgjithshme të ENNHRI-t**, e cila u zhvillua në datat 30 Nëntor – 1 Dhjetor 2015, në Utrecht të Hollandës. Në këtë takim të rëndësishëm u trajtua plani strategjik i veprimtarisë së ENNHRI-t për vitin e ardhshëm, projektet dhe partneritetet e organizatës, si edhe u votua për strukturat organizatës. Në këtë takim që i pranishëm si i ftuar special Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës, z. Niels Muznieks, i cili në prezantimin e tij trajtoi problematikën e krizës emergjente të refugjatëve dhe emigrantëve. Referuar axhendës së prioriteteve dhe grupeve të punës së ENNHRI-t, institucioni i Avokatit të Popullit është angazhuar në dhënien në vijimësi të kontributeve dhe shkëmbimin e ekspertizës në grupet e punës mbi refugjatët e azilkërkuesit, mbi zbatimin e mandatit të Mekanizmave Kombëtarë Parandalues, të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore – si edhe në grupin e ri të punës me fokus Axhendën për Zhvillim të Qëndrueshëm 2030.

Më 15 dhjetor 2015, **institucioni i Avokatit të Popullit u bë anëtar me të drejta të plota në Rrjetin European të Ombudsmanëve për Fëmijët (ENOC)**, pas një procesi aplikimi dhe vlerësimi për përmbushjen e kritereve staturore të organizatës. Krijuar në 1997 dhe me zyrën e Sekretariatit të Përhershëm në Strasburg (Francë), rrjeti ENOC numëron 41 anëtarë, me institucione të pavarura për fëmijët nga 33 shtete anëtare të Këshillit të Europës. Mandati i organizatës është lehtësimi i promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve sic përcaktohen

<sup>101</sup> 29 -30 Janar 2015, Strasbourg, France dhe 3 -4 dhjetor 2015, Strasbourg France

<sup>102</sup> OPRE Platform (Council of Europe, FRA, ENNHRI, EQUINET), 6 tetor 2015.  
[http://a.cs.coe.int/team81/opre\\_platform/SitePages/Home.aspx](http://a.cs.coe.int/team81/opre_platform/SitePages/Home.aspx).

në Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve. Me herët gjatë vitit, institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua në Konferencën Vjetore të 19-të të ENOC me temë luftën kundër dhunës ndaj fëmijëve, aktivitet që u mbajt në datat 23–24 shtator në Amsterdam (Hollandë). Punimet e Asamblesë së Përgjithshme konkluduan ndër të tjera me një Deklaratë të Përbashkët nga ENOC dhe Përfaqësuesja Speciale mbi Dhunën ndaj Fëmijëve pranë OKB-së. Vlen të theksohet se anëtarësimi pranë ENOC, sikurse edhe veprimtaritë për të drejtat e fëmijëve në kuadër të AOMF dhe CRONSEE, përfaqësojnë angazhime të rëndësishme për forcimin e kapaciteteve institucionale në kuadër të krijimit të Seksionit për të Drejtat e Fëmijëve dhe atributet që institucioni ka lidhur me promovimin dhe edukimin e të drejtave të njeriut.

### 8.3. Përfaqësimi i institucionit të Avokatit të Popullit në aktivete ndërkombëtare

Gjatë vitit 2015, institucioni i Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në një sërë aktivitesh ndërkombëtare, në fusha të ndryshme.

Institucioni i Avokatit të Popullit, mori pjesë në *Seminarin për Dimensionit Njerëzor të OSBE-së mbi “Rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (NHRI)”*, mbajtur nga 1- 3 Qershor 2015, në Varshavë, Poloni, përfaqësuar nga Komisionerja e Seksionit të Administratës. Në këtë seminar ndërkombëtar, përfaqësuesja e Institucionit të Avokatit të Popullit mbajti një diskutim në kuadër të panelit me temë: “Përmirësimi i punës së NHRI-ve dhe kapërcimi i sfidave”. Seminari shërbeu jo vetëm në shkëmbimin e përvojave, por edhe në mësimin e praktikave më të mira për të përballuar sfidat e punës së NHRI-ve.

Në kuadër të angazhimeve për promovimin e të drejtave të fëmijëve nga institucionet e ombudsmanit dhe ndërmjetësuesve, përfaqësues të Avokatit të Popullit morën pjesë në *takimin e organizuar nga Organizata Botërore e Frankofonisë (OIF)*, i cili u mbajt në datat 1 – 4 Prill 2015, në Paris (Francë). Gjithashtu në vazhdim të angazhimeve në këtë fushë, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në *punimet e Konferencës së Rrjetit të Ombudsmanëve për të Drejtat e Fëmijëve në Europën Juglindore (CRONSEE)*, e cila u mbajt në 28 Tetor 2015 në Osijek (Kroaci). Përmes mbështetjes dhe në bashkëpunimë me Save the Children Albania, institucioni i Avokatit të Popullit u përfaqësua në këtë veprimtari të rëndësishme në fokus të së cilës ishte protokoli opsional i Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (OP3–CRC) dhe roli i ombudsmanëve për fëmijë.

Në vijim të publikimit nga ECRI, të raportit të 5-të për Shqipërinë, në datat 28–29 Maj 2015, Avokati i Popullit z. Totozani që i pranishëm në punimet e seminarit të nivelit të lartë të ECRI-t me temë, “*Roli i organizmave kombëtarë kundër diskriminimit në adresimin e raportimit të ulët të diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes*”, mbajtur në Strasburg (Francë).

Në 4 Qershor 2015, Institucioni i Avokatit të Popullit mori pjesë në seminarin e nivelit të lartë të organizuar nga OSBE dhe APT, që u mbajt në Varshavë (Poloni), përfaqësuar nga Komisionerja e Seksionit të Administratës. Seminari ishte me fokus zbatimin e mandatit të MKPT-së nga institucionet e ombudsmanit në hapësirën e OSBE-së, përmes shkëmbimit të praktikave të mira, rritjes së efektivitetit të NHRI-ve, forcimin të dialogut ndër-institucional dhe zgjerimi i bashkëveprimit mes aktorëve ndërkombëtarë.

Përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit, në datat 26– 27 Tetor 2015, morën pjesë në *Takimin e 11-të Grupit të Punës të ENNHRI-t mbi zbatimin e Konventës së të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD)*, të organizuar në Zagreb të Kroacisë. Në fokus të këtij takimi ishin, neni 12 i kësaj konvente, si edhe standardet mbi indikatorët dhe praktikat e

monitorimit, për të cilën institucioni i Avokatit të Popullit i ka adresuar Ministrisë së Drejtësisë një rekomandim për pasaktësitë në gjuhën shqip të Konventës.

#### **8.4 Lista e anëtarësimeve**

Institucioni i Avokatit të Popullit aktualisht është anëtar me të drejta të plota në 9 organizata/ rrjete rajonale dhe ndërkombëtare, si më poshtë:

- Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanit (IOI), krijuar në 1978, anëtar që nga viti 2000.
- Instituti European i Ombudsmanit (EOI), krijuar në 1988, anëtar që nga viti 2000.
- Shoqata e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësueve Frankofonë (AOMF), krijuar në 1998, anëtar që nga viti 2000.
- Shoqata e Ombudsmanit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (USOA), krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2006.
- Shoqata e Ombudsmanit Ndërkombëtar (IOA), krijuar në 1977, anëtar që nga viti 2007.
- Shoqata e Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), krijuar në 2008, anëtar që nga viti 2009.
- Komiteti Koordinues Ndërkombëtar për Institucionet Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ICC), krijuar më 1993. Institucioni i Avokatit të Popullit është akredituar në ICC për herë të parë në vitin 2004 dhe është riakredituar në vitin 2008 dhe 2014 me Statusin A.
- Rrjeti European i Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (ENNHRI), krijuar në 2012, anëtar që nga viti 2014.
- Rrjeti European i Ombudsmanëve për Fëmijët (ENOC), krijuar në 1997, anëtar që nga viti 2015.

#### **8.5 Ndërveprimi me institucionet dhe organizatat rajonale dhe ndërkombëtare, që operojnë në fushën e të drejtave të njeriut**

Gjatë vitit 2015 institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar komunikimin dhe ndërveprimin e vazhdueshëm me organizmat dhe mekanizmat e ndryshëm në sistemin e OKB-së, duke përfshirë ndër të tjera Zyrën e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut (OHCHR) dhe Këshillin për të Drejta e Njeriut (KDNj), i cili mbikqyr procesin e Vlerësimit Periodik Universal (UPR), për të gjitha vendet anëtare të OKB-së.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson si moment veçanërisht të rëndësishëm faktin që Shteti Shqiptar është zgjedhur anëtar i KDNj-së për periudhën 2015–2017, duke nxitur kështu përmbushjen e detyrimeve në fushën e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Sikurse evidentohet në rekomandimet e Vlerësimit Periodik Universal për Shqipërinë, të ndërmarrë në 2014, qeveria shqiptare duhet të angazhohet në mënyrë të qenësishme për mbështetjen e veprimtarisë së Avokatit të Popullit – duke përfshirë ndër të tjera garantimin e burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme, si edhe duke ndjekur në vijimësi zbatimin e rekomandimeve të institucionit të Avokatit të Popullit.

Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2015, në ndjekje të zbatimit të rekomandimeve dhe detyrimeve akteve ndërkombëtare, përgatiti dhe dorëzoi raportin hije (“shadow report”) me vlerësimet për zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), në kuadër të punimeve të Grupit të Punës të 64<sup>-të</sup> të CEDAW.

Referuar plotësisht të obligimeve që burojnë nga Konventa e OKB-së për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, në Tetor 2015, institucioni i Avokatit të Popullit adresoi Ministrisë së Punëve të Jashtme një rekomandim lidhur me depozitimin e këtij raporti pranë Komitetit të Zhdukjeve me Forcë.



Gjithashtu, institucioni i Avokatit të Popullit ka përgatitur gjatë vitit 2015, raportin paralel në kuadër të monitorimit të zbatimit të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (CRPD), pranë Komitetit CRPD, pranë OKB-së, krahas raportit të depozituar nga shteti shqiptar.

Një sërë organizatash ndërkombëtare dhe rajonale kanë referuar dhe cituar si burim të besueshëm raportet, analizat dhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të Popullit.

**Raporti i OKB-së për Shqipërinë 2015,<sup>103</sup> prezantuar nga Zyra e OKB-së në Tiranë,** vlerëson angazhimet dhe nismat institucionale të Avokatit të Popullit, për mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të njeriut dhe si edhe grupeve vulnerabël, duke përfshirë këtu edhe ato të komunitetit LGBTI, komunitetit Rom, personave të ngujuar si pasojë e gjakmarrjes, si edhe ish-të përndjekurve politikë. Vlerësohet gjithashtu angazhimi institucional për ndërgjegjësimin lidhur me CEDAW, si dhe nënvizohet roli kyç i Avokatit të Popullit për të drejtat e njeriut në vend dhe rëndësinë e ndjekjes nga institucionet e shtetit shqiptar, të kërkesave për informacion dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit konsideron bashkëpunimin me ECRI-n dhe organizma të tjerë të Këshillit të Europës si veçanërisht të rëndësishëm edhe në funksion të krijimit të koherencës dhe sinergjive të nismave ligjore dhe reformave institucionale, me qëllim plotësimin e kriterëve dhe avancimin e standardeve të të drejtave të njeriut në kuadër të procesit të integritimit European të vendit. Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar komunikimin dhe ndërveprimin e qëndrueshëm me **Komisionin kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI)** pranë Këshillit të Europës, duke dhënë kontributin e vet edhe në kuadër të dialogut konfidencial institucional. Në Raportin e 5-të periodik mbi Shqipërinë, ECRI ndër të tjerash ka evidentuar rolin<sup>104</sup> jetësor të Avokatit të Popullit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të grupeve vulnerabël dhe minoriteteve në veçanti, si edhe kontributin institucional në një sërë nismash ligjore dhe ndërgjegjësuëse, përfshirë këtu të drejtat e minoritetit Rom dhe komunitetit Egjiptian dhe të drejtat e komunitetit LGBTI.

Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit ka mbajtur komunikim të vazhdueshëm me Komisionerin për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës, z. Niels Muzniek, duke përcjellë ndër të tjera edhe gjetjet dhe rekomandimet e institucionit të Avokatit të popullit për problematika emegjente në vend. Spikat ndër të tjera ndërveprimi lidhur me zhvendosjen me forcë të komunitetit rom pranë liqenit artificial në Tiranë – çështje për të cilën Komisioneri z. Niels Muzniek ka ndjekur me vëmendje të veçantë, duke mbështetur angazhimin e posaçëm të Avokatit të Popullit. Gjithashtu edhe Amnesty International më datë 13 Tetor 2015, publikoi një deklaratë zyrtare për zhvendosjen me dhunë të komunitetit Rom – duke vënë theksin mbi nevojën e adresimit nga autoritetet nën dritën e standardeve dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit për trajtimin e kësaj problematike.<sup>105</sup>

<sup>103</sup> UN Albania and Council of Ministers of the Republic of Albania, “Common Country Assessment – Albania”, Tirana 2015, [http://www.un.org.al/editor-files/file/CCA%20Albania\\_2015.pdf](http://www.un.org.al/editor-files/file/CCA%20Albania_2015.pdf).

<sup>104</sup> Mw 28–29 maj 2015, Avokati i Popullit z. Totozani që i pranishëm në punimet e seminarit të nivelit të lartë të ECRI-t me temë “Roli i organizmave kombëtarë kundër diskriminimit në adresimin e raportimit të ulët të diskriminimit dhe krimeve të urrejtjes”, mbajtur në Strasburg (Francë)

<sup>105</sup> Amnesty International, “Albania: 44 Roma families desperately need adequate housing, not forced eviction”, <https://www.amnesty.org/download/Documents/EUR1126442015ENGLISH.pdf>, tetor 2015.

## 8.6 Bashkëpunim i Avokatit të Popullit në rrafshin dypalësh

Avokati i Popullit mban lidhje të drejtpërdrejta dhe bashkëpunim të ngushtë me Ombudsmanët në rajonin e Ballkanit, përfshirë këtu Ombudsmanin e Kosovës, Maqedonisë, Greqisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Bosnie-Hercegovinës.

Viti 2015 është karakterizuar nga shkëmbime dhe bashkëpunime që përfshijnë vizita zyrtare, ndarje informacioni dhe ekspertize, delegim për kompetencë të ndjekjes së praktikave/ankesave të qytetarëve në vendet respektive, si edhe ndërveprim e bashkëpunim në kontekstin e organizatave rajonale, Europiane dhe ndërkombëtare. Aspekt i rëndësishëm i marrëdhënieve në rrafshin dypalësh dhe me një dimension rajonal e Europian është bashkëpunimi në kuadër të krizës emergjente të flukseve mikse migratore, ndër të tjera për monitorimin e situatës dhe angazhimi proaktiv për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të migrantëve të paligjshëm, që tranzitojnë përmes të ashtëquajturit “Itinerari Ballkanik”.

Më 7 Korrik 2015, Avokati i Popullit z. Igli Totozani, zhvilloi një takim zyrtar në Prishtinë me homologun e tij Avokatin e Popullit të Kosovës, z. Hilmi Jashari. Kjo ishte pritja e parë zyrtare për Avokatin e Popullit të Kosovës, i cili mori mandatin e tij më herët në krye të muajit Korrik 2015. Të dy palët shprehën angazhimin për një bashkëpunim të ngushtë të ndërsjellë, shkëmbimin e eksperiencave dhe ekspertizës institucionale (veçanërisht edhe në kuadër të MKPT-së), si edhe për fuqizimin e ndërveprimit me shoqërinë civile në të dyja vendet. Avokati i Popullit z. Totozani shprehu gjithashtu angazhimin për të mbështetur përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e institucionit të Avokatit të Popullit të Kosovës, në organizmat dhe rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare të institucioneve të të drejtave të njeriut. Të dy palët konfirmuan angazhimin për forcimin e bashkëpunimit dhe shkëmbimeve për garantimin e të drejtave për refugjatët dhe emigrantët e paligjshëm që tranzitojnë rajonin e Ballkanit, por edhe mbrojtjen e të drejtave për qytetarët azilkërkues nga rajoni të cilët rikthehen nga shtetet e BE-së në vendet e tyre të origjinës.

Avokati i Popullit ka vijuar bashkëpunimin dypalësh me *institucionin e Ombudsmanit të Greqisë*, duke përfshirë ndër të tjera përcjelljen për kompetencë të ankesave në mbrojtje të të drejtave dhe interesave të ligjshëm të qytetarëve respektivë.

Gjatë vitit 2015 ndërveprimi dypalësh me Ombudsmanët e Greqisë, Maqedonisë dhe Serbisë është intensifikuar edhe në kuadër të nismave dhe veprimtarive rajonale dhe ndërkombëtare mbi krizën emergjente të migracionit.

Në muajin Nëntor 2015, Avokati i Popullit mori pjesë në Konferencën e Ombudsmanëve të mbajtur në Beograd dhe të organizuar nga Ombudsmani i Serbisë. Kjo konferencë konkludoi me një Deklaratë të përbashkët mbi sfidat për hapësirën e Mesdheut, rajonin e Ballkanit dhe më gjerë Europë, më fokus mbrojtjen e të drejtave të migrantëve që tranzitojnë rajonin, mbrojtjen e grupeve vulnerabel, aksesin ndaj institucioneve të Ombudsmanit dhe bashkëpunimin ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2015 ka vijuar komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionin e Ombudsmanit të Turqisë, duke përfshirë edhe përfaqësimin në aktivitete ndërkombëtare reciproke.

Një ndër bashkëpunimet e ngushta dypalëshe janë ato të Avokatit të Popullit me institucionin Ombudsmanit/ Mbrojtësit të të Drejtave të Spanjës, që ka shërbyer edhe për realizimin e vizitave studimore në Madrid.

Avokati i Popullit z. Totozani ka mbajtur një bashkëpunim të ngushtë me homologen e tij *Mbrojtësen e të Drejtave të Spanjës*, zj. Soledad Becerril, veçanërisht në kuadër të drejtimit të AOM-it dhe angazhimeve, referuar krizës së migracionit. Bashkëpunim i rëndësishëm në planin

dypalësh dhe atë shumëpalësh është ai me homologun francez, Mbrojtësin e të Drejtave, z. Jacques Toubon. Në datat 20–24 Maj 2015, Avokati i Popullit z. Totozani kryesoi vizitën pranë institucionit të *Mbrojtësit të të Drejtave të Francës*, vizitë në të cilën morën pjesë edhe përfaqësues të mediave të rëndësishme në vend. Në funksion të shkëmbimit të eksperiencave dhe ekspertizës mbi bashkëpunimin mes komunitetit mediatik dhe institucioneve të ombudsmanit, gjatë kësaj vizite u realizuan ndër të tjera takime me një sërë mediash të fuqishme botërore, si Euronews, Reporters sans Frontières, TV5 Monde, si edhe me përfaqësues të Asamblesë Parlamentare Frankfone dhe Amnesty International France. Bashkëpunimi i ngushtë mes dy institucioneve është shënuar edhe në kontekstin e angazhimeve dhe veprimtarive të AOM-it dhe AOMF-së, duke qenë të dyja organizatat me seli të Sekretariatit të Përhershëm pranë institucionit të Mbrojtësit të të Drejtave në Francë.

Në muajin Korrik 2015, Avokati i Popullit z. Totozani zhvilloi një vizitë zyrtare në Vjenë me ftesë të homologut z. Günther Krauter në *institucionin e Bordit të Ombudsmanit Austriak* (AOB). Gjatë këtij takimi u diskutua për zgjerimin e bashkëpunimit në rrafshin dypalësh, si edhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare – duke përfshirë këtu IOI, Sekretariati i Përgjithshëm i së cilës është atashuar pranë AOB në Vjenë dhe organizatë ku z. Totozani është anëtar i bordit botëror. Bashkëpunimi me AOB është parë edhe në planin e vizitave studimore të stafit edhe të grupit të medias shqiptare, konkretisht në datat 23–27 Nëntor 2015, përfaqësues të mediave të rëndësishme shqiptare zhvilluan një vizitë studimore pranë AOB në Vjenë, me fokus rolin e komunitetit mediatik në promovimin dhe edukimin e të drejtave të njeriut.

Bashkëpunim me rëndësi në rrafshin dypalësh është edhe me institucionin e Ombudsmanit Parlamentar të Danimarkës, pranë të cilit në datat 19–23 Janar 2015, një grup gazetarësh morën pjesë në një vizitë studimore në Kopenhagen, në kuadër të Projektit DANIDA dhe në bashkëpunim me Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut.

Ndër të tjera, në datat 2–5 dhjetor 2015, Avokati i Popullit z. Totozani u prit në një vizitë zyrtare nga homologu i tij *Ombudsmani Parlamentar i Danimarkës* z. Jørgen Steen Sørensen, vizitë gjatë së cilës u trajtuan fusha me interes për zgjerim dhe thellim të bashkëpunimit, duke qenë bashkëpunimi dhe mbështetja e partnerëve institucionalë danezë me rëndësi të spikatur për institucionin e Avokatit të Popullit të Shqipërisë.

Gjatë këtij viti janë shënuar bashkëpunime me rëndësi edhe me institucionet e ombudsmanëve dhe institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në Suedi, Maltë, Gjermani, Çeki dhe Poloni, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit dhe ekspertizës, pjesëmarrjen në veprimtaritë respective dhe koordinimin në kuadër të nismave dhe organizatave ndërkombëtare.

Me mbështetjen e Projektit DANIDA, në datat 26–30 prill 2015, një përfaqësi e përzgjedhur e komunitetit të mediave dhe Këshilltari për Mediat pranë Avokatit të Popullit morën pjesën në një vizitë studimore në Gjermani me takime pranë Institutit Gjerman për të Drejtat e Njeriut, Agjensinë e Komisionierit Federal për Dosjet e Stasi-it, Fondacionin Federal për Rivlerësimin e Diktaturës së RFGDj-së, me fokus reflektimin shoqëror dhe institucional mbi të shkuarën totalitare. Në rrafshin e bashkëpunimit dypalësh, ankesa të qytetarëve të administrura institucionalisht janë përcjellë për kompetencë dhe ndjekje pranë institucioneve homologe në Qipro dhe Luksemburg.

Duke parë tek komuniteti ndërkombëtar një aleat dhe partner të rëndësishëm për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit ka mbajtur kontakte të afërta dhe ka patur një axhendë të ngjeshur bashkëpunimesh me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Tiranë, si edhe me përfaqësitë e organizatave dhe institucioneve të rëndësishme

rajonale dhe ndërkombëtare që operojnë në vend. Me rëndësi të veçantë ka qenë komunikimi, konsultimi dhe ndërveprimi i vazhdueshëm me Ambasadën e Spanjës, Ambasadën e Austrisë, Ambasadën e Gjermanisë, si edhe Ambasadën e Sh.B.A.-ve.

Bashkëpunimi është zhvilluar përmes takimeve në nivel titullarësh, ekspertësh dhe përfaqësuesish specialë për çështje të ndryshme në fushën e të drejtave dhe lirive themelore, në funksion të shkëmbimit të informacionit, konsultimit për çështje emergjente të të drejtave të njeriut dhe grupeve vulnerabël, konsultimit për nisma ligjore dhe reforma institucionale në vend, si edhe partneritetit për organizimin e aktiviteteve të ndryshme.

Angazhimi i faktorit ndërkombëtar në një sërë aktiviteteve të organizuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, ka qenë veçanërisht i rëndësishëm për një sërë dimensionesh prioritare të angazhimit të institucionit të Avokatit të Popullit, sikurse mbrojtja e minoriteteve dhe grupeve vulnerabël, të drejtat e komunitetit Rom dhe problematika e zhvendosjes me forcë nga vendstrehimi pranë Liqenit Artificial në Tiranë, të drejtat e ish-të përndjekurve politikë dhe procesi i lustracionit, e drejtat e pronës, ndërveprimi mes çështjeve mjedisore dhe të drejtave të njeriut, të drejtat e komunitetit LGBTI, kriza emergjente e migracionit etj.

Ndër të tjera vlen të theksohet rëndësia e bashkëpunimit të qëndrueshëm dhe mbështetjes së Ambasadës së Sh.B.A.-ve në Tiranë për institucionin e Avokatit të Popullit dhe avancimin e standardeve të të drejtave të njeriut dhe demokracisë në vend. Gjatë vitit 2015, Avokati i Popullit ka zhvilluar takime dhe vijuar bashkëpunimin me një sërë përfaqësuesish të Departamentit të Shtetit Amerikan (DASH.) për problematika të caktuara. Në muajin Maj 2015, Avokati i Popullit priti pranë mjedisëve të institucionit Nën-sekretaren për Sigurinë Civile, Demokracinë dhe Demokracinë, znj. Sarah Sewall dhe Ambasadorin e Sh.B.A.-ve z. Donald Lu, të cilët shprehën vlerësimin për rolin dhe punën e kryer nga institucioni i Avokatit të Popullit, si edhe nënvizuan lidhjet e ngushta dhe mbështetjen për veprimtarinë e institucionit në mbrojtje të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në Shqipëri. Në Nëntor 2015, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit zhvilluan një takim me zj. Judith E. Heumann, Këshilltare Speciale për të Drejtat Ndërkombëtare të Aftësisë së Kufizuar pranë D.A.Sh., ku u diskutuan edhe problematika që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës së përshtatshme në ambientet publike dhe private, si edhe respektimin e dispozitave ligjore për punësimin, aksesin në drejtësi dhe strukturat e pushtetit qëndror/vendor, si edhe e drejta për arsimim për fëmijëve me aftësi të kufizuar.

Në Raportin për Shqipërinë të DASH, publikuar në Qershor 2015,<sup>106</sup> ndër të tjerash evidentohen edhe problematika e konsultimit jo adekuat nga ana e institucioneve shqiptare të Avokatit të Popullit për nisma ligjore dhe reforma institucionale, të cilat ndërlidhen me fushën e veprimtarisë dhe kompetencave institucionale, si edhe mosshqyrtimi sistematik nga Kuvendi i Shqipërisë i raporteve, dhe problematika e ndjekjes së rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet shtetërore. Nga ana tjetër, raportimet nga DASH përbëjnë dokumenta të rëndësishëm referencë në punën e Avokatit të Popullit.

Gjatë muajit Korrik 2015, u publikua nga DASH raporti për Trafikimin e Qenieve Njerëzore,<sup>107</sup> i cili në pjesën dedikuar Shqipërisë vë theksin mbi problematikat prioritare dhe angazhimet e aktorëve institucionalë të ngarkuar me luftën ndaj këtij fenomeni.

<sup>106</sup> U.S. Department of State, “*Human Rights Report – Albania 2014*”, publikuar në qershor 2015.  
<http://www.state.gov/documents/organization/236704.pdf>.

<sup>107</sup> U.S. Department of State, “*TIP (Trafficking in Persons Report) – Albania*”, publikuar në korrik 2015.  
<http://www.state.gov/documents/organization/245365.pdf>.

Në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe me faktorin ndërkombëtar në vend, Avokati i Popullit ka patur kontakte të vazhdueshme dhe bashkëpunime me Delegacionin e BE-së të Tiranë, si edhe përfaqësitë e organizatave dhe institucioneve rajonale dhe globale që operojnë në vend, si Prania e OSBE-së në Shqipëri (PiA), Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë, Zyra e Koordinatorit Rezident të OKB-së dhe agjensi në kuadër të OKB-së si UNDP, UNHCR, UNICEF dhe UN Women, si edhe Save the Children Albania. Bashkëpunimi është realizuar përmes komunikimit të vazhdueshëm dhe shkëmbimit të informacionit, bashkërendimit të veprimtarive me shoqërinë civile dhe aktorët ndërkombëtarë, partneritetit në aktivitete të përbashkëta sensibilizuese, monitorimin e situatës dhe përgatitjen e raportimeve mbi të drejtat e njeriut, si edhe konsultimin për nisma ligjore dhe reforma institucionale me impakt për të drejtat dhe liritë themelore. Prania e OSBE-së në Tiranë (PiA) vijon të jetë një partner i rëndësishëm për institucionin e Avokatit të Popullit, bashkëpunëtor tepër i rëndësishëm dhe kontribues në aktivitetet e organizuara nga AP. Raportet, analizat dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit përbëjnë informacion të rëndësishëm burimor OSBE-në. Në raportin vjetor mbi Shqipërinë nga Kreu i pranisë së OSBE-së në Tiranë (PiA), Amb. Rauning, prezantuar gjatë mbledhjes plenare të Këshillit të Përhershëm të OSBE-së në Vjenë, në Shtator 2015,<sup>108</sup> nënvizohet rëndësia e bashkëpunimit të ngushtë me Avokatin e Popullit për promovimin, mbrojtjen dhe forcimin e të drejtave të njeriut në Shqipëri, duke përfshirë edhe zbatimin e legjislacionit në mbrojtje të minoriteteve dhe grupeve vulnerabël. Vlen të nënvizohet se në këtë vlerësim të rëndësishëm periodik, theksohet edhe problematika e numrit të vogël të përgjigjeve nga institucionet shtetërore ndaj kërkesave për informacion dhe rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

### **8.7 Ngritja e kapaciteve të stafit dhe vizita studimore**

Përfaqësues dhe staf i institucionit të Avokatit të Popullit ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh dhe vizita studimore me qëllim ngritjen e kapaciteteve në veprimtarinë e tyre,

Në datat 28 Shtator – 2 Tetor, përfaqësues të institucionit të Avokatit të Popullit morën pjesë në programin e trajnimit të organizuar nga AOMF me fokus mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Në datat 27 Qershor – 5 Korrik 2015, stafi pranë Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë mori pjesë në Akademinë e ENNHRI-t, organizuar me mbështetjen e OSBE/ODIHR, në Varshavë të Polonisë. Në fokus të këtij programi kualifikimi ishin standartet e monitorimit të zbatuara nga institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, çështjet e barazisë gjinore në praktikat institucionale, bashkëveprimi me mekanizmat e Këshillit të Europës dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, si edhe koordinimi dhe bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e të drejtave dhe lirive themelore.

Në datat 29 Mars–2 Prill 2015, stafi i MKPT-së zhvilloi një vizitë studimore të bashkërenduar mes Ombudsmanit të Danimarkës dhe MKPT-së pranë këtij institucioni, Institutit Danez për të Drejtat e Njeriut, si edhe Institutit Shëndetësor Danez kundër Torturës.

Në datat 14–18 Qershor 2015, stafi i Seksionit të Përgjithshëm pranë Avokatit të Popullit zhvilloi një vizitë studimore në Madrid, pranë institucionit homolog spanjoll dhe një sërë institutesh me fokus të drejtat e fëmijëve dhe grupeve të caktuar vulnerabël. Kjo vizitë u realizua në funksion të

---

<sup>108</sup> OSCE Presence in Albania, “*Report to the Permanent Council by the Head of the OSCE Presence in Albania*”, 17 shtator 2016.

shkëmbimit të eksperiencave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale, në kuadër të mbështetjes së Projektit Danez pranë institucionit

Në datat 25 Nëntor – 18 Dhjetor 2015, me mbështetjen e Projektit DANIDA, staf i seksionit të Administratës zhvilloi një praktikë internshipi pranë institucionit homolog austriak, në kuadër të bashkëpunimit për shkëmbimin e eksperiencave dhe ekspertizës.

Në muajin Qershor 2015, stafi i institucionit së bashku me përfaqësuesit e zyrave rajonale, realizuan një vizitë studimore pranë Ombudsmanit suedez, duke përfshirë ombudsmanin parlamentar, për diskriminimin, për fëmijët, si edhe për ombudsmanin për mediat.

### **8.8 Mbështetja e Mbretërisë së Danimarkës, për veprimtarinë e institucionit të Avokatit të Popullit**

Mbretëria e Danimarkës ka dhënë një kontribut të veçantë për veprimtarinë e Avokatit të Popullit qysh prej krijimit të tij, duke ndihmuar në përmbushjen e rolit të tij kushtetues në mbrojtje të të drejtave të qytetarëve.

Aktualisht Mbretëria e Danimarkës po financoi që prej vitit 2012 projektin “Mbështetja e Avokatit të Popullit të Shqipërisë – më pranë komuniteteve lokale, shoqërisë civile dhe medias (2012-2015)”, i njohur ndryshe edhe si Projekti Danez. Ky është një projekt në mbështetje të të drejtave të njeriut dhe mirëqeverisjes në Shqipëri. Partneri kryesor është Avokati i Popullit i Shqipërisë, i themeluar në vitin 1999 me një mandat kushtetues, për të mbrojtur të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshme të individëve nga veprimet e paligjshme, apo të parregullta, apo mosveprimet e organeve të administratës publike.

Bazuar në marrëveshjen midis Ministrisë së Punëve të Jashtme të Danimarkës dhe Avokatit të Popullit Shqiptar, financimi direkt bëhet për aktivitete që mbulohen nga planet e punës dhe buxhetet e aprovuara nga Komiteti Drejtues i Projektit. Projekti zbatohet nga Instituti Danez për të Drejtat e Njeriut në bashkëpunim me SIPU International AB (Instituti Suedez për Administratën Publike). Ai synon ta bëjë Avokatin e Popullit më efektiv në tre fusha strategjike që pasqyrojnë ngritjen organizative të institucionit e që në të njëjtën kohë përputhen me Opinionin e Komisionit Europian në prioritetet kyçe për reformën e qeverisjes shqiptare. Ky projekt ka për qëllim të ndërtojë kapacitetet institucionale në nivel lokal, si dhe lidhjet e forta me shoqërinë civile dhe median nëpërmjet kombinimit të financimit direkt të Avokatit të Popullit dhe asistencës teknike ndërkombëtare.

Objektivi i përgjithshëm i këtij projekti mbështetjeje për Avokatin e Popullit të Shqipërisë është të kontribuojë për vazhdimësinë e procesit të reformave kombëtare dhe përpjekjeve për demokratizim, lidhur me garancitë demokratike efektive në nivel qendror dhe lokal të qeverisjes; mundësi të aksesueshme nga qytetarët për zbatimin e të drejtave themelore të njeriut dhe perspektiva të përmirësuar për Shqipërinë, që të bëhet pjesë e Bashkimit Europian.

Projekti ka për qëllim të ndërtojë kapacitetet institucionale dhe të forcojë lidhjet me shoqërinë civile dhe median, për ta bërë Avokatin e Popullit më efektiv në këto komponentë me rëndësi të veçantë për institucionin:

1. Forcimi i garancive demokratike në nivel lokal për qytetarët dhe shoqërinë civile.
2. Përmirësimi i kushteve në burgje dhe në qendrat e paraburgimit.
3. Rritja e profilit publik dhe e pozicionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet lidhjeve me shoqërinë civile dhe median.

Projekti ka mbështetur edhe dy nënkomponentë të tjerë që janë hartimi i një strategjie të korporuar disavjeçare të Avokatit të Popullit, që ka ndihmuar në realizimin e planeve të aktiviteteve të projektit më të detajuara dhe operacionale për zhvillimin e institucionit për periudhën 2012-2015, si dhe komponenti i IT-së.

Aktivitetet e komponentit të pushtetit vendor zhvillojnë eksperiencën në organizimin e Ditëve të Hapura dhe mbështesin aspiratat e Avokatit të Popullit për forcimin e rolit të tij, në shqyrtimin e ankesave dhe përkrahjen e të drejtave të njeriut, transparencën në procesin e vendim-marrjes dhe parandalimin e korrupsionit në nivel bashkie. Këto aktivitete synojnë promovimin e përgjegjshmërisë së administratës publike shqiptare në nivel lokal.

Me ndihmën e projektit është bërë e mundur hapja dhe funksionimi i shtatë zyrave rajonale të Avokatit të Popullit duke mbuluar gjithë territorin e vendit nga veriu në jug.

Bashkëpunimi i ngushtë me organizatat e shoqërisë civile ka qënë një aspekt tjetër i punës së projektit. Projekti ka mbështetur kryerjen e shumë inspektimeve, ri-inspektimeve, kontrolleve me tematikë të veçantë dhe vizitave monitoruese në të gjitha institucionet ku privohet liria e individit me pjesëmarrje të rregullt të organizatave të shoqërisë civile. (institucione penitenciare, njësi policore, spitale psikiatrike, baza ushtarake ku ka dhoma sigurie, qendra ku trajtohen shtetas të huaj, azilkërkues dhe viktimat e trafikut). Janë realizuar inspektime të përbashkëta me organizata të shoqërisë civile, inspektime që kanë pasur një karakter multidisiplinar dhe të thelluar edhe në qendra rezidenciale për fëmijë e të moshuar, si dhe institucione të tjera që ofrojnë shërbime publike, duke dalë në çdo rast me përmbledhjen e gjetjeve dhe rekomandimet përkatëse.

Është krijuar një rrjet i medias, për të forcuar pozicionin e institucionit të Avokatit të Popullit nëpërmjet lidhjeve aktive të komunikimit me median profesionale. Ky rrjet gazetarësh mbliidhet rregullisht për të diskutuar mbi mekanizmat e dialogut për mbulimin e çështjeve të të drejtave të njeriut në median e shkruar dhe atë vizive.

Vendimmarrja e projektit realizohet nëpërmjet mbledhjeve të Komitetit Drejtues, në përbërje të të cilit janë: Avokati i Popullit, Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë së Danimarkës, Ambasada e Mbretërisë së Danimarkës në Tiranë, Zyra e Prezencës së OSBE-së, Zyra e Këshillit të Europës, Zyra e Delegacionit të BE-së, Zyra e Kombeve të Bashkuara/UNDP, etj. Institucionet ndërkombëtare janë ftuar në Komitetin Drejtues të Projektit për një qëllim të dyfishtë, atë të sigurimit të cilësisë teknike dhe për koordinimin e donacionit.

## KREU 9

### Institucioni i Avokatit të Popullit në shifra për vitin 2015

#### 9.1. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit, Menaxhimi i Burimeve Njerëzore dhe Administrative

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, në veprimtarinë e tij duhet të mbështetet nga një infrastrukturë që mundëson realizimin e objektivave dhe qëllimeve të tij, në përputhje të plotë me Parimet e Parisit.

Janë këto parime, të cilat i lejojnë një institucion kombëtar për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të përshtatë strukturën me prioritetet e tij, qoftë edhe nëpërmjet krijimit të strukturave ad hoc, duke pasur një autonomi organizative për sa i përket strukturës dhe mënyrës së funksionimit të saj.

Kjo qasje është nënvizuar edhe nga Raporti i Komisionit Evropian, për vitin 2015, në të cilin është theksuar, ndërmjet të tjerash se, “Ndryshimet në ligjin për Avokatin e Popullit i japin atij të drejtën për të publikuar raportet e tij nëse Kuvendi nuk i diskuton ato. Ato sigurojnë një përzgjedhje më transparente dhe përfshirëse të kandidatëve për komisionerë, por nuk parashikojnë rritjen e buxhetit të Avokatit të Popullit dhe as autonominë organizative”.

Gjithashtu, edhe misioni i ekspertëve të pavarur të Komisionit Evropian, në raportin e hartuar në lidhje me pavarësinë e institucioneve të pavarura në Shqipëri, (Dhjetor 2014) për sa i përket strukturës së institucionit të Avokatit të Popullit do të theksonin se “... Një organizim i ngurtë pengon Avokatin e Popullit të përshtatë strukturën e institucionit me prioritetet e tij, nëpërmjet krijimit të strukturave “ad hoc”. Një organizim i tillë është në kundërshtim me Parimet e Parisit, të cilat sanksionojnë se “Një institucion kombëtar duhet të ketë një infrastrukturë që mundëson një drejtim të kënaqshëm të aktiviteteve të tij...”

Përtej këtyre problematikave, institucioni i Avokatit të Popullit është përpjekur maksimalisht të rrisë dhe forcojë më tej kapacitetet institucionale, nëpërmjet rritjes së nivelit të kualifikimit dhe të trajnimit, përmirësimit të menaxhimit të burimeve njerëzore, njohjes dhe zbatimit të plotë të legjislacionit të ri të ri në fushën e shërbimit civil, rritjes së transparencës dhe përgjegjshmërisë në të gjitha nivelet e vendimmarrjes, me qëllim krijimin e një administrate sa më funksionale, eficiente dhe të aftë për të realizuar misionin dhe objektivat e institucionit.

Gjatë vitit 2015, me miratimin e ndryshimeve të ligjit të Avokatit të Popullit, nr. 155/2014, datë 27.11.2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, lindi nevoja, e një shtese në numrin e punonjësve për dy pozicione të reja (1(një) Komisioner për Seksionin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve dhe 1(një) Komisioner në Mekanizmin kombëtar për parandalimin e torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar).

Gjatë muajit Janar dhe Qershor të vitit 2015, zyrtarisht institucioni i Avokatit të Popullit, bazuar në nenet 28, 29, si dhe 46, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, kërkoi nga Ministria e Financave ndërmarrjen e iniciativës ligjore për ndryshimin e ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me qëllim miratimin e rritjes së numrit të punonjësve të institucionit nga 51, në 53 punonjës. Ky propozim, i cili mbështetej tërësisht në ndryshimet e mësipërme ligjore, nuk gjeti pasqyrim në Aktin Normativ nr.1, datë 29.07.2015 “Për disa ndryshime në ligjin nr.160/2014 “Për buxhetin e vitit 2015”.



Përtej kësaj, institucioni duke respektuar detyrimin ligjor ka nisur disa herë procesin e përzgjedhjes së kandidatave për Komisioner për dy vende vakante, por për shkak të mungesës së numrit të nevojshëm të kandidatave pjesëmarrëse, apo mosplotësimit të kriterëve ligjore, procesi i përzgjedhjes së kandidatëve nuk ka mundur të realizohej. Për këtë është njoftuar në mënyrë të përsëritur edhe Kuvendi i Shqipërisë.


Duhet të theksojmë, gjithashtu, se gjatë vitit 2015, nga institucioni janë shpallur edhe pozicionet e lira që bien brenda ligjit për Shërbimin Civil, por ka qenë një proces i vazhdueshëm, duke pasur parasysh dorëheqjet, largimet në detyra të tjera brenda administratës shtetërore, pezullimin e statusit për shkak të trajnimeve jashtë vendit, situata të cilat sigurisht nuk mund të parashikohen nga institucioni.

Nuk duhet të harrojmë, edhe faktin se legjislacioni aktual në fushën e shërbimit civil është konceptuar në funksion të mbështetjes së karrierës së nëpunësit dhe lëvizjeve brenda sistemit të shërbimit civil, gjë që për vetë specifikën e strukturës së institucionit, ka çuar në disa raste në ri përsëritjen e proceseve të rekrutimit, dhe për rrjedhojë, në tej zgjatjen e detyruar të tyre.

Në zbatim të ligjit nr.160/2014, datë 27.11.2014, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2015”, sipas të cilit numri i përgjithshëm i punonjësve në institucionin e Avokatit të Popullit ishte 51, konsiderohej e nevojshme reflektimi i këtij ndryshimi në strukturë, që lidhej me shtimin e një specialisti finance, për t’i hapur rrugë nisjes së procedurave të nevojshme të rekrutimit sipas legjislacionit në fushën e shërbimit civil.

Për këtë arsye u miratua Urdhri nr.159, datë 23.07.2015, “Për disa ndryshime në Urdhrin nr. 82, datë 21.04.2014 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të institucionit të Avokatit të Popullit”. Për atë kohë sa nuk ishte reflektuar në ligjin për buxhetin shtimi i numrit të dy komisionerëve, u reflektua në organikë vetëm shtimi i numrit të punonjësve me një specialist finance, ndërkohë që ndryshimet e mundshme të mëvonshme në ligjin për buxhetin, do të reflektoheshin menjëherë edhe në organikën e institucionit.

**Struktura e institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2015, e paraqitur sipas organigramës së mëposhtme:**



Gjatë diskutimeve të bëra në Kuvendin e Shqipërisë, në lidhje me miratimin e buxhetit për vitin 2016, nga institucioni i Avokatit të Popullit u kërkua reflektimi i ndryshimeve të bëra në ligjin nr. 8454, datë 4.2.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, për shtimin e numrit të dy komisionerëve, si dhe propozimi i ri për miratimin e dy pozicioneve të reja si pjesë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve, dhe me konkretisht: *1(një) Punëtor Mirëmbajtje dhe 1(një) Sanitar*. Propozimet e bëra nga ana e institucionit, të cilat ishin dakortësuar paraprakisht gjatë takimeve të bëra me ekspertët e Ministrisë së Financave, gjetën mirëkuptimin e plotë të Kuvendit të Shqipërisë, dhe tashmë janë reflektuar edhe në ligjin nr. 147/2015, datë 17.12.2015, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2016”.

Në zbatim të Urdhrit nr.167, datë 12.09.2014 “Për rritjen e aftësive profesionale dhe trajnimin e punonjësve të institucionit të Avokatit të Popullit”, në muajin Janar 2015, u miratua edhe Plani Vjetor i Trajnimeve, mbi bazën e së cilit punonjësit u përfshinë në një proces trajnimesh, brenda dhe jashtë vendit, të cilat mundësuan shkëmbimin e eksperiencës dhe njohjen me praktikën më të mira. Në këtë kontekst vlen të theksohet nisja e procesit të intershipëve (financuar nga Projekti Danez), që nënkupton dërgimin e ekspertëve të institucionit për trajnime *deri në 1 muaj*, pranë zyrave homologe të vende të ndryshme të Evropës, me qëllim marrjen e eksperiencës sipas fushave të përgjegjësisë dhe të drejtave specifike që mbulojnë.

Në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, është miratuar Urdhri nr. 66, datë 23.04.2015, “Për miratimin e programit të transparencës të institucionit të Avokatit të Popullit”, i cili vlerësohet si një instrument konkret përmes së cilës institucioni i Avokatit të Popullit ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nëpërmjet vënies në dispozicion të publikut, pa kërkesë, të informacioneve të ndryshme, sipas modelit të miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me nenin 6 të ligjit të sipër-përmendur.

Programi i transparencës përditësohet në mënyrë të vazhdueshme, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare të institucionit në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, duke mbajtur parasysh interesin më të mirë të publikut në garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik.

#### ***Raporti i Kontrollit të Lartë të Shtetit***

Gjatë muajit Shtator - Tetor 2015, pranë institucioni të Avokatit të Popullit nga grupi i ekspertëve të Kontrollit të Lartë të Shtetit (KLSH), u ushtrua një kontroll në drejtim të auditimit të veprimtarisë ekonomiko-financiare, i cili përfshinte periudhën Janar 2014 - Shtator 2015.

Në përputhje me nenin 15 të ligjit Nr. 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, nga ana e këtij institucioni u paraqit Raporti Përfundimtar i Auditimit, në të cilën janë përfshirë një tërësi masash/rekomandimesh të karakterit organizativ.

Institucioni i Avokatit të Popullit është i angazhuar për zbatimin tërësor të këtyre rekomandimeve, duke qenë të bindur se rëndësia e pranimin dhe zbatimit të tyre qëndron në faktin se ato fuqizojnë mekanizmin e brendshëm administrativ, orientojnë institucionin drejt përmirësimit të rezultateve të cilat kanë një rëndësi të madhe në përmbushjen e objektivave institucionale, në funksion të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të qytetarëve.

Gjithashtu, zbatimi i këtyre rekomandimeve do të ndikojë pozitivisht në një administrim më të përgjegjshëm, efektiv dhe transparent të fondeve publike si dhe zbatimit të standardeve dhe praktikave me të mira administrative në këtë drejtim, në përputhje me parimet e integritetit, ekonomicitetit, dhe eficientësisë.

Rekomandimet e Kontrollit të Lartë të Shtetit, janë tashmë të pasqyruara në faqen zyrtare të institucionit në rubrikën “*Programi i Transparencës*”.

## 9.2 Realizimi i buxhetit të Institucionit për vitin 2015

Në mbështetje të ligjit nr. 160/2014, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2015", Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.2 datë 06.02.2012 "Procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", si dhe Udhëzimit Plotësues të Ministrit të Financave nr. 2/1, datë 11.02.2015, "Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin plotësues nr. 2, datë 09.01.2015, Për Zbatimin e Buxhetit të Vitit 2015", performanca e produktit të buxhetit për institucionin e Avokatit të Popullit, sipas programit buxhetor të miratuar për vitin 2015, paraqitet si më poshtë:

### Programi - "Shërbim i Avokatisë"

Buxheti i akorduar për këtë program (i vetmi program që ka institucioni i Avokatit të Popullit) ka në bazë të tij Deklaratën e Politikës së Programit (DPP) të hartuar gjatë procesit të PBA 2015-2017 dhe ka për qëllim arritjen e objektivave e produktit të përcaktuar e të miratuara në dokumentin e Programit Buxhetor Afatmesëm (2015-2017).

### Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve për vitin 2015.

Me Ligjin Nr. 160/2014, "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2015", fondet e akorduara me ndryshimet e bëra gjatë vitit për funksionimin e aktivitetit të Institucionit të Avokatit të Popullit sipas artikujve, paraqiten në tabelat e mëposhtme:

#### Raporti i Shpenzimeve Faktike të programit sipas Artikujve

Tabela nr. 1

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Shtesa&Pakësi mi	Plani ndryshuar	Fakti
600	Paga	66.000.000	-2.500.000	63.500.000	58.171.616
601	Sig.Shoqërore e	9.500.000		9.500.000	7.921.542
602	Mallra dhe shërbime të	14.500.000	2.500.000	17.000.000	15.243.643
605	Transferta. Korente të	1.500.000		1.500.000	1.489.710
231	Investimet	4.000.000		4.000.000	3.109.517
	<b>TOTALI</b>	<b>95.500.000</b>		<b>95.500.000</b>	<b>85.936.028</b>


#### Raporti Vjetor i Realizimeve të Shpenzimeve për vitin 2015

Tabela nr. 2

Nr.	Emërtimi	Plani i ndryshuar	Fakti	Diferenca	Realizimi në %
1	Paga	63.500.000		5.328.384	91,60
2	Sig. Shoqërore e	9.500.000		1.578.458	83,40
3	Mallra dhe shërbime të	17.000.000		1.756.357	89,70
4	Transferta. Korente të	1.500.000			99,30
5	Investimet	4.000.000			77,70
	<b>Totali</b>	<b>95.500.000</b>	<b>85.936.028</b>	<b>9.563.972</b>	<b>90</b>

## Struktura e Shpenzimeve 2015

■ Paga ■ Sig. Shoqërore e Shëndetësore ■ Shpenzime Operative ■ Investimet.



### 1. Shpenzime Personeli

Realizimi i fondit të pagave reflekton strukturën dhe organikë, lëvizjet e brendshme dhe të jashtme. Ky fond i akorduar për vitin 2015, për mbulimin e shpenzimeve në paga personeli është 66.000.000 lekë, i ndryshuar me shkresë të Ministrisë së Financave nr. 15799 Prot., datë 19.11.2015, “Miratim limiti” në 63.500.000 lekë, ndërsa realizimi është 58.171.616 lekë ose 91,60%, si dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore janë në plan 9.500.000 lekë, ndërsa realizimi është 7.921.542 lekë ose në masën 83,40%. Të dyja zërat së bashku paga personeli dhe sigurime shoqërore dhe shëndetësore (600+601) për vitin 2015 janë realizuar në masën 90,60%. Gjatë vitit 2015, numri mesatar i punonjësve ka qenë 47 punonjës nga 51 punonjës që ka qenë kufiri i miratuar me ligjin e lartpërmendur. Mosrealizimi i këtij zëri të shpenzimeve vjen për shkak të mosplotësimit të strukturave organike si rezultat i vendeve vakant të krijuara në fund të vitit 2014 dhe gjatë vitit 2015 nga lëvizja e punonjësve të institucionit tonë në detyra të tjera.

Numri i punonjësve i miratuar me ligj për vitin 2015, nuk është plotësuar në të gjithë strukturat përbërëse të tij gjatë këtyre periudhave.

Ka patur mungesa në 3/mujorin e parë:

- 1- Ndhimëskomisioner të MPKT,
- 2- Ndhimëskomisioner në seksionin për të Drejtat e Fëmijëve,
- 2- specialist i Financës dhe Administratës,
- 1- Ndhimëskomisioner në seksionin e Administratës,
- 1- Ndhimëskomisioner në seksionin e Administratës (pezullim i përkohshëm i statusit të nëpunësit civil),
- 1- specialist në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve,
- 1- Përgjegjës në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve (pezullim i përkohshëm i statusit të nëpunësit civil),
- 1- Këshilltar i Avokatit të Popullit.

Gjatë tremujorit të dytë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Ndhimëskomisioner në seksionin për të Drejtat e Fëmijëve,
- 1- Specialist i Financës dhe Administratës,
- 1- Specialist i zyrës së Pritjes me Popullin

- 1- Ndhimëskomisioner në seksionin e Administratës (pezullim i përkohshëm i statusit të nëpunësit civil),
- 1- Përgjegjës në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit dhe Koordinimit të Projekteve (pezullim i përkohshëm i statusit të nëpunësit civil),
- 1- Këshilltar i Avokatit të Popullit.

Gjatë tremujorit të tretë institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Ndhimëskomisioner në seksionin për të Drejtat e Fëmijëve,
- 1- Specialist i Financës dhe Administratës,
- 1- Specialist i zyrës së Pritje me Popullin
- 1- Përgjegjës në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit dhe Koordinimit të Projekteve

Gjatë tremujorit të fundit të vitit institucioni ka patur këto mungesa:

- 1- Ndhimëskomisioner të MPKT,
- 1- Përgjegjës në sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritimit dhe Koordinimit të Projekteve

## **2.- Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të Tjera**

Shpenzimet operative të miratuara për institucionin tonë, me gjithë ndryshimet gjatë vitit ushtrimor, janë në vlerën prej 17.000.000 Lekë, ndërkohë që në fund të vitit, niveli i realizimit të shpenzimeve operative rezulton në vlerën prej 15,243,643 lekë ose 89,70% përkundrejt planit të ndryshuar. Për vitin 2015 shpenzimet operative, janë përdorur për pagesat e energjisë elektrike, ujë, Albtelecom, Vodafone, abonime gazeta, shërbimi postar, kancelari, materiale pastrimi, materiale për funksionimin e pajisjeve të zyrës, siguracion automjetesh, dieta brenda dhe jashtë vendit, shërbime për automjetet, mirëmbajtjen e ambienteve, mirëmbajtje fotokopje e printer, shpenzime pritje-përcjellje të huajve, si dhe shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Gjithashtu, duke qenë anëtare e organizatave ndërkombëtare si Association des Ombudsmans et Mediateurs de la Francophonie (AOMF), European Ombudsman Institute (EOI), Association of Mediterranean Ombudsmen (AMO), International Ombudsman Institute (IOI), International Coordinating Committee (ICC), European Network of National Human Rights Institutions (ENNHRI), një pjesë e buxhetit është përdorur për shlyerjen e detyrimeve që lidhen me kuota anëtarësimi, të cilat janë kryer në kohën e duhur dhe që pasqyrohen sipas tabelës më sipër. Ky fondi për transfera korente të huaja (**zëri 605**) për vitin 2015, është 1.500.000 lekë. Realizimi i këtij artikulli është 1.489.710 lekë ose 99,30 % i buxhetit.

## **3.- Shpenzime në investime**

Fondi i investimeve akorduar nga buxheti i shtetit për vitin 2015 është 4.000.000 lekë, ndërsa realizimi është 3.109.517 lekë ose 77,70% i buxhetit të rishikuar. Për përmirësimin e kushteve të godinës të institucionit të Avokatit të Popullit janë bërë këto investime (shiko tabelën e mëposhtme).

në mijë/lekë

Projekti	Kodi i Projektit	Plan	Fakt	%
1. Blerje pajisje	M660001	1.000	720	72
2. Rikonstruksion godine	M660005	782	549	70,20
3. Përshatje e ambienteve për personat me aftësi të kufizuar (PAK)	M660010	218	218	100
4. Pajisje - Kompjuterike	M660009	1.000	710	71
5. Mjete dhe pajisje të tjera	M660011	1.000	912	91,20
<b>TOTALI</b>		<b>4.000</b>	<b>3.109</b>	<b>77,70</b>

### 9.3 Donacionet

#### Pasqyra financiare të planifikimit dhe zbatimit të Projektit Danez

Nr.	Emërtimi	Viti 2015		
		Plani DKK	Fakti në lekë	Fakti në DKK
1	Strategjia	0	0	0
2	Komponenti i Pushtetit Vendor	784.119	6.674.942,10	358.320,10
3	Komponenti i Burgjeve MKPT	553.954	5.901.483,25	317.282,96
4	Komponenti i Shoqërisë Civile dhe Media	666.200	5.187.532,10	276.951,49
5	Komponenti i IT	110.000	0,00	0,00
6	Rekrutimi	172.550	2.582.716,00	137.682,70
7	Përkthime të institucionit	125.000	554.008,00	29.773,51
8	Auditimi	64.000	293.416,16	15.508,36
9	Kontigjenca	40.000	0,00	0,00
10	Vizita studimore dhe internshipe	95.854	1.025.369,90	55.600,55
11	Rekrutimi i Arkivisti	13.400	0,00	0,00
12	Kosto ekspetesh ndërkombëtar	19.000	0,00	0,00
<b>Totali</b>		<b>2.644.077</b>	<b>22.219.467,51</b>	<b>1.191.119,67</b>

## 9.4 Statistika përmbledhëse të ankesave dhe trajtimit të tyre për vitin 2015

Një vend të veçantë në Raportet Vjetore të institucionit të Avokatit të Popullit, që i paraqiten Kuvendit, zënë edhe pasqyrimi i statistikave për prezantimin e numrit të ankesave të shqyrtuara nga Institucioni ynë për gjatë gjithë vitit. Konkreisht më poshtë gjenden te detajuara këto statistika, të cilat lejojnë të krijohet përshtypja mbi objektin e ankesave, numrin e tyre, mënyrën e trajtimit nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, reagimi i administratës publike, çështjet e hapura për vitin 2014 dhe ato të mbartura, etj.


Të dhënat e paraqitura sa më poshtë i përkasin periudhës 1 Janar - 31 Dhjetor 2015. Në total janë trajtuar nga zyra e Avokatit të Popullit 4203 ankesa, kërkesa dhe njoftime (*duke përfshirë dhe ato të pritjes së qytetarëve*).

Ankesa, kërkesa, njoftime gjatë vitit 2015 që kanë qenë pjesë e objektit të institucionit të Avokatit të Popullit, janë 2735 gjithsej. Nga zyra e pritjes së qytetarëve, 1112 ankesa i janë dhënë përgjigje menjëherë, ndërsa 356 ankesa i janë dhënë përgjigje në formën e këshillimeve shkresore.

### I. Gjatë shqyrtimit të këtyre ankesave të bëra nga institucioni i Avokatit të Popullit rezultojnë se janë mbyllur 1409 ankesa si më poshtë vijon:

- 70 Ankesa jashtë Juridiksionit
- 94 Ankesa jashtë Kompetence
- 473 Ankesa të pabazuara
- 51 Ankesa me Rekomandime të Refuzuar
- 160 Ankesa me Rekomandime të Pranuara
- 510 Ankesa të Pranuara pa Rekomandim (*të zgjidhura në favor të qytetarëve*)
- 51 Ankesa me heqje Dorë


### Paraqitja grafike Nr.1-Trajtimi i ankesave



**II. Grafiku më poshtë tregon mnyrën e shpërndarjes së ankesave, kërkesave dhe njoftimeve sipas seksioneve në Institucionin e Avokatit të Popullit, konkretisht:**


Seksioni i Administratës	<b>1125</b> ankesa
Seksioni i Veçantë	<b>672</b> ankesa
Seksioni i Përgjithshëm	<b>807</b> ankesa
Njësia e parandalimit të Torturës	<b>131</b> ankesa

**Paraqitja grafike Nr.2-Shpërndarja e Ankesave Sipas Seksioneve**




**III. Tabelat në vijim japin në mënyrë grafike një informacion rreth ankesave që janë trajtuar gjatë viteve nga Institucioni i Avokatit të Popullit.**

**Paraqitje grafike Nr.3- Ankesat e ardhura në Institucionin e AP ndër vite.**







**Paraqitja grafike Nr.5 – Shpërndarja e ankesave përgjatë vitit 2015, sipas qyteteve.**




**Paraqitja grafike Nr.6 – Ankesat e regjistruara gjatë vitit 2015, sipas të drejtës që i është shkelur qytetarëve**



**Paraqitja grafike Nr.7 – Shpërndarja e ankesave drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit drejt Institucioneve Shtetërore dhe institucioneve që janë në vartësi të tyre.**




**Paraqitja grafike Nr.8 – Ndarja e ankesave sipas mënyrës së trajtimit dhe zgjidhjes 2015**




## RASTET E MBARTURA NË VITE

Gjatë vitit 2015, 1091 ankesa janë mbartur nga viti 2014, prej të cilave 912 ankesa janë përfunduar në vitin 2015. Më poshtë kemi paraqitur si janë zgjidhur këto ankesa, sipas Seksioneve:

### Paraqitja grafike Nr.9 – Zgjidhja e ankesave të mbartura nga 2014 sipas Seksioneve dhe zgjidhja e tyre në 2015



### Paraqitja grafike Nr.10 – Rekomandimet sipas Seksioneve nga ankesat e mbartura 2014



## **ANEKSET**

1. Lista e institucioneve shtetërore që kanë zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit.
2. Tabela e Rekomandimeve pa përgjigje gjatë viti 2015.
3. Tabela e Rekomandimeve të Refuzuara sipas institucioneve gjatë vitit 2015
4. Tabela e Rekomandimeve Legjislative të nisura gjatë 2015
5. Tabela e Vizitave Studimore dhe trajnimeve gjatë vitit
6. Tabela e Inspektimeve të Kryera gjatë vitit

**Aneks 1 – Lista e institucioneve shtetërore që kanë zbatuar rekomandimet e Avokatit të Popullit**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI QE I ESHTË DERGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>NUMRI I REKOMANDIMEVE TE ZBATUARA<sup>1</sup></b>
1.	Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Kamëz	1
2.	65 Bashkive në të gjithë vendin	1
3.	Drejtorisë Rajonale të Aluizni-t Tiranë	1
4.	Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t	1
5.	Këshillit të Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë Presidentes së Urdhërit të Farmacistëve të Shqipërisë	1
6.	Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territori	1
7.	Zyra vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë	1
8.	24 Zyra vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme	1
9.	Zyrës Qëndrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	1
10.	Drejtoria e Përgjithshme e Meteorologjisë	1
11.	Ministrisë së Mjedisit	1
12.	Ministrisë së Bujqësisë, Zvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave	1
13.	Bashkisë Tiranë	4
14.	“OSHEE” sh.a. Tiranë	2
15.	Ministrisë së Inovacionit dhe Administratës Publike	1
16.	Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë	1
17.	Kryeministrisë	1
18.	Ministrisë së Financave	2
19.	Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës	1
20.	Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës	1
21.	Komunës Zall-Bastar	1
22.	Bashkisë Korçë	3
23.	Prefektit Lezhë	1

<sup>1</sup> Numri i Rekomandimeve të zbatuara sipas tabelës rezulton më i lartë për shkak se një rekomandim me të njëjtën objekt ju është drejtuar më shumë se një Institucioni

24.	Këshillit të Qarkut Lezhë	1
25.	Komunës Kurbin	1
26.	ALUIZNI Korçë	2
27.	Drejtoria e Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Vlorë	1
28.	Bashkisë Shkodër	5
29.	Instituti të Sigurimeve Shoqërore	7
30.	Drejtoria e Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë	12
31.	Drejtoria e Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier	2
32.	Drejtoria të Spitalit Rajonal Fier	1
33.	Ministria e Drejtësisë	4
34.	Komisioni Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Lushnje	1
35.	Njësia Administrative Krutje	1
36.	Bashkisë Berat	1
37.	Këshillit Bashkiak Berat	1
38.	Këshillit të Qarkut Gjirokastrë	1
39.	Drejtoria e Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Gjirokastrë	1
40.	Ministria e Shëndetësisë	4
41.	Shërbimi Social Shtetëror Tiranë	5
42.	5 Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të Partive në Kuvendin e Shqipërisë	1
43.	Drejtoria e Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Dibër	1
44.	Ministria e Arsimit dhe Sporteve	2
45.	Këshillit Bashkiak Tiranë	1
46.	Drejtoria e Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë	1
47.	Bashkisë Librazhd	1
48.	Drejtoria të Përgjithshme të Policisë së Burgjeve	2
49.	Ministria e Punëve të Brendshme	2
50.	Prokuroria e Përgjithshme	3
51.	Këshillit të Lartë të Drejtësisë	1
52.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kukës	1
53.	Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit	6

54.	Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve	11
55.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë	1
56.	Ministrit të Punëve të Jashtme	2
57.	Drejtoria e Policisë të Qarkut Gjirokastrë	2
58.	Përmbauesit privat	1
59.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Korçë	1
60.	Komisariatit të Policisë Nr.1 Tiranë	1
61.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës	1
62.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë	1
63.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Krujë	1
64.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë	1
65.	IEVP Fushë Krujë	1
66.	IEVP Lezhë	1
67.	IEVP Krujë	1
68.	Departamenti për Kufirin dhe Migracionin	1
69.	Qendrës së Mbyllur për të Huajt Kareç	1
70.	Instituti të të Miturve Kavajë	1
71.	IEVP "Ali Demi", Tiranë	1
72.	IEVP Tropojë	1
73.	IEVP Kukës	1
74.	Drejtoria e Policisë të Qarkut Dibër	1
75.	IEVP Vaqarr	1
76.	IEVP Peqin	1
77.	Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër	1
78.	Shërbimit të Psikiatrisë të QSUT	1
79.	Shërbimit të Shëndetit Mendor me Shtretër Shkodër	1
80.	Drejtoria e Shëndetit Publik Shkodër	1
81.	IEVP Durrës	1

**Aneks 2 – TABELA E REKOMANDIMEVE PA PERGJIGJE GJATE VITIT 2015**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI QE ESHTË DERGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>NUMRI I REKOMANDIEMVE PA PERGJIGJE</b>
1	Kryeministrit të RSH-së	2 Pa përgjigje
2	Ministrit të Drejtësisë	3 Pa përgjigje
3	Ministria e Bujqësisë	1 Pa përgjigje
4	Ministresë së Mjedisit	1 Pa përgjigje
5	Ministres së Zhvillimit Urban dhe Turizmit	1 Pa përgjigje
6	Ministres se Arsimit dhe Sportit	5 Pa përgjigje
7	Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	1 Pa përgjigje
8	Ministria e Financave	1 Pa përgjigje
9	Ministria e Brendshme	1 Pa përgjigje
10	Komisioni per Ceshtjet Ligjore, Administraten Publike dhe te drejtat e	1 Pa përgjigje
11	DAP	1 Pa përgjigje
12	Prokurori I pergjithem	2 Pa përgjigje
13	Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Tirane	2 Pa përgjigje
14	Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Durres	1 Pa përgjigje
15	Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Lushnje	1 Pa përgjigje
16	Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit	4 Pa përgjigje
17	Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	1 Pa përgjigje
18	Shtabi I Pergjithshem I Forcave te Armatosura	1 Pa përgjigje
19	Shefi I Komisarariatit Tirane	1 Pa përgjigje
20	Shefi I komisarariatit te Policise Burrel	1 Pa përgjigje
21	Permbarimi Privat	2 Pa përgjigje
22	OSHEE	3 Pa përgjigje
23	OSHEE Durres	1 Pa përgjigje
24	Bashkia Tiranë	6 Pa përgjigje
25	Bashkia Sarande	1 Pa përgjigje
26	Bashkia Korce	2 Pa përgjigje
27	Bashkia Erseke	1 Pa përgjigje
28	Bashkia Gjirokaster	3 Pa përgjigje
29	Bashkia Mat	1 Pa përgjigje
30	Bashkia Tepelene	1 Pa përgjigje
31	Zyra e Gjendjes Civile, bashkia Elbasan	1 Pa përgjigje
32	Njesia Administrative Devoll	1 Pa përgjigje
33	IKMT	6 Pa përgjigje
34	Prefektit te Qarkut Tirane	1 Pa përgjigje
35	Kryeregjistruesit te ZQRPP Tirane	2 Pa përgjigje
36	ZVRPP Tirane	3 Pa përgjigje
37	Sherbimi Social Shteteror	1 Pa përgjigje



**ANEKS 3 - TABELA E REKOMANDIMEVE TE REFUZUARA SIPAS INSTITUCIONEVE GJATE  
VITIT 2015**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI QE ESHTË DERGUAR REKOMANDIMI</b>	<b>NR. I REKOMANDIMEVE TE REFUZUARA</b>
1	Ministrisë së Zhvillimit Urban	1 Rekomandim
2	Ministrit të Punëve të Brendshme	3 Rekomandim
3	Kryeministrisë	1 Rekomandim
4	ZVRPP Tiranë	1 Rekomandim
5	ZVRPP Fier	1 Rekomandim
6	Bashkia Fier	1 Rekomandim
7	ZVRPP Korçë	1 Rekomandim
8	Drejtoria Përgjithshme të Burgjeve	20 Rekomandim
9	Drejtoria e Arsimit Korçë	1 Rekomandim
10	Ministrit të Financave	1 Rekomandim
11	Posta Shkodër	1 Rekomandim
12	Bashkia e Tiranës	1 Rekomandim
13	Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	2 Rekomandim
14	Degësi i Sigurimeve Shoqërore Tropojë	1 Rekomandim
15	ALPETROL.Sh.a Patos	3 Rekomandim
16	DRSSH-Korçë	1 Rekomandim
17	DRSSH-Durrës	1 Rekomandim
18	Kryetari i Komunës Paskuqan	1 Rekomandim
19	Kryetari i Bashkisë Rrëshen	1 Rekomandim
20	Universiteti Fan Noli, Korçë	1 Rekomandim
21	Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve	1 Rekomandim
22	Ministrisë së Shëndetësisë	1 Rekomandim
23	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit	2 Rekomandim
24	Drejtoria e Përgjithshme të Përmbartimit	1 Rekomandim
25	Drejtoria e IEVP "Shënkoll Lezhë"	1 Rekomandim
26	Drejtuesi i Prokurorisë për Krime të Rënda	1 Rekomandim

ANEKS Nr. 4 - TABELA E REKOMANDIMEVE LEGJISLATIVE TE NISURA GJATE VITIT 2015

NR	NR.DOCULIVE	DATA E NISJES	OBJEKTI I REKOMANDIMIT	INSTITUCIONI QE ESHTE DERGUAR REKOMANDIMI	STATUSI I REKOMANDIMIT PRANUAR/MOSPRANUAR/PAPERGJIGJE/ZBATUAR OSE JO
1	201302622	17.02.2015	Propozim për miratim të projektligjit "Për përmirësimin e cilësisë së jetesës dhe plotësimin të nevojave për moshën e tretë".	Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	Mospranuar dhe dërguar përsëri. më datë 21.09.2015
2	201500100	12.03.2015	Për marrjen e iniciativës për përmirësim në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë me synim përfaqësimin dhe aksesin e barabartë gjinor (	Kryetarëve të Grupeve Parlamentare të partive Kuvendit të Republikës	Pjesërisht i zbatuar
3	Nr.Prot. 99	10.04.2015	Dërgohen mendime dhe komente për ndryshime në ligjin nr.69/2012 "Për sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë"	Kuvendit të Republikës.	Refuzuar/I pazbatuar
4	201500495	10.04.2015	Për aplikimin e ndjekjes penale në gjendje të lirë dhe masa sigurimi më të buta se "arresti në burg" ndaj autorëve të veprave penale "Vjedhja e energjisë elektrike dhe impulsive telefonike" dhe "Ndërtimi i	Ministrit të Punëve të Brendshme	Pranuar Zbatuar pjesërisht
5	201500496	10.04.2015	"Propozime për shtesa dhe përmirësim në nenet 48,58 dhe 326 të Kodit të Procedurës Penale, për vendosjen e avokatit mbrojtës në procedimin dhe gjykimin penal për mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të ligjshëm të viktimes, si dhe ankimit në gjykatë ndaj vendimit të pezullimit të hetimeve, marrë nga organi i Prokurorisë".	Ministrit të Drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Komisionit Parlamentar të Çështjeve ligjore, Administratës Publike dhe të Drejtave të Njeriut.	Me përgjigje nga Ministri i Drejtësisë, pranuar, por I pa zbatuar.
6	201402562	28.04.2015	Revokimi i pikës pesë të letër porosisë nr.8701 Prot., datë 03.09.2014 të DPBurgjeve	Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	Pa përgjigje
7	201402354	12.05.2015	Për saktësimin e përkthimit të neneve 29 dhe 32 të ligjit nr.108/2012 "Për ratifikimin e Konventës së OKB-së "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara	Ministrit të Drejtësisë	Pa përgjigje
8	201400240	13.05.2015	Për përmirësim legjislativ në Kodin e Procedurës Civile, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin nr. 7829, datë 01.06.1994 "Për noterinë", me qëllim garantimin e aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuara.	Ministrit të Drejtësisë Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	Zbatuar pjesërisht
9	201500637	21.05.2015	Për ndryshimin dhe përmirësimin e Rregullores "Për rregullat e hollësishme të sjelljes së punonjësve të Policisë së Burgjeve", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr. 5251/2, datë 30.07.2010.	Ministrit të Drejtësisë Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve	Pranuar Në proces
10	20150554	28.05.2015	Për një shtesë në pikën 1 të VKM nr.8 dt.14.01.2015 "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike deri në 300 kwh në muaj	Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë dhe Ministrit të Financ.	Parimisht pranuar nga Min.Financave, mospranuar nga Min.Mirëqënies sociale
11	201500607	01.06.2015	Përmirësim të nenit 35 pika 2 si dhe të nenit 41 pika 1 të ligjit nr.7703 datë 11.05.1993 "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, në kuptimin e rivendosjes së parimit të sigurisë juridike	Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	Mospranuar dhe dërguar përsëri më datë 03.12.2015
12	201500220	03.08.2015	Për ndryshimin dhe përmirësimin e dispozitave të ligjit nr.9780 date 16.07.2007 "Për inspektimin e ndertimit", i ndryshuar.	Ministrit të Punëve të Brendshme	Refuzuar

13	201500220	14.08.2015	Për ndryshimin dhe permiresimin e dispozitave te ligjit nr.9780 date 16.07.2007 "Per inspektimin e ndertimit", i ndryshuar.	Ministrit të Drejtësisë	Pa përgjigje
14	201501690	22.09.2015	Rekomandohen ndryshime në ligjin nr. 9062, datë 05.08.2003 "Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë i ndryshuar.	Ministrit të Drejtësisë	Përgjigje nga Ministri i Drejtësisë e Pazbatuar Drejtuar kuvendit. Pritet vendimi
15	201502111	26.10.2015	Për ndryshimin e miratimin e bazës ligjore që do të mundësojë procesin e "Lustracionit", në Shqipëri.	Kryeministrit Kryetarit te Kuvendit	Refuzuar
16	201502111	26.10.2015	Per disa shtesa në Ligjin nr.8454 datë 4.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", që do të mundësojnë procesin e "Lustracionit", në veprimtarinë e tij institucionale.	Ministrit të Drejtësisë	Pa përgjigje
17	201401442	09.11.2015	Për nxjerrjen e një Vendimi të Këshillit të Ministrave "Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve të punonjësve buxhetore të caktuara gjatë vitit 1993, 1994, 1995".	Ministrit të Mirëqënies Sociale dhe Rinisë	Pa përgjigje

**Aneks Nr 5 - TABELA E VIZITAVE STUDIMORE DHE TRAJNIMEVE GJATE VITIT 2015**

NR	DATA	VIZITË STUDIMORE /TRAJNIM	OBJEKTI	INSTITUCIONI DHE VENDI KU ESHTE ZHVILLUAR VIZITA
1	23-28 Shkurt 2015	Trajnim për nëpunësit civilë	Trajnim i detyrueshëm gjatë periudhës së provës për nëpunësit civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm Organizuar nga ASPA	Shkolla Shqiptare e Administratës Publike, ASPA, Tiranë.
2	29 Mars – 2 Prill 2015	Vizitë studimore	Mbi mënyrën e inspektimeve të zyrës së MKPT	Instituti Danez i të Drejtave të Njeriut, Danimarkë
3	08.04.2015	Trajnim	Monitorimi dhe vlerësimi i standarteve të shërbimeve sociale e shëndetësore në institucionet e kujdesit social dhe shëndetësore.	Qendra Kombëtare për Studime Sociale Komiteti i Helsinkit Shoqata Hotel Grand
4	31 Maj – 5 Qershor 2015	Vizitë studimore	Mbi mënyrën e trajtimit të ankesave të qytetarëve	SKL International, Suedi
5	14-18 Qershor 2015	Vizitë studimore	Mbi mënyrën e ofrimit të shërbimeve sociale personave me aftësi të kufizuar	Ombudsmani i Spanjës, Spanjë
6	22-24 Shtator 2015	Konferenca 19 Vjetore e Ombudsmanve Evropiane për Fëmijët	“Mbi dhunën kundër fëmijëve”	Amsterdam, Hollandë, Ombudsmani i Fëmijëve i Hollandës dhe ENOC-Rrjeti i Omb.Evropianë për
7	28 Shtator-2 tetor 2015	Trajnim	“Mbi të drejtat e Fëmijëve”	Paris, Francë, AOMF, Defenseur des Droits-Ombudsmani i Francës
8	27-29 Tetor 2015	Mbledhje vjetore e Rrjetit CRONSEE	Mbledhja Vjetore e CRONSEE “Protokolli opsional i KDF” Mbi procedurën e komunikimit” (OP3-CRC)- Pozicioni/Roli i Ombudsmanit për Fëmijët.	CRONSEE-Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore, Osijek, Kroaci-Ombudsmani Kroat për Fëmijët
9	02.12.2015	Trajnim	Trajnerë në fushën e mësimdhënies për të drejtat e njeriut.	Projekti Danez  Hotel Mondial

**ANEKS 6. - TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2015**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI I INSPEKTUAR</b>	<b>QËLLIMI I INSPEKTIMIT</b>	<b>DATA E INSPEKTIMIT</b>
1.	Qendra e Zhvillimit Vlorë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	30.01.2015
2.	Qendra e Shërbimeve Sociale Komunitare Kukës	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK e të moshuar.	04.06.2015
3.	Qendrat e Votimit në Kukës e Tropojë	Garantimi i të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar.	04.06.2015
4.	Qendrat e Votimit në Tropojë	Garantimi i të drejtës së votës për personat me aftësi të kufizuar	04.06.2015
5.	Spitali Rajonal Kukës	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	09.06.2015
6.	Spitali Rajonal Tropojë	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	10.06.2015
7.	Spitali Rajonal i Lushnjës	Kushtet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor në këtë spital	26.06.2015
8.	Spitali Rajonal Fier	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	01.07.2015
9.	Qendra Ditore për Integrim dhe Zhvillim Librazhd	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	07.07.2015
10.	Komuna Lazarat	Marrja e ankesave në fshatin Lazarat	08.07.2015
11.	Shtëpia e Fëmijës Shkollore Sarandë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për fëmijët.	13.07.2015
12.	Qendra E Zhvillimit “Unë jam si Ju”, Berat.	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	27.07.2015
13.	Qendra Ditore dhe Rezidenciale “Lira”, Berat.	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	28.07.2015
14.	Qendra Ditore e Zhvillimit Lezhë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	03.08.2015
15.	Qendra e Zhvillimit Durrës	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	04.08.2015
16.	Qendra Shëndetësore Fushë Arrës	Kushtet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor në Qendrën Shëndetësore Fushë Arrës	10.9.2015
17.	Spitali i Rrethit Rrëshen	Kushtet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor në Qendrën Shëndetësore Fushë Arrës	11.9.2015
18.	Spitali Rajonal Pukë	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	15.09.2015
19.	Spitali Rajonal Ersekë	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	22.09.2015
20.	Spitali Rajonal Leskovik	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	23.09.2015
21.	Spitali Rajonal Tiranë	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	06.10.2015
22.	Shtëpia e Fëmijës Shkollorë 6-18 vjeç, Shkodër	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për fëmijët	16.10.2015
23.	Spitali Rajonal Shkodër	Verifikimi i kushteve dhe respektimi i të drejtave të pacientëve, problematikat	20.10.2015
24.	Shtëpia e të Moshuarve Shkodër.	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për të moshuarit.	03.11.2015
25.	Shtëpia e Fëmijës Parashkollorë 3-6 vjeç, Shkodër	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për fëmijët.	03.11.2015
26.	Qendra e Zhvillimit Korçë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	09.11.2015
27.	Shtëpia e Foshnjës 0-6 vjeç Korçë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për fëmijët.	09.11.2015

28.	Qendra Ditore Atelier Korçë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	10.11.2015
29.	Shtëpia e të Moshuarve Gjirokastrë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për të moshuarit.	16.11.2015
30.	Qendra Komunitare për Fëmijët Autistë Gjirokastrë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për fëmijët AK.	16.11.2015
31.	Spitali Rajonal i Burrelit	Kushtet e ofrimit të shërbimit të kujdesit shëndetësor në këtë spital	30.11.2015
32.	Shtëpia e të Moshuarve Fier	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për të moshuarit	07.12.2015
33.	Shtëpia e të Moshuarve Kavajë	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për të moshuarit.	15.12.2015
34.	Qendra e Zhvillimit Shkodër	Kushtet e përshtatshme të jetesës dhe garantimi i zbatimit të standarteve të shërbimeve shoqërore për PAK.	16.12.2015

**TABELA E INSPEKTIMEVE TE KRYERA GJATE VITIT 2015 NGA MKPT**

<b>NR.</b>	<b>INSTITUCIONI I INSPEKTUAR</b>	<b>QËLLIMI I INSPEKTIMIT</b>	<b>DATA E INSPEKTIMIT</b>
1.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riadhesimit	29.01.2015
2.	I.E.V.P. Vaqar	Vizitë Monitoruese	24.02.2015
3.	Shërbimi i Psikiatrisë pranë QSU “Nënë Tereza” Tiranë	Vizitë Monitoruese	04.03.2015
4.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	18.03.2015
5.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	19.03.2015
6.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	20.03.2015
7.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Hetim	24.03.2015
8.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riadhesimit	24.03.2015
9.	Instituti i të Miturve Kavajë	Vizitë Monitoruese	26.03.2015
10.	I.E.V.P Durrës	Vizitë Monitoruese	09.04.2015
11.	I.E.V.P “ Mine Peza” (302)	Vizitë Monitoruese	21.04.2015
12.	I.E.V.P Zahari, Krujë	Vizitë Monitoruese	04.05.2015
13.	I.E.V.P. Drenovë, Korçë	Vizitë Monitoruese	07.05.2015
14.	I.E.V.P “ Ali Demi” (325), Tiranë	Vizitë Monitoruese	15.05.2015
15.	I.E.V.P Peqin	Vizitë Monitoruese	27.05.2015
16.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riadhesimit	28.05.2015
17.	Drejtoria e Policisë Vendore Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
18.	Komisariati i Policisë Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
19.	Komisariati i Policisë Shijak	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
20.	Drejtoria e Policisë Kufitare Durrës	Vizitë Monitoruese	28.05.2015
21.	Komisariati i Policisë Krujë	Vizitë Monitoruese	29.05.2015
22.	Drejtoria e Policisë Vendore Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
23.	Komisariati i Policisë Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
24.	Komisariati i Policisë Malësi e Madhe	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
25.	Drejtoria e Policisë Kufitare Han i Hotit, Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
26.	Spitali Psikiatrik Shkodër	Vizitë Monitoruese	02.06.2015
27.	Komisariati i Policisë Pukë	Vizitë Monitoruese	03.06.2015
28.	Reparti Ushtarak 1010 Vau i Dejës Shkodër	Vizitë Monitoruese	03.06.2015
29.	Komisariati i Policisë Mirditë	Vizitë Monitoruese	10.06.2015
30.	I.E.V.P Shën Koll Lezhë	Vizitë Monitoruese	11.06.2015
31.	Drejtoria e Policisë së Vendore Lezhë	Vizitë Monitoruese	12.06.2015
32.	Komisariati i Policisë Lezhë	Vizitë Monitoruese	12.06.2015
33.	Komisariati i Policisë Laç	Vizitë Monitoruese	12.06.2015
34.	Drejtoria e Policisë Vendore Dibër	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
35.	Komisariati i Policisë Peshkopi	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
36.	Komisariati i Policisë Burrel	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
37.	Komisariati i Policisë Bulqizë	Vizitë Monitoruese	15.06.2015
38.	I.E.V.P. Kukës	Vizitë Monitoruese	16.06.2015
39.	I.E.V.P. Tropojë	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
40.	Drejtoria e Policisë Vendore Kukës	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
41.	Komisariati i Policisë Kukës	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
42.	Komisariati i Policisë Has	Vizitë Monitoruese	17.06.2015
43.	Komisariati i Policisë Tropojë	Vizitë Monitoruese	18.06.2015
44.	I.E.V.P. “Mine Peza”, Tiranë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
45.	Institucioni i Veçantë Shëndetësor i Burgjeve, Tiranë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
46.	I.E.V.P. “Ali Demi”, Tiranë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
47.	I.E.V.P. Durrës	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
48.	I.E.V.P. Rrogozhinë	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
49.	I.E.V.P. Peqin	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
50.	I.E.V.P. Elbasan	Monitorim I procesit zgjedhor	21.06.2015
51.	Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë	Hetim	30.06.2015
52.	Komisariati i Policisë Nr. 2, Tiranë	Hetim	01.07.2015
53.	I.E.V.P. Peqin	Hetim	08.07.2015
54.	I.E.V.P. “Shën Koll”, Lezhë	Hetim	13.07.2015
55.	I.E.V.P. Fier	Hetim	16.07.2015
56.	I.E.V.P. “Mine Peza”, Tiranë	Hetim	21.07.2015
57.	I.E.V.P. “Mine Peza”, Tiranë	Hetim	22.07.2015
58.	I.E.V.P. “Mine Peza”, Tiranë	Hetim	24.07.2015

59.	I.E.V.P. "Shën Koll", Lezhë	Hetim	27.07.2015
60.	I.E.V.P. Zahari, Krujë	Hetim	30.07.2015
61.	Komisariati i Policisë Shkodër	Hetim	08.08.2015
62.	I.E.V.P. Drenovë, Korçë	Hetim	12.08.2015
63.	Komisariati i Policisë Pogradec	Hetim	17.08.2015
64.	Komisariati i Policisë Nr. 5, Tiranë	Hetim	25.08.2015
65.	Komisariati i Policisë Kuçovë	Vizitë Monitoruese	02.09.2015
66.	Komisariati i Policisë Çorovodë	Vizitë Monitoruese	02.09.2015
67.	Drejtoria e Policisë Vendore Berat	Vizitë Monitoruese	02.09.2015
68.	Komisariati i Policisë Berat	Vizitë Monitoruese	03.09.2015
69.	IEVP Berat	Vizitë Monitoruese	03.09.2015
70.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	04.09.2015
71.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	15.09.2015
72.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	16.09.2015
73.	Qendra e Azilkërkuesve, Babrru	Vizitë Monitoruese	17.09.2015
74.	Qendra e Mbyllur për të Huaj, Kareç	Vizitë Monitoruese	17.09.2015
75.	Qendra Kombëtare Pritëse e Viktimave të Trafikut, Linzë të	Vizitë Monitoruese	25.09.2015
76.	I.E.V.P Burrel	Vizitë Monitoruese	28.09.2015
77.	Drejtoria e Policisë Kufitare Korçë (Kapshticë)	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
78.	Komisariati i Policisë Devoll	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
79.	Komisariati i Policisë Ersekë	Vizitë Monitoruese	30.09.2015
80.	Drejtoria e Policisë Vendore Korçë	Vizitë Monitoruese	01.10.2015
81.	Komisariati i Policisë Korçë	Vizitë Monitoruese	01.10.2015
82.	Komisariati i Policisë Pogradec	Vizitë Monitoruese	01.10.2015
83.	I.E.V.P Tepelenë	Vizitë Monitoruese	05.10.2015
84.	Komisariati i Policisë Përmet	Vizitë Monitoruese	05.10.2015
85.	Pika Kufitare "Tre urat"	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
86.	I.E.V.P Sarandë	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
87.	Komisariati i Policisë Sarandë	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
88.	Komisariati i Policisë Delvinë	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
89.	Pika Kufitare "Qafë Botë"	Vizitë Monitoruese	06.10.2015
90.	Drejtoria e Policisë Vendore Gjirokastrë	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
91.	Komisariati i Policisë Gjirokastrë	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
92.	Drejtoria Rajonale e Kufirit Gjirokastrë	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
93.	Komisariati i Policisë Tepelenë	Vizitë Monitoruese	07.10.2015
94.	I.E.V.P Fier	Vizitë Monitoruese	09.10.2015
95.	Komisariati i Policisë Peqin	Vizitë Monitoruese	14.10.2015
96.	Komisariati i Policisë Gramsh	Vizitë Monitoruese	14.10.2015
97.	Komisariati i Policisë Librazhd	Vizitë Monitoruese	14.10.2015
98.	Komisariati i Policisë Kufitare, Rinas	Monitorim i operacioneve të riatdhesimit	14.10.2015
99.	IEVP Elbasan	Vizitë Monitoruese	15.10.2015
100.	Spitali Psikiatrik Elbasan	Vizitë Monitoruese	16.10.2015
101.	Drejtoria e Policisë Vendore Elbasan	Vizitë Monitoruese	16.10.2015
102.	Komisariati i Policisë Elbasan	Vizitë Monitoruese	16.10.2015
103.	I.E.V.P. Rrogozhinë	Vizitë Monitoruese	21.10.2015
104.	Drejtoria e Policisë Kufitare Kukës	Vizitë Monitoruese	20.10.2015
105.	Drejtoria e Policisë Kufitare Dibër	Vizitë Monitoruese	20.10.2015
106.	I.E.V.P Vlorë	Vizitë Monitoruese	22.10.2015
107.	Drejtoria e Policisë Vendore Vlorë	Vizitë Monitoruese	22.10.2015
108.	Komisariati i Policisë Vlorë	Vizitë Monitoruese	22.10.2015
109.	Spitali Psikiatrik Vlorë	Vizitë Monitoruese	23.10.2015
110.	Drejtoria e Policisë Kufitare Vlorë	Vizitë Monitoruese	23.10.2015
111.	Drejtoria e Policisë Vendore Tiranë	Hetim	02,03.11.2015
112.	Drejtoria e Policisë Vendore Fier	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
113.	Komisariati i Policisë Fier	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
114.	Komisariati i Policisë Lushnje	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
115.	Komisariati i Policisë Mallakastër	Vizitë Monitoruese	10.11.2015
116.	IEVP Kosovë- Lushnje	Vizitë Monitoruese	11.11.2015
117.	Policia Ushtarake Sauk, Tiranë	Vizitë Monitoruese	18.11.2015
118.	Komisariati i Policisë Nr.3, Tiranë	Vizitë Monitoruese	19.11.2015
119.	Komisariati i Policisë Nr.5, Tiranë	Vizitë Monitoruese	19.11.2015
120.	Komisariati i Policisë Nr.1, Tiranë	Vizitë Monitoruese	23.11.2015
121.	Komisariati i Policisë Nr.4, Tiranë	Vizitë Monitoruese	23.11.2015
122.	Komisariati i Policisë Nr.2, Tiranë	Vizitë Monitoruese	24.11.2015
123.	IVSHB Tiranë	Vizitë Monitoruese	25.11.2015
124.	IEVP " Ali Demi" (325)	Hetim	07.12.2015



125.	Komisariati i Policisë Nr.5, Tiranë	Hetim	10.12.2015
126.	Komisariati i Policisë Nr.6, Tiranë	Hetim	10.12.2015
127.	Komisariati i Policisë Rinas	Vizitë Monitoruese	10.12.2015
128.	IEVP Berat	Vizitë Monitoruese	14.12.2015
129.	IEVP "Jordan Misja"	Vizitë Monitoruese	15.12.2015
130.	IEVP Fushë-Krujë	Vizitë Monitoruese	28.12.2015